

EUROPA 2030

PROGRAMI ZGJEDHOR 2024 - 2028



**FRONTI
EUROPIAN**



FRONTI EUROPIAN	2
EUROPA 2030.....	10
1. NJË KRYEMINISTËR PËR TË GJITHË	13
1.1. QEVERISJE E MIRË	14
1.2. BARAZI, KONSENSUS DHE KOHEZION	15
1.3. SUNDIM I LIGJIT DHE SË DREJTËS	17
1.4. LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR	21
1.5. ADMINISTRATË PROFESIONALE DHE SHËRBIME PUBLIKE TE DIGJITALIZUARA	25
1.6. RENDI DHE SIGURIA	32
2. JO RUSISË, PO EUROPËS	36
2.1. INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN.....	37
2.2. BASHKËPUNIMI RAJONAL.....	40
2.4. GJEOPOLITIKA DHE NATO-JA	42
2.4. PARTNERITET DHE DIALOG STRATEGJIK ME SHBA-NË	44
3. MARRËVESHJE E KONSENSUSIT EKONOMIK.....	45
PARTNERITET NË POLITIKBËRJE	45
3.1. EKONOMI KONKURRUESE DHE TRANSFORMIM DIGJITAL	47
3.1.1. KONTEKSTI EKONOMIK 2020-2023	49
3.1.2. RRIJTE E PËRSHPEJTUAR DHE FINANCA TË QËNDRUESHME.....	50
3.1.3. MJEDIS I MIRË PËR BIZNES DHE EKONOMI KONKURRUESE	57
3.1.4. DIGJITALIZIMI I EKONOMISË DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE	70
3.2. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE TRANSFORMIMI I GJELBËR.....	74
3.2.1. AMBIENTI I PASTËR DHE I SHËNDETSHËM.....	75
3.2.2. ENERGJIA E SIGURT DHE E RIPËRTËRITSHME	79
3.2.3. BUJQËSIA MODERNE DHE USHQIMI I SIGURT	84
3.3. INFRASTRUKTURA MODERNE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL.....	90
3.3.1. TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMI MODERN	91
3.3.2. ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL.....	95
3.3.3. TURIZMI PËRFAQËSUES.....	103
3.4. KAPITALI NJERËZOR DHE CILËSIA E JETËS	106
3.4.1. ARSIMI CILËSOR	107
3.4.2. SHËNDETËSI MODERNE	119
3.4.3. MIRËQENIE SOCIALE E QËNDRUESHME	125
3.5. RINI AKTIVE DHE SHOQËRI E BARABARTË	133
3.5.1. DIVERSITET DHE BARAZI	134
3.5.2. KULTURË PËRFAQËSUESE	134
3.5.3. RINI AKTIVE.....	140
3.5.4. SPORT DHE REKREACION	145
3.5.5. AKTIVIZËM QYTETAR.....	147
3.5.6. FAMILJA BËRTHAMA E SHOQËRISË.....	150
3.5.7. DEMOGRAFIA, DIASPORA DHE MIGRACIONI	151
PROJEKTE	155

FRONTI EUROPIAN

MARREVESHJET E KOALICIONIT FRONTI EUROPIAN

*Ali Ahmeti, Bashkimi Demokratik për Integrim
Skender Rexhepi, Lëvizja Populli
Shkup, 19 Mars, 2024*

*Ali Ahmeti, Bashkimi Demokratik për Integrim
Menduh Thaçi, Partia Demokratike Shqiptare
Arianit Hoxha, Partia Demokratike Europiane
Skender Rexhepi, Lëvizja Populli
Tetovë, 25 Mars, 2024*

*Ali Ahmeti, Bashkimi Demokratik për Integrim
Dr. Beycan Ilyas, Partia Demokratike e Turqëve të Maqedonisë
Gostivar, 27 Mars, 2024*

*Ali Ahmeti, Bashkimi Demokratik për Integrim
Fatima Osmanovska, Unioni i Romëve
Shkup, 28 Mars, 2024*

*Ali Ahmeti, Bashkimi Demokratik për Integrim
Salih Murat, Lëvizja e Turqëve të Maqedonisë për Drejtësi dhe Demokraci
Prof. Dr. Süleyman Baki, Lëvizja e Turqëve të Maqedonisë për Drejtësi dhe Demokraci
Shkup, 29 Mars, 2024*

*Ali Ahmeti, Bashkimi Demokratik për Integrim
Ziadin Sela, Aleanca për Shqiptarët
Gostivar, 31 Mars, 2024*

*Ali Ahmeti, Bashkimi Demokratik për Integrim
Munir Kolashinac, Lidhja Demokratike Boshnjake
Shkup, 2 Prill, 2024*

Duke respektuar vullnetin unanim të qytetarëve shqiptarë dhe shumicës dërmuese të qytetarëve tjerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Duke riafirmuar përcaktimet programore dhe strategjike të shqiptarëve dhe të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Të udhëhequr nga përcaktimet rilindase shqiptare dhe ideali kombëtar shqiptar,

Të angazhuar për paqë, stabilitet, siguri dhe bashkëpunim në vend dhe rajon, marrëdhënie të shëndosha ndëretnike dhe ndërfqinjësore, sundim të ligjit, drejtësi joselektive, luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zhvillim ekonomik dhe mirëqenie shoqërore,

Duke nënvizuar të arriturat që nga Marrëveshja e Ohrit, Marrëveshja e Prespës, Marrëveshja e fqinjësisë së mirë, anëtarësimi në NATO dhe fillimi i bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian,

Të vetëdëshëm që në vazhdimësi dhe të bashkuar mund të bëhet akoma më shumë dhe të punohet edhe më mirë si dhe më me përkushtim në të gjitha nivelet,

Të përcaktuar, pa asnjë alternativë tjetër, për integrim në Bashkimin Evropian,

Të shqetësuar për kërcënimet e vazhdueshme dhe të orkestruara ndaj përcaktimeve tona euro-amerikane si dhe përpjekjet për të devijuar rrugëtimin tonë evropian,

Kryetarët e partive politike zotohen për:

MARRËVESHJE KOALICIONIMI

Ne, të poshtënëshkruarit:

Konfirmojmë përcaktimet politike si dhe vlerat demokratike të theksuara në Preambulën e Deklaratës Politike të Frontit Evropian dhe zotohemi për bashkëpunim koalicionues për zgjedhjet Presidenciale të 24 prillit dhe ato parlamentare të 8 majit të vitit 2024.

Obligojmë të gjitha organet tona partiake që të veprojnë në përputhje me detyrimet e paracaktuara në këtë Marrëveshje Koalicioni dhe në programin e harmonizuar politik,

Udhëzojmë organet tona partiake që të vijojnë kursin Euro-Amerikan si alternativë e vetme për të ardhmën e përbashkët të Maqedonisë së Veriut dhe të angazhohen për zbatim të plotë të normave dhe të frymës së Marrëveshjes së Ohrit, Marrëveshjes së Prespës dhe atë për fqinjësi të mirë dhe mbylljes së të gjitha çështjeve të hapura me fqinjët,

Angazhohemi për vijimin dhe thellimin e marrëdhënieve institucionale vëllazërore me autoritetet e Tiranës dhe të Prishtinës dhe avancimin e lidhjeve politike dhe infrastrukturore me Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës si dhe largim të kufijve mes nesh,

Konsiderojmë që përfshirja jonë në procesin integruar dhe të ndryshimeve kushtetuese është e patjetërsueshme dhe paraqet garancë për zgjidhje të qëndrueshme dhe të suksesshme,

Synojmë sundim të drejtë dhe të barabartë të ligjit, drejtësi joselektive si dhe transparencë dhe paanshmëri absolute të gjyqësorit,

Garantojmë partneritet dhe mbështetje ndaj organeve më të larta të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar,

Promovojmë vlerën e zhvillimit të demokracisë konsensuale në përputhje me frymën e Marrëveshjes së Ohrit dhe Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Konfirmojmë që partnerët koalicionues qeverisës duhet të përcaktohen nga vullneti politik i dy komuniteteve më të mëdha në vend, shqiptarëve dhe maqedonasve, të shprehur në zgjedhje të lira, fer dhe demokratike, që mundëson konsensualitet dhe përfaqësim të drejtë në vendimmarrje,

Konstatojmë që legjitimiteti i Presidentit duhet të buron nga shumica e dy të tretave, e konfirmuar edhe nga shumica e Badinterit në Kuvend për të siguruar konsensualitet të plotë shtetëror dhe ndëretnik,

Vlerësojmë se rreziku rus në vend dhe rajon është faktor destabilizues që ka përfshirë ekonominë tonë, infrastrukturën kritike, partitë politike, mediat, komunitetet fetare, shoqërinë civile dhe synon të destabilizojë shoqërinë tonë të brishtë multietnike, multifetare dhe multikulturore për të promovuar një efekt domino në të gjithë rajonin.

Respektojmë lirinë e shprehjes dhe të mediave që duhet të përcillet me vetëdije të lartë të përgjegjësisë shoqërore edhe nga bartësit e këtij procesi,

Promovojmë zhvillimin ekonomik dhe shanse të barabarta si modeli më i drejtë i mirëqenies në një shoqëri multietnike, e cila do të arrihet nëpërmjet të rritjes ekonomike të shpejtë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Nxisim integrimin e diasporës në ekonominë e vendit sepse ajo paraqet një potencial të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, ndërsa integrimi ekonomik rajonal, evropian dhe global do të ndihmojnë në krijimin e tregjeve të reja duke krijuar politika të liberalizimit ekonomik dhe ndërtimit të projekteve strategjike të infrastrukturës së transportit, energjetikës dhe komunikimit informatik në korridorin tetë dhe dhjetë, si dhe lidhjes me vendet fqinje.

Vlerësojmë nevojën për vazhdim të përfshirjes dhe kohezionit nëpërmjet të qasjes së barabartë në financat publike, zhvillimit lokal dhe rajonal të balancuar, si dhe barazisë sociale, duke mundësuar arsim dhe shëndetësi cilësore për të gjithë, por edhe zhvillim të sportit dhe kulturës që do të mundësojë kohezion ekonomik, social dhe territorial. Gjithashtu, zvogëlimi i mëtejshëm i papunësisë, duke hapur vende të reja të punës sidomos për rininë dhe lufta kundër varfërisë do të mundësojë rritje përfshirëse ashtu që benefitet e zhvillimit ekonomik t'i përfshiejnë të gjithë.

Përkrahim përpjekjet për fuqizimin dhe mbështetjen e arsimit, shkencës, inovacionit dhe standardit të studentëve si dhe reformat në arsim në drejtim të ngritjes së cilësisë si një nga shtyllat kryesore të shoqërisë, promovimin e ekselencës dhe sistematizimin e kuadrove,

Ftojme në partneritet të gjitha forcat progresive shoqërorenë vend që ndajnë vlerat e njejta me ne që të na bashkangjiten në përpjekjet tona për një shoqëri tolerante, demokratike, me siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm, me marrëdhënie të shëndosha ndëretnike, me marrëdhënie të mira ndërfaqinjësore dhe për tejkalim të çështjeve të hapura, për integrim të plotë në Bashkimin Evropian si dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenie shoqërore,

Sigurojmë qytetarët që nuk do të rreshtim së punuari në drejtim të realizimit të zotimeve zgjedhore, programore dhe kombëtare në përputhje me besimin dhe interesat e popullit shqiptar dhe të të gjithë qytetarëve në Maqedoninë e Veriut.

Kuzey Makedonya Cumhuriyeti vatandaşlarının bütünsel iradesini göz önünde bulundurarak,

Kuzey Makedonya Cumhuriyeti'nin tüm vatandaşlarının programsal ve stratejik kararlılıklarını yeniden tasdikleyerek,

Ülkede ve bölgede barış, istikrar, güvenlik ve iş birliğini, etnik gruplar ve komşular arası sağlıklı ilişkileri, hukukun üstünlüğünü, objektif adaleti, yolsuzluk ve organize suçla mücadeleyi, sosyal refaha bağlı ekonomik kalkınmayı taahhüt ederek,

Ohri Anlaşması, Prespa Anlaşması, İyi Komşuluk Anlaşması, NATO üyeliği ve Avrupa Birliği üyeliğine yönelik müzakerelerin başlamasından bu yana elde edilen kazanımları vurgulayarak,

Her düzeyde, daha fazla özveriyle, sürekli ve birlik içinde daha fazlasının, daha iyi çalışmaların yapılabileceğinin bilincinde olarak,

Başka alternatifi olmaksızın Avrupa Birliği'ne entegrasyon konusunda kararlı olarak, Avrupa-Amerika ve dost ülkelere yönlü kararlılığımıza yönelik süregelen ve planlanmış tehditlerden ve Avrupa entegrasyon yolculuğumuzdan sapmaya yönelik girişimlerden endişe duyarak,

Temsilcileri karşılıklı olarak şunları taahhüt eder:

KOALİSYON ANLAŞMASI

Aşağıda imzası olan bizler:

Avrupa Cephesi Siyasi Bildirgesi'nin Giriş bölümünde vurgulanan siyasi kararlılıkların yanı sıra demokratik değerleri de onaylayarak, 24 Nisan Cumhurbaşkanlığı seçimleri ve 8 Mayıs 2024 parlamento seçimleri için stratejik koalisyon iş birliği taahhüdünde bulunuyoruz.

Tüm parti organlarımızı, bu Koalisyon Anlaşması ve uyumlu siyasi programda, önceden belirlenen yükümlülüklerle uygun hareket etmekle yükümlü tutuyoruz,
Parti organlarımıza, Kuzey Makedonya'nın ortak geleceği için tek alternatif olarak Avrupa rotasını takip etmeleri ve Ohri Anlaşması, Prespa Anlaşması, İyi Komşuluk Anlaşması ve komşu ülkelerle olan tüm açık sorunları çözümlenmesi yanı sıra yakınlaşma normlarının ve ruhunun tam olarak uygulanmasına bağlı kalmaları talimatını veriyoruz,
Toplumlarımız arasında stratejik dostluğa bağlılık taahhüdünü veriyoruz,

Entegrasyon ve anayasa değişikliği sürecine katılımımızın vazgeçilmez olduğunu ve bunun istikrarlı ve başarılı çözümlerin garantisi olduğunu düşünüyoruz,

Adil ve eşit hukukun üstünlüğünü, seçici olmayan adaleti, yargının şeffaflığını ve mutlak tarafsızlığını hedefliyoruz,
Yolsuzluk ve organize suçla mücadelede en yüksek yargı organlarıyla ortaklık ve desteği garanti ediyoruz,
Ohri Anlaşması ve Kuzey Makedonya Cumhuriyeti Anayasası'nın ruhuna uygun olarak uzlaşmaya dayalı demokrasiyi geliştirmenin değerini destekliyoruz,

Mutlak devlet ve etnik gruplar arası uzlaşmayı sağlamak için, Cumhurbaşkanının meşruiyetinin üçte ikilik bir çoğunluktan gelmesi gerektiği ve bunun Meclis'teki Badenter çoğunluğu tarafından da onaylanması gerektiği sonucuna varıyoruz,

Rusya'nın ülkeye ve bölgeye yönelik tehdidinin ekonomimizi, kritik altyapımızı, siyasi partilerimizi, medyamızı, dini topluluklarımızı ve sivil toplumu kapsayan istikrarsızlaştırıcı bir faktör olduğunu ve toplumun tüm katmanlarında domino etkisini teşvik etmeyi hedefleyen kırılgan çok etnikli, çok dinli ve çok kültürlü toplumumuzu istikrarsızlaştırmayı amaçladığını değerlendiriyoruz,

Bu sürecin yürütücüleri tarafından dahi yüksek bir sosyal sorumluluk bilinciyle aktarılması gereken ifade ve medya özgürlüğüne saygı duyuyoruz,

Çok etnik gruptan oluşan bir toplumda hızlı, sürdürülebilir ve kapsayıcı ekonomik büyüme yoluyla ulaşılabilecek en adil refah modeli olarak ekonomik kalkınmayı ve fırsat eşitliğini destekliyoruz.

Ekonomik kalkınma için önemli bir potansiyeli temsil eden diasporanın ülke ekonomisine entegrasyonunu destekliyor, bölgesel, Avrupa ve küresel ekonomik entegrasyon, ekonomik liberalizasyon politikaları oluşturarak 8. ve 10. koridorda ulaştırma altyapısı, enerji ve BT (Bilişim Teknolojisi) iletişimi ile komşu ülkelerle bağlantıya ilişkin stratejik projeler inşa ederek yeni pazarlar yaratılmasına yardımcı olacaktır.

Kamu maliyesine eşit erişim, dengeli yerel ve bölgesel kalkınma, sosyal eşitlik, herkes için kaliteli eğitim ve sağlık hizmetleri sağlanması ve aynı zamanda ekonomik, sosyal olarak sağlayacak spor ve kültürün geliştirilmesi yoluyla sürekli katılım ve uyum ihtiyacını yineliyoruz. Ayrıca işsizliğin daha da azaltılması, özellikle gençlere yönelik yeni iş imkanlarının açılması ve yoksullukla mücadele, ekonomik kalkınmanın faydalarının herkesi kapsamaları için kapsayıcı büyümeyi mümkün kılacaktır.

Топлумун темел сүтунlarından biri olan kalitenin yükseltilmesi, mükemmelliğin teşvik edilmesi ve kadroların sistemleştirilmesi açısından eğitim, bilim, yenilikçilik ve öğrenci standartlarının yanı sıra eğitim reformlarının güçlendirilmesi ve desteklenmesine yönelik çabaları destekliyoruz,

Ülkede bizimle aynı değerleri paylaşan tüm ilerici toplumsal güçleri, kalıcı güvenlik ve istikrarın olduğu, etnik gruplar arası sağlıklı ilişkilerin olduğu, açık olan sorunların aşılması, Avrupa Birliği'ne tam entegrasyonun yanı sıra sürdürülebilir ekonomik kalkınma ve sosyal refah için iyi komşuluk ilişkilerinin olduğu hoşgörülü, demokratik bir toplum kurma çabalarımıza ortak olarak katılmaya davet ediyoruz.

Arnavut toplumunun ve Kuzey Makedonya'daki tüm vatandaşların inanç ve çıkarları doğrultusunda seçimle ilgili programsal ve ulusal taahhütlerin gerçekleştirilmesi için çalışmayı bırakmayacağımıza dair vatandaşlara güvence veriyoruz.

Почитувајќи ја едногласната волја на граѓаните на Република Северна Македонија,
Потврдувајќи ги програмските и стратешките определби на сите граѓани на Република Северна Македонија,

Посветени на мир, стабилност, безбедност и соработка во земјата и регионот, на здрави меѓуетнички и меѓусоседски односи, владеење на правото, неселективна правда, борба против корупцијата и организираниот криминал, економски развој и социјална благосостојба,

Истакнувајќи ги достигнувањата од Охридскиот Договор, Договорот од Преспа, Договорот за добрососедство, членството во НАТО и почетокот на преговорите за членство во Европската Унија,

Свесни дека континуирано и обединети може да се направи повеќе и да се работи уште подобро и со поголема посветеност на сите нивоа,
Решени, без ниту една друга алтернатива, за интеграција во Европската Унија,

Загрижени за постојаните и оркестрирани закани за нашите евро-американски определби, како и обидите да го попречат нашиот европски пат,

Претседателите на политичките партии, едногласно се заложиле за:

КОАЛИЦИСКИ ДОГОВОР

Ние, долупотпишаните:

Ги потврдуваме политичките определби како и демократските вредности истакнати во Преамбулата на политичката декларација на Европскиот фронт и се залагаме за стратешка коалициона соработка за претседателските избори на 24 април и парламентарните избори на 8 мај 2024 година.

Ги обврзуваме сите наши партиски тела да постапуваат согласно обврските однапред утврдени во овој Коалициски договор и во усогласената политичка програма,

Ги упатуваме нашите партиски тела да го следат Евро-Американскиот курс како единствена алтернатива за заедничката иднина на Северна Македонија и да се заложат за целосно спроведување на нормите и духот на Охридскиот договор, Договорот од Преспа и добрососедството и затворањето. сите отворени прашања со соседите,

Се обврзуваме за стратешко пријателство меѓу нашите народи,

Сметаме дека нашето вклучување во процесот на интеграција и уставни измени е неопуѓливо и претставува гаранција за стабилни и успешни решенија,
Наша цел е фер и еднакво владеење на правото, неселективна правда, како и транспарентност и апсолутна непристрасност на судството,
Гарантираме партнерство и поддршка на највисоките органи на правдата во борбата против корупцијата и организираниот криминал,
Ја промовираме вредноста на развивање на консензуалната демократија во согласност со духот на Охридскиот договор и Уставот на Република Северна Македонија,

Констатираме дека легитимитетот на Претседателот треба да произлезе од двотретинско мнозинство, потврдено и од мнозинството на Баденер во Собранието за да се обезбеди целосна државна и меѓуетничка консензуалност,

Оценуваме дека руската закана за земјата и регионот е дестабилизирачки фактор кој ја опфатил нашата економија, критичната инфраструктура, политичките партии, медиумите, верските заедници, граѓанското општество и има за цел да ја дестабилизира нашата кривка мултиетничка, мултирелигиозна и мултикултурна општеството да промовира домино ефект во целиот регион,

Ја почитуваме слободата на изразување и медиумите, кои мора да бидат пренесени со висока свест за општествена одговорност дури и од носителите на овој процес,

Промовираме економски развој и еднакви можности како најправеден модел на благосостојба во мултиетничко општество, што ќе се постигне преку брз, одржлив и инклузивен економски раст,

Ја поттикнуваме интеграцијата на дијаспората во економијата на земјата бидејќи таа претставува важен потенцијал за економски развој, додека регионалната, европската и глобалната економска интеграција ќе помогне да се создадат нови пазари преку креирање политики за економска либерализација и градење стратешки инфраструктурни проекти транспорт, енергија и ИТ комуникација во Коридорот осум и десет, како и поврзувањето со соседните земји,

Ја цениме потребата од континуирана инклузија и кохезија преку еднаков пристап до јавните финансии, рамномерен локален и регионален развој, како и социјална еднаквост, овозможување квалитетно образование и здравје за сите, но и развој на

спортот и културата кои ќе овозможат економски, социјални и територијална кохезија. Исто така, натамошното намалување на невработеноста, отворањето нови работни места особено за младите и борбата против сиромаштијата ќе овозможат инклузивен раст, така што придобивките од економскиот развој ги вклучуваат сите,

Ги поддржуваме напорите за зајакнување и поддршка на образованието, науката, иновациите и стандардот на студентите, како и реформите во образованието во смисла на подигање на квалитетот како еден од главните столбови на општеството, промовирање на извонредноста и систематизирање на кадрите,

Ги покануваме во партнерство сите прогресивни општествени сили во земјата кои делат исти вредности со нас да ни се придружат во нашите напори за толерантно, демократско општество, со одржлива безбедност и стабилност, со здрави меѓуетнички односи, со добрососедски односи и за надминување на отворените прашања, за целосна интеграција во Европската унија како и за одржлив економски развој и социјална благосостојба,

Ги уверуваме граѓаните дека нема да престанеме да работиме кон остварување на изборните, програмските и националните определби во согласност со довербата и интересите на албанскиот народ и на сите граѓани во Северна Македонија.



EUROPA 2030

1. NJË KRYEMINISTËR PËR TË GJITHË

Fushata e vitit 2020 u fokusua kryesisht në përkatësinë etnike të kandidatit për të thyer mbetjet e regjimit monist me politika përjashtuese. Qeverisja jonë gjatë viteve 2020-2024 dëshmoi se mund të qeverisim me mbarë vendin me përgjegjësi dhe në emër të të gjithë qytetarëve, prandaj këtë herë kandidati do të jetë Kryeministër i të gjitha komuniteteve, i të gjithë qytetarëve, duke apeluar për vota në të gjithë territorin.

Barazia e të gjithë qytetarëve, demokracia konsensuale dhe kohezioni shoqëror do të mundësojnë stabilitet politik dhe qëndrueshmëri institucionale me mundësi të barabarta pavarësisht përkatësisë etnike, fetare, gjuhësore ose kulturore.

Sundimi i ligjit, drejtësia dhe qeverisja e mirë garantojnë lojalitet dhe përgjegjësi të njëjtë për çdo qytetar para ligjit. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të jetë pa kompromis, tolerancë zero dhe veting për të gjithë bartësit e funksioneve publike, respektivisht atij ligjvënës, ekzekutiv, në gjyqësor, prokurori dhe për çdo funksion tjetër në sektorin publik, në nivel qendror dhe lokal, të emëruar ose të zgjedhur.

Administrata duhet të jetë profesionale dhe efikase në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë. Riorganizim, racionalizim dhe optimizim i sektorit publik, si dhe digjitalizim i shërbimeve publike me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike.

Rendi dhe siguria do të garantojnë stabilitet, paqe dhe qetësi për qytetarët. **Ne jemi NATO!**

2. JO RUSISË, PO EUROPËS

Pas zbatimit të suksesshëm të Marrëveshjes së Ohrit, anëtarësimit në NATO dhe hapjes së negociatave për anëtarësim në BE, synimi gjeostrategjik madhor i yni, i radhës për vendin është integrimi në Bashkimin Europian.

Ne duhet t'i bashkojmë të gjitha forcat progresive për të punuar dhe ta promovojmë integrimin europian, t'i miratojmë amendamentet teknike kushtetuese dhe t'i hapim klasterët negociues. Kjo ka rëndësi të madhe për stabilitetin, sigurinë, ekonominë, rininë, sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, demokracinë funksionale, qeverisjen e mirë etj. Kështu do ta parandalojmë largimin e të rinjve dhe do t'i rikthejmë ata që tashmë janë larguar.

Integrimi gjithashtu përfshin edhe standardet europiane në vend dhe rajon. Krijimi i standardeve europiane në vendin tonë dhe bashkëpunimi rajonal do të kontribuojnë në krijimin e paqes së qëndrueshme dhe zhvillimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Si anëtar i NATO-s dhe partner strategjik me SHBA-në, doemos duhet të parandalojmë ndikimin rus në vend, në mënyrë të drejtpërdrejt dhe tërthorazi. Me zhvillimet në Ukrainë,

Kosovë, Bosnjë, Mal të Zi, Moldavi, Gjeorgji, 5 Stanet (Kazakistani, Kirgistani, Taxhikistani, Turkmenistani dhe Uzbekistani) dhe Lindje të Mesme, është thelbësore që njerëzit ta shohin rrezikun e destabilizimit në Ballkan, mbi të gjitha në Maqedoninë e Veriut si një shoqëri multietnike, multikulturore dhe multireligjioze. **Jo, ndikimit Rus!**

3. MARRËVESHJE E KONSENSUSIT EKONOMIK

Pas Marrëveshjes së Ohrit, Marrëveshjes së Prespës dhe Marrëveshjes për Marrëdhënie të Mira Fqinjësore me Bullgarinë, ka ardhur koha për një marrëveshje të madhe, respektivisht për Marrëveshjen e Konsensusit Ekonomik (Marrëveshje Kornizë Ekonomike). Një Marrëveshje e konsensusit që do të arrihet me dialog të vazhdueshëm dhe partneritet midis politikbërësve, rregullatorëve, komunitetit të biznesit, sindikatave të punëtorëve, akademiasë dhe shoqërisë civile, si dhe organizatat e konsumatorëve, pensionistëve, rinia etj.

Marrëveshja e Konsensusit Ekonomik, gjegjësisht Marrëveshja Kornizë Ekonomike, synon të sigurojë kornizë për mundësi të barabarta në një ekonomi të lirë të tregut funksional me konkurrencë të ndershme dhe zhvillim të barabartë rajonal dhe infrastrukturë që krijon mundësi të barabartë në ekonomi për të gjithë pjesëmarrësit pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, kulturore, gjinore dhe grupe tjera të shoqërisë.

Marrëveshja e Konsensusit Ekonomik do të sigurojë konsensus politik dhe shoqëror për prioritetet zhvillimore, politikat dhe reformat kryesore që do të mundësojnë barazi sociale dhe mundësi të barabarta ekonomike për të gjithë, do të krijojnë optimizëm dhe do të nxisin rritje ekonomike të përshpejtuar (mbi 5% rritje e PBB-së në nivel vjetor), zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për standard dhe cilësi më të lartë të jetesës për të gjithë qytetarët.

Marrëveshja e Konsensusit Ekonomik bazohet në orientimin strategjik të vendit për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe përcaktimin euroatlantik të vendit në kontekstin gjeostrategjik, si anëtar në NATO dhe partner strategjik me SHBA-në.

Marrëveshja e Konsensusit Ekonomik si parakusht ka: stabilitetin politik, qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe administratën profesionale dhe efikase me shërbime publike të digjitalizuara.

Marrëveshja e Konsensusit Ekonomik synon këto prioritetet: Ekonomi konkurruese dhe transformim digjital; Zhvillim i qëndrueshëm dhe transformim i gjelbër; Infrastrukturë moderne dhe zhvillim i barabartë rajonal; Kapitali njerëzor dhe cilësia e jetës; si dhe Rini aktive dhe shoqëri e barabartë.

Ekonomia konkurruese dhe transformimi digjital nënkupton rritje të përshpejtuar dhe financa të qëndrueshme, mjedis të mirë për biznes, luftë kundër monopoleve dhe oligarkisë, luftë kundër ekonomisë joformale dhe sistem tatimor të drejtë dhe lojal, si dhe përkrahje ndaj biznesit, specializim të zgjuar dhe digjitalizim të ekonomisë.

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe transformimi i gjelbër do të përqendrohen në ambient të pastër dhe të shëndetshëm, energji të sigurtë, përtëritëse dhe efikasitet energjetik, si dhe bujqësi moderne dhe ushqim të qëndrueshëm.

Infrastruktura moderne dhe zhvillimi i barabartë rajonal janë kyçe për ekonomi të vogël dhe të hapur, gjegjësisht korridoret paneuropiane 8 dhe 10 vendosin në udhëkryq vendin tonë dhe krijojnë avantazhe konkurruese me transport dhe komunikim modern, autostrada e hekurudha. Modernizimi i infrastrukturës komunale, transportit dhe komunikimit do të jetë bazë për mundësi të barabarta zhvillimore në gjithë territorin e vendit. Turizmi përfaqësues do të jetë një mundësi e zhvillimit të ekonomisë lokale dhe nacionale duke u bazuar në pasuritë natyrore dhe kulturore.

Kapitali njerëzor dhe cilësia e jetës janë përcaktues në produktivitetin e ekonomisë nëpërmjet arsimit cilësor, shëndetësisë moderne dhe sigurisë sociale të qëndrueshme.

Rinia aktive dhe shoqëria e barabartë do të krijojnë një ambient tërheqës në vendin tonë me diversitet kulturor, mundësi të reja për rininë, sport dhe rekreacion, si dhe aktivizëm qytetar në të gjitha fushat e jetës. Gjithashtu, demografia, migracioni dhe diaspora do jenë në vëmendjen e të gjitha politikave ekonomike dhe sociale për të krijuar perspektiva të reja.

Marrëveshja e Konsensusit Ekonomik do ta bëjë Maqedoninë e Veriut vend të dëshiruar për jetesën e qytetarëve tanë, për mbajtjen e rinisë në vend dhe për rikthimin e diasporës, vend tërheqës për turistët dhe vend të preferuar për investitorët.

Ne jemi Europa!

1. NJË KRYEMINISTËR PËR TË GJITHË

- *Qeverisje e mirë*
 - *Transparencë, pjesëmarrje, efikasitet, përgjegjshmëri, llogaridhënie*
- *Barazi, konsensus dhe kohezion*
 - *Barazi e plotë për të gjithë dhe bashkëqeverisje*
 - *Demokraci konsensuale në vendimmarrje për çështje të rëndësishme*
 - *President konsensual i zgjedhur në parlament me 2/3 të votave dhe votim me Badenter*
 - *Një kryeministër për të gjithë*
 - *Respektim i diversitetit dhe kohezion shoqëror*
- *Sundim i ligjit dhe së drejtës*
 - *Gjyqësor i paanshëm dhe i pavarur*
 - *Gjyqësor efikas dhe me integritet*
- *Luftë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar*
 - *Veting të politikanëve, gjyqësorit, prokurorisë dhe organet e rendit dhe sigurisë*
 - *Veting për korrupsion, ndikimi rus dhe “shërbime” anti-shtetërore*
 - *Zero tolerancë dhe qasje sistemore*
 - *Përgjegjësi individuale dhe llogaridhënie*
- *Administratë profesionale dhe shërbime publike të digjitalizuara*
 - *Digjitalizim i proceseve dhe shërbimeve publike*
 - *Identitet digjital për qytetarët dhe subjektet juridike*
 - *Riorganizim dhe optimizim i organeve shtetërore në efikase dhe funksionale*
 - *Racionalizim dhe optimizim i administratës shtetërore*
 - *Përfaqësim i drejtë dhe adekuat në të gjitha nivelet e udhëheqjes në sektorin publik*
 - *Diversiteti në mjedisin e punës përparsi për organizatat në sektorin privat dhe qhpërinë civile*
- *Rendi dhe siguria*
 - *Organe të rendit dhe sigurisë që garantojnë lirinë, paqen dhe sigurinë për çdo qytetar dhe subjekt juridik*

1.1. QEVERISJE E MIRË

Qeverisja e mirë i referohet menaxhimit efektiv, efikas, të barabartë dhe etik të vendit, organizatave ose institucioneve me qëllim të promovimit të mirëqenies së qytetarëve. Qeverisja e mirë përfshin parime dhe praktika të ndryshme që do të sigurojnë që proceset e vendimmarrjes dhe zbatimit të jenë transparente, pjesëmarrëse, të orientuara nga konsensusi, të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse dhe të barabarta. Ja një vështrim më i afërt i attributeve kryesore të qeverisjes së mirë:

Transparenca. Proceset dhe veprimet e vendimmarrjes kryhen në mënyrë të hapur, duke u mundësuar palëve të interesuara që të kenë akses në informacionin që u nevojitet për kuptimin dhe monitorimin e operacioneve.

Llogaridhënia. Vendimmarrësit në Qeveri, në sektorin privat ose organizatat e shoqërisë civile janë përgjegjës ndaj publikut ose ndaj aktorëve të tyre institucionalë. Ekzistojnë mekanizma për t'i mbajtur ata përgjegjës për veprimet e tyre.

Pjesëmarrja. Të gjithë burrat dhe gratë duhet të kenë një zë në vendimmarrje, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet institucioneve të ndërmjetme legjitime që përfaqësojnë interesat e tyre. Pjesëmarrja duhet të jetë e informuar dhe e organizuar.

Sundimi i ligjit. Kornizat ligjore duhet të jenë të drejta dhe të zbatohen në mënyrë të paanshme, veçanërisht ligjet për të drejtat e njeriut.

Përgjegjshmëria. Institucionet dhe proceset përpiqen t'u shërbejnë të gjithë palëve të interesuara brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Konsensusi. Qeverisja e mirë ndërmjetëson interesa të ndryshme për të arritur një konsensus të gjerë mbi atë që është në interesin më të mirë të grupit dhe aty ku është e mundur, mbi politikat dhe procedurat.

Barazia dhe Përfshirja. Të gjithë anëtarët e një komuniteti ose grupi duhet të ndjejnë se kanë mundësi për ta përmirësuar ose ruajtur mirëqenien e tyre.

Efikasiteti dhe Efektiviteti. Proceset dhe institucionet krijojnë rezultate që i plotësojnë nevojat duke i shfrytëzuar sa më mirë burimet.

Vizioni Strategjik. Udhëheqësit dhe publiku kanë perspektivë të gjerë dhe afatgjatë për qeverisjen e mirë dhe zhvillimin njerëzor, së bashku me aspektin e ndjenjës se çfarë nevojitet për një zhvillim të tillë.

Këto parime do të na shërbejnë për ta drejtuar udhëheqjen e vendit në drejtim të sigurimit të prosperitetit, paqes dhe respektit për të drejtat e njeriut. Qeverisja e mirë është thelbësore për zhvillimin, pasi ajo krijon besimin mes qytetarëve dhe shtetit, nxit kohezionin shoqëror dhe avancoon rritjen e qëndrueshme ekonomike. Një perspektivë europiane për qytetarët dhe vendin tonë!

1.2. BARAZI, KONSENSUS DHE KOHEZION

Barazia e plotë e të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve, si dhe konsensusi politik në vendimmarrje në çështjet e rëndësishme, bashkë me kultivimin e kohezionit shoqëror në vendin tonë multietnik dhe me diversitetin kulturor do të janë baza e paqes, proseritetit dhe mirëqenies për çdo qytetar.

Marrëveshja e Ohrit dhe fryma e saj janë të padiskutueshme dhe të pamohueshme në kontributin për paqe dhe prosperitet. Parimet të cilat burojnë nga kjo Marrëveshje, do të ngelin si një ndër pikat kryesore në të cilat do ta fokusojmë vëmendjen, pavarësisht se pjesa normative tani më është koncipuar në të drejtën e brendshme. Kthim prapa nga të arriturat e Marrëveshjes së Ohrit nuk mund të ketë dhe do të vazhdohet që në pajtim me frymën e saj, të sigurohet barazi e plotë, konsensus politik dhe kohezion shoqëror brenda vendit me orientim euroatlantik, si anëtar të ardhshëm në Bashkimin Europian.

I. BARAZI E PLOTË DHE BASHKËPËRGJEGJËSI

Ne do t'i mbrojmë dhe avancojmë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe komuniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me garantimin, kultivimin dhe mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të të gjitha bashkësive në vend. Barazia e plotë do ta përforcojë lojalitetin ndaj shtetit, respektivisht bashkëpërgjegjësinë në vendimmarrje.

Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat, përdorimi i gjuhës dhe simboleve kombëtare e kulturore. Shumëkombësia e shoqërisë me diversitetin e vet pasuron trashëgiminë kulturore dhe njëherazi paraqet avantazh në integrimin rajonal dhe ndërkombëtar të vendit tonë. Ne angazhohemi për rritje të respektit dhe bashkëpunimit ndëretnik, ndërkulturor, ndërfetar edhe politik. Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat, përdorimi i gjuhës dhe simboleve kombëtare e kulturore do të vazhdojnë të jenë prioritet i veprimit politik në periudhën e ardhshme të qeverisjes.

Kryeministri i parë shqiptar. Një zotim i ynë programor në zgjedhjet e vitit 2020, të cilin tanimë e realizuam. Me këtë hodhëm poshtë mitin disadekadësh për vende apo pozita shtetërore të "rezervuara" ekskluzivisht për etnitete të caktuara. Kryeministri i parë shqiptar nuk është thjesht një funksion politik, por është një koncept dhe ideologji e barazisë. Një Kryeministër i cili unifikon dhe hap një epokë të re në historinë e Maqedonisë së Veriut, duke e bërë shtetin tonë një avangardë të vërtetë të barazisë dhe demokracisë në rajon dhe më gjerë. Ideja e Kryeministrit të parë shqiptar është ide unifikuese që synon t'i hedhë poshtë dogmatizimet dhe paragjykimet e trashëguara nga e kaluara dhe ta promovojë barazinë e vërtetë shoqërore.

Këtë konsistencë dhe pjekuri politike deri më tani e kemi dëshmuar edhe në të kaluarën duke marrë pozita kyçe që deri atëherë ishin të rezervuara dhe me të cilat asnjëherë nuk kishin udhëhequr shqiptarët, si psh: Kryeparlamentari, ministri i Mbrojtjes, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Financave, ministri i Punëve të Jashtme, kryetarët në gjykata dhe prokurori, etj.

ii. DEMOKRACI KONSENSUALE DHE FUNKSIONALE

Demokracia funksionale dhe participuese, me institucione kredibile dhe vendimmarrje konsensuale për çështjet e rëndësishme janë kyçe për një vend multietnik dhe me diversitet kulturor. Si vazhdimësi e barazisë së plotë është konsensusi për politika të qëndrueshme afatgjate dhe jetike për stabilitetin, paqen dhe prosperitetin e vendit.

Konsensualiteti. Një nga parakushtet për funksionim të mirëfilltë të shtetit dhe për një qeverisje të drejtë dhe demokraci funksionale është konsensusi i gjerë shoqëror. Besojmë se instrumenti i shumicës së dyfishtë apo parimi i Badinterit parandalon majorizimin dhe mbivotimin e komuniteteve joshumicë, si dhe siguron barazi në vendimmarrje mes dy komuniteteve më të mëdha në shtetin tonë.

Kryeministër për të gjithë. Pushteti ekzekutiv i bazuar në demokracinë e shumicës parlamentare ka pushtet dhe përgjegjësi në udhëheqjen e vendit. Pozicioni i Kryeministrit si pushtet më përgjegjës në politike më të lartë do të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve pavarësisht përketësisë së tyre etnike, kulturore, fetare, gjinisë etj., por do të jetë një Kryeministër për të gjithë. Pas konceptit për “Kryeministër të parë shqiptar”, koncepti aktual është “Një Kryeministër për të gjithë”.

Qeveria. Me qëllim të avancimit të funksionimit të Qeverisë me pushtet më të balancuar mbi baza etnike e kulturore dhe zgjerimit të konsensualitetit, do të angazhohemi për ngritjen e institucioneve dhe mekanizmave që do të sigurojnë konsensus në vendimmarrje dhe politikat qeveritare.

Kuvendi. Për ta avancuar bashkëpunimin dhe kohezionin mes komuniteteve dhe vendimmarrjen konsensuale do të angazhohemi për rritjen e efikasitetit të Kuvendit përmes mekanizmave për avancim të marrëdhënieve mes komuniteteve në organet e Kuvendit. Kuvendi si organ më i lartë ligjvënës do ta rrisë integritetin me rritje të efikasitetit të procedurave dhe ngritje të cilësisë së debatit politik.

Presidenti konsensual. Për ta avancuar edhe më tej idenë e barazisë dhe bashkëpërgjegjësisë në kapacitetin demokratik të shtetit, në mandatin që vjen do të angazhohemi që zgjedhja e Presidentit të shtetit të bëhet në Kuvend me 2/3 e votave dhe me votim të dyfishtë duke respektuar parimin e Badinterit. Kjo procedurë do ta bëjë Presidentin institucion unifikues dhe konsensual me çka i ndihmon demokracisë së vendit dhe rrit besueshmërinë si përfaqësues i të gjithëve.

iii. KOHEZION SHOQËROR NË DIVERSITETIN KULTUROR

Kohezioni shoqëror. Ka të bëjë me bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndëretnik, mirëbesimin mes komuniteteve, resektin e ndërsjellë kulturor duke krijuar harmoni në shoqëri. Kjo do të krijojë kushte për integrim të brendshëm sa më të madh dhe barazi mes të gjitha komuniteteve duke evituar marginalizimin dhe diferencimin.

1.3. SUNDIM I LIGJIT DHE SË DREJTËS

Shteti i së drejtës konceptohet si një parim i qeverisjes, sipas të cilit, individët, institucionet, subjektet publike dhe private, përfshirë edhe vet shtetin, janë përgjegjës përpara ligjeve, të cilët duhet të jenë të shpallura publikisht, të zbatueshme në mënyrë të njëjtë, të gjykuara në mënyrë të pavarur, dhe në pajtim me normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Sipas këtyre parimeve, do t'i ndërmarrim të gjitha masat e nevojshme, me qëllim të sigurimit të respektimit të parimit të sundimit të ligjit, ndarjes së pushteteve, barazisë dhe përgjegjësisë përpara ligjit, drejtësisë në zbatimin e tij, pjesëmarrjes së publikut dhe organizatave të shoqërisë civile në vendimarrje, qartësisë ligjore, shmangies së arbitraritetit dhe sigurimit të transparencës ligjore dhe procedurale në veprimtarinë e administratës publike dhe shtetërore.

Një nga prioritetet programore është zbatimi i barabartë dhe i paanshëm i ligjit. Për ne, ky është gjeneratori më i mirë i zhvillimit të tërësishëm të shoqërisë. Prandaj, gjatë këtyre viteve kemi krijuar një sistem dhe shoqëri të bazuar në shtetin e së drejtës, ku institucionet e drejtësisë veprojnë në mënyrë të pavarur, të përgjegjshme dhe sipas Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo për ne është e vetmja rrugë për ta ndërtuar shtetin e së drejtës dhe institucionet demokratike në shërbim të qytetarit.

Në shoqëritë moderne, ligji shihet si një mjet për krijimin e realitetit shoqëror dhe për përfshirjen e të gjithë personave në jetën shoqërore. Sot ligji paraqet mekanizmin bazë për t'i tejkaluar dhe mbrojtur shkeljet e të drejtave të njeriut. Megjithatë, vetëm ekzistenca e legjislacionit nuk e arrin qëllimin e dëshiruar. Që ky legjislacion ta ketë efektin e dëshiruar, duhet të shoqërohet me masa të tjera shtesë, si p.sh.: ndërgjegjësimi i shoqërisë, ngritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse dhe analiza e detajuar e legjislacionit dhe politikave.

Do të angazhohemi për sistem efikas dhe cilësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë drejtim ne do të angazhohemi që institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut të ketë kompetencë të promovojë, parandalojë dhe mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut, sipas konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Me vizion të qartë për zhvillimin e mëtejshëm të shtetit ligjor në të cilin çdo qytetari i garantohet siguria ligjore, mbetemi të përkushtuar ndaj prioritetëve reformues, për të siguruar institucione të drejtësisë që do t'i mbrojnë të drejtat dhe interesin e qytetarëve. Do të vazhdojmë t'i përmirësojmë kushtet për të siguruar drejtësi efikase, në kohë dhe të paanshme, përmes implementimit dhe promovimit të aktiviteteve që do ta rrisin nivelin e transparencës, pavarësisë dhe paanshmërisë së institucioneve të drejtësisë.

Gjyqësor i pavarur, me integritet dhe efikas. Një nga prioritetet e reformave është të kemi një Gjyqësor transparent dhe me besueshmëri në opinionin e gjerë në vend dhe kudo, që do t'i mbrojë të drejtat dhe liritë themelore. Do të vazhdojmë t'i promovojmë fuqishëm këto kriterë në funksionim të vazhdueshëm të Gjyqësorit. Pavarësia e Gjyqësorit, do të mbrohet si

parakusht për ruajtjen e shtetit të së drejtës dhe si garanci themelore për zhvillimin e procedurave të bazuara në fakte. Pavarësia, cilësia dhe efikasiteti janë parametra thelbësore të një sistemi gjyqësor efektiv. Sistemet gjyqësore efektive janë thelbësore për besimin e ndërsjellë dhe për përmirësimin e klimës së investimeve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike afatgjate.

Funksioni kryesor i pavarësisë është ta garantojë të drejtën e individit që të drejtat dhe liritë e tij/saj të përcaktohen, të mbrohen dhe të zbatohen nga një gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm. Me qëllim të përmirësimit të situatës në sistemin gjyqësor, duke përfshirë përmirësimin e pavarësisë së Gjyqësorit do të vazhdojmë me avancimin e pavarësisë së Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorëve, procedurat për përzgjedhjen/avancimin e gjyqtarëve si masa kyçe mbrojtëse për pavarësinë e gjyqësorit; autonomia dhe pavarësia e prokurorive; kornizat disiplinore dhe llogaridhënia për gjyqtarët dhe prokurorët; investimi në cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë dhe avokatët si aktorë kryesorë për sistemet gjyqësore të bazuara në sundimin e ligjit, noterinë dhe sistemin e përmbartimit.

Padryshim, rëndësi do të ketë edhe avancimi i metodave për zgjidhje alternative të kontesteve duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e mediacionit dhe arbitrazhit. Fokus do t'i kushtohet edhe avancimit të shpërndarjes së lëndëve, sistemit të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Pavarësia e Gjyqësorit është e kushtëzuar me pavarësinë financiare, andaj do të rishikohen masat, të cilat parashikojnë rritjen e buxhetit të Gjyqësorit, përmirësimin e kushteve për punën e gjyqtarëve, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme, pajisje teknike dhe materiale zyre.

Rruajtja e pavarësisë së Gjyqësorit është thelbësore për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e duhur të funksioneve të tij në një shoqëri të lirë, duke respektuar shtetin e së drejtës. Pavarësia e Gjyqësorit dhe e gjyqtarëve duhet të garantohet nga shteti.

Përmirësimi i integritetit të sistemit gjyqësor. Kjo do të arrihet përmes rishikimit të procesit të rekrutimit, përzgjedhjes, emërimit, vlerësimit, avancimit, transferimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme 4 vjeçare nëpërmjet implementimit të këtyre masave dhe aktiviteteve:

- Vendet e zbrazëta për gjyqtarë dhe prokurorë do të plotësohen përmes implementimit të strategjive për menaxhimin e resurseve njerëzore në gjykata dhe në njësitë e Prokurorisë Publike;
- Përmirësimi i kornizës ligjore për rekrutim, përzgjedhje, emërim, vlerësim, avancim, transferim dhe shkarkim të gjykatësve dhe prokurorëve;
- Miratimi dhe implementimi në kohë i Ligjit të Prokurorisë Publike dhe Ligjit të Këshillit të Prokurorisë Publike, të harmonizuar plotësisht me legjisllacionin dhe standardet e Bashkimit Europian, duke përfshirë edhe mendimin e Komisionit të Venedikut;
- Zgjidhjet ligjore për rregullimin e pagave të gjyqtarëve, prokurorëve, personelit gjyqësor dhe Prokurorisë;
- Do të sigurohet pavarësia financiare e sistemit gjyqësor për arritjen e qëllimeve të Strategjisë gjyqësore (2024-2028), në përputhje me Ligjin e Buxhetit Gjyqësor;

- Krijimi i masave të veçanta për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve;
- Përcaktimi i kriterëve për promovimin e gjyqtarit dhe prokurorit publik me qëllim të rritjes së besueshmërisë së opinionit në raport me Gjyqësorin;
- Vendosja e parakushteve të tjera për dhënien e provimeve të kandidatëve para komisioneve të ekspertëve, bazuar në kriterë të larta dhe objektiva për vlerësimin e njohurive të tyre.

Parandalimi i korrupsionit në sistemin gjyqësor. Kjo do të arrihet përmes miratimit dhe implementimit të Planit të ri aksional për periudhën 2026-2029, i cili do të mundësojë rritjen e kredibilitetit të Gjyqësorit në shtet dhe besueshmërisë së qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë. Këtë do ta realizojmë përmes këtyre masave konkrete:

- Miratimi i Kodit të ri për procedurën penale, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe praktikën ndërkombëtare;
- Miratimi i Planit aksional për parandalimin e korrupsionit në Gjyqësor për vitet 2026-2029;
- Reduktimi i kohës mesatare të nevojshme për zgjidhjen e ankesave ndaj zyrtarëve gjyqësorë, në harmonizim të plotë me standardet europiane;

Konsolidimi i funksionimit të Këshillit Gjyqësor do të jetë një nga prioritetet e qeverisjes së ardhshme. Ky organ duhet të vendoset në funksion të mbrojtjes së integritetit dhe pavarësisë së gjykatësve dhe institucioneve dhe duhet t'i kundërvihet çdo ndikimi të jashtëm i cili tenton të pengojë apo kompromitojë funksionimin e drejtë të Gjyqësorit.

Zbatimi dhe përmirësimi i kornizës rregullatore të Këshillit Gjyqësor, me theks të veçantë në lidhje me procedimin disiplinor dhe apelues të gjyqtarëve, në përputhje me misionin vlerësues të Komisionit European të muajit shtator të vitit 2023. Në këtë drejtim do t'i ndërmarim këto masa konkrete:

- Plotësimi i Ligjit të Këshillit Gjyqësor në pajtueshmëri me rekomandimet e misionit vlerësues të Komisionit European për funksionimin e Këshillit Gjyqësor (shtator 2023) dhe mendimet e Komisionit të Venedikut;
- Përzgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillit Gjyqësor që do t'i zëvendësojnë anëtarët që u ka kaluar mandati, do të bëhet sipas kriterëve të ligjit të ri të plotësuar, respektivisht të Ligjit të Këshillit Gjyqësor;
- Gjyqtarët dhe prokurorët që i nënshtrohen procedimit disiplinor do të kenë të drejtën e gjykimit të drejtë dhe të drejtën për t'i kundërshtuar deri në instancat e apelit, vendimin dhe sanksionet;
- Rishikimi i kornizës legjislative dhe funksionimit të përgjithshëm të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve për rritjen e transparencës dhe pavarësisë, por edhe përgjegjësisë së secilit anëtar për veprimet e veta.

Efikasiteti i Gjyqësorit. Kjo do të mundësohet përmes implementimit të sistemit funksional dhe plotësisht të automatizuar për menaxhimin e lëndëve në gjykata dhe prokurori, duke menjanuar tërësisht shpërndarjen manuale të lëndëve. Me këtë do t'u vihet fund ndikimeve të jashtme dhe do të luftohet dukuria e "gjyqtarëve apo prokurorëve të preferuar", duke

mundësuar paanshmëri dhe procedura gjyqësore të shpejta dhe efikase. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi, në mandatin e ardhshëm do t'i ndërmarrim këto masa konkrete:

- Vendosja e mekanizmit për monitorim, për të siguruar shfrytëzimin e plotë dhe efektiv të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Gjykatave (ACCMIS), bazuar në përgjegjshmëri dhe respektim të masave të parapara disiplinore;
- Në mënyrë të plotë dhe funksionale do të bëhet menaxhimi i automatizuar i rasteve gjyqësore në përputhje me praktikën më të mira të Bashkimit Europian dhe shteteve anëtare. Kjo do të mundësojë përshpejtimin e kohës së procesimit të rasteve dhe lëndëve, si dhe reduktimin e kohës së sjelljes së verdikteve gjyqësore për raste specifike, në përputhje me Metodologjinë e Komisionit Europian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ);
- Komisioni i Mbikëqyrjes së Funksionalitetit të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Gjykatave (ACCMIS) do të kryejë mbikëqyrje sistemore dhe transparente, në përputhje me Planin vjetor të mbikëqyrjes;
- Përfundimi i zbatimit të Strategjisë së reformës në drejtësi dhe Planit të përditësuar të veprimit, me fokus të veçantë në miratimin e ligjeve me të cilat rregullohen procedurat në sferën civile, penale dhe administrative, në përputhje me të gjitha aktet normative të BE-së dhe standardet ndërkombëtare;
- Sigurimi i kushteve për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve, zhvillimin e standardeve të menaxhimit efikas të gjykimit;
- Unifikimi i praktikës gjyqësore përmes rritjes së nivelit të trajnimit të gjyqtarëve dhe rishikimit të kriterëve të vlerësimit për gjykatësit dhe prokurorët publikë duke shfrytëzuar praktika dhe përvoja të mira krahasuese nga Bashkimi Europian dhe vendet anëtare;
- Përcaktimi i detyrimit ligjor për trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve, noterëve, përmbaruesve, mediatorëve që do të organizohen nga ana e odave në bashkëpunim me organet apo institucionet e tjera sipas nevojës.

Strategjia zhvillimore e gjyqësorit 2024-2028. Vizioni i ynë është një gjyqësor i pavarur, i përgjegjshëm, transparent dhe i aksesueshëm, rezistent ndaj ndikimeve të brendshme dhe të jashtme, i cili mbron të drejtat e njeriut dhe siguron sundimin e ligjit në mënyrë efikase. Strategjia fokusohet në pesë fusha kryesore prioritare: gjyqësori dhe prokuroria publike, kapacitetet e institucioneve të posaçme të sistemit të gjyqësorit, profesionet individuale dhe shërbimet publike, Gjykata Kushtetuese dhe fushat specifike juridike (penale dhe civile) të cilat janë relevante për funksionimin e gjyqësorit.

1.4. LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

i. VETING PËR POLITIKANËT, GJYQËSORIN, PROKURORINË DHE ORGANET E RENDIT DHE SIGURISË

Veting për korrupsion dhe interesa shtetërore. Vetingu do të instalohet me ligj si institucion për të parandaluar dhe për të luftuar në vazhdimësi korrupsionin në shoqërinë tonë, për të çrrënjosur atë nga institucionet e vendit. Gjithashtu, vetingu do të parandalojë dhe luftojë ndikimin rus, si dhe reliktet e ish-regjimit komunist dhe ndikime tjera të “shërbimeve” anti përcaktimeve tona Euro-Atlantike, NATO, Bashkimi Europian dhe Partneritetit strategjik me SHBA.

Institucionalizim i vetingut. Do të riafirmohet propozim **Ligji për veting**, të cilin e kemi propozuar në Kuvend. I njëjti do të avancohet në bashkëpunim me ekspertë të vendit dhe ndërkombëtar. Ky do të jetë në bashkëveprim me **Ligjin për masa restriktive**, me çka krijohet bazë për të vepruar insitucionet e vendit sipas sanksioneve ndërkombëtare (“lista të zeza”, etj.) për qytetarë dhe subjekte juridike të vendit dhe të huaj që veprojnë në territorin tonë.

Çertifikatë për funksion shtetëror (publik). Vetingu do të përfshijë politikanët, gjyqtarët, prokororët dhe funksionarët në detyra të larta të rendit dhe sigurisë. Do të instalohet praktikë çertifikatave për detyrë publike në bazë të verifikimit të fakteve për mospërfshirje në korrupsion ose “shërbime” kundër interesave shtetërore. Këto çertifikata do të prkatikohen në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare, si NATO, BE dhe SHBA.

ii. LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

Lufta kundër korrupsionit, demokracia dhe sundimi i së drejtës përbëjnë një tërësi të pandashme dhe komplementare. Prandaj, në mandatin e ardhshëm do të vazhdojmë ta zhvillojmë konceptin e një shteti të barabartë për të gjithë qytetarët pa përjashtim. Këtë do ta bëjmë duke e luftuar në mënyrë sistemore dhe të qëndrueshme krimin dhe korrupsionin e lartë, nepotizmin dhe klientelizmin.

Si subjekt politik progresiv dhe i përgjegjshëm, do ta vazhdojmë luftën pa kompromis, me tolerancë zero kundrejt çdo lloj veprimtarie të paligjshme, duke

inkurajuar edhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në të gjitha nivelet.

Lufta kundër korrupsionit kërkon përpjekje sistemore dhe angazhim të plotë nga të gjithë dhe një qasje që adreson edhe parandalimin e këtij fenomeni. Fokusi ynë do të jetë përforcimi i sistemit të drejtësisë në funksion të sigurisë juridike, pavarësisë, profesionalizmit, paanshmërisë, përgjegjësisë, efikasitetit dhe transparencës që do të mundësojë trajtimin e barabartë të secilit para ligjit, ku si rrjedhojë do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës.

Zotohemi, se në luftën kundër korrupsionit do të udhëhiqemi nga standardet universale të qeverisjes së mirë, me ç'rast në periudhën 4 vjeçare të ardhshme do të angazhohemi për:

- Luftën efikase kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe keqpërdorimit të pushtetit në të gjitha nivelet;
- Rritjen e nivelit të përgjegjësisë politike dhe demonstrimit të vullnetit për luftë kundër korrupsionit;
- Ndarjen e mjeteve dhe burimeve plotësuese për zyrën e Prokurorisë Themelore Publike të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, në veçanti për prokurorët e specializuar, ekspertët financiarë dhe analistët e mjekësisë ligjore digjitale;
- Përmirësimin e evidencës së hetimeve, ndjekjeve penale, dënimeve, sekuestrimeve dhe konfiskimeve që kanë të bëjnë me korrupsionin, përfshirë edhe rastet e korrupsionit të nivelit të lartë;
- Udhëheqjen e ndërgjegjshme dhe pa ndikim politik në sektorin publik;
- Zbatimin e detyrimeve në sektorin publik, duke u bazuar në ligj, në mënyrë transparente, etike, ekonomike, të përgjegjshme dhe efektive;
- Përforcimin e integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik;
- Përforcimin e mekanizmave në drejtim të kontrollit dhe mbikëqyrjes;
- Digjitalizimin e shërbimeve publike;
- Përfshirjen e sektorit civil dhe mediave në luftën kundër korrupsionit në shoqëri dhe krijimin e integritetit personal dhe profesional.

iii. LUFTË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Lufta kundër krimit të organizuar mbetet prioritet në krijimin e shtetit të drejtë dhe demokracisë funksionale. Deri më tani kemi arritur avancim të

konsiderueshëm në luftën kundër krimit të organizuar me theks të veçantë në luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm, tregtisë me substanca narkotike dhe tregtisë me njerëz, edhe atë nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me vendet e Bashkimit Europian, shtetet fqinje si dhe orgnizatrat ndërkombëtare EUROPOL dhe EUROJUST.

Institucionet kryesore në luftën kundër krimit të organizuar janë njësitë e specializuara policore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që janë të autorizuar për lloje të ndryshme të krimit të organizuar dhe hetime financiare.

Nevojitet që edhe më tej të përforcohet kapaciteti i Qendrës Koordinative Nacionale për Luftë kundër Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar. Koordinimi më efikas institucional mbetet indikator kyç për të gjitha institucionet dhe palët në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë këtu prokurorët dhe policinë.

Lufta Kundër krimit të organizuar si një nga shtyllat kyçe për funksionimin e shtetit të së drejtës do të mbetet zotimi ynë edhe në periudhën e ardhshme.

Qëllim kryesor është që në periudhën vijuese të promovojmë qasje të bazuar në objektiva konkrete për t'i luftuar krimet e rënda dhe krimin e organizuar, me plan aksional dhe strategji konkrete që sjellë përmirësimin e bilancit të hetimeve, ndjekjeve penale, gjykimeve përfundimtare, konfiskimeve dhe konfiskimeve përfundimtare në rastet e krimit të organizuar, me theks të veçantë në rastet e nivelit të lartë.

Duke u nisur nga ky aspekt, në luftën kundër krimit të organizuar do të ndërmarrim këto masa dhe aktivitete konkrete:

- Do ta përmirësojmë bilancin e evidencës së hetimeve, ndjekjes penale dhe shqiptimit të dënimeve për rastet e krimit të organizuar dhe pastrimit të parave, me fokus të veçantë në konfiskimin e pronës dhe të mirave materiale, të fituara përmes aktiviteteve kriminale dhe krimit të organizuar;
- Miratimi dhe implementimi i kornizës së nevojshme ligjore për shërbimin e konfiskimit të pronës;
- Përforcimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të agjencive për implementimin e ligjit, që hetojnë krimet e rënda dhe krimin e organizuar, krimin financiar dhe pastrimin e parave;

- Ndyshimi në Ligjin e Armëve nëpërmjet harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Europian për klasifikimin e armëve;
- Promovimi i sistemit funksional për paralajmërimin e hershëm të ndërlidhur me sistemin e Bashkimit Europian dhe rritja e kapaciteteve njerëzore të Observatorit Nacional të Drogës, me qëllim të luftës efikase kundër tregtisë së drogës dhe substancave narkotike;
- Harmonizimi dhe plotësimi i listës së substancave psikotrope, me atë të Bashkimit Europian.

Konfiskimi i pronës së fituar në mënyrë ilegale dhe si rezultat i krimit të organizuar është prioritet programor, që do të sigurojë kthimin e kapitalit të akumuluar në mënyrë kriminale, deri tek qytetarët dhe për qytetarët.

Konfiskimi i pronës ilegale është një nga indikatorët e funksionimit demokratik të shtetit, si dhe efikasitetit të institucioneve. Përmes miratimit të masave për përforcimin e kapaciteteve të institucioneve relevante për kryerjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës, një pjesë e mjeteve apo pronës së konfiskuar, mbetet për institucionet relevante që merren dhe luftojnë krimin e organizuar, siç janë: MPB-ja, Policia Financiare, Prokuroria dhe Drejtoria Doganore me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të institucioneve që punojnë në këtë drejtim.

Me ndryshimet e Ligjit të Konfiskimit të Pronës i cili është në procedurë parlamentare, do të mundësohet që prona e konfiskuar e cila nuk mund të shitet, të transferohet për organizatat civile, që do të dedikohen për projekte të natyrës sociale. Kjo është praktikë e njohur në vendet e Bashkimit Europian që mundëson kthimin e mjeteve dhe pronave të fituara ilegalisht në sektorin publik dhe tek qytetarët përmes financimit të projekteve ku përfitues të drejtpëdrejt janë vetë qytetarët.

Në drejtim të përforcimit të kapaciteteve të Agjencisë së Menaxhimit të Pronës së Konfiskuar, e cila merret me identifikimin dhe ndjekjen e pronave të fituara në mënyrë kriminale dhe në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Europian, do t'i ndërmerrem këto masa dhe aktivitete konkrete:

- Ndyshimi dhe plotësimi i Ligjit të Konfiskimit dhe Kthimit të Pronës së Fituar në Mënyrë Ilegale;
- Punësimi dhe plotësimi i vendeve vakante të punës së Agjencisë së Menaxhimit të Pronës së Konfiskuar, për të siguruar përmirësim të bilancit të punës, hetimeve dhe ndjekjeve penale nga krimi i organizuar

dhe pastrimi i parave, me fokus në konfiskimin e mjeteve dhe pronave të fituara;

- Përforcimi i ndjekjes dhe identifikimit të rasteve të konfiskimit të pronës ilegale, fiksimi i pronave të fituara në mënyre ilegale dhe menaxhimi i tyre, me qëllim të ruajtjes së vlerës së tyre;
- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të Agjencisë së Menaxhimit të Pronës së Konfiskuar, sigurimi i një software-i efikas dhe cilësor dhe hapësirave të mjaftueshme për magazinim të sigurtë të mjeteve dhe pronave të konfiskuara.

1.5. ADMINISTRATË PROFESIONALE DHE SHËRBIME PUBLIKE TË DIGJITALIZUARA

Administrata publike paraqet një nga themelet institucionale të udhëheqjes me shtetin. Një administratë profesionale dhe efikase ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, kohezionin shoqëror dhe mirëqenien e qytetarëve. Deri më tani, në vazhdimësi jemi angazhuar për administratë publike profesionale dhe efikase, të orientuar drejt qytetarit dhe shoqërisë. Qëndrojmë të vendosur në parimin se vetëm ata që në të vërtetë kujdesen dhe punojnë për nevojat e qytetarëve mund të krijojnë shtet të fortë, efikas dhe të qëndrueshëm. Administrata profesionale në nivel qendror dhe lokal është një nga faktorët kryesorë për rikthimin e besimit në institucione dhe profesionalizmin e tyre për t'i shërbyer qytetarit. Ajo paraqet një nga kushtet kryesore për zhvillim të përgjithshëm shoqëror, kulturor, ekonomik si dhe për ruajtjen e ekuilibrit demografik. Prandaj, ne gjithmonë jemi udhëhequr dhe do të vazhdojmë ta ndjekim modelin e përzgjedhjes së kodit të duhur moral dhe profesional në procesin e përzgjedhjes së zyrtarëve dhe nëpunësve administrativë, si e vetmja mënyrë për përforcimin e besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore dhe rritjen e efikasitetit të tyre.

Strategjia për reformë në administratën shtetërore 2023-2030 përcakton kornizën strategjike drejt një administrate publike të depolitizuar, efikase, efektive dhe të përgjegjshme që ofron politika cilësore dhe shërbime lehtësisht të arritshme për qytetarët dhe subjektet afarsite. Këto politika bazohen në parimet dhe vlerat europiane dhe kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme ekonomike, sundimin e ligjit, kohezionin social dhe mirëqenien e përgjithshme. Kjo strategji bazohet në katër fusha, respektivisht:

- Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
- Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Përgjegjësia, llogaridhënia dhe transparencja;
- Ofrimi i shërbimeve dhe transformimi digjital.

Do të punojmë për vazhdimësinë e reformave në administratën publike, me qëllim të krijimit të një administrate efikase, profesionale, të depolitizuar, me qëllimin e vetëm që ajo të shndërrohet në servis të vërtetë për qytetarët. Në tërësi dhe në kontinuitet do të

angazhohemi në ngritjen e standardeve për punën administrative të institucioneve, duke u bazuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit, duke rritur profesionalizmin dhe cilësinë e administratës. Përpyekjet tona, do të drejtohen në rritjen e diturisë së të punësuarve në administratë, me qëllim që qytetarëve t'u ofrohen shërbime të shpejta dhe cilësore në njërin anë dhe nga ana tjetër të kemi administratë të përgatitur për të qenë në hap me procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Krijimi i një administrate të fuqishme dhe inovative që shërben me përkushtim qytetarët dhe promovon zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, duke synuar fuqizimin e administratës, inovacionin dhe digjitalizimin, ku në fokus do jenë shërbimet më efikase ndaj qytetarëve, si dhe përmirësimin e imazhit publik.

Platforma jonë për administratën e qëndrueshme dhe të fuqishme synon t'i adresojë këto sfida dhe të krijojë një strukturë të përmirësuar për të ardhmen:

- **Administratë publike profesionale.** Do të sigurojmë proces transparent dhe objektiv të rekrutimit dhe emërimit të të punësuarve, duke rritur integritetin, pavarësinë e administratës dhe digjitalizimin e proceseve;
- **Avancimi i sistemit meritokratik.** Për të siguruar një strukturë rekrutimi dhe avancimi të bazuar në aftësitë dhe përvojën e të punësuarve, duke përmirësuar kështu profesionalizmin dhe efikasitetin e administratës;
- **Fuqizimi i kapaciteteve administrative.** Përmes Akademisë së Trajnimeve (Akademia e Nëpunësve Administrativë dhe Akademia e Financave Publike);
- **Inovacioni dhe digjitalizimi.** Duke implementuar Strategjinë nacionale për shfrytëzimin e teknologjisë dhe metodologjive të reja për t'i përmirësuar shërbimet dhe proceset administrative. Si dhe në infrastrukturë dhe teknologji, me përkrahje financiare dhe teknike, për përgatitjen e administratës për sfidat e reja të epokës digjitale;
- **Avancimi i E-shërbimeve.** Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve online në platformën digjitale për të ofruar përvojë më të lehtë dhe të përshtatshme për qytetarët gjatë shërbimeve publike;
- **Optimizimi i administratës publike përmes transferimit në sektorin privat.** Zvogëlimi i numrit të të punësuarve në administratën publike, nëpërmjet transferimit në sektorin privat për të ofruar burime për shërbime më të mira. Do të mbulohen kontributet shtesë për tre vitet e para për ta inkurajuar sektorin privat që të pranojnë nëpunës administrativë. Kjo nismë synon ta rrisë efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike;
- **Riorganizimi i organeve shtetërore.** Si reformë e rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe optimizimin e funksionalitetit dhe racionalizimin e kostove për qytetarët dhe bizneset;
- **Identiteti digjital.** Krijimi i identitetit digjital për qytetarët dhe subjektet juridike si bazë e integruar në një platformë nacionale ku do mund të lidhen të gjitha bazat e të dhënave dhe shërbimeve publike.
- **Politika për mabjtjen e administratës (Retention policies).** Do të promovohen politika për rritjen e pagave dhe nxitjeve që do tërhiqin kuadra profesional në administratë në përgjithësi, si dhe administrata në pozicione të larta udhëheqëse profesionale dhe jopolitike.

i. ADMINISTRATË PROFESIONALE DHE EFIKASE

Fuqizimi i kapaciteteve administrative është një proces i rëndësishëm për ta përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve qeverisëse dhe organizatave të tjera. Kjo përfshin investime në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të të punësuarve, si dhe në përmirësimin e infrastrukturës administrative dhe teknologjisë së informacionit. Nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme, udhëzimeve dhe standardeve të qarta të veprimit, fuqizimi i kapaciteteve administrative krijon mjedis të favorshëm për krijimin e politikave të mirëqenies dhe për t'i adresuar sfidat komplekse në mënyrë efektive dhe efikase.

- **Trajnimi dhe zhvillimi profesional.** Miratimi i një politike të përqendruar në zhvillimin e kapaciteteve administrative përmes investimeve në trajnim dhe zhvillim profesional, në një institucion të vetëm - Agjencia e Administratës dhe Trajnimeve. Kjo politikë synon të krijojë një mjedis ku të punësuarit kanë mundësi të vazhdojnë t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre dhe të përvetësojnë njohuritë më të fundit në fushën e tyre të punës. Krijimi i një ambienti për ndarjen e njohurive dhe eksperiencave mes të punësuarve, duke promovuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ideve. Kjo do të përfshijë organizimin e punëtorive, seminareve dhe aktiviteteve të tjera që promovojnë transferimin e njohurive dhe ndërveprimin ndërmjet të punësuarve.
- **Politika e mbajtjes së personelit.** Zhvillimi i politikës gjithëpërfshirëse për mbajtjen e personelit, duke e bërë administratën publike më tërheqëse dhe më të aftë në drejtim të mbajtjes së kuadrove të talentuara dhe profesionale. Kjo politikë për mbajtjen e personelit duhet të përfshijë elemente të tilla si: paga konkurruese dhe garantimin e të drejtave të të punësuarve, duke siguruar kështu një motivim të qëndrueshëm për të qëndruar në administratën publike. Po ashtu, do të kemi fokus zhvillimin e karrierës, duke ofruar mundësi për trajnime dhe avancime të qarta për të punësuarit e talentuar.

ii. PËRFAQËSIM I DREJTË DHE ADEKUAT

- **Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në administratë dhe sektorin publik.** Si një e drejtë kushtetuese e cila buron nga Marrëveshja e Ohrit, përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në baza etnike, do të vazhdojë të jetë prioritet në politikat dhe reformat e avancimit të administratës publike në interes të shërbimeve më cilësore për qytetarët. Për ta promovuar përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të të gjitha grupeve të shoqërisë në procesin e avancimit në administratë, për përfaqësimin e grupeve të ndryshme etnike, gjinore dhe sociale.
- **Balanseri në procesin e punësimit në sektorin publik.** Do të vazhdojë dhe avancohet praktika e punësimit duke përdorur mekanizmin ligjor të "balanserit". Ky hap synon ta inkurajojë diversitetin dhe të sigurojë përfaqësim më të drejtë dhe adekuat të të gjitha komuniteteve në administratë, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të pasur dhe të reflektuar shoqëror.
- **Përfaqësim i drejtë dhe adekuat në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike.** Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat si normë kushtetuese dhe ligjore do të aplikohet në të gjitha institucionet punlike, shtetërore, qeveri, gjyqësor, prokurori, arsim,

shëndetësi, ndërmarrje publike dhe shtetërore, bankën popullore, akademinë e shkencave, etj., gjithashtu duke respektuar kriteret profesionale dhe të cilësisë.

- **Përfaqësim i drejtë dhe adekuat në të gjitha nivelet udhëheqëse të sektorit publik.** Përveç përfaqësimit të drejtë dhe adekuat për punësim, do të praktikohet edhe në nivelet udhëheqëse duke respektuar kriteret e cilësisë dhe kapaciteteve profesionale.
- **Diversiteti në mjedisin e punës përparësi për sektorin privat dhe shoqërinë civile.** Duke u bazuar në praktikat pozitive të qeverisjes së mirë në nivel ndërkombëtar, do të inkurajojme qasje afirmative për diversitet në mjedisin e punës për organizatat e ndryshme në sektorin privat dhe shoqërinë civile.

iii. AVANCIMI I SISTEMIT MERITOKRATIK

Avancimi i sistemit meritokratik është një proces që përmirëson mundësitë për avancim në bazë të aftësive dhe meritave të individëve, duke shmangur favorizimin e bazuar në lidhje personale, pasurimin financiar, ose përkatësitë e tjera. Në një sistem meritokratik, përparimi dhe sukcesi i një personi vlerësohet dhe kompensohet në përputhje me aftësitë, përkushtimin dhe arritjet e tyre. Kjo promovon shpërndarjen e barabartë të mundësive dhe inkurajon inovacionin dhe punën e palodhshme.

- **Krijimi i kriterëve për avancim.** Miratimi i një politike që përcakton kriteret e qarta dhe objektive për avancimin në nivelet e larta të administratës. Kjo politikë synon të sigurojë se avancimi bëhet në bazë të aftësive dhe kontributeve të vërteta të të punësuarve, duke reduktuar ndikimin e faktorëve politikë në këtë proces. Me anë të kësaj do të rritet përgjegjësia individuale e të punësuarve për zhvillimin e tyre profesional. Përfshirja e hartimit të planeve individuale të karrierës dhe vlerësimit të rendimentit, do ta promovojë kulturën e meritokracisë dhe përgjegjësisë në tërë administratën. Gjithashtu, do të organizohen trajnime për përmirësimin e shkathtësive dhe njohurive të të punësuarve, duke krijuar një mjedis ku ata mund të rriten dhe të avancojnë në bazë të vlerave të tyre individuale.
- **Intelegjenca artificiale (AI).** Në këtë drejtim, do ta përdorim teknologjinë e inteligjencës artificiale në testimin e kandidatëve për eliminimin e përsëritjes së pyetjeve dhe për sigurimin e një procesi transparent dhe efikas në vlerësimin e aftësive të tyre. Për ta njoftuar publikun dhe kandidatët potencialë rreth këtij ndryshimi, planifikojmë lancimin e një fushate informuese. Kjo fushatë do t'i theksojë avantazhet e përdorimit të inteligjencës artificiale në rritjen e objektivitetit në përzgjedhjen e të punësuarve në administratë. Për krijimin e një mjedisi ku rekrutimi është i drejtë, i pavarur dhe i fokusuar në aftësitë e vërteta të kandidatëve, përpiqemi që të garantojmë proces të drejtë dhe të pavarur në përzgjedhjen e nëpunësve administrativë.

iv. INOVACION DHE DIGJITALIZIM

Inovacioni dhe digjitalizimi janë dy elemente kyçe për modernizimin dhe përmirësimin e administratës publike. Duke përdorur teknologjinë dhe inovacionin për t'i optimizuar proceset administrative, qeveritë mund të ofrojnë shërbime më efikase dhe transparente për qytetarët. Kjo gjithashtu krijon një marrëdhënie më të ngushtë dhe të besueshme midis qytetarëve dhe administratës, duke përmirësuar përvojën e shfrytëzuesve dhe duke rritur nivelin e besimit në institucionet qeveritare.

- **Transformimi i administratës.** Krijimi i politikës që inkurajon inovacionin në administratë. Kjo politikë destinohet në krijimin e kulturës inovative duke lehtësuar implementimin e teknologjive të reja dhe metodave efikase në shërbimet dhe proceset administrative. Implementimi në këtë drejtim do të përfshijë krijimin e disa qendrave inovacioni (Inovation HUB, Inovation LAB...) në administratë, ku të punësuarit mund të zhvillojnë dhe testojnë projekte inovative. Në këtë mënyrë do t'i nxisim të punësuarit të propozojnë dhe të zhvillojnë projekte të reja dhe efikase për përforsimin e kreativitetit dhe aftësive inovative të të punësuarve në zhvillimin e ideve të reja;
- **Modernizimi i administratës në drejtim të digjitalizimit.** Do të ndërmarrim hapa të rëndësishëm drejt digjitalizimit të administratës së vendit tonë, duke hartuar kornizë ligjore dhe strategjike për të lehtësuar implementimin e projekteve digjitale dhe për të përdorur teknologjitë e fundit në shërbimet administrative. Në këtë drejtim, synojmë krijimin e Agjencisë Digjitale, që do të koordinojë dhe zbatojë projekte digjitale në administratën tonë. Kjo agjenci do të funksionojë si qendër e specializuar për digjitalizim, duke siguruar qasje efikase dhe të përgjegjshme për zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive digjitale në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve. Përveç kësaj, planifikojmë krijimin e platformës online, ku qytetarët dhe bizneset do të kenë mundësinë të propozojnë dhe të vlerësojnë projekte digjitale për administratën. Këto masa synojnë ta përmirësojnë efikasitetin dhe transparencën e shërbimeve administrative, duke krijuar një mjedis më modern dhe të përshtatshëm për të gjithë;
- **Krijimi i qendrës GovTech.** Govtech është shkurtesa e të ashtuquajturës “teknologji qeveritare”. Kjo është një fushë që fokusohet në përdorimin e teknologjisë për t'i përmirësuar shërbimet dhe funksionimin e qeverisjes publike. Në esencë, Govtech përdor inovacionet teknologjike si aplikacione mobile, analizat e të dhënave, inteligjencën artificiale dhe *blockchain* për t'i lehtësuar dhe përmirësuar proceset qeveritare, duke përfshirë monitorimin e burimeve, automatizimin e proceseve vendimmarrëse dhe sigurinë e të dhënave. GovTech mund ta përforcojë besimin mes qytetarëve dhe shtetit me kusht që zgjidhjet të jenë efektive, të fokusuara te njerëzit dhe të trajtojnë ndarjen digjitale. Që GovTech-i të jetë efektiv, kërkohet që qeveritë të dëgjojnë dhe të përgjigjen në mënyrë aktive ndaj nevojave të qytetarëve. Po ashtu, ofruesit e teknologjisë duhet t'i dëgjojnë qeveritë dhe t'i kuptojnë nevojat e tyre për ofrimin dhe bashkëkrijimin e rezultateve publike me ndikim. Me një fjalë, GovTech synon modernizimin dhe efikasitetin e administratës publike përmes teknologjisë. Ne synojmë të hapim qendrën e parë GovTech në Shkup për ta përforcuar transformimin digjital dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e qeverisjes e cila do të fokusohet në transformimin digjital të Qeverisë, zhvillimin e qeverisjes elektronike dhe edukimin digjital, që është një hap shumë i rëndësishëm për avancimin e

teknologjisë në Maqedoninë e Veriut. Nëpërmjet kësaj qendre, Maqedonia e Veriut do t'i përforcojë lidhjet e saj me bashkësinë ndërkombëtare të GovTech dhe do të kontribuojë në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe transparente. Ky hap do të sjellë përparim në modernizimin e Qeverisë dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

v. AVANCIMI I E-SHËRBIMEVE

Rritja e numrit të shërbimeve online në platformën e-shërbime në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të sjellë ndikim pozitiv të qëndrueshëm për qytetarët. Ky aspekt do të përshkruhej si një hap drejt modernizimit të shërbimeve publike duke përfshirë avantazhet e mëposhtme:

- **Reduktimi i kohës së pritjes së radhës.** Shfrytëzuesit do të përfitojnë nga mundësia për realizimin e shumicës së kërkesave dhe transaksioneve të tyre në mënyrë elektronike, duke shmangur kështu radhët e gjata në sportelet fizike. Kjo do të rezultojë në rritjen e shpejtësisë dhe efikasitetit të shërbimit për qytetarët;
- **Përmirësimi i aksesit dhe shfrytëzimit të shërbimeve.** Shfrytëzuesit do të gëzojnë qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në shërbimet publike, duke i lejuar ata të kryejnë transaksione dhe të marrin shërbime në kohë të shkurtër dhe në mënyrë të thjeshtë, nga shtëpia ose vendet e tyre të punës;
- **Rritja e transparencës dhe besueshmërisë.** Përdorimi i platformës së e-shërbimeve do të ndihmojë në rritjen e transparencës duke e bërë të mundur për qytetarët që ta monitorojnë statusin e kërkesave dhe transaksioneve të tyre. Kjo do ta rrisë besueshmërinë dhe përceptimin e Qeverisë si një institucion të hapur dhe të përgjegjshëm;
- **Përkrahja e inovacionit dhe zhvillimit ekonomik.** Një qasje e lehtë në shërbimet publike mund të nxisë rritjen e përdorimit të teknologjisë, inovacionit dhe zhvillimit ekonomik. Kjo mund të sjellë përparim në sektorin privat dhe krijim të mundësive të reja të biznesit.

vi. OPTIMIZIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE PËRMES TRANSFERIMIT NË SEKTORIN PRIVAT

Synojmë ta bëjmë administratën tonë më efikase dhe më të përgjegjshme. Në këtë drejtim, planifikojmë të transferojmë një pjesë të të punësuarve të administratës publike në sektorin privat. Kjo do të ndihmojë në zvogëlimin e numrit të të punësuarve në administratë dhe ofrimin e burimeve financiare.

- **Nismat për sektorin privat.** Qeveria do t'i mbulojë kontributet shtesë për dy vitet e para, duke e bërë transferimin e nëpunësve administrativë financiarisht tërheqës për bizneset. Kjo do ta inkurajojë pranimin e nëpunësve administrativë nga sektori privat dhe të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve publike.
- **Përgatitja dhe kalimi i suksesshëm.** Të punësuarve të transferuar do t'u ofrohen trajnime të nevojshme për t'u përgatitur për rolet e tyre të reja në sektorin privat.

Qeveria do të ofrojë përkrahje të fuqishme për sigurimin e kalimit të suksesshëm dhe integritet të lehtë në sektorin privat.

Kjo synon të sigurojë një administratë më të specializuar dhe më efikase, duke përmirësuar kështu shërbimet për qytetarët dhe duke e bërë sektorin privat më të fuqishëm dhe më konkurrues në tregun e punës. Në këtë mënyrë, të gjithë përfitojnë nga një administratë më e mirë dhe më efikase, duke krijuar mjedis më të përshtatshëm për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

vii. RIORGANIZIMI I ORGANEVE SHETËRORE

Riorganizimi i organeve shtetërore është një hap kritik drejt përmirësimit të administratës publike. Ky proces duhet të përfshijë zvogëlimin e numrit të institucioneve shtetërore dhe krijimin e linjave të qarta të përgjegjësisë për secilën prej tyre. Organizimi i tillë do të sjellë përfitime të rëndësishme, respektivisht:

- **Efikasiteti dhe efektiviteti.** Me një numër më të vogël institucioneve, administrata publike do të jetë në gjendje të operojë më mirë dhe të ofrojë shërbime më cilësore për qytetarët;
- **Transparenca dhe llogaridhënia.** Me linja të qarta të përgjegjësisë, do të jetë më e lehtë për ta monitoruar dhe vlerësuar performancën e institucioneve shtetërore, duke rritur kështu transparencën dhe llogaridhënien;
- **Reduktimi i shpenzimeve.** Zvogëlimi i numrit të institucioneve shtetërore do t'i ulë shpenzimet administrative dhe do të mundësojë shfrytëzimin më efikas të burimeve publike;
- **Lehtësimi i koordinimit.** Me strukturë më të thjeshtë organizative, bashkëpunimi dhe koordinimi mes institucioneve do të përmirësohen, duke lehtësuar realizimin e qëllimeve të përbashkëta.

viii. IDENTITETI DIGJITAL

Në përputhje me avancimet teknologjike dhe nevojat e sigurisë informative, krijimi i identitetit digjital është sfidë e rëndësishme për shoqërinë moderne. Identiteti digjital është koncept i rëndësishëm në epokën digjitale, që lidhet ngushtë me identitetin personal të një individi në ambientet online. Për të siguruar një identitet digjital të sigurtë dhe të besueshëm, duhet t'i ndërmarim këto hapa:

- **Karta digjitale e identitetit (ID-card):** Duhet krijuar karta digjitale e identitetit për qytetarët, që përfshin një çip të integruar për autentifikimin elektronik. Ky dokument u mundëson qytetarëve të identifikohen dhe të firmosin dokumente online me siguri të lartë;
- **Platforma e identifikimit elektronik (eID):** Platforma e identifikimit elektronik ofron një gamë të gjerë të shërbimeve online që mund të aksesohen përmes identitetit

digjital të qytetarëve, duke përfshirë shërbimet e administratës publike, shëndetësisë, financave etj.;

- **Stabiliteti dhe siguria e të dhënave:** Duhet investuar në infrastrukturën digjitale për të siguruar mbrojtjen dhe integritetin e të dhënave personale të qytetarëve. Këtu përfshihen sisteme të avancuara për enkriptimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në pajisjet dhe shërbimet digjitale;
- **Edukimi dhe përgatitja:** Duhet investuar në edukimin dhe përgatitjen e qytetarëve për shfrytëzimin e identitetit digjital dhe për praktikën e sigurisë informative. Kjo përfshin fushata të informimit publik dhe trajnime për shfrytëzuesit në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit për rreziqet potenciale dhe praktikën e sigurisë në ambientet digjitale.

Këto masa janë dëshmi e aftësisë për të përparuar në drejtim të një shoqërie digjitale të sigurtë dhe të avancuar. Me përdorimin e teknologjisë për përmirësimin e qeverisjes dhe shërbimet publike, do të na mundësohet qasje e zgjuar dhe e përgjegjshme, në mënyrë që qytetarët të kuptojnë se si identiteti digjital mund të sjellë përfitime të mëdha për vet ata dhe për shoqërinë në tërësi.

1.6. RENDI DHE SIGURIA

Rendi dhe siguria janë dy aspekte shumë të rëndësishme të çdo shoqërie apo shteti. Përmes rendit dhe sigurisë arrihet mirëqenia e qytetarëve dhe stabiliteti apo funksionimi i drejtë i shtetit.

Kemi punuar në vazhdimësi për krijimin e policisë efikase në shërbim të qytetarëve, me ç'rast kemi arritur ta garantojmë sigurinë dhe ta kthejmë besimin e qytetarëve në organet e rendit dhe sigurisë.

Sipas Indeksit Global të Paqes për vitin 2022, shteti ynë është në grupin e 36 shteteve më të sigurta në botë, dhe shteti i parë në Ballkanin Perëndimor për sa i përket sigurisë, me avancim prej 67 vendeve krahasuar me vitin 2017.

Gjithashtu, kemi promovuar dhe përfunduar politika në funksion të reformave në fushën e rendit dhe sigurisë. Këtu mund ta theksojmë reformën që po bëhet në polici, e cila synon harmonizimin me rekomandimet e GRECO-s, në bazë të së cilës janë bërë ndryshime në Ligjin e Punëve të Brendshme, nga të cilat mund të veçojmë:

- Ofrimi i garancive ligjore shtesë për pavarësinë operacionale të policisë në raport me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB);
- Lidhja e marrëdhënies së punës pa shpallje publike në MPB vetëm për punët për të cilat në aktin e sistematizimit të vendeve të punës, për shkak të llojit dhe natyrës së detyrave të punës, si dhe kushteve të veçanta në të cilat kryhen, konstatohet se mund të zhvillohet procedura e punësimit pa shpallje publike;
- Prezantimi i detyrimit me rastin e lidhjes së marrëdhënies së punës, më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e lidhjes së kontratës së punës, të punësuarit duhet të dorëzojnë deklaratën e gjendjes së pasurisë dhe të interesave në njësinë organizative

kompetente në MPB, me qëllim të respektimit të dispozitave të Ligjit të Parandalimit të Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit;

- Krijimi i njësisë së posaçme organizative përgjegjëse për zhvillimin e procedurave për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore në rastet e përcaktuara me Ligjin e Punëve të Brendshme, që filloi të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimit të ligjit, respektivisht nga muaji prill i vitit 2023;
- Rritja e kushteve të reja të përgjithshme për lidhjen e marrëdhënies së punës në MPB, përkatësisht: që personi të mos jetë anëtar i partisë politike ose anëtar i organeve dhe organeve të një partie politike dhe ta ketë kaluar testin e integritetit;
- Prezantimi dhe rregullimi i testit të integritetit, i cili ka funksionin e parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare, që ka implikim përkatës edhe në procesin e avancimit të të punësuarve në MPB;
- Reduktuam dukshëm dukurinë e kërcënimeve hibride dhe sulmeve nëpërmjet internetit dhe rrjeteve sociale, shpërndarjes së lajmeve të rreme, dezinformative dhe gjuhës së urrejtjes;
- Në drejtim të luftës kundër korrupsionit brenda policisë, realizuam vendosjen e më shumë se 700 kamerave trupore për anëtarët e forcave të rendit që njëherit ndikoi pozitivisht edhe në ngritjen e profesionalizmit të punës së nëpunësve policorë;
- Implementuam projektin për vendosjen e Numrit të Vetem të Thirrjeve Urgjente (Emergency 112);
- Implementuam zgjidhje softuerike, me ç'rast do të bëhet monitorimi i plotë i armëve të zjarrit dhe municionit, nga momenti i hyrjes në kufijtë e shtetit, duke kaluar në doganë, dhe deri tek shitoret e specializuara dhe qytetarët;
- Me qëllim të rritjes së efikasitetit për zgjidhjen e shpejtë të hetimeve dhe rasteve të krimit realizuam lidhjen e bazave forenzike të policisë së shtetit dhe Interpolit;
- I reduktuam gjobat dhe dënimet për qytetarët dhe bizneset, përmes vendosjes së metodologjisë progresive në varësi nga të ardhurat e tyre.

Përveç kësaj, në fushën e rendit dhe sigurisë është bërë përparim në luftën kundër terrorizmit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në përputhje me objektivat e përcaktuara në Planin e përbashkët të veprimit për luftimin e terrorizmit për Ballkanin Perëndimor dhe Marrëveshjen e re dypalëshe të zbatimit. Strategjitë nacionale për luftimin e terrorizmit (2023-2027) dhe Parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (2023-2027), në bashkëngjitje me plane veprimi, u miratuan në muajin maj të vitit 2023.

Duhet të ceket edhe Marrëveshja e statusit për bashkëpunimin operacional në menaxhimin e kufijve me Agjencinë Europiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare (Frontex) që hyri në fuqi më 1 prill të vitit 2023, duke mundësuar fillimin e një operacioni të përbashkët me vendosjen e policisë kufitare nga vendet anëtare të BE-së për të ofruar përkrahje në kufi, si dhe për kontrollin dhe menaxhimin e migracionit të parregullt dhe krimit ndërkufitar.

Në drejtim të ngritjes së nivelit të rendit dhe sigurisë në periudhën e ardhshme 4 vjeçare do të angazhohemi:

- Në vazhdimin e reformimit në mënyrë proaktive të strukturave përgjegjëse për luftimin e krimit të organizuar me fokus në rritjen e kapaciteteve operacionale dhe bashkëpunimit;

- Në sigurimin e zbatimit dhe monitorimit efektiv të strategjive nacionale për luftën kundër terrorizmit (2023-2027), kundër ekstremizmit të dhunshëm (2023-2027) dhe të Planit të përbashkët të veprimit kundër terrorizmit;
- Në kryerjen e regjistrimit sistematik të migrantëve dhe përmirësimin e profilizimit të ndjeshëm ndaj mbrojtjes;
- Në implementimin e qasjes sistematike për ta luftuar kontrabandën e migrantëve dhe përafrimin e legjislacionit nacional me listën e vendeve të kërkuara për viza të BE-së;
- Në finalizimin dhe miratimin e Planit emergjent për menaxhimin e flukseve të mëdha të migrimit;
- Do të vazhdojmë me modernizimin e pajisjeve policore dhe furnizimin e automjeteve të reja motorike, si dhe modernizimin e njësive ajërore përmes furnizimit të helikopterëve të rinj;
- Me qëllim avancimin e resurseve njerëzore në organet e policisë dhe në veçanti për pozitat udhëheqëse, do të vendosim si kusht dhënien e provimeve të specializuara për pozitat e reja udhëheqëse;
- Do të vazhdojë implementimi i modeleve të avancuara të trajnimeve të nëpunësve policorë, duke dashur që të investojmë në kualitetin e kuadrove dhe shërbimeve policore. Me këtë dëshirojmë ta mbindërtojmë perceptimin dhe ndërlihdjen pozitive mes policisë dhe shoqërisë;
- Angazhimi i stafit të pensionuar të policisë, në procesin e trajnimit dhe edukimit të gjeneratave të reja të policëve, duke marrë parasysh eksperiencën e tyre në fushën e caktuar. Kjo do të bëhet përmes vendosjes së kriterëve strikte mbi atë se cilët kuadro të pensionuara do të mund të japin kontribut për përkrahjen dhe diseminimin e njohurive të akumuluar ndërr vite drejt gjeneratave të reja të nëpunësve policorë;
- Duke respektuar parimet e meritokracisë, do të vendosim prioritete ku kuadrot e diplomuara dhe kualitative në lëminë e kriminalistikës do të kenë prioritet gjatë punësimit në forcat e rendit;
- Do ta implementojmë dhe ndryshojmë Ligjin e Kundërvajtjeve për Prishjen e Qetësisë së Qytetarëve nga Zhurma, Muzika e Zhurmshme dhe të gjithë Faktorët e tjerë që Ndikojnë në Prishjen e Qetësisë Publike. Këtë do ta bëjmë me qëllim që të mund të dënohen të gjithë individët dhe subjektet të cilët prishin qetësinë publike në çdo kohë të ditës;
- Do ta bëjmë ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ta mundësuar funksionalizimin e Policisë Komunale e cila do të merret me rendin dhe sigurinë në nivel lokal, duke parandaluar dhe vepruar ndaj shkeljeve më të vogla dhe formave më të lehta të kriminalitetit.

Qytete të sigurta. Siguria e qytetarëve është dhe do të mbetet një nga prioritetet tona kyçe programore. Për arritjen e këtij qëllimi vazhduam me procesin e implementimit të sistemit - Qytete të sigurta, përmes vendosjes së videosistemeve të observimit në kohë reale në të gjitha rrugët kryesore dhe udhëkryqet e qyteteve tona. Me këtë kemi arritur ta rrisim nivelin e rendit dhe sigurisë për qytetarët në Tetovë, Shkup dhe Kumanovë, si dhe përgjatë rrugëve rajonale dhe lokale të vendit. Në mandatin e ardhshëm do të vazhdojmë me implementimin e këtij projekti edhe në qytetet e tjera. Ky projekt ka mundësuar që dukshëm të reduktohet kriminaliteti dhe ka ndihmuar pjesëtarët e policisë në kryerjen e shpejtë dhe efikase të

punëve ditore, si dhe zbardhjen e shpejtë të rasteve si vjedhjet, krimet e rënda apo kundërvajtjet e trafikut.



2. JO RUSISË, PO EUROPËS

- *Integrimi në Bashkimin Europian*
 - *Ndryshime kushtetuese në 2024*
 - *Hapja e kapitujve në bisedimet për anëtarësimin në BE në 2024*
 - *Antarësim në Bashkimin Europian në 2030*
- *Bashkëpunimi rajonal*
 - *Procesi i Berlinit*
 - *Plani i Bashkimit Europian për rritje ekonomike të Ballkanit Perëndimor*
- *Gjeopolitika dhe NATO-JA*
 - *Mbi 2% e PBB buxhetit për mbrojtje sipas vendimit të NATO-s*
 - *Unifikim i qëndrimeve të sigurisë dhe politikës së jashtme sipas NATO-s*
 - *Unifikim i qëndrimeve të sigurisë dhe politikës së jashtme me Bashkimin Europian*
 - *Jo ndikimit Rus në Maqedoninë e Veriut*
- *Partneritet dhe dialog strategjik me SHBA*
 - *Siguria, sundimi i ligjit, ekonomia dhe tregtia, regjimi i vizave dhe kultura*

2.1. INTEGRIMI NË BASHKIMIN EUROPIAN

Integrimi në Bashkimin European mbetet një nga objektivat tona kryesore strategjike dhe programore. Pas tejkalimit të bllokadës së procesit integrues dhe hapjes së negociatave për anëtarësim me BE-në, do t'i shrytëzojmë të gjitha kapacitetet politike dhe mundësitë institucionale për të vazhduar me fazën e dytë të negociatave për anëtarësim apo hapje të kapitujve.

I. HAPJA E NEGOCIATAVE PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EUROPIAN

Maqedonia e Veriut, pas një pritjeje të gjatë 18 vjeçare, arriti t'i hapë **negociatat me BE-në** dhe të përparojë në rrugën e integrimit european. Sot njihemi si faktor i stabilitetit rajonal, si shtet i cili përmes dialogut konstruktiv dhe diplomacisë zgjidh çështjet e hapura me shtetet fqinje.

Më 19 korrik të vitit 2022, në Bruksel u mbajt Konferenca e parë ndërqeveritare e negociatave për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në Bashkimin European. Në të njëjtën ditë u zhvillua takimi i parë formal për të nisur procesin e rishikimit analitik të legjislacionit european, apo procesin e skringut.

Skringu me Komisionin European. Skringu bilateral filloi zyrtarisht më 15 shtator të vitit 2022 dhe përfundoi më 7 dhjetor të vitit 2023. Ishte një operacion gjithëpërfshirës dhe dinamik, që zgjati plot 15 muaj, ku morën pjesë 900 ekspertë nga administrata e Maqedonisë së Veriut, që realizuan mbi 850 prezantime përhapura 800 ekspertëve të Komisionit European.

Gjatë skringut, Komisioni European prezantoi më shumë se 4.500 masa, akte, rregullativa dhe direktiva të cilat Maqedonia e Veriut do të duhet t'i transponojë në legjislacionin nacional.

Sa i përket **harmonizimit të legjislacionit**, vlen të theksohet se Maqedonia e Veriut ka diku 45% harmonizim të legjislacionit nacional me atë të Bashkimit European, që është nivel shumë i mirë i harmonizimit dhe korespondon me mesataren e harmonizimit të vendeve si Serbia dhe Mali i Zi, të cilat që 10 vite kanë hapur negociatat për anëtarësim në BE.

Pas përmbylljes së skringut, Maqedonia e Veriut në Komisionin European ka dorëzuar tre udhërrëfyesit, edhe atë: Udhërrëfyesin për sundimin e së drejtës dhe Udhërrëfyesin për reformën në administratën publike, që sipas metodoilogjisë së re për anëtarësim në BE, paraqesin kusht për hapjen e Klasterit të Parë – Vlerat Fundamentale. Udhërrëfyesi i tretë, Funksionimi i institucioneve demokratike është gjithashtu një dokument i rëndësishëm, por nuk paraqet kusht për hapjen e klasterit të parë.

Ajo që varej nga aspekti teknik, si dhe realizimi profesional i detyrimeve, u përmbush me sukses. Sfidë mbetet përmbushja e detyrimeve politike që rezultojnë nga korniza negociuese për hapjen e bisedimeve me BE, apo miratimi i ndryshimeve kushtetuese, që shteti të mund

të vazhdojë në fazën e dytë të bisedimeve, apo hapjen e klasterëve në procesin e negociatave për antarësim në BE.

ii. PLANI I RITJES PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Komisioni Europian në muajin maj të vitit 2023, paralajmëroi Planin e rritjes për Ballkanin Perëndimor, i cili u zyrtarizua dhe u prezantua si propozim nga KE më 8 nëntor të vitit 2023, si pjesë e Pakos së zgjerimit, bashkë me Raportin vjetor të Komisionit Europian mbi progresin e Maqedonisë së Veriut.

Plani i rritjes për Ballkanin Perëndimor është mekanizmi apo instrumenti më kryesor për integrim të përshpejtuar dhe zhvillim ekonomik të rajonit dhe përbëhet nga 4 shtylla kryesore:

- Integrimi ekonomik në Tregun e Vetëm të Bashkimit Europian;
- Nxitja e integritit ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor;
- Përshpejtimi i procesit reformues sa i përket reformave fundamentale;
- Rritja e përkrahjes financiare për reforma dhe zhvillim të vendeve të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet Instrumentit të Reformës dhe Rritjes (Reform and Growth Facility).

Ky plan do të na mundësojë që të avancojmë në mënyrë të shpejt dhe të sigurt në procesin e negociatave, duke kapur hapin me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, të cilët tani më që një dekadë negociojnë me BE-në. Me këtë plan, qytetarët e Maqedonisë së Veriut do të mund t'i shfrytëzojnë disa nga përfitimet dhe të mirat që i ofron anëtarësimi në Bashkimin Europian, përpara se shteti ynë të bëhet anëtar i plotë i Unionit.

Plani i rritjes gjithashtu synon t'i reduktojë disparitetet ekonomike në mes ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe ekonomive të shteteve anëtare të BE-së. Kjo bëhet me të vetmin qëllim që pas anëtarësimit në BE, vendet e Ballkanit Perëndimor si shtete anëtare të reja, të mundën të funksionojnë dhe të jenë konkurruese brenda Tregut të Vetëm të BE-së.

Përshpejtimi i integritit në BE, duke vazhduar me krijimin dhe zbatimin e politikave reformuese dhe përmbushjen e standardeve. Kjo do të bëhet përmes shfrytëzimit të mekanizmave të **Planit të rritjes për Ballkanin Perëndimor**, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, me qëllim të **anëtarësimit të plotë në BE deri në vitin 2030**.

Do të vazhdojmë të angazhohemi që Maqedonia e Veriut të përparojë dhe të jetë një shtet europian dhe modern, demokratik, me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Përshpejtimi i integritit në BE dhe vazhdimi i procesit të reformave, përfundimi i kornizave institucionale dhe ligjore mbeten prioritet në mënyrë që të hyjmë me përgjegjësi dhe të përparojmë në fazën përfundimtare të integritit në BE. Në mandatin e ri hyjmë me gatishmëri të plotë për këtë hap historik në zhvillimin dhe transformimin e tërësishëm të shoqërisë sonë.

Së bashku me BE-në, duhet të gjejmë përgjigje ndaj krizës energjetike, migracionit, ekstremizmit në rritje, dhe ajo që është e rëndësishme për ne, të gjejmë përgjigje për

marrëdhëniet me shtetet candidate, kandidatët potencialë për anëtarësim në BE, me theks të veçantë në kontekstin e sfidave të reja të sigurisë me të cilat përballet Europa (kërcënimet hibride, ndryshimet klimatike etj.).

iii. QASJE MË E MIRË NË FONDET EUROPIANE

Me fondet e Bashkimit Europian, më shumë projekte për qytetarët, bizneset dhe shoqërinë. Fondet e Bashkimit Europian paraqesin komponentin kryesor zhvillimor ekonomik të shtetit tonë. Me shfrytëzimin maksimal të këtyre fondeve do të përkrahet një shoqëri solidare, infrastrukturë moderne, bujqësi produktive, zhvillim ekonomik, mbrojtje e mjedisit jetësor, tranzicion i gjelbër energjetik, si dhe institucione efikase dhe në shërbim të qytetarëve.

Fondet nga programi i ri IPA 3 do të sigurojnë më shumë projekte zhvillimore për komunat, shkollat, organizatat e shoqërisë civile, uljen e papunësisë me theks të veçantë tek të rinjtë, zhvillimin dhe promovimin e sipërmarrësisë dhe bizneset e vogla dhe të mesme.

Një histori suksesi që vlen të ceket është programi IPARD2, në të cilin kishim shkallë më të lartë të realizimit në rajon me 98% absorbim të mjeteve. Si rezultat i këtij suksesi, fondet IPARD të BE-së të dedikuara për shtetin tonë u rritën nga 60 në 97 milionë euro për programin IPARD3.

Për këtë arsye, në të ardhmen do të fokusohemi edhe më shumë në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për absorbimin e fondeve strukturore dhe kohezive të Bashkimit Europian, me të cilat do të krijojmë një shoqëri dhe ekonomi të qëndrueshme dhe produktive.

Të vetëdijshëm për mundësinë zhvillimore që ofrojnë fondet dhe programet e ndryshme të ndihmës nga Bashkimi Europian, në mandatin e ardhshëm do të angazhohemi që t'i përmbushim këto masa dhe politika konkrete:

- Hapja e qendrave lokale apo rajonale për informim dhe asistencë rreth fondeve të BE-së, ku qytetarët dhe bizneset do të mund të informohen dhe të marrin asistencën e nevojshme profesionale për atë se si të aplikojnë dhe si të arrijnë më shpejt deri tek fondet zhvillimore të BE-së;
- Sigurimi i fondit shtetëror për kofinancimin e projekteve cilësore - Kompanitë, bizneset dhe qytetarët që do të kenë projekte cilësore dhe do të aplikojnë në programet e financimit të BE-së, por që nuk kanë mundësi kofinancimi, do ta fitojnë të drejtën e përkrahjes shtetërore për projektet e tyre. Me këtë masë do ta ndihmojmë drejtpërdrejt ekonominë, bizneset dhe do ta rrisim shkallën e absorbimit të fondeve europiane në shtetin tonë;
- Për stimulimin e shfrytëzimit të fondeve të BE-së nga qytetarët dhe bizneset, do të parashohim pako lehtësuese tatimore, me theks të veçantë në kompanitë e vogla dhe të mesme.

iv. REFORMAT DHE NDRYSHIMET KUSHTETUESE PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EUROPIAN

Vazhdimi i procesit të reformave të brendshme me qëllim të anëtarësimit në Bashkimin European deri në vitin 2030. Anëtarësimi i vendit në BE është i lidhur ngushtë me procesin e reformave të brendshme për ruajtjen e demokracisë dhe vlerave të saj. Është fakt se procesi i skringut mbaroi dhe se tani mbetet të lëvizim shpejt dhe me vendosmëri drejt fazës së dytë dhe përfundimtare për anëtarësim të plotë në BE, por vëmendja dhe kultivimi i vlerave themelore të demokracisë si: sundimi i së drejtës, gjyqësori i pavarur dhe i paanshëm, mediat e lira, zgjedhjet e lira dhe demokratike, mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, administrata efikase dhe e profesionalizuar, ekonomia e lirë e tregut, digjitalizimi, mbrojtja e mjedisit jetësor, etj., janë vlera dhe procese që kërkojnë përkushtim të vazhdueshëm dhe duhet mbrojtur e zhvilluar për hir të sigurimit të jetesës më cilësore të qytetarëve tanë.

Miratimi i ndryshimeve kushtetuese mbetet kushti politik pa të cilin Maqedonia e Veriut nuk mund të vazhdojë procesin tani më të filluar të negociatave për anëtarësim të plotë në Bashkimin European. Që ta arrijmë synimin tonë strategjik dhe të bëhemi anëtarë të BE-së deri në vitin 2030, duhet ta përmbushim në afat sa më të shkurtër këtë detyrim dhe kjo për ne paraqet vijë të kuqe nga e cila nuk ka reterim dhe nuk mund të jetë pjesë e kompromiseve politike.

Ndryshimet kushtetuese janë obligimi ynë, të parapara në Kornizën negociuese të hapjes së negociatave me Bashkimin European, prandaj duhet të tregojmë pjekuri dhe kredibilitet se detyrimet e ndërmarra i përmbushim ashtu siç edhe i kemi dakorduar.

Me miratimin e ndryshimeve kushtetuese vazhdojmë negociatat për anëtarësim në Bashkimin European, me ç'rast do të mbahet edhe Konferenca e dytë ndërqeveritare me Bashkimin European dhe si shtet do të fillojmë me hapjen e Klasterit të Parë -Vlerat Themelore, duke mbetur të përkushtuar maksimalisht edhe në procesin e reformave të brendshme.

2.2. BASHKËPUNIMI RAJONAL

Arritëm që përmes politikave të fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit të ndërsjellë me vendet fqinje dhe ato të rajonit ta kthejmë mirëbesimin dhe bashkëpunimin rajonal në një mundësi dhe realitet zhvillimor që po jep efektet e dëshiruara sinergjike sa i përket integritetit të rajonit në BE dhe zhvillimit rajonal ekonomik.

Përmes nismës Forumi i Prespës për Dialog, arritëm të krijojmë një platformë solide të bashkëpunimit rajonal e cila përveç bashkëpunimit ekonomik synon të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve bilaterale mes vendeve të rajonit.

Marrëveshja e Prespës paraqet hap të rëndësishëm, vlera e së cilës më së miri pasqyrohet me anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Si rezultat i kësaj, u lidhën marrëveshje, me ç'rast ndryshimet kushtetuese poashtu nuk mund të kthehen prapa.

Marrëveshja për fqinjësi të mirë me Bullgarinë poashtu mbetet në fuqi dhe në pajtim me parimin **Pacta Sunt Servanda (Marrëveshjet duhen respektuar)** dhe si rrjedhojë mbetet obligim i legjislaturës dhe Qeverisë së ardhshme që të punojnë për respektimin e plotë të saj.

Më nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve dëshmuam se jemi partner dhe lojtar konstruktiv në skenën politike rajonale dhe se vetëm përmes dialogut dhe vullnetit të mirë mundemi të adresojmë dhe të gjejmë zgjidhje për të gjitha sfidat dhe mosmarrëveshjet në rajon.

Ruajtje e marrëdhënieve të mira me vendet fqinje dhe vendet e tjera të rajonit - Ballkani Perëndimor njihet si rajon në të cilin çështjet e hapura midis vendeve fqinje zgjojnë shumë vëmendje. Në këtë drejtim, zgjidhja e kontestit me Republikën e Greqisë ishte shkak për bllokadë dekadëshe nga Greqia për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO. Tanimë, ajo çështje është përmbyllur dhe ngelet që t'i ruajmë raportet e mira ndërfaqinësore me vendet fqinje: Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës, Republikën e Serbisë, Republikën e Greqisë dhe Republikën e Bullgarisë, ku për këtë të fundit, vend të posaçëm kanë ndryshimet kushtetuese për njohjen e komunitetit bullgar në Kushtetutë.

Kontribut dhe pjesëmarrje aktive në Procesin e Berlinit. Efektet e Procesit të Berlinit, si nismë për rritjen e përafrimit dhe bashkëpunimit rajonal para anëtarësimin të plotë në Bashkimin Evropian, tanimë janë të dukshme në shumë sfera të jetës së qytetarëve tanë. Pjesëmarrja jonë aktive në takime, organizime, forume të niveleve të ndryshme në kuadër të Procesit të Berlinit do të mbetet si pikë prioritare për politikën e jashtme të 2024-2028.

Në kuadër të Procesit të Berlinit në vitin 2022 nënshkruam dhe vendosëm në fuqi 3 marrëveshje, edhe atë:

- Marrëveshja për lëvizje të lirë në Ballkanin Perëndimor me letërnjoftime;
- Marrëveshja për pranim të kualifikimeve të arsimit të lartë/diplomave që mundëson mobilitet më të madh të studentëve dhe të punësuarve akademikë dhe procedurat për pranim të diplomave shkurtohen në mënyrë të theksuar, nga disa muaj në 2 javë dhe pa shpenzime plotësuese;
- Marrëveshja për pranim të kualifikimeve profesionale për mjekët, stomatologët dhe arkitektët, që do të mundësojnë që profesionistë nga këto fusha të mund të ofrojnë shërbime profesionale pa kufizime në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Procesi i Berlinit paraqet një platformë kyçe rajonale e cila fokusohet në infrastrukturë, biznes, shkencë, shkëmbim (mobilitet) të rinjve përmes programeve të ndryshme, por edhe harmonizim të politikave të cilat kanë implikime dhe ndikim direkt në jetën e qytetarëve, siç është **Marrëveshja rajonale për roaming**, e cila mundëson lehtësime dhe benefite për qytetarët e rajonit.

Përforcimi i bashkëpunimit rajonal, në përputhje me idenë e krijimit të nismave të reja që nuk do të ishin zëvendësim për anëtarësimin në BE, por kanë për qëllim thellimin e bashkëpunimit në nivele dhe sektorë me interes të përbashkët dhe që do të pëshpejtojnë integrimin e rajonit në BE, respektivisht nëpërmjet:

- Bashkëpunimit më të madh ekonomik;
- Konkurrueshmërisë dhe plasmanit të prodhimeve vendase në tregjet e vendeve të rajonit dhe mënjanimin të barrierave tregtare;
- Reduktimit të kohës së pritjes në pikat kufitare;
- Mobilitetit më të madh të kuadrove profesionale në tregun rajonal të punës;
- Investimeve të përbashkëta rajonale, në formën e projekteve infrastrukturore dhe energjetike.

Do të mbetemi partner konstruktiv nëpërmjet afirmimit të fqinjësisë së mirë dhe respektit reciprok me të gjitha vendet e rajonit. Të përforcohen marrëdhëniet me vendet e rajonit, bazuar në respektimin e parimeve të tolerancës, respektimin e dallimeve, solidaritetit në arritjen e objektivave të përbashkëta.

Përforcimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me vendet fqinje, veçanërisht me Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës.

Përkrahja e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Republika e Kosovës si vend fqinj, vend me të cilin kemi lidhje të ngushta gjuhësore, kombëtare dhe kulturore ka parashtruar kërkesë për anëtarësimin e saj në Këshillin e Europës, në NATO, etj..

Republika e Maqedonisë së Veriut, si vend anëtar i plotë në këto organizata relevante ndërkombëtare gëzon të drejtën e votës së plotë dhe në këtë drejtim do të qëndrojmë në krah të Republikës së Kosovës duke e përkrahur drejt anëtarësimit të plotë të saj, në pajtim me politikën shtetërore të RMV-së.

Me Republikën e Shqipërisë tashmë jemi partner në disa nisma rajonale dhe ndërkombëtare. Bashkë filluam dhe përfunduam fazën e parë të procesit të negociatave për anëtarësim në BE, apo procesin e skringut. Ky partneritet bazohet në shkëmbimin e eksperiencave, njohurive dhe përkrahjes së ndërsjellë drejt anëtarësimit të plotë në BE.

2.4. GJEOPOLITIKA DHE NATO-JA

Gjeopolitika. Në rrafshin gjeopolitik dhe të politikës së jashtme, Maqedonia e Veriut është e pozicionuar për arritjen e synimeve strategjike të shtetit siç janë anëtarësimi në NATO, objektiv të cilin tashmë e kemi arritur, si dhe anëtarësimi i plotë në Bashkimin Europian, ku tanimë i kemi hapur bisedimet, me ç'rast nga ne si shtet pritës t'i plotësojmë obligimet që rezultojnë nga korniza negociuese, me qëllim që të arrijmë të bëhemi shtet anëtar i plotë i Bashkimit Europian deri në vitin 2030.

Sa i përket politikës së jashtme, Maqedonia e Veriut është plotësisht e harmonizuar me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Europian, fakt ky i cili u vlerësua edhe në Raportin e Komisionit Europian mbi progresin e Maqedonisë së Veriut.

Pjesëmarrja në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) të BE-së bazohet në vendosmërinë politike për të ndarë objektivat dhe përparësitë e saj përpara se të fitojë

anëtarësimin e plotë në Bashkimin Europian. Në këtë mënyrë, vendi mund të kontribuojë aktivisht në përpjekjet e BE-së për përmirësimin e paqes dhe stabilitetit global. Prandaj, Maqedonia e Veriut dhe BE-ja rregullisht zhvillojnë konsultime politike, si dhe me ekspertë për çështje që kanë të bëjnë me PPJS-në, të cilat synojnë të vendosin qëndrime kryesore të përbashkëta në rrafshin ndërkombëtar, por edhe zhvillim të kapaciteteve institucionale për pjesëmarrje në politikën e përbashkët të BE-së.

Ndër të tjera, pranimi i vendit në deklarata të përbashkëta, deklarata dhe akte të tjera ligjore të Bashkimit Europian është një aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit në këtë fushë. Është e rëndësishme të theksohet fakti se është arritur një shkallë e lartë e përputhshmërisë me qëndrimet e Bashkimit Europian, siç vlerësohet në raportet e progresit të Komisionit Europian mbi vendin.

Në lidhje me Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, e cila është një komponent i rëndësishëm në politikën e jashtme të BE-së, Maqedonia e Veriut kontribuon në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, përmes pjesëmarrjes (me personel dhe ekspertizë) në Misionin Ushtarak të BE-së - EUFOR Althea (Bosnja dhe Hercegovina).

Në raport me rritjen e pjesëmarrjes në misionet ndërkombëtare të udhëhequra nga BE-ja, në bashkëpunim me Republikën e Francës dhe në përputhje me kapacitetet e vendit tonë, Maqedonia e Veriut merr pjesë me personel në Misionin e BE-së - EUTMRCA (Misioni Trajnues i BE-së në Republikën e Afrikës Qendrore).

Gjatë këtyre viteve kemi marrë pjesë aktive në të gjitha proceset sa i përket realizimit të prioriteteve të politikës së jashtme dhe të përkushtuar në përmbushjen e qëllimeve strategjike të shtetit. Kjo nënkupton ndërtimin e shtetit si anëtar të NATO-s, që ishte një nga qëllimet tona programore të cilin tashmë e kemi përmbushur.

NATO-JA. Anëtarësimi në NATO për Maqedoninë e Veriut është garanci e integritetit territorial, paqes, stabilitetit, me ç'rast ky aspekt, tani theksohet akoma më shumë duke marrë parasysh gjendjen aktuale në skenën politike europiane me marrëdhëniet e trazuara gjeopolitike si pasojë e luftës në Ukrainë, zgjidhja e të cilave sigurisht që do të jetë një sfidë në vitet e ardhshme.

Aleanca Veriatlantike udhëhiqet nga parimi i “mbrojtjes kolektive” që nënkupton se sulmi ndaj një shteti anëtar është sulm ndaj të gjithë aleatëve. Ky parim është i përcaktuar në nenin 5 të Marrëveshjes së Uashingtonit, ku u themelua Aleanca Veriatlantike në vitin 1949 dhe që tani paraqet aleancën më të fuqishme politiko-ushtarake në botë me gjithsej 32 shtete anëtare.

Anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO mundësoi pjesëmarrje më të madhe të Armatës në misionet dhe stërvitjet e përbashkëta ndërkombëtare, si dhe rritje të rrogave të pjesëtarëve të Armatës. Gjithashtu, u rritën kriteret e nevojshme për ushtarët profesionistë, si dhe profesionalizimi i dukshëm i Armatës. Bashkë me aleatët tanë jemi vendimmarrës të barabartë në Aleancën Veriatlantike.

Duke qenë vend anëtar i NATO-s, si shtet jemi më rezistent ndaj kërcënimeve globale të kohës siç janë: terrorizmi global, ndyshimet klimatike, pandemitë, kërcënimet kibernetike dhe hibride, përmes krijimit të kapaciteteve nacionale, si dhe shfrytëzimit të mekanizmave të mbrojtjes kolektive të cilat i kemi në disponim si vend anëtar i NATO-s.

Përforcimi i aktiviteteve për promovimin e politikave të NATO-s është angazhim të cilin do ta vazhdojmë në mënyrë që të përmirësohet perceptimi i Maqedonisë së Veriut si vend anëtar i NATO-s nëpërmjet ngritjes së vetëdijes, mirëkuptimit dhe informimit më të mirë të të gjitha aspekteve, duke filluar nga kontributi i përbashkët në Aleancën Veriatlantike, ashtu edhe në drejtim të përfitimeve që kemi si shtet nga anëtarësimi në NATO.

Në NATO, jemi aleat i barabartë i cili kontribuon në drejtim të paqes dhe sigurisë në nivel global. Duke marrë parasysh se jemi shtet i vogël me burime dhe mundësi të kufizuara, anëtarësimi në NATO, na mundësoi ta rrisim ndikimin tonë gjeopolitik si vend anëtar i plotë dhe i barabartë i Aleancës Veriatlantike.

2.4. PARTNERITET DHE DIALOG STRATEGJIK ME SHBA-NË

Prioritet i politikës së jashtme në rrafshin gjeopolitik, mbetet ruajta e marrëdhënieve të mira diplomatike dhe bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjegjësisht avancimi i partneritetit strategjik. SHBA-ja mbetet partnerja jonë kryesore në skenën globale gjeopolitike dhe avancimi i këtij bashkëpunimi do të vazhdojë përmes dialogut strategjik.

Maqedonia e Veriut ishte shteti i parë në Ballkanin Perëndimor që filloi procesin e Dialogut Strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo për ne dëshmon se jemi partner i besueshëm dhe faktor kyç i stabilitetit dhe promovimit të vlerave demokratike në rajon.

Do të punojmë drejt përforcimit të bashkëpunimit në të gjitha nivelet me partnerët strategjikë e sidomos me SHBA-në, e cila është përkrahësja më e madhe e pavarësisë dhe stabilitetit të vendit tonë. Intensifikimi i bashkëpunimit me SHBA-në pasqyrohet në pesë fusha kyçe:

- Bashkëpunimi në fushën e sigurisë;
- Sundimi i ligjit;
- Bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar;
- Regjimi i vizave;
- Bashkëpunimi kulturor.

Në rrethanat e reja me zhvillimet aktuale gjeostrategjike, partneriteti strategjik me SHBA-në është jetik për stabilitet, paqe dhe prosperitet në vend.

3. MARRËVESHJE E KONSENSUSIT EKONOMIK

- *Partneritet në politikbërje midis sektorit publik, privat dhe civil*
- *Ekonomi konkurruese dhe transformim digjital*
- *Zhvillim i qëndrueshëm dhe transformim i gjelbër*
- *Infrastrukturë moderne dhe zhvillim i barabartë rajonal*
- *Kapitali njerëzor dhe cilësia e jetës*
- *Rini aktive dhe shoqëri e barabartë*

PARTNERITET NË POLITIKBËRJE

Synimi ynë është standard më i lartë i qytetarëve me standarde europiane në vendin tonë dhe ekonomi me mundësi të barabarta për të gjithë. Për të realizuar këtë na duhet një konsensus në shoqëri, ashtu siç është Marrëveshja e Ohrit, Marrëveshja e Prespës, Marrëveshja e fqinjësisë së mirë, na duhet një Marrëveshje e Konsensusit Ekonomik, gjegjësisht Marrëveshje Kornizë Ekonomike e cila dhe do të definojë prioritetet e rritjes ekonomike të përsheptuar dhe të qëndrueshme me mundësi të barabarta për të gjithë.

Konsensusi ekonomik do të arrihet me një konsensus politik dhe shoqëror, partneritet duke respektuar parimet për dialog sistemor, gjithëpërfshirje dhe prioritet strategjike.

Partneritet në politikbërje. Partneriteti me të gjithë palët e interesuara, politikëbërësit, rregullatorët, komunitati i biznesit, sindikatat e punëtorëve, organizatat e konsumatorëve, akademia dhe shoqëria civile, pensionistë, rini, mbrojtësit e mjedisit, kulturë, sport, etj.

Dialog sistemor dhe i qëndrueshem. Reformat strukturore dhe politikat e qëndrueshme kërkojnë dialog të vazhdueshëm për debat publik me qëllim të arritjes së zgjidhjeve më optimale. Dialog i vazhdueshëm dhe sistemor është jetik në arritje të vendimeve të qëndrueshme duke përfshirë të gjitha palët e interesuara të shoqërisë, si dhe gjithë spektrin politik (shumicë parlamentare dhe opozitë).

Proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Rritja e mirëbesimit midis gjithë përfaqësuesëve në shoqëri do të arrihet nëpërmjet transparencës dhe përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara në procesin e vendimmarrjes.

Strategji me prioritet dhe objektiva të qarta. Për të realizuar me sukses synimin për një të ardhme me standard europian dhe mundësi të barabarta për të gjithë duhet strategji me prioritet dhe objektiva të qarta dhe indikator matës. Strategji e cila përcakton reformat strukturore dhe politikat të qëndrueshme për rritje ekonomike të përsheptuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Ekonomi konkurruese, inovative e bazuar në kapital njerëzor, qeverisje të mirë, infrastrukturë moderne dhe të qëndrueshme, energji të sigurt, ekonomi të gjelbër dhe transformim digjital.

Mundësi të barabarta për të gjithë. Ekonomi e lirë e tregut me konkurrencë të ndershme dhe zhvillim të barabartë rajonal dhe infrastrukturë që krijon mundësi të barabartë ne ekonomi për të gjithë pjesëmarrësit pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, kulturore, gjinore dhe grupe tjera të shoqërisë.



3.1. EKONOMI KONKURRUESE DHE TRANSFORMIM DIGJITAL

- *Rritje e përshpejtuar*
 - *Rritje ekonomike mesatare mbi 5% në nivel vjetor*
 - *Çmime stabile me inflacion vjetor prej 2%*
 - *Rritje e investimeve në ekonomi për 10% në nivel vjetor*
 - *Investime të huaja direkte mbi 3 miliardë euro për periudhën 2024-2028*
 - *Paga neto mesatare 900-1.000 euro në vitin 2028*
 - *Papunësia do të bjerë në nivel nën 7% në vitin 2028*

- *Financa të qëndrueshme*
 - *Financa “SMART”, të digjitalizuara, transparente, IFMIS (Sistemi i Integruar i Financave)*
 - *Akademi e Financave Publike*
 - *Menaxhim efikas i investimeve publike*
 - *Ristrukturim dhe menaxhim i suksesshëm i ndërmarrjeve shtetërore publike*
 - *Menaxhim transparent, efikas dhe hartë e ndihmave shtetërore*

- *Buxhet transparent, zhvillimor dhe konsensual*
 - *Rritje e shpenzimeve kapitale nga 733 milionë euro në 2024, në 1.1 miliardë euro në 2028*
 - *Rritje e subvencioneve dhe transfereve ekonomike nga 410 milionë euro në 2024, në 640 milionë euro në 2028*
 - *Rritje e transfereve për komunat nga 485 milionë euro në 2024, në 710 milionë euro në 2028*
 - *“Rregulla fiskale” me deficit buxhetor 3% dhe borxh i jashtëm nën 60%*
 - *“Vlera e parasë” për politikën buxhetore dhe indikatorë të performancës*
 - *Bllokvargu për subvencionet buxhetore*
 - *Instrumente inovative për financim të buxhetit: bono të qytetarëve, bono të gjelbra, bono zhvillimore*

- *Tatime të drejta dhe të ndershme*
 - *Transparencë dhe efikasitet i institucioneve tatimore*
 - *Ridefinim i tatimit personal në tatimin familjar dhe debat për tatimin progresiv*
 - *Ulje e tatimit personal efektiv me lehtësim tatimor deri 50% të pagës minimale*
 - *“Tax free” për konsumatorët jorezidentë*
 - *“Sugar tax” për produktet jo të shëndetshme*
 - *Mundësi për “freelancer” të paguajnë kontribute dhe të sigurojnë stazh dhe sigurim shëndetësor*
 - *Dy norma të kontributeve në shëndetësi, në vend të normës aktuale prej 7.5%: pako bazike 5% dhe pako e zgjeruar 10%, për të siguruar shërbime shëndetësore cilësore*
 - *Rishikimi i akizave për duhan dhe alkool për të ndihmuar kujdesin shëndetësor*
 - *“Tatime të gjelbra” për ta ruajtur mjedisin jetësor*

- *Mjedis i mirë për biznes dhe ekonomi konkurruese*
 - *Digjitalizim tatimor: e-fiskalizim, e-faturë, “track & trace”*
 - *Zvogëlim i rregullativës dhe ulje e taksave parafiskale*
 - *Kalendari tatimor*
 - *Listë e bardhë dhe listë e zezë e taksapaguesve*
 - *Ndal ekonomisë joformale*
 - *Qasje më e lehtë në financa: kredi koncesionuese, garanci kreditore, crowdfunding, business angels, lehtësime tatimore, fond zhvillimor*
 - *Specializim i zgjuar: ekosistem inovativ, transformim digjital, kapital njerëzor*
 - *Promovim i eksportit dhe kyçje në zinxhirin global të vlerës së shtuar*
 - *Masa aktive në tregun e punës: trajnim, vetëpunësim dhe hapje të vendeve të reja të punës*
 - *Garancia për të rinjtë*
 - *Nxitje e integruar e investimeve të huaja direkte me teknologji të avancuar dhe vlerë shtesë të lartë*
 - *Agjencia e zhvillimit dhe diplomacia ekonomike*

- *Digjitalizim i ekonomisë dhe shërbimeve publike*
 - *Digjitalizim i shërbimeve të biznesit dhe bankave*
 - *Digjitalizim i shërbimeve publike*
 - *Komitet Nacional për Intelejencë Artificiale*

3.1.1. KONTEKSTI EKONOMIK 2020-2023

Menaxhimi i suksesshëm i ekonomisë gjatë krizave të shumta, krizës së pandemisë së Covid-it, krizës energjetike dhe të çmimeve, të shkaktuara nga lufta e Rusisë në Ukrainë

- Në periudhën 2020-2023 u miratuan **nëntë pako masash antikrizë me vlerë prej 2.7 miliardë eurove, që paraqet 20% të PBB-së vjetore në atë periudhë.**
- Janë mbrojtur më shumë se **263.000 vende pune, me ç'rast është siguruar asistencë për më shumë se 35.000 kompani dhe është ofruar përkrahje direkte financiare për 538.478 shfrytëzues** nga kategoritë e ndjeshme sociale (309.337 shfrytëzues nga radhët e të papunësuarve, të rinjve dhe të punësuarve me paga të ulëta neto; 41.878 shfrytëzues të ndihmës sociale dhe 187.263 pensionistë me të ardhura më të ulëta).
- Me masat antikrizë dhe politikat e tjera **u lehtësua efekti negativ i krizës së Covid-it në rritjen ekonomike**, me ç'rast rënia reale e projektuar fillimisht e PBB-së prej -8.4% u lehtësua në rënie prej -4.7% në vitin 2020.
- Për përballimin e pandemisë, krizës energjetike dhe rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore, sipas raporteve të Bankës Botërore në Maqedoninë e Veriut është siguruar **përkrahja më e madhe buxhetore në rajonin e Ballkanit Perëndimor.** Ndihma financiare e përgjithshme deri në muajin mars të vitit 2022 arriti në 4.9% të PBB-së ose dy herë më shumë se përkrahja buxhetore e siguruar në Serbi, si vendi i dytë i radhitur (Western Balkans Regular Economic Report, no. 21, Banka Botërore, Spring 2022).

Siguroam baza të mirëfillta për rritje të qëndrueshme dhe të përshpejtuar ekonomike, si dhe standard më të lartë jetese për qytetarët

- Rimëkëmbja ekonomike lidhur me PBB-në kthehet në nivelin e para Covid-it deri në mesin e vitit 2022. **Kemi arritur rritje të vazhdueshme gjatë krizës më të madhe globale, përkatësisht 4.5% në vitin 2021, 2.2% në vitin 2022 dhe 3.0% në vitin 2023** me projeksion të rritjes prej 3.4% në vitin 2024;
- **PBB-ja për banor në vitin 2023 arriti në 7905 euro, që krahasuar me vitin 2020 kur ishte 5.236 euro, paraqet rritje nominale prej 51% (ose 34% më shumë nëse korrigohet sipas rezultateve të Regjistrimit në vitin 2021);**
- **Shkalla e papunësisë ka shënuar rënie** edhe gjatë krizës dhe ka arritur nivelin më të ulët historik prej 12.8% në vitin 2023, për diferencën nga 17.3% dhe 16.4% në vitin 2019 dhe 2020. Ky është rekord në nivel të ulët në historinë e pavarur ekonomike. Tashmë vitin e ardhshëm pritet normë njëshifrore e papunësisë;
- **Inflacionin e shkaktuar nga kriza të shumta e ulëm me sukses dhe në muajin dhjetor të vitit 2023 krahasuar me vitin 2022, u ul në nivel prej 3.6%,** që vetëm një vit më parë ishte 19.8% në muajin tetor të vitit 2022. Në muajin janar të vitit 2024, norma e inflacionit ulet më tej në 3.2%;
- **Vendosëm sistemin e rritjes së pagës minimale, e cila në muajin mars 2024 do të arrijë mbi 22.500 denarë.** Krahasuar me 14.500 denarët në muajin janar të vitit 2020, u arrit rritje prej 55.2%;
- **Paga mesatare neto është rritur në nivel prej 40.000 denarëve** në muajin dhjetor të vitit 2023, që paraqet rritje prej 57.5% në krahasim me vitin 2020;

- **Vendosëm sistemin e rritjes konstante të pensioneve, me ç’rast pensioni mesatar në muajin dhjetor të vitit 2023 arriti në 20.200 denarë, që është 38.4% më i lartë në krahasim me katër vitet paraprake.** Sipas metodologjisë së re, e vendosur me ndryshimet e fundit në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor nga muaji mars i vitit 2022, pritet që në muajin mars të vitit 2024 të kemi rritje të mëtejshme;
- Pensionin minimal e rritëm në nivel prej 12.530 denarëve nga 8.970 denarë sa ishte para katër viteve.
- **Pagat në sektorin publik janë rritur çdo vit** në katër vitet e fundit, në sektorë të ndryshëm, përkatësisht në shëndetësi, arsim, shërbime të sigurisë dhe inspektorate, si dhe në të gjithë administratën publike në vitin 2023. Rritja është nga 43.2% në 61.8% në sektorë të caktuar;
- **Ulja e shkallës së varfërisë në nivelin më të ulët historik,** përkatësisht në vitin 2023 ulet në 17.9% nga 20.1% (për 20% krahasuar me vitin 2020, sipas vlerësimeve të Bankës Botërore sa ishte në vitin 2020);
- **Paga mesatare neto është 85% e konsumit të përgjithshëm në muajin tetor të vitit 2023,** krahasuar me 76% në raport me katër vitet paraprake. Për herë të parë, shuma e një page mesatare neto dhe një page minimale neto është mbi shportën e konsumit dhe kjo është 30% më e lartë;
- Përkrahja e qytetarëve dhe **reduktimi i ekonomisë joformale përmes “TVSH-ja lme”, me ç’rast qytetarëve u janë kthyer mbi 150 milionë euro** për katër vite.

3.1.2. RITJE E PËRSHPEJTUAR DHE FINANCA TË QËNDRUESHME

i. PËRSHPEJTIM I RITJES EKONOMIKE

Rritje ekonomike mbi 5% në nivel vjetor. Në periudhën 2024-2028 do ta përshpejtojmë rritjen ekonomike duke realizuar rritje të PBB-së mesatarisht prej 5.1% në nivel vjetor. Rritja në periudhën afatmesme do të nxitet nga kërkesa e brendshme, ndërkohë që eksporti neto pritet të ketë kontribut negativ, që gradualisht do të ngushtohet.

Rritje e standardit jetësor, PBB-ja për banor 11.600 euro në vitin 2028. PBB-ja për banor do arrijë 11.600 euro në vitin 2028 krahasuar me 7.260 në vitin 2023. Gjithashtu, PBB-ja për banor do të rritet edhe në krahasim me mesataren e BE-së.

Rritje e investimeve mbi 10% në nivel vjetor. Analiza e zhvillimit ekonomik tregon se investimet do të luajnë një rol kyç në këtë periudhë dhe pritet të shënojnë rritje mesatare vjetore prej 10.1%, bazuar në rritjen e pritur të investimeve private, si dhe impulsin fiskal të pritshëm që do të kanalizohet nëpërmjet rritjes së shpenzimeve kapitale në buxhet. Pjesëmarrja e investimeve në PBB do të rritet në 38% në vitin 2028 krahasuar me 32% në vitin 2023. Kjo do të bazohet edhe në investimet inovative dhe teknologji të reja që do ta rrisin produktivitetin dhe aftësinë konkurruese të ekonomisë së vendit me çka do të rritet eksporti me dinamikë më të shpejtë se importi. Gjithashtu, krahas investimeve vendore, do të vazhdojmë t’i përkrahim investimet e huaja direkte kryesisht me vlerë të shtuar dhe teknologji

të re që do hapin vende të reja pune dhe do ta vendosin ekonominë tonë më lartë në zinxhirin e vlerës së shtuar në ekonominë botërore.

Stabilizimi i çmimeve dhe kursi devizor i paluhatshëm. Në periudhën 2024-2028 do ta stabilizojmë normën e inflacionit në 2%. Kursi devizor i valutës së vendit ndaj euros do të jetë i paluhatshëm dhe stabil.

Zvogëlimi i normave të interesit dhe rritja e kreditimit për investime. Do të rritet dinamika e bankave gjatë kreditimit sa i përket sektorit privat për investime dhe rritje ekonomike, me ç'rast normat e interesit do të zvogëlohen në nivel nën 3% si rezultat i fluksit devizor në ekonominë vendore, liberalizimit të mëtejshëm të tregut financiar dhe depërtimit në treg të institucioneve financiare jobankare dhe fondeve investuese për financimin e sektorit privat në ekonominë e vendit.

Rritja e eksportit dhe zvogëlimi i deficitit tregtar. Me politikat e përkrahjes së investimeve në teknologji të reja dhe përkrahjes së eksportit, do të përshpejtohet rritja e eksportit (mbi 10% në nivel vjetor) në krahasim me importin (6-7% në nivel vjetor) dhe me këtë do të zvogëlohet deficitit tregtar dhe do të përfitohen tregje të reja.

Investimet e huaja direkte mbi 3 miliardë euro. Deri në vitin 2028 do të realizohen mbi 3 miliardë euro investime të huaja direkte në ekonominë e vendit, gjegjësisht mesatarisht 4% e PBB në nivel vjetor.

Rritja e produktivitetit në ekonominë vendore. Me përkrahje të investimeve në teknologji të re dhe sektorë me vlerë të shtuar më të lartë do të rritet produktiviteti dhe aftësia konkurruese e ekonomisë.

Paga mesatare neto do të arrijë vlerën prej rreth 56.000 denarëve. Pagat reale do të rriten mbi 6% për çdo vit dhe paga mesatare neto do të arrijë vlerën prej rreth 56.000 denarëve në vitin 2028.

Zvogëlim i papunësisë në nivel njëshifror, nën 7%. Papunësia do të zvogëlohet nën 7%, historikisht norma më e ulët që nga pavarësimi, gjegjësisht hera e parë që kjo shifër të jetë njëshifrore.

Zvogëlimi i nivelit të varfërisë në nivel nën 12%. Do të vazhdojmë me trendin e zvogëlimit të nivelit të varfërisë nga 17.9% në vitin 2023 në nivel nën 12% në vitin 2028.

ii. FINANCA PUBLIKE TË ZGJUARA (SMART)

Financat publike janë baza e funksionimit të ekonomisë dhe do të bazohen në konceptin e financave publike të zgjuara "SMART". Ato do të jenë transparente, efikase dhe të parashikueshme. Shpërndarja do jetë e drejtë dhe lojale duke u bazuar në prioritetet zhvillimore dhe "vlerën e parasë", respektivisht paratë e qytetarëve do të destinohen atje ku japin më shumë efekt për mirëqenien e tyre. Financat SMART do të mundësojnë planifikimin

afatmesëm, respektimin e rregullave fiskale dhe vendosjen e indikatorëve të performancës për implementimin e politikave.

Menaxhimi i financave publike. Në menaxhimin e financave publike do të përqëndrohem në këto prioritete:

- Avancimi i analizave ekonomike, kornizës makroekonomike dhe fiskale (rritje e kapaciteteve njerëzore dhe insitucionale);
- Mobilizimi i të hyrave fiskale (rritje e efikasitetit dhe zvogëlim i ekonomisë joformale);
- Planifikimi afatmesëm dhe inkluziv i buxheti (instalim i kritereve të performancës);
- Prokurimi publik transparent dhe efikas (digjitalizim, transparencë dhe përgjegjësi);
- Proceset horizontale të menaxhimit të financave publike (digjitalizim i procesit buxhetor dhe thesarit);
- Përforsimi i kontrollit të brendshëm financiar publik (për rritjen e përgjegjësisë);
- Përforsimi i kontrollit të jashtëm dhe mbikëqyrja parlamentare (për rritjen e llogaridhënies);
- Avancimi i financave publike në nivel lokal (decentralizim fiskal, disiplinë dhe përgjegjësi).

Akademia e Financave Publike. Duke u nisur nga rëndësia e menaxhimit të financave publike do fillojë me funksionimin e saj Akademia e Financave Publike për rritjen e kapaciteteve njerëzore të të gjithë nëpunësve financiarë në sektorin publik.

Digjitalizimi i financave publike. Në bashkepunim me Bashkimin Europian dhe Bankën Botërore do ta zhvillojmë Sistemin e Integruar Informativ Financiar, i cili do sigurojë efikasitet dhe transparencë më të lartë. Me këtë do të integrohen të dhënat dhe proceset të thesari i shtetit, të hyrat publike, doganat dhe ndihmat shtetërore, si dhe financat publike në nivel të pushtetit qendror dhe atij lokal (komunat).

Menaxhimi i investimeve publike. Do të përmirësohet menaxhimi me investimet publike me krijimin e njëjseve organizative të financave publike në nivel qendror, krijimi i Regjistrimit të investimeve me partneritetet private-publike, si dhe modifikimi i menaxhimit të investimeve në nivel të projektit me njësitë e implementimit.

Ristrukturimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe publike. Do të ndërmerren masa për ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe publike me qëllim që të mos punojnë me humbje dhe do të shqyrtohen forma të ndryshme të funksionimit të tyre, duke përfshirë racionalizimin, partneritetet private-publike dhe format e tjera.

Sistem transparent dhe efikas i ndihmave shtetërore. Racionalizim, prioritizim dhe transparencë më e lartë e sistemit të ndihmave shtetërore në funksion të rritjes së efikasitetit të ndihmave për investime dhe rritje ekonomike me sistemin e ri të digjitalizuar.

iii. BUXHET ZHVILLIMOR, KONSENSUAL DHE TRANSPARENT

Konsensualitet. Transparencë dhe shpërndarje të drejtë të buxhetit dhe financave publike. Vazhdim i praktikave dhe mekanizmave për konsensus në Qeveri për buxhetin e propozuar në shpërndarje të shpenzimeve kapitale, dotacioneve për komunat, subvencioneve, si dhe programet në sektorë të ndryshëm, respektivisht në arsim, kulturë, shkencë, infrastrukture komunale, zhvillim rural, bujqësi, mjedis etj.

Rregulla fiskale. Qëndrueshmëri e buxhetit me respektimin e rregullave fiskale, gjegjësisht, deficitit buxhetor jo më i lartë se 3% e PBB dhe borxhi i jashtëm jo më i lartë se 60% e PBB-së.

Buxhet zhvillimor. Struktura e shpenzimeve buxhetore do të përfshijë komponent zhvillimor më të lartë, gjegjësisht do të vazhdojnë të rriten shpenzimet kapitale në buxhet dhe do të arrijnë në nivel mbi 5% e PBB-së (për dallim nga dekada e kaluar kur mesatarisht kanë qenë në nivel prej 2-3% e PBB-së). Githashtu, do të vazhdojnë të rriten subvencionet për përkrahje të rritjes ekonomike.

“Rregulla e artë fiskale”. Deficiti buxhetor do të jetë më i ulët se shpenzimet kapitale, gjegjësisht deficitit do të shfrytëzohet vetëm për shpenzime kapitale. Huazimi për financimin e deficitit, gjegjësisht projekteve zhvillimore do të bëhet me norma të interesit më të ulëta se rritja ekonomike.

“Vlera e parasë”. Për t’i menaxhuar në mënyrë më optimale prioritetet programore dhe për ta rritur cilësinë dhe transparencën e politikave buxhetore, do të vendoset në funksion njësi organizative e “vlerës së parave” që do të krijojë indikatorë të performacës për shpenzimet buxhetore sipas prioriteteve programore. Kjo do të kontribuojë në kursime buxhetore dhe optimizim të shpenzimeve fiskale.

“Bllokvargu” (Blockchain) për subvencionet buxhetore. Promovim i teknologjive digjitale dhe metodave “bllokvargje” për ta rritur kontrollin dhe efikasitetin e subvencioneve buxhetore me qëllim që të sigurohemi që mjetet destinohen sipas programeve dhe politikave përkatëse.

Financimi inovativ i buxhetit. Një nga qëllimet kryesore të menaxhimit të borxhit publik është të mundësojë zhvillimin e tregut vendas të titujve të vlerës së shtetit, duke krijuar kushte për zvogëlimin e riskut të rrefinancimit të borxhit, rezistencën ndaj goditjeve eksterne dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjate të borxhit. Me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të tregut financiar për bonot e shtetit dhe për t’i ndjekur praktikën botërore, do të vazhdojmë me diversifikimin e burimeve të financimit dhe në promovimin e llojeve të reja të instrumenteve financiare që do të zbatohen në mënyra të ndryshme: **Fletobligacionet e gjelbra, Fletobligacionet projektuese, Fletobligacionet e qytetarëve dhe Fletobligacionet e denacionalizimit.**

iv. POLITIKA TATIMORE TË DREJTA DHE LOJALE

Reforma e sistemit dhe politikës tatimore do të synojë:

- **Drejtësi dhe lojalitet (ndershmëri) në tatim.** Vendosja e drejtësisë në tatim, me qëllim që secili ta plotësojë detyrimin e tij shoqëror dhe ta paguajë pjesën e tij të drejtë të tatimeve. Rezultatet e pritshme përfshijnë modelin e ri të tatimit të drejtë, implementimin e standardeve për parandalimin e zvogëlimit të bazës së tatimit dhe zhvendosjen e fitimeve (BEPS), rishikimin e legjislacionit nacional për t'i përmbushur kërkesat e BE-së;
- **Efikasitet në mobilizimin e të hyrave tatimore.** Për efikasitet më të lartë të sistemit tatimor për arkëtimin më të mirë të të hyrave, përmes luftës më efektive kundër veprimtarive të pa-regjistruara dhe evazionit fiskal, si dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale, analizën dhe rregullimin e bazës tatimore, zvogëlimin e detyrimeve tatimore të munguara dhe zbatimin e Regjistrimit të pronarëve të vërtetë. Disa prej masave të parashikuara për përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit të sistemit për arkëtimin e tatimeve përfshijnë rishikimin e rregullativave tatimore ekzistuese, zbatimin e teknologjive të përparuara, përforsimin e kapaciteteve institucionale, modernizimin dhe automatizimin e proceseve të punës, koordinimin institucional, si dhe bashkëpunimin e përforsuar ndërkombëtar;
- **Transparencë më të lartë tatimore.** Përmirësim të shkëmbimit të informacionit midis organeve tatimore dhe subjekteve të tjera, që do të bazohet kryesisht në shërbimet elektronike dhe digjitalizimin e proceseve. Me këtë prioritet pritet të rezultojë përmirësimi i “mosnjohësve tatimorë” dhe një pajtim më i madh vullnetar me tatimet;
- **Cilësi më të mirë të shërbimeve.** Thjeshtim dhe përsheptim i proceseve, si dhe reduktim i ngarkesës administrative. Rezultatet e synuara përfshijnë një nivel më të lartë të shërbimeve digjitale, menaxhim më të mirë të lëshimit të lejeve të importit-eksportit, eliminim të barrierave të panevojshme jotarifore dhe kontroll më të mirë të brendshëm dhe tatimor.
- **Politika tatimore të “gjelbra”.** Politika tatimore për uljen e aktiviteteve që kontribuojnë në ndotje të mjedisit jetësor. Qëllimi kryesor është lufta kundër ndotjes dhe mbrojtja e burimeve natyrore për të arritur zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Tatimi mbi të ardhurat personale:

- Hapja e debatit për **tatimin e të ardhurave në nivel të familjes** (p.sh.: SHBA-ja, Republika e Francës etj.) si opsion (alternativë) e sistemit aktual të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kjo do ta lehtësojë ngarkesën tatimore në nivel të familjes (amvisërisë);
- **Lirimi nga tatimi personal në nivel deri 50% të pagës minimale** dhe kjo do të jetë lehtësim për të gjithë pavarësisht nivelit të pagës. Me këtë masë, tatimi efektiv për pagën minimale do jetë 5% dhe njëherit do të shqyrtohen mundësitë dhe **modalitetet për rimbursim**, kështu që tatimi personal për kategorinë me paga minimale do të jetë 0%;

- **Hapja e debatit për modelet e tatimit progresiv**, si dhe shqyrtimin e mundësisë për normë tjetër tatimore për dallimin e të ardhurave më të larta se 10 paga minimale bruto.

Tatimi mbi fitimin:

- Përafrimi dhe zbatimi i plotë i Shtyllës së Dytë – Rregullat e Modelit Global kundër Erozionit Bazë, sipas Kornizës Gjithëpërfshirëse të OECD-së dhe G20 kundër erozionit bazë dhe zhvendosjes së fitimit, të cilat, ndër të tjera, parashikojnë normën minimale tatimore prej 15% për kompanitë e mëdha shumëkombëshe.
- Hapja e debatit për mundësitë e përjashtimit të pjesëshëm nga tatimi mbi fitimin për riinvestimin e fitimeve (50% e investimeve) për investime në tranzicion të gjelbër, digjitalizim, kërkime dhe zhvillim (R&D).

Tatim mbi vlerën e shtuar:

- Shqyrtimi i mundësisë për **“tax free”**, gjegjësisht rimbursimi i një pjese të TVSH-së për shtetasit e huaj që konsumojnë ose harxhojnë në vendin tonë;
- Rishikimi dhe riprojektimi i konceptit **“TVSH-ja ime”** për të optimizuar në funksion të formalizmit të ekonomisë joformale;
- Diskutimi dhe shqyrtimi i politikave tatimore në funksion të mbrojtjes së shëndetit të konsumatorëve (psh, **“sugar tax”** taksat e sheqerit për produktet që përmbajnë një sasi më të lartë sheqeri dhe që konsiderohen si një nga shkaqet e peshës më të lartë trupore, etj.).
- Hapja e debatit për **TVSH progresiv**, gjegjësisht riformatim të normave aktuale të TVSH (0%, 5%, 10% dhe 18%), me qëllim të zbutjes së efektit regresiv që ka modeli aktual i TVSH për konsumatorët.

Kontributet nga sigurimet shoqërore të detyrueshme:

- Regjistrimi vullnetar i profesionistëve të lirë **“freelancer”** në sistemin e sigurimeve pensionale (shtylla e parë dhe e dytë e sigurimit të detyrueshëm pensional);
- Vendosja e **dy normave të kontributeve për shëndetësinë**, duke pasur parasysh se promovojmë modelin e sigurimit shëndetësor me dy pako, **pako bazike dhe pako e zgjeruar**, zvogëlimi i normës aktuale (nga 7.5% në 5%) dhe vendosja e një norme tjetër për pakon e zgjeruar (10%). Kjo do ta rrisë cilësinë e shërbimeve shëndetësore;
- **“Tavani”** aktual i pagesës së kontributeve deri në 16 paga mesatare do të tërhiqet për sigurimin shëndetësor bazik që do duhet ta paguajnë (me normë më të ulët se ajo aktualja), ndërsa pakoja e zgjeruar do të jetë opsion vullnetar.

Akcizat:

- Rishikimi i akcizës për duhan dhe alkool me qëllim të **financimit të kujdesit shëndetësor parandalues** dhe për t'iu përgjigjur sfidave të ardhshme të sistemit shëndetësor në sanimin e pasojave të dëmshme afatgjate nga pirja e duhanit dhe alkoolit.

V. PLANI I RITJES EKONOMIKE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Një stimul shtesë për dinamizimin e rritjes ekonomike pritet edhe nga “Plani i rritjes për Ballkanin Perëndimor” i promovuar nga Bashkimi European. Zbatimi i këtij plani duhet ta përshpejtojë rritjen në rajon dhe konvergjencën drejt BE-së dhe ta dyfishojë PBB-në për banor në dhjetë vitet e ardhshme. Vlera e përgjithshme e këtij plani është **6 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor**, nga të cilat 850 milionë euro do të jenë për vendin tonë. Plani i rritjes do të bazohet në këto shtylla:

- 1) **Rritja e integritit ekonomik me Tregun e Vetëm të Bashkimit European**, me kusht që Ballkani Perëndimor të përafrohet me rregullat e tregut të vetëm dhe të hapë sektorët dhe zonat përkatëse për të gjithë fqinjët e tyre njëkohësisht, në përputhje me Tregun e Përbashkët Rajonal;
- 2) **Nxitja e integritit ekonomik në kuadër të Ballkanit Perëndimor përmes Tregut të Përbashkët Rajonal**, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, të cilat potencialisht mund të rrisin për 10% në ekonomitë e tyre;
- 3) **Përshpejtimi i reformave themelore**, duke përfshirë reformat themelore, përkrahjen e rrugës së Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, përmirësimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe përforcimin e stabilitetit rajonal;
- 4) **Rritja e asistencës financiare për përkrahjen e reformave nëpërmjet lehtësimit të reformave dhe rritjes për Ballkanin Perëndimor**, instrument i ri me vlerë prej 6 miliardë eurove si përkrahje e pakthyeshme dhe përkrahje kreditore, me pagesë të kushtëzuar nga partnerët e Ballkanit Perëndimor që t’i përmbushin reformat themelore dhe në veçanti reformat socio-ekonomike specifike.

Prioritetet e integritit në Tregun e Vetëm të BE-së, do të jenë të fokusuar në këto fusha:

- Lëvizja e lirë e mallrave;
- Lëvizja e lirë e të punësuarve dhe shërbimeve;
- Qasja në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA);
- Lehtësimi dhe modernizimi i transportit rrugor;
- Integrimi dhe dekarbonizimi i tregjeve të energjisë;
- Tregu i Vetëm Digjital;
- Integrimi në zinxhirët e furnizimit industrial.

Prioritetet nacionale për Agjendën reformuese, do të fokusohen në këto fusha:

- Qeverisja e mirë: Reformat në administratën publike dhe Menaxhimi i financave publike;
- Energjia dhe tranzicioni i gjelbër: Reformat e tregut energjetik, Energjia ripërtëritëse dhe Efikasiteti energjetik;
- Digjitalizimi: Siguria kibernetike, Infrastruktura digjitale dhe Shërbimet publike të digjitalizuara;
- Kapitali njerëzor: Arsimi cilësor dhe Aftësia për punë;
- Klima e biznesit dhe Zhvillimi i sektorit privat: Formalizimi i ekonomisë joformale, Transparenca dhe efikasiteti i ndihmave shtetërore, Përkrahja e NVM-ve, Ekosistemi

inovativ (Smecializimi i zgjuar), Reformat në ndërmarrjet publike (hekurudhat, posta, etj), E-doganat dhe lehtësimi i procedurave, si dhe Sistemi intelegjent i transportit.

3.1.3. MJEDIS I MIRË PËR BIZNES DHE EKONOMI KONKURUESE

Ekonomia konkurruese, e krijuar mbi baza të qëndrueshme të ndërmarrjeve është dhe vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore në politikën ekonomike zhvillimore të vendit. Rritja e qëndrueshme e shoqërive dinamike, inovative dhe rezistente është në masë të madhe nën ndikimin e mjedisit në të cilin ato operojnë. Pritet që pranimi në BE, ta përmirësojë në mënyrë të theksuar mjedisin e biznesit dhe ta shtrijë rrugën drejt integritimit më të suksesshëm në ekonominë globale.

- Rregullativë e qartë, gjyqësor i drejtë dhe shërbime publike efikase;
- Tatime lojale dhe të parashikueshme;
- Konkurrencë lojale dhe luftë kundër ekonomisë joformale;
- Ndihmë shteterore efikase dhe transparente;
- Qasje më e lehtë në financa për bizneset;
- Infrastrukturë moderne dhe strategjike;
- Arsim cilësor dhe shkathtësi pune;
- Inovacione, sipërmarrësi dhe specializim i zgjuar;
- Masa aktive në tregun e punës;
- Tranzicion i gjelbër dhe digjital.

i. RREGULLATIVË E QARTË, GJYQËSOR I DREJTË, SHËRBIME PUBLIKE EFIKASE DHE NDAL KORRUPSIONIT

Rregullativë e qartë dhe lehtësim i procedurave. Legjislacion i qartë dhe transparent me procedura të diskutimit paraprak me komunitetin e biznesit dhe gjithë palët e interesuara. Lehtësim i procedurave për licenca dhe leje për aktivitet biznesi. Rregullim i çështjeve pronësore dhe juridike duke e garantuar të drejtën e pronës si e drejtë universale dhe kushtetuese.

Gjyqësor i drejtë dhe i paanshëm. Gjyqësor efikas, profesional dhe i paanshëm, me procedura transparente dhe të përshpejtuara që garanton drejtësi për bizneset, investitorët dhe të gjithë pjesëmarrësit në ekonomi dhe shoqëri. Digjitalizim i proceseve gjyqësore, veting në pushtetin gjyqësor dhe prokurori.

Shërbime publike efikase dhe profesionale. Administratë profesionale dhe efikase, duke implementuar afate për shërbimet publike dhe norma për cilësinë e shërbimeve, transparencë dhe digjitalizim.

Ndal korrupsionit dhe burokracisë inerte. Çdo vonesë e paarsyshme nga byrokracia dhe tehnokratët do të konsiderohet si bazë për korrupsion dhe do të dënohet. Tolerancë zero për çdo akt dhe tentative korruptuese nga sporteli deri te krimi i organizuar.

Regjistër dhe reduktim i parataksave parafiskale. Do të instalohet regjistër i gjithë taksave parafiskale dhe reduktim i tze me qëllim të lehtësimit të kostove të biznesit.

Digjitalizim i liçencimit. Transparenca dhe digjitalizimi i proceseve në dhënien e liçencave, sidomos në urbanizëm do të përshpejtojë procesin e investimeve dhe ndërtimeve.

ii. TATIME TË NDRSHME DHE TË PARASHIKUESHME

Sistemi tatimor i drejtë dhe ndershëm. Tatimet do të vlejné njëjtë për të gjithë obliguesit tatimorë dhe do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe barazisë sociale.

Kalendari tatimor. Publikimi i kalendarit për ndryshimet e legjislacionit tatimor me plan njëvjeçar për rritjen e parashikueshmërisë së politikave tatimore dhe t'i ndihmojë bizneset në planifikimet e tyre.

Digjitalizimi i shërbimeve dhe administratës tatimore dhe doganore. Promovimi i faturës elektronike (e-fatura), fiskalizimit elektronik (e-fiskalizimi), sistemit elektronik doganor “ndiq dhe gjurmo” (track and trace) për ndjekjen e mallrave me akcizë (nafta, duhani dhe alkooli) dhe digjitalizimi i tërësishëm i procedurave tatimore dhe doganore.

Kontrolli dhe inspektimet profesionale, sistemore dhe efikase. Qasje sistemore dhe efikasitet në kontrollin e të gjitha inspektorateve dhe drejtoritë e të hyrave publike. Kontroll i brendshëm në Administratën Tatimore dhe Doganore, si dhe inspektoratet.

Ndal taksapaguesve të papërgjegjshëm. Rishikimi i listave të obliguesve tatimorë që kanë borxh tatimor të pashlyer dhe zgjidhje për të kryer obligimet ndaj shtetit dhe buxhetit duke kufizuar qasjen në shërbimet publike, licenca dhe koncesionime.

Lista e bardhë e taksapaguesve. Do të publikohet lista e taksapaguesit me kontribut më të lartë në arkën e shtetit në bazë të tatimeve dhe të hyrave tjera publike (publikimi do të jetë me pëlqimin paraprak të taksapaguesve duke ruajtur të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale ose konfidencialitetin e biznesit).

iii. KONKURENCË LOJALE, NDAL EKONOMISË JOFORMALE DHE MONOPOLEVE

Ndal ekonomisë joformale. Qasje sistemore dhe gjithëpërfshirëse do të zbatohet për ndalimin e ekonomisë joformale e cila shkakton efekt negativ fiskal të drejtpërdrejtë, por edhe impakt negativ mbi konkurrencën e tregut dhe kështu largon investorët dhe dëmton zhvillimin e vendit. Strategjia për formalizimin e ekonomisë joformale do të fokusohet në këto prioritetë:

- Përforcimi i kapaciteteve të administratës publike për detektim, gjurmim dhe adresim të ekonomisë joformale;
- Digjitalizimi i proceseve me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të dhënave, analizën, raportimin dhe monitorimin e ekonomisë joformale;
- Avancimi i rregullativës ligjore dhe efikasiteti i implementimit të saj;
- Përmirësimi i mjedisit të biznesit, përmirësimi i shërbimeve publike dhe krijimi i kornizës stimuluese për formalizimin e ekonomisë joformale;
- Rritja e efikasitetit të shërbimeve inspektuese dhe sistemit të sanksioneve dhe gjobave;
- Ngritja e ndërgjegjësimit për ekonominë joformale dhe përforcimi i moralit tatimor dhe besimit në institucione;
- Ngritja e parashikueshmërisë në përgatitjen e vendimeve ligjore, politikave dhe masave;
- Nxitja e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Ndal monopoleve dhe oligarkisë. Legjislacioni për ta luftuar konkurrencën jolojale dhe institucionet për mbrojtjen e konkurrencës do të jenë në harmoni të plotë me rregullativat dhe direktivat europiane për tregun e brendshëm dhe konkurrencën. Masat dhe politikat që do ndalojnë monopolet dhe oligarkitë do të jenë pjesë përbërëse në të gjitha politikat ekonomike dhe zhvillimore.

Mbrojtja e konsumatorit. Legjislacioni për tregun e brendshëm dhe institucionet për mbrojtjen të konsumatorëve do të jenë në harmoni të plotë me rregullativat dhe direktivat europiane për tregun e brendshëm dhe informimin e drejtë të konsumatorëve në treg.

Përgjegjshmëria shoqërore. Do të inkurajohen dhe afirmohen praktikat e përgjegjshmërisë shoqërore që mund të aplikojnë bizneset dhe korporatat e ndryshme.

iv. NDIHMA SHTETËRORE EFIKASE DHE TRANSPARENTE

Harta e ndihmave shtetërore. Do të bëhet rivlerësimi dhe riprojektimi i skemave të ndihmës shtetërore për ta rritur efikasitetin e ndihmave shtetërore dhe duke respektuar parimin e tregut funksional. Ndihamat shtetërore do të fokusohen në rritjen e aftësisë konkurruese të vendit nëpërmjet përkrahjes së investimeve, inovacioneve, sipërmarrësisë, tranzicionit të gjelbër dhe digjital, si dhe hulumtimeve dhe teknologjive të reja. Harta e ndihmave shtetërore do t'i sistemojë dhe në mënyrë transparente do t'i paraqesë të gjitha mundësitë dhe përkrahjet që ekzistojnë për ekonominë vendore.

Sistemi Informativ i Menaxhimit të Ndihamave Shtetërore (SAMIS). Sistemi digjital SAMIS do ta rrisë transparencën dhe efikasitetin e ndihmave shtetërore. Do të mundësojë menaxhimin më optimal me burimet e disponueshme dhe efektin në ekonominë e vendit.

Hetimet e rregullta. Metodologji për kryerjen e hetimeve të rregullta, bazuar në riskun sektorial, shënjestrimin e rastësishëm brendasektorial, duke marrë parasysh rastet e dhënies mbi 200,000 euro për kompani. Një minimum prej 5 hetimesh *ex-officio*, të rastësishme, bazuar në riskun, do të kryhen në bazë tremujore).

Trajnimi i gjyqtarëve. Sipas nevojave për trajnim, një numër i mjaftueshëm gjyqtarësh do të jenë të specializuar me qëllim të rritjes së ekspertizës për ndihmën shtetërore në gjykata.

v. QASJE MË E LEHTË NË FINANCA PËR BIZNESET

Qasja në financa është komponent kritik për sipërmarrësit që kërkojnë të fillojnë ose t'i rrisin bizneset e tyre. Për ta përmirësuar qasjen e tyre në burimet financiare, do të promovohen:

Programet e kredive të favorshme. Banka e Zhvillimit do të realizojë programe kreditore të krijuara posaçërisht për sipërmarrësit, veçanërisht për ata në sektorët me rritje të shpejtë. Këto kredi do të jenë me norma interesi më të ulëta dhe kushte më të favorshme se ato të disponueshme nga bankat.

Garancitë e kredisë. Për inkurajimin e bankave dhe institucioneve financiare që të japin hua për startup-et dhe NVM-të (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), do të ofrohen skema garancie kreditore. Kjo zvogëlon riskun për huadhënësit duke garantuar një pjesë të shumave kreditore kundër mospagimit.

Institucionet mikrofinanciare. Përkrahja e zhvillimit dhe qasjes së institucioneve mikrofinanciare mund të jetë e dobishme, veçanërisht për mikrondërmarrjet dhe sipërmarrësit në zonat rurale ose për ato që janë më pak të zhvilluara. Këto institucione zakonisht ofrojnë kredi më të vogla, të cilat janë thelbësore për bizneset që mund të mos kualifikohen për produktet tradicionale bankare.

Stimujt e “investitorëve të engjëjve” dhe kapitalit të sipërmarrjes. Do të promovojmë politika që do inkurajojnë investitorët engjëj (business angels) dhe kapitalistët e sipërmarrjes (venture capital) për të investuar në startup-e dhe biznese të vogla, me ç'rast do të rrisin dukshëm qasjen e sipërmarrësve në financa. Stimujt tatimorë, fondet e bashkëinvestimit dhe proceset e thjeshtuara rregullatore janë shembuj të masave që mund të tërheqin më shumë investime private në ekosistemin fillestar.

Bashkëinvestimet (Crowdfunding). Rregullimi dhe promovimi i platformave crowdfunding, mund të hapë rrugë të reja për sipërmarrësit në drejtim të mbledhjes së fondeve. Politikat që mbrojnë investitorët, ndërsa u mundësojnë bizneseve të mbledhin kapital nga një audiencë e gjerë mund të stimulojnë zgjidhje inovative financimi.

Trajnimi dhe edukimi financiar për sipërmarrësit. Sigurimi i sipërmarrësve me trajnime në edukimin financiar, planifikimin e biznesit dhe menaxhimin mund të përmirësojë aftësinë e tyre për të siguruar financim. Sipërmarrësit e mirëinformuar kanë më shumë gjasa për sukses dhe të bëjnë raste bindëse për huadhënësit ose investitorët e mundshëm.

Bashkëpunimi dhe financimi ndërkombëtar. Lehtësimi i qasjes në tregjet ndërkombëtare dhe financimi nëpërmjet partneriteteve, marrëveshjeve tregtare dhe programeve ndërkombëtare të zhvillimit mund të sigurojë burime dhe mundësi shtesë për sipërmarrësit.

Lehtësimet tatimore. Ofrimi i lehtësimeve tatimore ose stimujve për investime në startup-e dhe biznese të vogla mund t'i inkurajojë si individët ashtu edhe institucionet që të ofrojnë më shumë fonde për sipërmarrësit. Kjo mund të përfshijë taksa të reduktuara mbi fitimet kapitale për investime afatgjata në bizneset e vogla ose kredi tatimore për investime në sektorë të caktuar.

Ndihma financiare nga shteti. Masat për dhënien e përkrahjes financiare përfshijnë përkrahjen e investimeve për zhvillimin teknologjik dhe kërkimet (R&D), transformimin e gjelbër dhe digjital, si dhe për krijimin e vendeve të reja të punës. Përveç masave bazë të përkrahjes financiare, jepet edhe përkrahje financiare shtesë për subjektet afariste të themeluara nga bashkëqytetarët që kanë vendbanim jashtë vendit, ku vlera e përkrahjes financiare rritet për 15% të shpenzimeve të arsyetuara investuese deri në maksimum në milion euro në nivel vjetor. Përveç kësaj, jepet përkrahje financiare shtesë për investimet e realizuara në zonat e pazhvilluara të territorit të vendit përmes Instrumentit për Zhvillim të Balancuar Rajonal. Gjithashtu, do të përkrahet ekonomia e gjelbër përmes financimit të aktiviteteve "Green deal" nga sektori privat, përkrahjes së sipërmarrësisë shoqërore, si dhe përkrahjes së sipërmarrësisë së femrave dhe të rinjve. Këto masa synojnë të ndihmojnë në rritjen dhe zhvillimin e bizneseve, duke krijuar një ambient më të favorshëm për investimet dhe rritjen ekonomike të vendit.

vi. INFRASTRUKTURË MODERNE DHE STRATEGJIKE

Autostrada e Korridorit 8 dhe 10d. Përfundimi i autostradës në Korridorin 8 dhe 10d do ta kompletojë infrastrukturën strategjike për transportin rrugor dhe tregtinë, me çka bëhet lidhja e ekonomisë së vendit me tre kontinente, Europë-Azi-Afrikë. Autostrada Shkup-Bllacë do të rrumbullakojë unazën Shkup-Prishtinë-Tiranë.

Linja hekurudhore e Korridorit 8 dhe 10. Ndërtimi i hekurudhës së Korridorit 8 pjesa lindore që bën lidhjen me Bullgarinë dhe pjesa perëndimore që bën lidhjen me Shqipërinë bashkë me modernizimin e hekurudhës në Korridorin 10 (veri-jug) do ta rrisë sigurinë e transportit, do t'i reduktojë kostot e transportit, si dhe do ta mbrojë mjedisin nga ndotjet e ajrit.

Rrugët rajonale dhe infrastruktura komunale. Sa i përket infrastrukturës do të avancojë infrastruktura rrugore dhe komunale në thellësi të territorit të vendit që do të mundësojë zhvillim të barabartë rajonal dhe do të krijojë mjedis të favorshëm për biznes në mbarë vendin.

vii. ARSIM CILËSOR DHE AFTËSI PUNE

Tejkalimi i mospërputhjeve të aftësive për punë dhe nevojave të tregut. Përforsim i sistemit arsimor për ta adresuar mospërputhjen e aftësive për punë dhe nevojave të tregut, për ta rritur qasjen dhe cilësinë e trajnimit profesional dhe për ta përmirësuar qasjen në mësimin e bazuar në punë dhe arsim të dyfishtë (duke përfshirë përfshirjen e sektorit privat). Rritja e

pjesëmarrjes në arsimin e të rriturve dhe përmirësimi i njohjes së të mësuarit formal dhe joformal.

Aftësi digjitale. Sigurimi i transformimit digjital efektiv, koherent dhe gjithëpërfshirës së arsimit duke integruar Kornizën Europiane për Aftësitë Digjitale në kurikulat nacionale për t'i përmirësuar aftësitë digjitale në vend.

Shkolla të “Zgjuara” (“Smart”). Krijimi i shkollave fillore dhe të mesme “të zgjuara” me mjete TI dhe infrastrukturë interneti duke siguruar gjithashtu funksionimin e tyre (“Smart” si në integrimin e teknologjive digjitale në mësimdhënie ashtu edhe në menaxhimin e shkollës, duke përfshirë komunikimin me familjet, mësimin interaktiv në distancë).

Ngritja e cilësisë së arsimit. Përmirësimi dhe sigurimi i cilësisë së arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë paraqet një nga bazat e strategjisë për kapitalin njerëzor duke vendosur praktika të reformave në programet dhe kurikulat e mësimdhënies dhe modeleve për evaluimin e procesit të arsimit.

viii. NOVACIONE, SIPËRMARRËSI DHE SPECIALIZIM I ZGJUAR

Strategjia për Specializimin e Zgjuar (Smart Specialization Strategy - S3). Si përgjigje ndaj sfidave ekonomike për të siguruar cilësi më të mirë të jetës për të gjithë, Strategjia e specializimit të zgjuar paraqet një model të gjerë për zhvillimin e mëtejshëm të ekosistemit të inovacionit, duke u fokusuar në hulumtim, zhvillim dhe inovacion për një shoqëri dhe ekonomi të qëndrueshme. Ky koncept i ri synon ta nxisë inovacionin rajonal dhe të promovojë modele të rritjes së qëndrueshme duke shfrytëzuar qasje të integruar të parimeve.

Specializimi i zgjuar ofron një rrugë të re drejt investimeve të mirëmenaxhuara në inovacion, duke u fokusuar në shfrytëzimin e burimeve publike, mobilizimin e pasurive lokale dhe kapaciteteve ndërmarrëse. Avantazhi kryesor i këtij koncepti është roli pjesëmarrës i të gjitha palëve të interesuara gjatë procesit të projektimit dhe zbatimit të strategjisë. Kjo do të ndihmojë në tranzicionin drejt një ekonomie të zgjuar, të qëndrueshme, të gjelbër dhe të digjitalizuar. Me anë të implementimit të Strategjisë së specializimit të zgjuar do fokusohemi në nxitjen e rritjes së gjelbër dhe të qëndrueshme, nëpërmjet përfshirjes së inovacionit, dijes dhe teknologjisë, për të krijuar produkte dhe shërbime me vlerë të shtuar, konkurruese në tregun ndërkombëtar dhe të brendshëm me anë të këtyre qëllimeve strategjike:

Krijimi i një shkence të ekselencës. Në këtë drejtim synohet të krijohet bazë për shkencë në fushat e specializimit, duke promovuar njohuritë si burim për zgjidhjen e sfidave shoqërore dhe ekonomike. Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore, internacionalizimi akademik, dhe transferimi i njohurive do ta rrisin konkurrencën dhe pjesëmarrjen në programet europiane të kërkimit dhe zhvillimit. Investimet do të shoqërohen me politika dhe procese për sigurimin e ndikimit dhe përshpejtimin e bashkëpunimit ndërdisiplinor dhe ndërmjet biznesit dhe akademisë. Planet aktive për përmbushjen e strategjisë janë:

- Përmirësimi i burimeve njerëzore për kërkime dhe zhvillim. Financimi për doktoratura, doktoratura industriale, postdoktoratura dhe pozicione kërkimore;

- Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore. Financimi për themelimin ose përmirësimin e laboratorëve në institucione të universiteteve dhe atyre kërkimore, si dhe në infrastrukturë për eksperimente dhe hulumtime në terren;
- Përmirësimi i aktiviteteve të kërkimit të zbatuar për transformimin e gjelbër dhe atë digjital. Financimi për projekte hulumtuese aplikative, veçanërisht ato që kanë marrë vlerësim të cilësisë nga thirrjet e BE-së, duke përfshirë publikimin e punimeve hulumtuese dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore;
- Rritja e internacionalizimit akademik. Anëtarësimi në organizatat profesionale ndërkombëtare dhe infrastrukturat hulumtuese;
- Harmonizimi i rregullave të rëndësishme në përputhje me Strategjinë e specializimit të zgjuar.
- Reformat në politikat e arsimit të lartë, shkencës dhe kërkimit shkencor;
- Ngritja/përforsimi i zyrave për zbatimin e projekteve në universitete.

Përmirësimi i ekosistemit për inovacione. Ekosistemi është kushti themelor për tranzicionin drejt një ekonomie inovative. Ky proces kërkon përforsimin e ekosistemit për inovacione në vend, duke eliminuar mangësitë dhe duke promovuar bashkëveprimin mes të gjitha subjekteve të sistemit të inovacionit - biznesit, shkencës dhe arsimit, si dhe duke përmirësuar mjedisin institucional. Të gjitha masat dhe instrumentet e propozuara në këtë drejtim synojnë krijimin e një ekosistemi të favorshëm për inovacionet, në përputhje me vizionin për specializim të zgjuar të vendit për ta stimuluar rritjen ekonomike. Sa i përket këtij qëllimi, përzjerja e politikave përfshin masa për zhvillimin e infrastrukturës institucionale, stimulimin e kërkimit dhe zhvillimit, zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, si dhe përshtatjen e legjislacionit nacional për përkrahjen e këtij zhvillimi. Për integrimin e parimeve të transformimit të gjelbër, digjital dhe të qëndrueshëm, organet përgjegjëse të zbatimit janë: Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik - FITR, Banka Zhvillimore dhe ministritë e ndryshme sektoriale, duke përfshirë ekonominë, arsimin, shkencën, mjedisin jetësor dhe bujqësinë, të cilat mund t'i përkrahin projektet në sektorët specifikë si ekonomia ciklike. Planet aktive janë:

- Zhvillimi i infrastrukturës institucionale dhe platformave për inovacione, dije dhe transferim të teknologjisë. Financimi për themelimin dhe/ose funksionimin e: Qendrave të inovacionit, qendrave teknologjike dhe/ose qendrave të ekselencës (ang. Center of Excellence - CoE); Zyrave nacionale për transferimin e teknologjisë; Parku Shkencor-Teknologjik; Rritja e gatishmërisë investuese dhe kapaciteteve për mbledhjen e fondeve në subjektet nacionale;
- Përmirësimi i kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit (R&D&I) në NVM. Vauçerë për inovacione për NVM-të. Grante ose kredi për zhvillimin e produkteve të tyre të reja dhe atyre inovative në treg. Grante për projekte bashkëpunuese/demonstruese në partneritet me institucionet akademike;
- Përkrahja për zhvillimin e kompanive të reja inovative. Grante për fillimin e programeve të përshtetura për startup-et/ bashkëfinancimin e investimeve me “engjëjt e biznesit”;
- Përshtatja e ligjeve nacionale për përkrahjen e kompanive për kërkim, zhvillim dhe inovacione;

- Reformat në politikat lidhur me tatimet, inovacionet, menaxhimin e mbetjeve, energjinë, prokurimet publike dhe standardizimin për t'i stimuluar inovacionet dhe rritjen e gjelbërimit.

Përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe gjelbërimit në sektorin e biznesit. Ky është një hap thelbësor drejt një ekonomie më inovative dhe të qëndrueshme të mjedisit. Kjo do të përfshijë investimet në inovacione, krijimin e mundësive të reja të biznesit, rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit, si dhe promovimin e mjedisit. Politikat dhe masat e shfrytëzuara përfshijnë grante, kredi dhe ndihmë teknike për ta përmirësuar prodhimin dhe shërbimet me vlerë të shtuar, si dhe programe për t'i përforcuar lidhjet ndërkombëtare dhe për rritjen e gatishmërisë për eksport. Ministria e Ekonomisë dhe agjencitë e tjera do jenë përgjegjëse për zbatimin e këtyre masave.

- Përmirësimi i produktivitetit dhe efikasitetit të kompanive në fushat e S3 bazuar në transformimin e gjelbër dhe atë digjital- Kredi/garanci/grante (në raste të veçanta) për investime të gjelbra dhe digjitale, vauçerë për certifikata dhe shërbime këshilluese biznesi për përmirësimin e biznesit, zgjerimin e tregut, dhe gjelbërimit.
- Nxitja e internacionalizimit të kompanive dhe pjesëmarrja në zinxhirët e vlerës në fushat e S3 përmes qasjeve inovative, të gjelbra dhe digjitale-programet lidhur me gatishmërinë për eksport/investim, programet për zhvillimin e GVC/furnizuesve me anë të komponentit grant.

Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe aftësitë për inovacione, transformim të gjelbër dhe digjital. Qëllimi kryesor është të përparohet në fushën e shkencës dhe teknologjisë për të ndikuar në një ndryshim të qëndrueshëm të strukturës së ekonomisë drejt një mjedisi më të pastër dhe më të qëndrueshëm. Në të njëjtën kohë, synohet rritja e konkurrueshmërisë dhe produktivitetit të biznesit përmes përgatitjes së fuqisë së punës me aftësi të reja dhe të përshtatshme për kërkesat e një tregu në ndryshim. Kjo do të ndihmonte në krijimin e mundësive të reja të biznesit dhe në rritjen e nivelit të të hyrave, ndërsa po përmirësohet gjendja e mjedisit dhe shëndetit publik. Në përgjithësi, synohet një e ardhme më e qëndrueshme dhe inovative, ku bashkëpunimi mes sektorëve dhe investimi në zhvillim janë thelbësore për t'i arritur këto qëllime:

- Përmirësimi i relevancës së programeve akademike për fushat e S3. Programet multidisiplinare që përkrahin fushat e S3 (për shembull, ICT në bujqësi). Rritja e përmbajtjes praktike (përmes pjesëmarrjes së sektorit privat) dhe fokusimi në qëndrueshmëri dhe digjitalizim në programet ekzistuese të arsimit të lartë dhe arsimit të mesëm;
- Përforcimi i aftësive dhe njohurive të të punësuarve në kompanitë dhe fermat e S3;
- Ofrimi i kurseve specifike për menaxherët dhe të punësuarit në kompanitë dhe fermat në fushat e S3 për: trendet dhe aftësitë në industrinë e fushave të S3; menaxhimin afarist/financiar, aftësitë e avancuara digjitale, tranzicionin e gjelbër, zhvillimin e qëndrueshëm dhe ekonominë ciklike.

Transformimi digjital i shoqërisë dhe bizneseve. Përmes digitalizimit të sektorit publik dhe atij privat dhe zhvillimit të zgjidhjeve digjitale inovative, synohet përmirësimi i interoperabilitetit institucional dhe përmirësimi i konkurrueshmërisë dhe produktivitetit nëpërmjet automatizimit të

proceseve. Kjo nxit një ambient të favorshëm për investime dhe zhvillim të biznesit, duke përmirësuar kështu aftësinë për t'i përballuar sfidat dhe trendet globale të digitalizimit. Ministritë, bankat e zhvillimit, universitetet dhe institucionet e tjera janë të përfshira në këtë përpjekje për ta përshpejtuar transformimin digjital dhe për të arritur ekonomi më efikase dhe me teknologji të sofistikuara.

- Përkrahja e inovacioneve përmes digjitalizimit në sektorin publik: Ofrimi i të dhënave të hapura në dispozicion për kompanitë, universitetet dhe qendrat e kërkimit për produkte dhe shërbime inovative; Krijimi i rrjeteve/platformave të hapura për kërkimin shkencor; Ofrimi i shërbimeve publike digjitale (implementuar përmes strategjisë së TIK-ut); Reforma ligjore për digjitalizimin (nënshkrimi elektronik, fatura elektronike, tregtia elektronike, siguria kibernetike).
- Përkrahja për digjitalizimin e kompanive dhe bujqësisë në fushën e S3 përmes mjeteve dhe praktikave të TI-së: Përkrahja për zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve digjitale inovative për fushat e S3; Kofinancimi për kompanitë (dhe fermat bujqësore) në fushat e S3 për implementimin e zgjidhjeve digjitale të përparuara/inovative; Zhvillimi i qendrave të inovacioneve digjitale si përkrahje për bizneset.

Sigurimi i dialogut të vazhdueshëm për specializimin e zgjuar. Kushti më i rëndësishëm për suksesin e ardhshëm të Strategjisë së specializimit të zgjuar është sigurimi i një dialogu të vazhdueshëm midis palëve të interesuara përmes një procesi të vazhdueshëm të zbulimit të sipërmarrësve. Me etablimin e niveleve të ndryshme të menaxhimit dhe sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë së specializimit të zgjuar, sigurohet implementimi efektiv i specializimit inteligjent në nivel rajonal dhe nacional.

- Krijimi i një mjedisi të favorshëm dhe implementimi i mjeteve digjitale për vazhdimin dhe monitorimin e procesit të specializimit inteligjent në S3: Krijimi i strukturës së menaxhimit të S3; Një buxhet vjetor i mjaftueshëm për implementimin e S3; Zhvillimi/përditësimi i platformës së S3 për ndarjen e informacioneve për implementimin e S3; Fushata publike për rritjen e ndërgjegjësimit për inovacionet që rezultojnë në rritje dhe ku evidentohen aktivitetet; Krijimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit.
- Nxitja e bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar midis palëve të interesuara të S3; Stimulimi i krijimit dhe financimit të grupeve funksionale dhe të qëndrueshme të punës në S3; PED-ja sipas fushave të specializimit inteligjent.

Prioritetet e specializimit të zgjuar:

- Bujqësi e zgjuar dhe ushqim me vlerë të shtuar të lartë: Promovimi i bashkëpunimit dhe partneritetit drejt bujqësisë së zgjuar dhe ushqimit me vlerë të shtuar; Vendosja e produkteve të ndryshme, cilësore me vlerë të shtuar në tregjet ekzistuese dhe atyre të reja; Zhvillimi i sektorit bujqësor-ushqimor, udhëhequr profesionalisht dhe bazuar në dije; Sigurimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve përmes zgjidhjeve inovative; Nxitja dhe lehtësimi i modernizimit dhe digjitalizimit për rritjen e produktivitetit në zinxhirin e vlerës së sektorit bujqësor-ushqimor;
- Sektori i teknologjisë dhe informacionit do të bëhet pionier i procesit të digitalizimit të shoqërisë: Rritja e tregtisë në sektorin e Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit

(TIK) dhe Eksporti i Zgjidhjeve TIK; Rritja e niveleve për hulumtimin dhe zhvillimin shkencor; Përforcimi i ekosistemit inovativ; Përmirësimi i niveleve të konkurrueshmërisë së industrive lokale përmes digitalizimit; Rritja e kapaciteteve njerëzore në fushën e TIK-ut; Digjitalizimi i sektorit publik;

- Industria elektro-makinerike, industria inteligjente dhe e qëndrueshme, e integruar në zinxhirët globalë të vlerës: Sistemet formale dhe joformale të arsimit zhvillojnë burime njerëzore të larta cilësore që i përmbushin nevojat e industrisë; Diversifikimi i instrumenteve financiare për modernizim dhe zgjerim; Zhvillimi i produkteve të brendshme me cilësi të lartë; Rritja e konkurrueshmërisë dhe integrimi në zinxhirët globalë të vlerës; Infrastruktura e zhvilluar e kërkimeve shkencore dhe e ndarjes së njohurive;
- Materialet e qëndrueshme dhe ndërtesat inteligjente: Krijimi i partneriteteve të fuqishme për përforcimin e ekosistemit inovativ; Modernizimi i sistemit arsimor për t'i përkrahur inovacionet (gjelbërimi dhe digjitalizimi) dhe sipërmarrjet; Përforcimi shkencor; Kompanitë konkurruese përmes modeleve të ekobizneseve të qëndrueshme; Ambiente të bizneseve që iniciojnë riciklimin, efikasitetin në energji dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë; Hapja e tregjeve të reja dhe internacionalizimi.

Këto strategji dhe prioritete do të ndihmojnë në realizimin e vizionit tonë për një ekonomi të qëndrueshme, të inovacionit, dhe të konkurrueshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke shfrytëzuar specializimin e zgjuar si një model për zhvillim të qëndrueshëm, ne mund të krijojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mjedisit tonë.

Strategjia e promovimit të eksportit. Nga kjo pikëpamje, masat dhe politikat janë orientuar në përforcimin e gatishmërisë drejt eksportit të kompanive ekzistuese eksportuese, por në të njëjtën kohë edhe në krijimin e kapaciteteve eksportuese të kompanive të reja. Fokusi do jetë në formulimin e masave për promovimin e madh të eksportit për kompanitë vendase të orientuara drejt eksportit, me qëllim të qasjes dhe shfrytëzimit të tregjeve të reja. Politikat dhe masat kryesore janë orientuar drejt segmenteve të mëposhtme: Përmirësimi i kushteve të biznesit për përkrahjen e eksportit; Përmirësimi i informacionit dhe inkurajimi i kompanive vendase që të fillojnë të eksportojnë ose për ta avancuar eksportin e tyre; Krijimi dhe përforcimi i kapaciteteve të përgjithshme eksportuese; Promovimi dhe lidhja e kapaciteteve eksportuese vendase; Lehtësimi dhe rritja e qasjes në financime përmes linjave kreditore të favorshme për eksportuesit dhe menaxhimi i risqeve të eksportit.

Strategjia nacionale për inteligjencë artificiale. Miratimi i Strategjisë nacionale për Inteligjencë Artificiale (Artificial Intelligence National Strategy): si rezultat i tendencave globale në digjitalizim, me nismën e Fondit të Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik do të formohet grupi i punës, qëllimi i të cilit është krijimi i Strategjisë së parë nacionale për inteligjencën artificiale në vend. Grupi i punës do të përfshijë ekspertë vendas dhe të huaj që janë profesionistë të njohur në këtë fushë dhe që punojnë në kompani dhe universitete të njohura botërore.

“Greening Business Facility”. Realizimi i Projektit IPA “Greening Business Facility” i financuar nga Bashkimi Europian, i cili parasheh fonde në vlerë prej 2 milionë eurove për krijimin e

kapaciteteve të Fondit të Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik, zhvillimin e politikave dhe skemave të reja për zhvillim të mëtutjeshëm të ekosistemit të inovacionit në vendin tonë, si dhe grante në vlerë prej 18 milionë eurove për kompanitë mikro, të vogla dhe të mesme të cilat përmes projekteve dhe ideve të tyre të “gjelbra” do të absorbojnë fonde të pakthyeshme për zhvillimin e bizneseve të tyre.

Akreditimi në Fondin e Gjelbër Klimatik. Përfundimi me sukses i procesit të akreditimit të Fondit të Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik në Fondin e Gjelbër Klimatik (Green Climate Fund), si institucion i vetëm nga Maqedonia e Veriut dhe i pari në Ballkanin Perëndimor, duke krijuar mundësi për qasje në fondet dhe grantet e këtij institucioni për bizneset vendore dhe idetë e tyre të “gjelbra”.

Parku Nacional i Shkencës dhe Teknologjisë. Krijimi i Parkut Nacional të Shkencës dhe Teknologjisë: themelimi i parkut si nismë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe realizimi nga Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik dhe institucioneve të tjera me interes në këtë fushë. PKSHT-ja synon rritjen e përshpejtuar ekonomike dhe lidhjen më të shpejtë me flukset ekonomike dhe sociale botërore. Ky park është perceptuar si hapësirë që ofron infrastrukturë, shërbime dhe qasje në financa nën një vend, me qëllim të inkurajimit të rritjes së bazuar në fondet vendore dhe ndërkombëtare, njohurive të shtuara dhe inovacionit. Në të njëjtën kohë, parku do të jetë vend kontakti dhe bashkëpunimi mes komunitetit akademik, studentëve, bizneseve dhe investitorëve.

Zhvillimi i infrastrukturës moderne laboratorike në universitete. Do të vazhdojmë ta përkrahim zhvillimin e infrastrukturës moderne laboratorike në universitete përmes programeve si MAKERSPACE dhe FABLABS. Qëllimi ynë është t’u ofrojmë të rinjve në komunitet kushte pune, hapësina, materiale dhe teknike për përvetësimin dhe ndarjen e njohurive dhe kërkimin shkencor, në të cilat do të shfrytëzohen mjete nga fusha shkencore, teknologjike dhe industria krijuese. Këto laboratore do të shërbejnë si një inkubator i vërtetë i njohurive dhe teknologjisë për shekullin e 21-të. Në të njëjtën kohë, laboratorët do të paraqesin një vend për bashkëpunim ndërmjet sektorit privat, institucioneve të arsimit të lartë dhe shkencor, ndërmarrjeve dhe shoqërisë civile.

Përkrahja për biznes akseleratorët e rinj. Do të vazhdojmë përkrahjen e biznes akseleratorëve të rinj për zhvillimin e ekosistemit të startup-eve, duke siguruar: Financim, mentorim, këshillim bashkëpunim me institucionet akademike. Biznes akseleratorët kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin dhe rritjen e ekosistemit të startup-eve. Këta akseleratorë ofrojnë ndihmë, burime dhe këshilla për startup-et në fillim të tyre, duke i ndihmuar ato të zhvillohen më shpejt dhe të kenë më shumë mundësi për sukses.

Hapja e infoqendrave të FIZHT-së. Do të hapim infoqendra të Fondit të Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik në qytete të ndryshme të vendit, me këto qëllime: Zhvillimi i ekosistemit të inovacionit; Ndhurma për startup-et lokale; Krijimi i rrjeteve dhe bashkëpunimi rajonal; Rritja e qasjes në informacione dhe Mundësia e bashkëpunimit mes institucioneve qendrore dhe atyre lokale.

Hapja e Agjencisë së Digjitalizimit. Krijimi i Agjencisë së Digjitalizimit është një hap i rëndësishëm për një vend që synon t’i përmirësojë dhe modernizojë shërbimet dhe proceset

e saj përmes teknologjisë digjitale. Kjo agjenci do të ketë rol të gjerë në zhvillimin, implementimin dhe mbikëqyrjen e nismave të digjitalizimit në nivel qeveritar. FIZHT-ja zotohet që në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës ta iniciojë themelimin e Agjencisë së Digjitalizimit dhe të luajë rol aktiv në ngritjen e një institucioni të tillë.

Projektet dhe kanalet e reja të financimit përmes programeve europiane. Do të angazhohemi në projekte të ndryshme që kanë për qëllim zhvillimin e shkencës dhe inovacionit, përmes programeve europiane si "Horizon Europe," "IPA Fondet," "Erasmus+," etj. Këto programe janë instrumente të rëndësishme për ta zhvilluar shkencën, inovacionin dhe arsimin, sepse ofrojnë financa dhe burime për hulumtuesit, inovatorët, institucionet arsimore dhe institucionet publike.

Mekanizmat dhe skemat e reja përkrahëse për biznesin. Krijimi i mekanizmave të reja për zhvillimin e skemave dhe kanaleve të reja të përkrahjes financiare për biznesin përmes: Zhvillimit të fondeve "equity", gjegjësisht krijimit të kushteve për zhvillimin e kapitalit sipërmarrës; Zhvillimit të programeve për përkrahjen e investimeve në bizneset start-up nga investitorët biznes engjëj të biznesit (business angel investors); Zhvillimit të programeve për përkrahjen e platformave "crowdfunding" me qëllim të hapjes së kanaleve të reja për rritjen e kapitalit nga bizneset start-up; Zhvillimit dhe përkrahjes së ekonomisë së gjelbër përmes financimit të aktiviteteve "Green deal" nga sektori privat; Zhvillimit dhe përkrahjes së sipërmarrësisë sociale; Zhvillimit të programeve për përkrahjen e sipërmarrësisë së femrave.

Ngritja në rangimin e Indeksit Global të Inovacionit. Maqedonia e Veriut shënoi ngritje prej 12 vendeve në Indeksin Global të Inovacionit sipas raportit të publikuar për vitin 2023, duke u ranguar në vendin e 54-të në botë, krahasuar me vendin e 66-të në vitin paraprak. Synojmë që në 5 vitet e ardhshme Maqedonia e Veriut të hyjë në top 50 ekonomitë më inovative në botë në periudhën 2024-2026, e pastaj edhe në top 40 vendet më të zhvilluara për inovacione në botë në periudhën 2027-2028. Pikësynimi vijues është që në vitet 2024-2025, Maqedoninë e Veriut ta rangojmë në vendin më inovativ në Ballkanin Perëndimor.

ix. MASA AKTIVE NE TREGUN E PUNËS

Aktiviteti në tregun e punës është 52.3% (791.647), duke treguar një nivel të mesëm të angazhimit në fuqinë punëtore në fund të vitit 2023, derisa shkalla e punësimit arrin 45.4% (688.296). Në anën tjetër, shkalla e papunësisë shënon rënie në 13.1% (103.351), si rezultat i uljes së vazhdueshme në vitet e fundit. Megjithatë, për shkak të mospërputhjeve të nevojës në treg dhe ofertës sipas aftësive të punës, në treg ka patur 9.518 vende të lira pune në fund të vitit 2023. Politikat aktive në tregun e punës janë prioritet, me ç'rast masat aktive do të orientohen në fushat e mëposhtme:

Trajnimi. Programet e trajnimit ofrojnë njohuri të përshtatshme për kërkesat e tregut të punës dhe ofrojnë kualifikime të njohura, duke synuar rritjen e mundësive të punësimit për personat e papunësuar. Trajnimet do të jenë në më shumë drejtime sipas nevojës së tregut: punë të një punëdhënës specifik, kualifikime profesionale me kërkesë të punëdhënësve,

profesione të kërkuara në tregun e punës, shoferë për kategoritë C, CE dhe D, në fushën e sigurisë private, specialist i burimeve njerëzore (rekrutues), zhvillim i aftësive digjitale, etj..

Puna praktike. Programet e praktikës, të organizuara nga Agjencia e Punësimit, ofrojnë përvojë praktike në zbatimin e programeve të BE-së dhe të cilat janë bazuar në Kornizën Europiane të Cilësisë, duke siguruar strukturë dhe përkrahje të përshtatshme për të rinjtë deri në moshën 34 vjeçare.

Subvencionet për punësim. Agjencia e Punësimit ofron subvencione për punëdhënësit që punësojnë persona të papunësuar, duke përfshirë një fokus të veçantë në drejtim të të rinjve. Subvencionet inkurajojnë punëdhënësit që t'i mbajnë të punësuarit e tyre për një periudhë të caktuar pas përfundimit të subvencionit.

Rehabilitimi profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara. Programet ofrojnë shërbime për rehabilitim profesional dhe ndihmë për punësim të personave me aftësi të kufizuara, duke synuar inkurajimin e përfshirjes së tyre në tregun e punës.

Ndihma për vetëpunësim. Ky aspekt përfshin trajnime për aftësitë e biznesit, përkrahje për hartimin e Planit të biznesit dhe qasje në grante dhe kredi me kushtet më të favorshme për ata që dëshirojnë të bëhen vetëpunësues.

Punët publike. Këto punë janë të projektuara për të ofruar mundësi pune të përkohshme për personat e papunësuar, duke krijuar infrastrukturë dhe shërbime të nevojshme në nivel lokal. Punë e dobishme komunale, trajnim dhe punësim të personave për të ofruar shërbime të kujdesit në shtëpi dhe në komunitet.

Krijimi i vendeve të reja të punës. Përkrahje për krijimin e vendeve të reja të punës përmes investimeve të gjelbra dhe digjitale. Me zhvillim teknologjik dhe nevoja të tregut, nevoja për këto investime dhe vende pune do të jetë vazhdimisht në rritje.

Garancia për rininë. Masa për zbatimin e Garancisë për rininë në Maqedoninë e Veriut synon t'i identifikojë dhe t'i përfshijë të rinjtë NEET, në programin e saj, duke ofruar mundësi për punësim, shkollim, trajnim ose praktikë brenda katër muajve pas lënies së shkollës ose pasi të mbeten të papunë. Qëllimi është që të paktën 35% e të rinjve të përfshirë në këtë program të arrijnë performancë të suksesshme në punësim, shkollim ose trajnim në periudhën 4 mujore pas përfshirjes së tyre në program. Koordinimi institucional, përforcimi i kapaciteteve institucionale dhe sigurimi i fondeve shtesë janë thelbi i zbatimit të kësaj mase, ndërsa përmirësimi i mekanizmave për partneritet dhe bashkëpunim siguron oferta cilësore për të rinjtë në nevojë të përkrahjes për punësimin dhe zhvillimin e aftësive.

x. TËRHEKJE E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Investimet e huaja direkte janë faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në aspekt të rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomsë, teknologji të reja dhe hapje të vendeve të punës. Strategjia e për të tërhequr IHD-të do të ridizajnohet për të përmirësuar efektivitetin e saj, për të stimuluar më mirë krijimin e vendeve të punës dhe për të nxitur lidhjet me ekonominë

vendore. Prioritet do të kenë investimet që krijojnë vende pune dhe ata me vlerë të shtuar më të lartë.

Për të rritur efikasitetin në tërheqjen e IHD, do të ndërmeren disa aktivitete:

Agjencia e zhvillimit. Do të integrohen disa institucione shtetërore Agjencia për përkrahje të investimeve dhe promovim të eksportit, Drejtoria për zonat teknologjike industriale dhe Agjencia për Ndërmarrësi nën drejtimin e menaxhmentit profesional në një Agjenci për zhvillim ekonomik.

Profesionalizimi i Agjencisë së zhvillimit ekonomik dhe krijimi i një modeli ku ajo mund të operojë sipas praktikave më të mira të biznesit si organizimi i shërbimeve profesionale (konsulencë). Drejtuesit e lartë dhe të mesëm duhet të jenë profesionistë dhe jo të emëruar politikë.

Zhvillimi i modelit dhe strategjisë së re gjithëpërfshirëse të tërheqjes së IHD-ve:

Ridisajnim i ofertës për IHD. Të krijohen oferta për IHD bazuar në avantazhin konkurrues, kapacitetet/aftësitë aktuale dhe të ardhshme dhe realitetin e ri të tregut të punës. Kjo duhet të përfshijë hartën e nevojave për kapacitete të IHD-ve potenciale dhe gjendjen aktuale dhe të ardhshme të ekonomisë tonë si anëtare në Bashkimin Europian.

Rrjet ndërkombëtar i zyrave dhe diplomacia ekonomike. Afirmimi i diplomacië ekonomike dhe zhvillimi i një rrjeti të qëndrueshëm dhe efikas të zyrave ndërkombëtare në Amerikën e Veriut, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Azi. Rrjeti duhet të zhvillohet në bazë të qasjes sektoriale/rajonale me objektiva të qarta dhe KPI për shtrirjen e IHD-ve.

Regulla dhe procedura të unifikuara. Sqarim i rregullave dhe proceseve (kritere uniforme të pranueshme për investime dhe legjislacion i vetëm që përcakton ndihmën shtetërore) sipas standardeve dhe praktikave më të fundit ndërkombëtare.

“One-stop-shop & aftercare”. Sistemi “një-sportel dhe kujdesi i vazhdueshëm” do të lehtësojnë procedurat për investitorët me do të sigurojnë përkrahje institucionale për investitorët në gjithë procesin e investimit, si dhe do të kujdesen edhe pas investimit që të përgjigjen në këkesat eventuale me qëllim të mbajtjes së investitorëve në ekonominë e vendit

3.1.4. DIGJITALIZIMI I EKONOMISË DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE

Digjitalizimi i ekonomisë dhe institucioneve publike është një proces që ka potencialin ta transformojë mënyrën se si operojnë bizneset dhe qeverisja. Në këtë periudhë të shpejtë të zhvillimit teknologjik, investimi në digjitalizim është një hap i domosdoshëm për të siguruar që vendet dhe organizatat qeveritare të përfitojnë nga avantazhet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Nëse hedhim një vështrim tek ekonomia dhe institucionet publike, shohim një progres gradual drejt digjitalizimit, por ende ka sfida dhe përparësi për t'u adresuar. Në shumicën e vendeve, ekonomia është ende në një fazë tranzicioni drejt një sistemi më të digjitalizuar. Institucionet publike, nga ana tjetër, kanë bërë progres në shfrytëzimin e teknologjisë për t'i përmirësuar shërbimet dhe efikasitetin, por ka ende hapësirë për përmirësime të mëtejshme.

Transformimi digjital do të përmirësojë shërbimet publike, do të nxitë rritjen ekonomike dhe do të nxitë angazhimin publik nëpërmjet teknologjive digjitale. Vizioni ynë është të krijojmë një shoqëri gjithëpërfshirëse, të mundësuar digjitalisht, në të cilën të gjithë qytetarët kanë mundësinë të marrin pjesë në ekonominë digjitale, të kenë qasje në shërbimet publike në internet dhe të kontribuojnë në formësimin e qeverisjes digjitale.

Fushat kryesore të fokusit do të jenë:

- **Zhvillimi i infrastrukturës.** Përparësi do të i jepet zgjerimit të qasjes në internet me shpejtësi të lartë në rajonet e pashërbyera. Investimi në infrastrukturën e sigurt dhe të shkallëzueshme të TI-së për të mbështetur shërbimet digjitale dhe menaxhimin e të dhënave.
- **Edukimi digjital dhe përfshirja.** Zbatimi i programeve kombëtare për të përmirësuar aftësitë digjitale në të gjitha grupmoshat dhe komunitetet. Shërbimet digjitale qo të jenë të qasëshme, duke marrë parasysh aftësitë dhe nevojat e ndryshme gjuhësore.
- **Shërbimet e qeverisjes elektronike.** Zhvillim i platforme online për shërbimet publike për të përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen. Inkurajoni ndërveprimet digjitale midis qeverisë dhe qytetarëve për të rritur angazhimin qytetar dhe ofrimin e shërbimeve.
- **Privatësia e të dhënave dhe siguria kibernetike.** Vendosje e rregulltivave të forta për mbrojtjen e të dhënave për të siguruar informacione personale dhe të ndjeshme. Ndërgjegjësim dhe mbrojtje për sigurinë kibernetike në të gjithë sektorët e shoqërisë.
- **Inovacioni dhe rritja ekonomike.** Mbështetje e rritjes e bizneseve dhe start-upeve digjitale përmes stimujve dhe rregulloreve të thjeshta. Nxitja partneritetit midis akademisë, industrisë dhe qeverisë për të nxitur inovacionin teknologjik.
- **Korniza Rregullative.** Përditësimi i ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese për të mbështetur transaksionet digjitale, të drejtat digjitale dhe modelet e reja të biznesit.

Agjencia e digjitalizimit. Për të mbikëqyrur zbatimin, menaxhuar resurset dhe për të koordinuar me aktorë të ndryshëm do të themelohet Agjenci e digjitalizimit që nismat e transformimit digjital të jenë të qëndrueshme dhe të ndërgjegjshme për mjedisin.

Për vlerësimin e nivelit të digjitalizimit të ekonomisë dhe institucioneve publike, mund të mbështetemi në faktorë të tillë si: shfrytëzimi i teknologjisë së informacionit për menaxhimin e proceseve, qasja në internet, integrimi i platformave digjitale dhe shfrytëzimi i analizës së të dhënave për marrjen e vendimeve. Në disa vende, ka pasur investime në infrastrukturën digjitale dhe hartimin e strategjive të qeverisjes digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe transparencës.

Prioritetet e digjitalizimit. Për t'i arritur objektivat në digjitalizimin e ekonomisë dhe institucioneve publike është e rëndësishme të vendosim disa qëllime specifike dhe prioritete të qarta. Disa nga objektivat janë:

- **Përmirësimi i qasjes së qytetarëve dhe bizneseve** në shërbime digjitale për të zvogëluar burokracinë dhe koston administrative;
- **Zhvillimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit** për të siguruar qasjen e barabartë për të gjithë;
- **Rritja e sigurisë së të dhënave** dhe mbrojtja e privatësisë në ambientet digjitale;
- **Krijimi i mjedisit të favorshëm për novacionin** dhe zhvillimin e aplikacioneve digjitale;
- **Shfrytëzimi i teknologjisë bllokvarg** për ta përmirësuar transparencën dhe sigurinë në transaksionet financiare dhe në administratën publike.

“Blokvargu” (Blockchain). Kjo paraqet teknologji inovative që ka potencial të madh për të ndikuar pozitivisht në ekonomi dhe në institucionet publike. Shfrytëzimi i bllokvargut mund të sjellë rritje të transparencës, përmirësim të sigurisë dhe efikasitet të lartë në shumë aspekte të aktivitetit ekonomik dhe administratës publike. Në institucionet publike, shfrytëzimi i bllokvargut mund të lejojë për një ndarje të të dhënave të sigurta dhe të verifikueshme, duke rritur transparencën dhe besueshmërinë në administratën publike.

Projekte të digjitalizimit. Transformimi digjital do të realizohet me projekte të ndryshme, siç janë: Rrjeti optik të transportit; Rrjeti i qeverisë dhe sektorit publik; Qendra kombëtare për kompjuterizimin në nuvull (National Cloud Center); Qendra kombëtare për përditësim të të dhënave në rast të katastrofës; Rrjeti edukativ kombëtar; Sistemi për Identitetin Digjital Kombëtar; etj.

Digjitalizimi do të implementohet duke u bazuar në disa qasje strategjike:

- **Korniza e politikave.** Zhvillimi i një politike gjithëpërfshirëse digjitale që trajton mbrojtjen e të dhënave, sigurinë kibernetike, të drejtat digjitale dhe rregulloret që nxisin modelet digjitale të biznesit dhe konkurrencën e ndershme.
- **Stimujt ekonomik.** Sigurimi i stimujve tatimorë, subvencioneve dhe mundësive të financimit të krijuara posaçërisht për të mbështetur projektet digjitale dhe për të inkurajuar ndërmarrjet që t'i nënshtrohen transformimit digjital.
- **Partneritet Publiko-Private (PPP).** Shfrytëzimi i partneriteteve midis qeverisë dhe sektorit privat për të nxitur projekte digjitale, të tilla si iniciativat e qytetit të zgjuar ose zgjidhjet digjitale të kujdesit shëndetësor.
- **Ekosistemi i sipërmarrjes dhe fillimit.** Krijimi i një mjedisi që mbështet startup-et digjitale me inkubatorë, kapital sipërmarrës dhe programe mentorimi, të cilat janë thelbësore për nxitjen e inovacionit.
- **Modernizimi rregullativës.** Rregullimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të mbështetur modelet e reja të biznesit dhe transaksionet digjitale, të cilat mund të përfshijnë rishikimin e ligjeve që lidhen me tregtinë elektronike, bankingun digjital dhe punën në distancë.
- **Bashkëpunimi Ndërkombëtar.** Angazhimi në bashkëpunime ndërkombëtare për të adoptuar praktikat më të mira, për të tërhequr investime dhe për të marrë pjesë në tregjet digjitale globale.

Aspektet kryesore të digjitalizimit të shërbimeve publike:

- **Shërbime publike online.** Zhvillimi dhe përmirësimi i platformave online ku qytetarët mund të kenë akses në shërbimet qeveritare në mënyrë efikase. Kjo përfshin aplikacione për dokumente, regjistrime, pagesa dhe më shumë, të aksesueshme nga kompjuterët dhe pajisjet celulare.
- **Portalet e E-Government.** Krijimi i portaleve gjithëpërfshirëse që shërbejnë si një ndalesë për informacion dhe shërbime, duke reduktuar nevojën për vizita fizike në zyrat e qeverisë dhe duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve.
- **Sistemet e identifikimit digjital.** Zbatimi i sistemeve të identifikimit digjital që ofrojnë verifikim të sigurt dhe universal të identitetit, duke lehtësuar aksesin më të lehtë në shërbimet publike dhe duke reduktuar mashtrimin.
- **Automatizimi dhe AI.** Përdorimi i automatizimit dhe inteligjencës artificiale për të përmirësuar shpejtësinë e përpunimit dhe saktësinë e shërbimeve publike, të tilla si përpunimi i automatizuar i formularëve, chatbots për shërbimin ndaj klientit dhe analiza e të dhënave të drejtuara nga AI për të informuar vendimet e politikave.
- **Ndërveprueshmëria.** Sigurimi që sisteme dhe shërbime të ndryshme digjitale mund të punojnë së bashku pa probleme nëpër departamente dhe agjenci, gjë që është thelbësore për ndarjen efikase të të dhënave dhe ofrimin e shërbimeve.
- **Privatësia dhe siguria e të dhënave.** Forcimi i masave të sigurisë kibernetike dhe politikave të mbrojtjes së të dhënave për të mbrojtur të dhënat e qytetarëve kundër aksesit dhe shkeljeve të paautorizuara.



3.2. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE TRANSFORMIMI I GJELBËR

- *Ambient i pastër dhe i shëndetshëm*
 - *Ndryshime klimatike (standardet COB21 dhe Kyoto Protokol)*
 - *Mbrojtje e natyrës, UNESCO, Mali Sharr Park Nacional*
 - *Mbrojte e ajrit, matje dhe masa ndaluese në transport, industri, amvisëri*
 - *Menaxhimi i ujrave, infrastrukturë e modernizuar*
 - *Menaxhimi i mbeturinave, qendra rajonale*
 - *Ekonomi qarkore, nxitje të investimeve të gjelbra*

- *Energji e sigurt dhe përtëritëse*
 - *Rritje e kapaciteteve prodhuese vendore*
 - *Rritje e prodhimit të energjisë përtëritëse (hidro, solar, erë, bio)*
 - *Diversifikim i burimeve energjetike dhe siguri energjetike*
 - *Gasifikim dhe lidhje në korridoret ndërkombëtare energjetike*
 - *Tranzicion energjetik dhe dekarbonizim*
 - *Fondi për Efikasitet Energjetik*
 - *Perspektivë energjetike: hidrogjeni dhe bateritë elektrike*

- *Bujqësi moderne dhe ushqim i sigurt*
 - *Konsolidim dhe shfrytëzim i tokave bujqësore*
 - *Modernizim i bujqësisë, blegtorisë dhe pylltarisë*
 - *Industri ushqimore dhe prodhime organike*
 - *Zhvillim rural dhe agrar*
 - *Sigurim i prodhimeve strategjike bujqësore dhe ushqimore*

3.2.1. AMBIENTI I PASTËR DHE I SHËNDETSHËM

Ambienti i pastër dhe i shëndetshëm është objektivi ynë afatgjatë për të garantuar cilësi të jetesës. Politikat e ndërmarra si zotimi për klimën në vitin 2021, respektivisht Konventa në kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe Marrëveshja e Parisit, si traktat ndërkombëtar dhe ligjërish i detyrueshëm paraqet dokumentin kyç që përcakton objektivat për aksione klimatike, transformim ekonomik dhe social, ku ne si nënshkrues jemi zotuar në drejtim të përmbushjes së tyre.

Sigurimi i ambientit të pastër dhe të shëndetshëm është një prej qëllimeve kryesore për ne. Ne synojmë të krijojmë mjedis të përshtatshëm për të gjithë qytetarët, duke përfshirë masa për përmirësimin e cilësisë së ajrit, trajtimin e ujërave dhe menaxhimin e mbeturinave.

Anëtarësimi në Programin LIFE të Bashkimit Europian në muajin korrik të vitit 2023, si mundësi e integritit të përsheptuar, do të mundësojë që vendi ynë të ketë qasje në këtë fond, nga i cili do të investohet në projekte të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë ambientin e pastër, përkrahjen për natyrën, biodiversitetin dhe aksionet klimatike.

Në këtë drejtim janë bërë hapa të rëndësishme, si miratimi i planit të menaxhimit të Malit Sharr dhe Maleve të Osogovës, që synojnë ta përforcojnë mbrojtjen e këtyre zonave, si dhe projektet e mëdha të ndërtimit të impiantit të ujërave të zeza në Shkup, Kërçovë dhe Tetovë. Përdorimi i qeseve të plastikës është ulur në 80% që nga ndalimi i tyre në fund të vitit 2021.

Kemi filluar dhe do të vazhdojmë me përmirësimin e infrastrukturës ujore, respektivisht në Saraj në vlerë prej 468,753.00 euro, Haraçinë në vlerë prej 317,074.00 euro, Likovë në vlerë prej 967,374.00 euro, Kumanovë në vlerë prej 1,833,804.00 euro, Strugë në vlerë prej 1,014,400.00 euro, Kërçovë në vlerë prej 973,745.00 euro, Dollnen në vlerë prej 583,723.00 euro, Pllasnicë në vlerë prej 487,287.00 euro, Dibër në vlerë prej 614,565.00 euro, Tetovë në vlerë prej 1,040,990.00 euro, Gostivar në vlerë prej 936,039.00 euro, Tearcë në vlerë prej 595,952.00 euro, Bërvenicë në vlerë prej 551,623.00 euro, Bogovinë në vlerë prej 624,205.00 euro, Vrapçishtë në vlerë prej 617,658.00 euro, si dhe Zhelinë në vlerë prej 622,090.00 euro.

Kemi filluar dhe vazhdojmë me projektet për menaxhimin e mbeturinave inerte: projektimi dhe ndërtimi i pesë transfer stacioneve, deponive rajonale sanitare, mbyllja e deponisë së vjetër Rusino, furnizimi me pajisje për grumbullimin e mbeturinave, transfer stacioneve dhe furnizimi me pajisje për punë lidhur me menaxhimin e deponive në këto qytete/fshatra: Strugë, Kërçovë, Dollnen, Pllasnicë, Dibër, Tetovë, Gostivar, Tearcë, Bërvenicë, Vrapçishtë dhe Zhelinë.

Ne synojmë promovimin e ambientit të pastër dhe të shëndetshëm, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit jetësor në përputhje me legjisacionin e BE-së, i cili përmban dispozita adresuar mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, mbrojtjes së natyrës, cilësisë së ajrit dhe ujit, si dhe menaxhimit të mbeturinave.

i. MBROJTJA E MJEDISIT DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Përcaktimi strategjik i yni do të jetë edhe harmonizimi i plotë i legjislacionit nacional me atë të BE-së në fushën e ndryshimeve klimatike, si sigurimi i kushteve për uljen e emetimit të karbonit, rritjen e rezistencës së sektorëve më të ndjeshëm nga ndryshimet klimatike, si dhe për kryerjen e detyrimeve që rezultojnë nga konventat ndërkombëtare në përputhje me dokumentet e ratifikuara rajonale dhe ndërkombëtare.

Për të siguruar ambient të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë, do të ndërmarim masa që adresojnë burimet kryesore të ndotjes së mjedisit, përfshirë industrinë dhe transportin:

- **Industria.** Do të zbatohen standarde më të larta të përmbajtjes së ndotësve në proceset e prodhimit dhe do të vendoset monitorimi i rregullt për të siguruar përmbushjen e këtyre standardeve.
- **Transporti.** Masa të tilla përfshijnë promovimin e transportit të pastër, siç janë automjetet elektrike dhe transporti publik, si dhe zbatimin e rregullave për emetimet e gazrave dhe për kufizimin e qarkullimit të makinave të vjetra dhe ndotëse.

ii. MBROJTJA E NATYRËS

Në fushën e mbrojtjes së natyrës, ne do të synojmë që të bëhet përcaktimi i Kanionit të Matkës, Liqenit të Ohrit dhe Belçisko Blato si zona të mbrojtura ashtu siç u veprua me Malin Sharr dhe Malet e Osogovës. Do të synojmë rritjen e fondeve nacionale dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës, si dhe rritjen e financimit të qëndrueshëm dhe kapaciteteve administrative për t'i menaxhuar zonat e mbrojtura dhe parqet nacionale.

Gjithashtu, do të synojmë zbatimin e plotë të rekomandimeve të UNESCO-s për trashëgiminë natyrore dhe kulturore të vendeve të mbrojtura. Si dhe do të angazhohemi për:

- Investime në projekte infrastrukturore për mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve në zonat rurale;
- Përkrahje financiare për vendbanimet që gjenden në kuadër të zonave të mbrojtura natyrore, si parqet nacionale, me çka do ta zhvillojmë ekoturizmin në këto zona;
- Hartimi i planit hapësinor për Parkun Nacional - Mali Sharr dhe ridefinimi i zonave për gjueti;
- Përkujdesje për hapësirat e gjelbra, respektivisht për ndërtimin e parqeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës së parqeve ekzistuese, si dhe për krijimin e rezervave natyrore dhe hapësirave të mbrojtura për ruajtjen e biodiversitetin dhe promovimin e ekoturizmit;
- Thjeshtimi i procedurave ligjore për regjistrimin e shoqatave ekologjike dhe anëtarësimin e tyre në federatat shtetërore.

iii. MENAXHIMI I UJËRAVE

Qasja në ujë të pijshëm është një nga qëllimet për zhvillimin e qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Konform këtyre qëllimeve do të sigurohet kontinuitet dhe cilësi e ujit për pije në çdo shtëpi dhe ndalim të keqpërdorimit të ujit për pije në të gjitha vendbanimet. Menaxhimi adekuat i ujërave të zeza në të gjitha vendbanimet rurale dhe urbane sipas standardeve europiane do të jetë prioritet i yni. Në menaxhimin e ujit, do behet harmonizimi i vazhdueshëm i legjislacionin nacional me legjislacionin e BE-së.

Për të garantuar që uji i pijshëm është i pastër dhe i sigurt për konsum, do të ndërmerrem:

- Zbatimin e standardeve të larta për cilësinë e ujit dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme për sigurimin e përputhshmërisë me këto standarde;
- Investime në infrastrukturë për trajtimin e ujërave dhe përmirësimin e sistemeve të furnizimit të ujit për sigurimin e qasjes së përshtatshme dhe të qëndrueshme në ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët;
- Promovimin e praktikave mjedisore në industri dhe bujqësi për ta ulur ndotjen e ujërave, në shfrytëzimin e teknologjive më të pastërta, si dhe përkrahjen e fermave dhe bizneseve për ndërmarrjen e veprimeve për ta zvogëluar ndotjen;
- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e ruajtjes së burimeve të ujit dhe për rolin e tyre në mbrojtjen e cilësisë së ujit dhe uljen e ndotjes;
- Krijimin e kapaciteteve lokale për menaxhimin e ujërave dhe hartimin e planeve të zbatueshme për adresimin e sfidave specifike të ndotjes së ujërave dhe sigurisë së ujit të pijshëm në nivel lokal.

iv. CILËSIA E AJRIT

Përmirësimi i kushteve të ajrit është një nga prioritetet kryesore në përpjekjet tona për të krijuar ambient më të pastër dhe më të shëndetshëm. Rrjetet e monitorimit të cilësisë së ajrit kanë vazhduar të mirëmbahen, riparohen dhe të zgjerohen me stacione të reja. Tanimë janë finalizuar kadastrat e ndotjes së ajrit në Kërçovë, Koçan, Shtip, Kavadar, Gjevgjeli dhe në Prilep, ndërsa në disa qytete të tjera akoma janë në fazën e zhvillimit. Prandaj, ne do të propozojmë të adoptohet programi si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Për reduktimin e emetimeve nga të gjithë sektorët e identifikuar do të zbatohen masat strategjike të planifikuara të cilat do të synojnë monitorimin, inspektimin, ngritjen e vetëdijes publike dhe harmonizimin e legjislacionit tonë me atë europian. Do ta synojmë zbatimin e masave konkrete për reduktimin e ndotjes së ajrit në nivel lokal dhe nacional, si dhe subvencionimin për pajisje dhe filtra për uljen e ndotjes së ajrit.

Ne gjithashtu do të investojmë në infrastrukturën e mbrojtjes së mjedisit dhe teknologji të reja që ndihmojnë në reduktimin e gazrave të ndotjes së ajrit. Për më tepër, ne do ta inkurajojmë shfrytëzimin e automjeteve të transportit të pastër dhe të energjisë së ripërtëritshme për zvogëlimin e emetimeve nga automjetet dhe ndërtesat.

Disa prej masave që do të ndërmerren për përmirësimin e kushteve të ajrit janë si në vijim:

- **Ndotja zero nga transporti:** Krijimi i politikave të transportit të qëndrueshëm, përfshirë promovimin e transportit publik, shfrytëzimin e automjeteve elektrike dhe ndalimin e automjeteve të cilat shkaktojnë ndotje të larta;
- **Rregullimi i emetimeve industriale:** Zbatimi i standardeve të larta për emetimet industriale, shfrytëzimi i teknologjive të pastrimit të ndotjeve dhe rritja e monitorimit të industrisë për t'i zbuluar dhe parandaluar ndotjet;
- **Promovimi i energjisë së ripërtëritshme:** Investime në burime alternative të energjisë si energjia diellore, era dhe hidroenergjia për të zvogëluar shfrytëzimin e energjisë fosile, e cila shkakton ndotje të madhe të ajrit;
- **Politika urbanistike të qëndrueshme:** Planifikimi urban që inkurajon zhvillimin e hapësirave të gjelbra, rritjen e transportit publik dhe promovimin e lëvizjes me biçikleta për ta zvogëluar trafikun dhe ndotjen;
- **Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut:** Fushata të ndërgjegjësimit për promovimin e sjelljeve të qëndrueshme dhe të pastër në jetën e përditshme, duke përfshirë shfrytëzimin e automjeteve të transportit të ndotjes së ulët dhe shfrytëzimin e teknologjive të pastrimit të ndotjeve në shtëpi dhe në vendet e punës;
- **Ndërhyrjet e drejtpërdrejta për zgjidhjen e problemeve aktuale:** Masa të menjëhershme për t'i luftuar situatat akute të ndotjes së ajrit, si ndalimi i veprimtarive të caktuara industriale, reduktimi i qarkullimit të automjeteve në qytete dhe promovimi i sistemeve të pastrimit të ajrit në zonat me ndotje të larta.

V. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Zbatimi i politikave për menaxhimin e mbeturinave është një aspekt kyç i ruajtjes së mjedisit. Në këtë kontekst, partneritetet midis sektorit publik dhe sektorit privat janë thelbësore për t'i arritur qëllimet e Planit nacional për menaxhimin e mbeturinave, i cili tashmë është miratuar. Do të përkushtojmë fokus të vazhdueshëm në inovacionet dhe mbrojtjen e mjedisit, dhe do ta përmirësojmë menaxhimin e mbeturinave, me ç'rast do t'i ndjekim praktikën më të mira të vendeve të zhvilluara duke u nisur nga qytetari e deri të operatorët më të mëdhenj. Do ta adresojmë me masa konkrete sfidën kryesore – mbylljen e deponive ilegale. Ne synojmë funksionalizimin e sistemit rajonal të menaxhimit të mbeturinave, infrastrukturën e mirëfilltë për seleksionim, reciklim dhe mbledhje të mbeturinave, si dhe investimet në infrastrukturë për reciklimin e mbetjeve të plastikës dhe materialeve tjera që ndotin ambientin. Gjithashtu, krahas zbatimit të legjislacionit prioritet i yni do të jetë edhe ngritja e vetëdijes shoqërore përmes fushatave të ndryshme dhe projekteve për ndërgjegjësim .

Disa masa që do të ndërmerren për këtë qëllim janë si në vijim:

- Zgjidhja e problemit për menaxhimin efikas të deponive rajonale dhe mbyllja e deponive të egra për një ambient pa mbeturina;
- Promovimi i riciklimit dhe përpunimit të mbeturinave për ta ulur sasisë e mbeturinave që destinohen në deponi dhe për t'i rikuperuar burimet e vlefshme;
- Investimi në infrastrukturë për trajtimin e mbeturinave për ta zvogëluar ndotjen dhe për t'i mbrojtur burimet natyrore;

- Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për ta kufizuar hedhjen e mbeturinave në mjedis, duke përfshirë rregulative për deponitë dhe fabrikat e përpunimit të mbeturinave;
- Inkurajimi i inovacionit dhe teknologjisë së pastër për menaxhimin e mbeturinave për t'i shfrytëzuar më efikasitet burimet dhe për ta zvogëluar ndotjen;
- Edukimi i publikut për praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave dhe për rëndësinë e riciklimit dhe përpunimit të tyre.

3.2.2. ENERGJIA E SIGURT DHE E RIPËRTËRITSHME

Si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ne miratuar Strategjinë nacionale për zhvillimin e energjisë deri në vitin 2040 dhe jemi zotuar t'i reduktojmë dukshëm ndotësit lokalë deri në vitin 2027. Vendi gjithashtu miratoi Planin nacional të veprimit për energjinë dhe klimën në përputhje me Pakon e BE-së për energjinë dhe klimën 2030 dhe Strategjinë për Europën me karbon të ulët.

Në mënyrë që t'i mbrojmë konsumatorët dhe standardin jetësor nga ndikimi i drejtpërdrejtë i rritjes së çmimeve të energjisë, në kuadër të Planit nacional të veprimit energjetik për ballafaqim me krizën energjetike, ne kemi përgatitur një sërë masash për ballafaqimin me tendencat globale, përkrahjen e ekonomisë dhe qytetarëve, si dhe masa për përmirësimin e legjislacionit dhe përgatitjen e dokumentacionit strategjik me qëllim të harmonizimit me rregullativat ligjore të BE-së, mundësimin e tranzicionit të drejtë energjetik dhe zbatimin e pakos për energji të pastër.

Ne kemi siguruar përkrahje makrofinanciare nga BE-ja nëpërmjet Programit IPA 2023 që do të sigurojë lehtësimin e ndikimit të drejtpërdrejt socio-ekonomik të krizës energjetike, si dhe vendosjen e bazës për krijimin e qëndrueshmërisë energjetike në vend. Kjo gjithashtu do të kontribuojë në zvogëlimin e presionit fiskal të vendit, duke zbatuar masa për uljen e probabilitetit të varfërisë energjetike nëpërmjet ndihmës për ekonominë dhe familjet e kategorive të ndjeshme, si dhe sigurimin e realizimit dhe qasjes së pandërprerë në shërbimet themelore.

Ne do të vazhdojmë me ristrukturimin, liberalizimin dhe privatizimin e sektorëve energjetikë në harmonizim me direktivat e Bashkimit Europian dhe parimet e ekonomisë së tregut. Zhvillimi i sektorit energjetik do të bazohet në ofrimin e energjisë së sigurt, rritjen e kapaciteteve energjetike nga burimet e ripërtëritshme, si dhe rritjen e efikasitetit energjetik.

I. ENERGJIA E SIGURT

Strategjia e miratuar e zhvillimit të energjisë së vendit tonë ofron bazë për modernizimin dhe transformimin e përgjithshëm të sektorit të energjisë në përputhje me trendet e energjisë së Bashkimit Europian, duke kontribuar në rritjen e qasjes, integrimin dhe efikasitetin e shërbimeve të energjisë, reduktimin e ndotjes lokale dhe globale, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat, duke marrë parasysh potencialin zhvillimor dhe karakteristikat vendore.

Ne do të sigurojmë politikë koherente energjetike, do ta përmirësojmë qeverisjen dhe kapacitetin institucional në sektorin e energjisë, do ta përmirësojmë programimin strategjik të investimeve, do ta përshpejtojmë tranzicionin drejt energjisë së gjelbër në përputhje me Agjendën e gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe Strategjinë nacionale të energjisë, si dhe do ta përditësojmë dhe zbatojmë energjinë nacionale dhe planin klimatik, në përputhje me objektivat klimatike dhe energjetike të Komunitetit të Energjisë për vitin 2030. Në kuadër të kësaj, ne do t'i certifikojmë operatorët e sistemeve të transmetimit të gazit dhe do ta inkurajojmë zhvillimin dhe integrimin rajonal të tregut; Do të fokusohemi në sigurinë energjetike, diversifikimin dhe rritjen e qëndrueshme socio-ekonomike, si dhe do ta miratojmë dhe zbatojmë legjislacionin për zbatimin e efikasitetit të energjisë.

Me qëllim të lehtësimit të ndikimit të drejtpërdrejtë socio-ekonomik të krizës energjetike, ne do të vazhdojmë të sigurojmë subvencione për amvisëritë për tejkalimin e rritjes së faturave të energjisë, me ç'rast do të ulet barra tatimore lidhur me furnizimin me energji, do të sigurohet përkrahje e drejtpërdrejtë financiare për qytetarët e kategorive të ndjeshme për ballafaqim, si dhe përkrahje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për sigurimin e vazhdimësisë së biznesit.

Gjithashtu, ne do t'i harmonizojmë politikat tona me pakon e integritit të energjisë elektrike për të mundësuar bashkimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së me atë të Maqedonisë së Veriut, si dhe operacionalizimin e pakos në përputhje me planin e integritit të operatorëve të tregut deri në fund të vitit 2025. Kjo nënkupton harmonizim të plotë të pakos së energjisë, implementim të pakos së integritit elektrik duke shfrytëzuar tregun brenda ditës.

ii. ENERGJIA E RIPËRTËRITSHME

Në drejtim të burimeve të ripërtëritshme kemi bërë hapa konkretë, përkatësisht, për një vit në Maqedoninë e Veriut janë instaluar fotovoltaike me fuqi prej një blloku në kapacitetin më të madh energjetik (REK Manastir), duke e rritur në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin elektrik nga energjia e ripërtëritshme, me ç'rast që në vitin 2023 prodhon mbi 41% të energjisë elektrike.

Ne si qëllim kryesor në politikën energjetike do të kemi zhvillimin sa më të përshtatshëm të sektorit energjetik, që do të sigurojë furnizim të sigurt dhe cilësor me energji dhe lëndë djegëse për konsumatorët, zhvillim të përshpejtuar ekonomik dhe rritje të kujdesit dhe mbrojtjes së mjedisit. Në fushën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, ne do të vazhdojmë me mekanizmat aktuale të përkrahjes për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE – Burime të Ripërtëritshme të Energjisë nëpërmjet tarifave preferenciale dhe premive preferenciale me ankande (të dhëna në procedurë tenderi). Ne do ta promovojmë shfrytëzimin e mëtejshëm të këtyre burimeve në sektorin e energjisë elektrike (pa stimulime), por edhe në sektorët e tjerë duke vendosur konceptin e "prodhuesit konsumator". Kjo do t'i rrisë përpjekjet e vendit për ta arritur objektivin ambicioz me pjesëmarrje prej 38% të BRE-ve në konsumin bruto të energjisë përfundimtare deri në vitin 2030 në përputhje me dokumentet strategjike.

Ne do të vazhdojmë të investojmë në burimet e ripërtëritshme nëpërmjet kompensimit të një pjese të shpenzimeve për sistemet diellore termike - kolektorët, dritaret PVC ose alumin, centrale fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike deri në 6KW për konsum vetanak në amvisëritë, si dhe nëpërmjet kompensimit të një pjese të shpenzimeve për amvisëri, për dokumentacionin e përpiluar të projektit për lidhjen e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror dhe/ose për lidhjen e kryer me sistemin e shpërndarjes së gazit natyror në vend.

Ne gjithashtu do të angazhohemi në: krijimin e Regjistrimit elektronik nacional për administrimin e garancive të origjinës; miratimin e Rregullores për licencën e instaluesve; miratimin e ligjit të ri, respektivisht Ligjit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, për t'i transponuar dispozitat e direktivës 2018/2001 dhe legjislacionit dytësor përkatës; si dhe përditësimin e Propozimligjit të Biokarburanteve.

Në përputhje me Planin e rritjes, ne do të:

- Implementojmë direktivat për energjinë e ripërtëritshme (lejet, garancitë e origjinës, komunitetet e energjisë) dhe procedurat transparente dhe konkurruese për vendosjen e energjisë së ripërtëritshme;
- Thjeshtësojmë procedurat e dhënies së lejeve për burimet e ripërtëritshme të familjeve, ndërtesave publike dhe instalimeve të mëdha;
- Zhvillojmë dhe operacionalizojmë komunitetet e energjisë.

iii. EFIKASITETI ENERGJETIK DHE RITJA E KAPACITETEVE PRODHUESE

Orientimi drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë nuk është e vetmja zgjidhje për përballimin e krizës energjetike. Një segment jashtëzakonisht i rëndësishëm në reduktimin e emetimeve po aq sa edhe tranzicioni i energjisë është edhe efikasiteti energjetik. Për ta kompletuar sistemin e qëndrueshëm energjetik do të fokusohemi në: miratimin e ndryshimeve të Ligjit të Efikasitetit Energjetik dhe legjislacionit përkatës zbatues, lëshimin e licencave dhe autorizimeve për auditorët e energjisë tek tregtarët e mëdhënj dhe ndërtesat, përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë për rindërtimin e objekteve deri në vitin 2030, realizimin e aktiviteteve të përcaktuara me planin e renovimit të ndërtesave, subvencionimin për efikasitet energjetik; lirim nga taksat dhe riinvestimin në digjitalizim dhe efikasitet energjetik.

Ne do ta inkurajojmë efikasitetin energjetik në amvisëri me vendosjen e kondicionerëve me efikasitet të lartë, me anë të ndarjes së vërtetimit/vauçerëve për amvisëri. Gjithashtu, do të investojmë në efikasitet energjetik nëpërmjet programeve komunale për efikasitet energjetik, rikonstruksionin e ndërtesave publike dhe ndriçimit rrugor, si dhe në përputhje me Planin e rritjes, ne do t'i implementojmë direktivat e BE-së për performancë të energjisë në ndërtesa dhe efikasitetin energjetik.

iv. FONDI PËR EFIKASITET ENERGJETIK

Zhvillimi i Fondit për Efikasitet Energjetik është pjesë e Projektit për efikasitet energjetik në sektorin publik, i përkrahur me kredi nga Banka Botërore. Konkretisht, janë bërë ndryshime dhe plotësime në Ligjin e Bankës Zhvillimore për Maqedoninë e Veriut, ku parashihet krijimi i Fondit për Efikasitet Energjetik në kuadër të bankës si njësi e veçantë organizative. Për fillimin e funksionimit dhe punës së fondit, përveç marrëveshjes, në periudhën e ardhshme do të përgatisim Strategjinë lidhur me qëllimet afatgjate të fondit, Planin e biznesit të fondit për një periudhë 5 vjeçare si dhe Doracakun operativ për funksionimin e fondit.

Duke pasur parasysh potencialin ujqor që ka vendi ynë, ne synojmë ndërtimin e hidrocentraleve dhe centraleve kogjeneruese me gaz për ruajtjen e energjisë për periudhë me kosto më të shtrenjtuar të energjisë elektrike, si dhe për balancimin e energjisë së ripërtëritshme, të cilat do të kenë rol më të madh në prodhimin e energjisë elektrike dhe termike.

v. GAZIFIKIMI DHE LIDHJET ME KORRIDORET NDËRKOMBËTARE

Do të vazhdojmë me Linjën interkonektive të gazit natyror dhe hidrogjenit me Greqinë, me gjatësi prej 68 km Negotinë-Gjevgjeli, që do të mundësojë diversifikimin e burimeve të furnizimit me gaz natyror dhe qasjen në TAP (Trans Adriatik Pipeline), ashtu si edhe në терминаlet LNG në Republikën e Greqisë. Përveç gazit natyror, kjo linjë do të mundësojë edhe transmisionin e hidrogjenit. Vlera e këtij projekti është 70.000.000 euro (10.000.000 euro grant nga WBIF - Western Balkan Investment Framework dhe 60.000.000 euro kredi nga Banka Europiane e Investimeve - European Investment Bank dhe BERZH-i). Ndërtimi përfundon në vitin 2025.

Terminali i gazit të lëngshëm në Aleksandropolis. Pasi është bërë rezervimi afatgjatë prej 10% të kapacitetit të rigazifikimit në këtë terminal, SHA Nomagas do të blejë edhe 10% të aksioneve në këtë terminal, si një investim strategjik afatgjatë për ta mundësuar blerjen e gazit nga çdo vend i botës dhe për ta garantuar pavarësinë afatgjate nga gazi rus. Vlera e këtij projekti është 12.5 milionë euro nga buxheti i Nomagasit.

Interkonektimi me Shqipërinë, me gjatësi prej 25 km, do të mundësojë kyçjen e dytë në TAP, duke rritur pavarësinë dhe sigurinë e furnizimit me gaz natyror dhe hidrogjen dhe do ta bëjë Maqedoninë e Veriut si shpërndarës të gazit natyror dhe hidrogjenit. Vlera e këtij projekti është 28 milionë euro, ku investitor është Nomagasi.

Linjat e reja interkonektive me Kosovën dhe Serbinë do të mundësojnë që rrjeti ynë i transmisionit të shfrytëzohet për furnizimin e fqinjëve tanë veriorë dhe të Europës Qendrore, duke rritur pavarësinë energjetike të rajonit dhe Europës nga gazi rus dhe për të krijuar pavarësi dhe stabilitet energjetik. Vlera e këtij projekti është 35 milionë euro, ku investitor është Nomagasi, ndërsa burimi i financimit është BERZH-i.

Akset e planifikuara të transmisionit që do të ndërtohen në periudhën 2024-2028, janë: Manastir – Ohër; Ohër – Kërçovë; Kërçovë - Gostivar; Sh.Nikole – Veles, Zona e lirë Tetovë, Tec Negotinë, Zona e lirë Shtip, zona e lirë Kavadar.

vi. TRANZICIONI ENERGJETIK DHE DEKARBONIZIMI

Prodhimi i energjisë elektrike nga gazi natyror planifikohet të shërbejë në një periudhë tranzitore deri në dekarbonizimin e plotë energjetik në vitin 2050. Në periudhën 2024 – 2028 do të ndërtohen disa impiante të rëndësishme të gjenerimit të energjisë elektrike nga gazi natyror:

- TC Negotinë, do të ndërtohet central i prodhimit të energjisë elektrike me gaz natyror me kapacitet maksimal të prodhimit prej 800 MW/h. Në këtë projekt planifikohet të kyçen edhe shtetet tjera të rajonit dhe do të shërbejë për prodhimin e energjisë bazë, por më e rëndësishmja është se do të shërbejë për balancimin e sistemit elektroenergjetik të shtetit dhe të të gjithë rajonit. Ky projekt do të adaptohet edhe për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrogjeni, për dekarbonizimin e përgjithshëm të sektorit energjetik. Planifikohet të ndërtohet edhe rezervuari i hidrogjenit, i cili do të prodhohet nga tepricat e gjenerimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike gjatë ditës dhe sidomos gjatë periudhës së verës kur prodhimi është i lartë. Vlera e këtij projekti është 1.2 miliardë euro dhe do të realizohet me partneritet të disa shteteve të rajonit.
- TC Oslomej do të adaptohet për prodhimin e energjisë elektrike me gaz natyror me kapacitet maksimal të prodhimit prej 150 MW/h, që do të shërbejë për prodhimin e energjisë bazë dhe për prodhimin e energjisë termike për Komunën e Kërçovës. Ky projekt do të realizohet me partneritet publiko-privat me vlerë 180 milionë euro.
- TC Manastiri, do të transformohet që si lëndë djegëse të shfrytëzohet gazi natyror në vend të lignitit ndotës. Tre blloqet funksionale të Tec Manastirit do adaptohen njëri pas tjetrit në një periudhë 6 vjeçare. Vlera e projektit është 360 milionë euro, ku investitor është SHA EMV-ja.

Gjithashtu, ne do t'i implementojmë politikat e klimës dhe energjisë të parapara në Planin nacional të energjisë dhe klimës, si:

- Struktura qeverisëse funksionale, së bashku me Planin vjetor të miratuar, të parapara në Udhërrëfyesin e tranzicionit të drejtë.
- Do të zhvillojmë masa afatshkurtra dhe afatmesme për zhvillimin e kapitalit njerëzor në rikualifikimin dhe ripunësimin e fuqisë punëtore në rajonet e qymyrit në Manastir dhe Osllovoj/Kërçovë.

Rrjeti i distribuimit të gazit natyror dhe hidrogjenit. Në periudhën në vazhdim do të intensifikohet ndërtimi i rrjetit të distribuimit të gazit natyror dhe hidrogjenit, me ç'rast kjo do të mundësojë furnizimin me gaz natyror dhe hidrogjen për çdo amvisëri, kompani, institucion dhe fabrikë në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të mundësuar alternativa energjetike, më të lira dhe më ekologjike. Burimi i financimit – BERZH-i (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) dhe partner privat.

3.2.3. BUJQËSIA MODERNE DHE USHQIMI I SIGURT

Sot bujqësia është një prej shtyllave kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit. Me investimet e realizuara në bujqësi në dekadën e fundit u mundësua një zhvillim më i hovshëm i vendit, sidomos në vendbanimet rurale, ku edhe ekziston traditë për kultivimin e produkteve bujqësore. Vendi ynë ka klimë mjaft të përshtatshme, me çka produktet bujqësore mund të jenë konkurruese me ato të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

Si shtet anëtar i CEFTA, sektorit të bujqësisë i mundësohet një treg shumë më i madh, ku prodhimet bujqësore plasohen në vende të ndryshme të rajonit. Do të angazhohemi edhe më fuqishëm në promovimin e bujqësisë dhe agroindustrisë, që nënkupton procedurë lidhur me prodhimin primar, deri tek përpunimi, konservimi dhe plasmani i produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Në proces është investimi prej 35 milionë eurove për sistemin e ujitjes prej 3.300 hektarëve tokë bujqësore në hidrosistemin Raven – Reçicë, investimi prej 14.5 milionë eurove për sistemin e ujitjes prej 1.960 hektarëve tokë bujqësore sa i përket Projektit për rehabilitimin e stacionit të pompimit, tubave dhe për sistemin e ujitjes së fushës së Dibrës, 2 milionë euro për sistemin e ujitjes në fushën e Tearcës, 2.2 milionë euro për sistemin e ujitjes në fushën e Kolibarit dhe Cërivicës, si dhe 4 milionë euro për rehabilitimin dhe modernizimin e sistemit të ujitjes në Komunën e Sarajit. Penda e Slupçanit në vlerë prej 25 milion euro, me të cilën është paraparë në mënyrë plotësuese të sigurohet ujë për pije dhe për industri si dhe zgjerim të rrjetit të ujitjes së tokave bujqësore për komunën e Likovës dhe Kumanovës.

Gjithashtu, duke pasur për bazë prodhimin e brendshëm bruto të përgjithshëm, ku 12-13% të mjeteve destinohen për bujqësinë dhe industrinë ushqimore të prodhimtarisë bujqësore, ne do të angazhohemi që buxheti për përkrahjen e prodhimtarisë bujqësore, i cili aktualisht është me vlerë 2.7% nga buxheti i shtetit, për katër vitet e ardhshme të rritet në vlerë prej 5% ose 1.2 miliardë euro. Nga kjo vlerë, 600 milionë euro do të parashihen për subvencione dhe 600 milionë euro për investime kapitale për katër vite.

Me përkrahjen dhe bashkëpunimin me agrobizneset vendore, do të vazhdojmë t'i adresojmë sfidat me të cilat ballafaqohet bujqësia, njëherit duke promovuar prodhimtarinë vendore në rajon dhe më gjerë. Ne do të vazhdojmë me investimet në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, blegtorisë, industrisë ushqimore dhe zhvillimit rural.

Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë. Kryesisht do të fokusohemi në rritjen dhe konsolidimin e tokës bujqësore, mbrojtjen e bimëve dhe kontrollin e farërave, zhvillimin e vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimtarisë, kultivimin e duhanit dhe zhvillimin e prodhimtarisë organike.

Zhvillimi i qëndrueshëm i blegtorisë. Kryesisht do të fokusohemi në zhvillimin e blegtorisë, gjedhtarisë, mbrojtjen shëndetësore të kafshëve dhe vaksinimin e tyre, zhvillimin e shpezëtarisë, prodhimtarisë së vezëve dhe rritjen e kapaciteteve si dhe bletarisë.

Industria ushqimore. Stimulimi i kapaciteteve të industrisë ushqimore do të jetë pikësynimi ynë parësor.

Zhvillimi rural dhe agrar. Modernizimi i bujqësisë për të reaguar ndaj sfidave aktuale do të integrohet nëpërmjet zhvillimit të industrisë agrare, zhvillimit të ekonomisë rurale, si dhe përkrahjes së bujqve të rinj dhe femrave në bujqësi.

i. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I BUJQËSISË

Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore me të mbjellura dhe konsolidimi i saj. Pjesa më e madhe e sipërfaqes është e mbjellur me drithëra (grurë 49%, pastaj me elb, thekër, misër etj), që mundëson zvogëlimin e varësisë nga importi i grurit ose afër 50%, plotësimin e nevojave vendore të industrisë së miellit me lëndën e parë. Me Strategjinë për konsolidimin e tokës bujqësore do të mundësojmë rregullimin e tokave duke i bashkuar sipërfaqet e tokës bujqësore, të asaj shtetërore dhe private, bashkimin e parcelave dhe shfrytëzimin më racional të tokës, rregullimin pronësor dhe juridik të tyre, mbrojtjen e ambientit jetësor, njëherit edhe mundësinë për përmirësimin e jetesës në vendbanimet rurale. Do të propozojmë themelimin e Fondit për Bashkimin e parcelave bujqësore (fondi për konsolidimin e tokave bujqësore), ku do të parashihet grumbullimi i mjeteve financiare nga shitblerja e tokave në llogarinë e veçantë rrjedhëse.

Mbrojtja e bimëve dhe kontrolli i farërave. Mbrojtja e bimëve është element i rëndësishëm në bujqësi që lidhet ngushtë me sigurinë e ushqimit me origjinë bimore, që lidhet edhe me mbrojtjen e konsumatorit. Për prodhimtari më të mirë dhe më efikasë lidhur me shëndetin e konsumatorit, me rëndësi është përdorimi i farërave cilësore dhe të certifikuara. Për këtë arsye, ne do ta përkrahim financiarisht prodhimtarinë dhe shfrytëzimin e të mbjellave me fara cilësore.

Zhvillimi i vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimtarisë. Qëllimi ynë do të jetë rritja e sipërfaqeve me pemë dhe perime, që do të ndikojnë në zhvillimin e industrisë së përpunimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Do të krijojmë kushte për zhvillimin e vreshtarisë si degë strategjike lidhur me verërat e RMV-së. Qëllimi ynë në pemëtari do të jetë zgjerimi i sipërfaqeve të mbjellura me: mollë, dardha, qershi, vishnje, kajsi, pjeshka, kumbulla, manaferra, dredhëza, gështenja, e në veçanti me lajthi, kulturë e cila gjithnjë e më shumë kërkohet në tregun e rajonit dhe atë të BE-së. Zgjerimi i sipërfaqeve me perime do të ndikojë në zhvillimin e industrisë së përpunimit dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Subvencionimi për vitet në vijim do të vazhdojë me anë të rritjes së mjeteve financiare, me ç'rast do t'i stimulojmë sipërfaqet e mbuluara me serra qelqi ose foli plastike, që njëherit mundëson kultivimin e produkteve të hershme bujqësore.

Kultivimi i duhanit. Në fushën e kultivimit të duhanit, me modelin e ri për rritjen e subvencioneve për klasën e parë për rekoltën e vitit 2024 parashihen 110 denarë për kilogram, për klasën e dytë 100 denarë, kurse për klasën e tretë 90 denarë. Në të njëjtën kohë, do të angazhohemi që në bashkëpunim me lidhjen e shoqatave të prodhuesve të duhanit dhe odës ekonomike, ta zvogëlojmë diferencën e çmimit të klasave të duhanit, me qëllim që kultivuesit ta përvetësojnë të drejtën e shfrytëzimit për subvencionimin e naftës së gjelbër, duke bërë të mundur që të zvogëlohen harxhimet në veprimtarinë e kultivimit të kësaj kulture.

Zhvillimi i prodhimit organikë. Një nga prioritetet e sektorit të bujqësisë do të jetë zhvillimi apo inkurajimi i bujqve që të orientohen sa më tepër drejt prodhimit të produkteve organike, si dhe arritjes së standardeve të kërkuara nga BE-ja. Me qëllim të rritjes së prodhimit bio dhe eksportit në vendet e BE-së, shumë bujq janë pajisur dhe do të vazhdojnë të pajisen me certifikata për prodhime organike, që mundëson eksportin e prodhimeve në BE. Me nxitje të fuqishme, si dhe me subvencionim të masave të Programit për prodhimtarinë organike, do të mundësojmë zgjerimin e sipërfaqeve të mbjellura me prodhimtari bio, si dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese të produkteve bujqësore organike, të cilat përpunohen dhe plasohen në tregun e jashtëm dhe atë vendor.

ii. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I BLEGTORISË

Zhvillimi i blegtorisë. Në fushën e blegtorisë synimi ynë do të jetë që edhe më tutje të vazhdojmë me ndarjen e kullotave dhe rritjen e subvencionimit të deleve, përmirësimin e kushteve të staneve dhe sigurimin e plasmanit të mishit në tregun ndërkombëtar. Rritja e numrit të kopeve të deleve do të ndikojë pozitivisht në rritjen e prodhimit të mishit të qingjit, industrisë së përpunimit të mishit, qumështit si dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të familjeve që merren me bagëti, ku çdo blegor i cili e ruan tufën në një lartësi mbidetare mbi 700 m, do të ketë rritje të subvencioneve në vazhdimësi edhe për 15% nga vlera e subvencioneve bazë.

Për periudhën 2024-2028 do të angazhohemi që me rritjen graduale të subvencioneve për blegtorinë, të ndikojmë në rritjen e numrit të bagëtisë për të pasur blegtori më të zhvilluar. Duke pasur për bazë problemin që kanë blegtorët me ruajtjen dhe kujdesin e kopeve, kemi propozuar masën për pagën neto për barinj të në vlerë prej 1000 eurove, e cila 100% do të jetë e financuar nga buxheti i shtetit.

Zhvillimi i gjedhtarisë. Synimi ynë do të jetë orientimi komercial i fermerëve për biznes familjar. Nëpërmjet subvencioneve, fermat e vogla familjare që merren me kultivimin e gjedhtarisë, kanë filluar të rriten dhe nga prodhimi për nevojat familjare kalojnë në prodhimin për tregun vendor dhe të jashtëm. Ky është rezultat i përkrahjes buxhetore të deritanishme e cila do të vazhdojë edhe më fuqishëm në periudhën e ardhshme, duke potencuar rritjen e vazdueshme të përkrahjeve financiare, buxhetit vetanak dhe fondeve europiane. Do të kemi rritje të subvencionimit për lopët, nga 4.000 denarë në 12.000 denarë për krerë me tendencë për rritjen e vlerës, si dhe vendosjen e masave shtesë lidhur me sasinë dhe cilësinë e qumështit. Gjatë periudhës 2024-2028, ne do të angazhohemi për investime me vlerë prej 1 milionë eurove, financuar nga Programi për zhvillimin rural, lidhur me përmirësimin e gjenetikës tek lopët qumështore nëpërmjet embriotransferit, për rritjen e sasisë së qumështit të lopëve vendore. Konform ligjit për zooteknikë, do të vazhdojmë me mbrojtjen ligjore të racave të ndryshme të kafshëve autoktone të vendit, siç është qeni i Sharrit ose Deltari Ilir dhe subvencionimi i këlyshëve të kësaj race të vjetër. Për këtë bazohemi në ndjekjen gjenetike të gjeneratave dhe prejardhjen e këlyshëve të kësaj race fisnike, si dhe racave të tjera të kafshëve autoktone të RMV-së.

Mbrojtja shëndetësore e kafshëve dhe vaksinimi. Preventiva e kafshëve është proces i cili do të kryhet në vazhdimësi në bashkëpunim me organizatat shëndetësore veterinarë, duke bërë

mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe njëherit edhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. Kjo do të bëhet për ta mbrojtur shëndetin e kafshëve si preventivë nga sëmundjet që qarkullojnë në shtet ose në rajon dhe për mbrojtjen nga sëmundjet zoonoze (sëmundje të cilat përcillen nga kafshët te njerëzit dhe e kundërta) siç janë: Tuberkulozi, Bruceloza, Tërbimi, Antraksi, Listerioza, Tularemia, Erizipelas, Salmoneloza, Tetanosi, Kampilobakterioza, Gripi i shpendëve, etj..

Zhvillimi i shpezëtarisë, prodhimit të vezëve dhe rritja e kapaciteteve. Shpezëtaria, prodhimi i vezëve dhe zogjve viteve të fundit ka një hov të dukshëm në vend. Evidente është rritja e kapaciteteve dhe modernizimi i fermave, duke shfrytëzuar mjete nga buxheti shtetëror dhe mjete nga fondet europiane. Në mënyrë konstante është rritur prodhimi i vezëve dhe zogjve, kështu nevoja e konsumit të brendshëm plotësohet 100% nga prodhimi vendor, ndërsa kemi rritje edhe të eksportit të vezëve, njëherit duke plotësuar standardet e kërkuara nga BE-ja. Do të vazhdojmë me përkrahjen e fermerëve për një zhvillim konstant të shpezëtarisë, në veçanti lidhur me rritjen e kapaciteteve për industrinë e mishit (kultivimi i brojlerëve), si dhe për prodhimin e vezëve dhe zogjve.

Zhvillimi i bletarisë. Përkrahja financiare ka ndikuar pozitivisht edhe në sektorin e bletarisë. Viteve të fundit vërehet një interesim më i madh për bletari, kështu dhe është rritur edhe numri i shoqërive të bletëve dhe i familjeve që meren me bletari. Do të vazhdojmë edhe më fuqishëm me subvencionimin e këtij sektori i cili ka bërë që bletarët ta rrisin prodhimin e mjaltit, cilësinë dhe numrin e koshereve. Pothuajse i gjithë prodhimi i mjaltit konsumohet nga tregu vendas, ndërsa importin kemi arritur ta ulim në vetëm 1% të nevojave të tregut vendor. Duke u bazuar në Programin për prodhimtari organike, në të ardhmën do të sugjerojmë që familjet të cilat merren me bletari të orientohen në prodhimin e mjaltit bio, duke mundësuar plasman të mjaltit organik në tregun vendas dhe atë të jashtëm.

iii. INDUSTRIJA USHQIMORE

Prodhimtaria dhe industria e mishit. Nga takimet e shpeshta me komunitetin e biznesit sidomos me industrinë e përpunimit të mishit dhe thertoret, kemi hasur në problemin e mungesës vendore të lëndës së parë, me ç'rast nevojat për industrinë e mishit plotësohen nga importi. Me anë të angazhimit më të fuqishëm, subvencionimit dhe stimulimit të fermerëve nëpërmjet Programit për përkrahje financiare në bujqësi, si subvencionim për therje të kafshëve në thertore të regjistruara, si dhe përfitime nëpërmjet të Programit IPARD III, të gjitha këto për stimulimin e gjedhëtarisë dhe nevojat e industrisë së mishit. Do të angazhohemi poashtu që edhe blegëtorëve t'u mundësohet plasman i sigurt i mishit të qingjit në thertoret e RMV-se, me një çmim të volitshëm.

Zhvillimi i industrisë së qumështit dhe prodhimtarisë qumështore. Në tregun e vendit ndjehet mungesë e madhe në furnizimin me qumësht dhe prodhime të qumështit, që ka ndikuar që tregu vendor të vërshohet nga produktet e importuara. Duke marrë për bazë rritjen e subjekteve të licencuara për përpunimin dhe paketimin e produkteve të qumështit, ne do ta nxisim këtë industri si një ndër industritë më të rëndësishme në vend. Do të përkushtohemi në rritjen e numrit të pikave grumbulluese të qumështit, investimet në

përmirësimin e gjenetikës për lopët qumështore nëpërmjet të embriotransferit, duke mundësuar kështu rritjen e sasisë së qumështit.

iv. ZHVILLIMI RURAL DHE AGRAR

Zhvillimi i industrisë agrare. Me politikat afatgjata të subvencionimit synojmë vazhdimësinë e përkrahjes për industrinë e agropërpunimit, nxitjen e madhe të prodhimitarisë bujqësore, përkrahjen e fermerëve, përmirësimin e cilësisë së produkteve me qëllim të arritjes së standardeve të BE-së, rritjen e cilësisë ushqimore dhe sigurisë së konsumatorit. Synimi ynë është që me këto masa të ndikojmë në sektorin e industrisë së agropërpunimit, të mishit dhe qumështit, duke mundësuar zhvillim më të qëndrueshëm të tyre, zvogëlim të papunësisë në vendbanimet rurale, si dhe ndikim pozitiv për mirëqenien familjare të fermerëve dhe blegtorëve.

Zhvillimi i ekonomisë rurale do të bëhet nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në mjediset rurale. Gjithashtu, me shfrytëzimin e fondeve nga **IPARD**, si një instrument për ndihmë parahyrëse për zhvillimin rural, në periudhën e ardhshme, do të bëjmë përmirësimin e efikasitetit të tregut dhe arritjen e standardeve të Bashkimit Europian nëpërmjet rikonstruimit dhe mbindërtimit të sektorit bujqësoro-ushqimor, si dhe rritjen e konkurrencës së prodhimeve bujqësore.

Ne do të vazhdojmë me realizimin e Programit IPARD III, që është me vlerë prej 125 milionë eurove, prej të cilave 97 milionë euro (75%) mbulohen nga fondet e Bashkimit Europian dhe 28 milionë euro (25%) janë mjete nga buxheti shtetëror. Këto mjete do të mund të shfrytëzohen në periudhën e ardhshme 7 vjeçare. Me anë të këtyre fondeve, ne do ta përmirësojmë efikasitetin e tregut dhe arritjen e standardeve të Bashkimit Europian nëpërmjet rikonstruimit dhe mbindërtimit të sektorit bujqësoro-ushqimor, si dhe rritjes të konkurrencës së prodhimeve bujqësore. Gjithashtu, do të kontibujmë në zhvillimin e ekonomisë rurale nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në mjediset rurale.

Këto mjete janë të parapara për përkrahjen financiare në lloj të grantit në vlerë prej 50-75% nga vlera e përgjithshme e realizuar e cila është në listën e shpenzimeve të pranuar sipas masave dhe investimeve nga Programi IPARD, si dhe për mundësinë për avans prej 50% nga mjetet e pakthyeshme.

Nafta e gjelbër. Do të vazhdojmë me ndarjen e kartelave për naftën e gjelbër. Risi për periudhën e ardhshme do të jetë mbulimi prej 100% i harxhimeve të naftës për përgatitjen e tokës për mbjellje. Me këtë masë do të bëhet zvogëlimi i harxhimeve të bujqve, duke mbuluar harxhimin e karburanteve, dedikuar lëvrimin dhe përgatitjes së tokës për mbjellje.

Përkrahja e bujqve të rinj. Me anë të rritjes së subvencioneve për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë gjatë periudhës 2024-2028, do të vazhdojmë me ndarjen e mjeteve financiare për stimulimin e bujqësisë. Këto mjete kanë mundësuar që të kemi prodhimtari më cilësore, si dhe nxitje të fuqishme të industrisë agrare. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet Programit për përkrahje financiare të bujqësisë dhe Programit për zhvillim rural, me ç'rast parashihen që masat dhe pagesat të bëhen vitin e njëjtë në të cilin është bërë edhe parashtrimi i

kërkesave nga bujqit. Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural do të jetë mundësi për zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë vendase dhe përmirësimin e kushteve nëpër fshatra. Me anë të këtij programi parashihet stimulimi i bujqve të rinj nën moshën 40 vjeçare, pastaj ekonomive bujqësore që duan të bëjnë investime për blerjen e kafshëve me përkrahje deri në 75% të investimit, si dhe ekonomive bujqësore që janë regjistruar si bujq individualë.

Përkrahja e femrave në bujqësi. Ne do ta përkrahim gruan aktive fermere me anë të subvencionimit deri në 6.000 euro për çdo shfrytëzuese. Këto mjete do të jenë grant i pakthyeshëm që do të shërbejë për biznes, projekte dhe investime në bujqësi. Gjithashtu, do t'i japim përparësi gruas në furnizim me makineri bujqësore etj..

Zhvillimi i turizmit rural. Ne do të angazhohemi që në vendbanimet rurale të mundësojmë dhënien e granteve nga shteti në vlerë prej 10.000 eurove, dedikuar meremetimit të shtëpive nëpër vendbanimet rurale, të cilat pastaj do të mund të licencohen nga institucionet përkatëse dhe të shfrytëzohen për bujtina për turistët. Pronarët e shtëpive do të kenë mundësi që turistëve t'u ofrojnë ushqime vendore dhe tradicionale nga vendbanimet e tyre. Për sezonën e verës, më saktësisht gjatë tre mujorit veror, punëtorëve sezonalë do t'u sigurohen paga nga shteti, me qëllim që të punojnë këtu në vend, e mos të largohen për punë sezonale në shtete tjera.



3.3. INFRASTRUKTURA MODERNE DHE ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

- *Transport dhe komunikim modern*
 - *Autostrada e korridoreve 8 dhe 10d*
 - *Autostrada Shkup-Bllacë*
 - *Bulevardi Hasan Prishtina*
 - *Rruga Tetovë-Prizren*
 - *Qarkorja e Tetovës*
 - *Modernizim dhe ndërtim i hekurudhës 8 dhe 10*
 - *Zona të gjelbra tranziti në Ballkanin Perëndimor*
 - *Broadband dhe rrjet telekomunikimi rajonal*

- *Zhvillim lokal dhe rajonal i barabartë*
 - *Rritje e pjesës së të hyrave nga TVSH-ja për komunat prej 6% në 9%*
 - *Rritje e pjesës së të hyrave nga tatimi personal për komunat prej 6% në 9%*
 - *Fondi i Barazisë dhe Fond i Performancës*
 - *Agjencia e Zhvillimit Lokal dhe Rajonal*
 - *Disiplinë fiskale dhe regulla fiskale për buxhetin e komunave*
 - *Instrumente për financim: bonde të komunave, bonde strukturore, huazime stand-by nga buxheti shtetëror*

- *Turizëm përfaqësues*
 - *Platformë digjitale turistike interaktive*
 - *Subvencione dhe lehtësime tatimore për turizëm*
 - *Turizëm kulturor, ekologjik, etnogastronomik, rural, alternativ dhe margaritarë turistikë*
 - *Ohri, Struga dhe Liqeni i Ohrit, si zonë e mbrojtur kulturore në UNESCO*
 - *Liqeni i Prespës bashkë me Parkun Nacional Pelister*
 - *Liqeni i Mavrovës bashkë me Parkun Nacional të Mavrovës, Kanjonin e Radikës dhe Dibrën me liqenet Glloboçicë dhe Shpilje, si dhe banjat e Kosovrastit;*
 - *Parku Nacional Mali Sharr me liqenet malore*
 - *Qendra Turisike Kodra e Diellit duhet të zhvillohet në qendër rajonale për turizëm dimëror për skijim, por edhe si ofertë turistike gjatë gjithë vitit*
 - *Saraji me Kanjonin Matka dhe rivitalizimi i Liqenit të Treskës*
 - *“Bit Pazari” në Shkup dhe turizmi multikulturor Kalaja e Shkupit, Amfiteatri Antik “Skupi”, “Aquadukti”, etj*
 - *Observatori megalitik “Kokino”*
 - *Pikat arkeologjike “Stobi”, “Heraklea”, etj.*
 - *Manastiri si qytet me arkitekturë të njohur dhe rajoni malor “Molika”*

3.3.1. TRANSPORTI DHE KOMUNIKIMI MODERN

Ne kemi bërë përparim të mirë drejt zbatimit të masave të Planit të veprimit për lehtësimin e transportit, duke arritur një shkallë të përgjithshme të zbatimit prej 63%. Arritja e rëndësishme është transformimi i kontrollit kufitar nga dy në një pikë ndalese në Qafë Thanë me Shqipërinë, e zbatuar nga 1 gushti i vitit 2023.

Me investime në transport, ne do të arrijmë të krijojmë rrjet strukturor komunikimi, që do të realizonte gradualisht barazimin e niveleve ekonomike sepse në këtë mënyrë përafrohen tregjet, si dhe bëhet lëvizje e sigurt për banorët. Ne do të angazhohemi drejt përmirësimit dhe përforcimit të infrastrukturës rrugore dhe asaj hekurudhore.

I. INFRASTRUKTURA RRUGORE

Në përputhje me Planin e rritjes për Ballkanin Prendimor, e propozuar nga BE-ja dhe përkushtimin tonë për ta përmirësuar lidhjen dhe infrastrukturën, ne zotohemi t'i japim përparësi lehtësimit të transportit rrugor në Maqedoninë e Veriut. Duke njohur rëndësinë e rrjeteve efikase të transportit në nxitjen e rritjes ekonomike dhe integritimit rajonal, ne do të ndërmerim nisma strategjike për t'i modernizuar dhe përmirësuar operacionet e transportit rrugor.

Për më tepër, ne do të punojmë drejt ofrimit të qasjes në sistemet thelbësore të informacionit të BE-së, si Informacioni i Tregut të Brendshëm (ITB) dhe Regjistri Elektronik i Ndërmarrjeve të Transportit Rrugor (RENTRE), për partnerët në Ballkanin Perëndimor. Duke mundësuar qasjen në këto sisteme dhe duke nxitur marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit, ne synojmë ta rrisim transparencën, efikasitetin dhe pajtueshmërinë rregullatore në operacionet e transportit rrugor. Kjo do të hapë rrugën për logjistikë më të butë ndërkufitare dhe lehtësimin e tregtisë, duke e nxitur rritjen ekonomike dhe integritimin rajonal.

Nëpërmjet këtyre përpjekjeve të përbashkëta, ne parashikojmë harmonizimin e përsheptuar të legjislacionit (acquis-it) të BE-së për transportin rrugor, duke hedhur bazat për integrim dhe bashkëpunim më të thellë në fushën e transportit rrugor. Duke shfrytëzuar ekspertizën, burimet e Bashkimit Europian dhe duke nxitur bashkëpunimin midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, ne do ta krijojmë lidhjen e rrjetit të transportit në mënyrë efikase, duke i mundësuar vendit tonë të përfitojë plotësisht nga vendndodhja strategjike gjeografike dhe të kontribuojë në zhvillimin më të gjerë rajonal.

Synimi ynë është ndërtimi i rrugëve moderne dhe të sigurta sipas standardeve europiane.

Promovimi i korsive të gjelbra (Green Lanes). Në kuadër të Planit të rritjes për Ballkanin Perëndimor, respektivisht shtyllës së dytë – Integrimi në Tregun e Vetëm të BE-së është paraparë vendosja në funksion të korsive të gjelbra.

Korsitë e gjelbra u vendosën gjatë pandemisë së COVID-it për ta lehtësuar qarkullimin e barnave dhe mallrave thelbësore mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Shkëmbimi i

menjëhershëm i të dhënave doganore të dërgesave mundësoi që mallrat të kalonin më shpejt nëpër pikat kufitare. Korsitë e gjelbra tani po zgjerohen me më shumë mallra edhe në vendkalimet e Bashkimit Europian me Ballkanin Perëndimor. Përmirësimi i bashkëpunimit doganor tani duhet të fokusohet, jo vetëm në lehtësimin e tregtisë, por edhe në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe në mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve. Masat kryesore që duhet të përfshihen janë:

- Shkëmbimi i të dhënave doganore;
- Njohja e ndërsjellë e operatorëve ekonomikë të autorizuar;
- Dispozitat për përcaktimin e treguesve kryesorë për sukses dhe luftimin kundër mashtrimit.

Megjithatë, nga ana tjetër, duhet të rishikohet edhe bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit dhe ndihmën lidhur me kompensimin në sferën e TVSH-së.

Përmes vendosjes së korsive të gjelbra do të arrihen këto përfitime:

- Korsitë e gjelbra ekzistuese tashmë kanë reduktuar kohën e pritjes në pikat kufitare. Reduktimi i kohës së pritjes në kufi për tri orë do të ishte e ngjashme me uljen e tarifave me rreth 2% në të gjitha ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- Sigurimi i funksionimit të vazhdueshëm të zinxhirëve të furnizimit të mallrave dhe prodhimeve.
- Rritja e tregtisë dhe rritja e atraktivitetit të rajonit për investitorët.

Korridori 8 dhe Korridori 10d. Ne kemi filluar realizimin e projektit historik për ndërtimin e Korridorit 8 dhe Korridorit 10d. Do të ndërtojmë 110km autostradë moderne me 6 kors, ku në këtë mënyrë vendi ynë do të bëhet pjesë e korridoreve europiane. Ky projekt pritet të përfundojë në muajin dhjetor të vitit 2027.

Rëndësia e Korridorit 8, si pjesë e korridoreve transeuropiane të transportit, nuk është vetëm infrastrukturë, por edhe politike dhe strategjike për shtetin tonë dhe rajonin. Këtë investim infrastrukturor duhet ta shohim edhe nga prizmi i integritetit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian. Në këtë drejtim, ky korridor, përveç rëndësisë ekonomike, gjithashtu përforcon kohezionin ekonomik, social dhe territorial të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor duke krijuar sisteme transporti pa probleme ndërkufitare, pa pengesa ose hallka që mungojnë, ndërkohë që synon ta reduktojë ndikimin mjedisor të transportit dhe ta rrisë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit. Korridori 8 ka edhe rëndësi strategjike dhe kulturore, në drejtim të bashkëpunimit të Maqedonisë së Veriut me vendet e rajonit dhe në përgjithësi me Europën.

Korridori 8 ka rëndësi të madhe ekonomike pasi bizneseve dhe kompanive vendase u mundëson qasje në tregjet europiane. Korridori 8 lidh Bullgarinë me Shqipërinë dhe me këtë edhe portet detare të Adriatikut dhe Detit të Zi, duke hapur mundësi të reja për zhvillim dhe qarkullim më të mirë të njerëzve, shërbimeve dhe mallrave që janë parakusht për ekonominë dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Vendosja e Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS) në Korridorin 10 po vazhdon të realizohet me sukses. Implementimi i këtyre sistemeve përgjatë aksit Tabanocë-Gjevgjeli do të mundësojë vendosjen e sistemeve të informimit përgjatë rrugës sa u përket kushteve klimatike, ngecjeve në komunikacion, kontrollin e transportit të materialeve të rrezikshme, por gjithashtu do të bëjë matjen e frekuencës dhe dendësisë së komunikacionit si dhe peshën e mjeteve transportuese.

Ky investim në vlerë prej 18.6 milionë eurove, përgjatë 2 pikave kufitare veri-lindje gjithashtu do ta masë emetimin e gazrave serrë, kamerave të sigurisë, telefonave emergjente SOS, si dhe do të destinohet në vendosjen e sinjalizimit elektronik për kushtet e komunikacionit rrugor. Të gjitha këto parametra për kushtet rrugore do të monitorohen nga Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore.

Rruga Tetovë - Prizren. Në bashkëpunim me Republikën e Kosovës, do ta ndërtojmë rrugën që lidh qytetin e Tetovës me qytetin e Prizrenit. Kemi nënshkruar marrëveshje për projektimin e tunelit të përbashkët që do të jetë në vijën kufitare. Në mandatin e ardhshëm do të fillojmë me realizimin e tij.

Ndërtimi i autostradës Kërçovë-Ohër. Me ndërtimin e kësaj autostrade me gjatësi prej 57km, do të ndikohet në rritjen e sigurisë së qytetarëve në komunikacion, uljen e shpenzimeve gjatë udhëtimit si dhe shkurtimin e kohës së udhëtimit.

Ndërtimi i rrugës rajonale Burimi - Ura e Garës (pjesë e rrugës së Arbërit). Ndërtimi i rrugës së re rajonale Burimi – Ura e Garës është në vlerë prej 23.7 milionë eurove dhe ky projekt pritet të përfundojë muajin dhjetor të vitit 2024.

Ndërtimi i qarkores në Tetovë (Trebosh - Neproshten). Ndërtimi i kësaj qarkoreje do ta përshpejtojë zhvillimin ekonomik të rajonit, do ta lehtësojë komunikacionin dhe qasjen e shumë kompanive që veprojnë në këtë pjesë. Faza e parë e këtij projekti është në gjatësi prej 5.4km dhe në vlerë prej 10.36 milionë eurove. Ky projekt pritet të përfundojë në muajin mars të vitit 2025.

Autostrada Shkup - Bllacë. Do të vazhdojmë me fazën e dytë në këtë lidhje rrugore me Republikën e Kosovës, e cila është në gjatësi prej 10.5km.

Riparimi i rrugës rajonale Ohër – Shën Naum. Kjo rrugë rajonale me gjatësi 24.3km dhe me vlerë investimi prej 12 milionë eurove pritet të përfundojë në vitin 2024.

Rehabilitimi i autostradës Katllanovë - Petrovec. Ky projekt është në gjatësi prej 5.5km në vlerë prej 5.9 milionë eurove. Gjithashtu pritet të përfundojë në vitin 2024.

Shumë projekte të tjera do të fillojnë me realizim gjatë këtij viti, që është edhe fillimi i mandatit të ardhshëm. Qëllimi ynë mbetet ndërtimi i rrugëve të sigurt dhe moderne që do ta lehtësojë qarkullimin e udhëtarëve dhe mallrave.

Ne kemi paraparë fillimin e ndërtimit të akseve të reja rrugore, përkatësisht: ndërtimin e autostradës Kërçovë - Bukojčan, rindërtimin e njës rrugore Bërvenicë, rikonstruimin e

segmentit rrugor Nikoforë - Leunovë - Bunec, vendosjen e gardhit mbrojtës të zërit në pjesë të caktuara të akseve rrugore në gjatësi të korridoreve 8 dhe 10, sinjalizimin e autostradave, projektimin dhe ndërtimin e rrugës shtetërore Kondovë - Radushë - Jegunovcë dhe ndërtimin e qarkores në Svillare të Komunës së Sarajit, projektimin dhe ndërtimin e qarkores në qytetin e Dibrës, projektimin dhe ndërtimin e rrugës shtetërore Frenovë - Jabollçisht i Epërm - Nezhillovë.

Investime në autostradën në Korridorin 10d (Prilep – Manastir), linja ujore Strugë – Pogradec, vendosja e pikës së përbashkët në vendkalimin kufitar Bllacë, sanimi dhe rikonstruimi i rrugës nga ura e Mellniçanit deri te f. Kosovrast i Poshtëm, përmirësimi dhe zhvillimi i rrugëve dhe lidhja e rrugëve lokale.

Gjithashtu, ne do të angazhohemi për miratimin e propozimligjeve për transponimin e rregullores së SIM; vendosjen dhe instalimin e pajisjeve ITS (fondet janë të disponueshme për pjesën jugore të korridorit dhe për pjesën veriore, financim ky që do të aprovohet nga Banka Botërore në kuadër të Programit të Transportit të Sigurt dhe të Qëndrueshëm (SSTP)), si dhe vendosjen e vinjetave për të huajt, ndërsa për qytetarat tanë pagesa e vinjetave do të bëhet gjatë regjistrimit të veturës.

ii. INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE

Në fushën e transportit është arritur progres i dukshëm edhe në sistemin hekurudhor me miratimin e ligjit, i cili lehtëson liberalizimin e tregut hekurudhor. Gjithashtu, vendi ka arritur progres të përgjithshëm prej 61% në zbatimin e Planit të veprimit hekurudhor. Sipas ligjit aktual, respektivisht sipas Ligjit të Hekurudhave, lejet e drejtimit të trenave nga shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e tjera njihen, ndërsa certifikatat e sigurisë dhe lejet e automjeteve njihen vetëm për shtetet anëtare të BE-së.

Trajektorja e Transportit Adriatiko-Jonian. Përveç aktiviteteve në nivel shtetëror, ne jemi fokusuar edhe në bashkëpunimin rajonal, me pjesëmarrje aktive të organeve brenda komunitetit të transportit që synojnë kryesisht bashkëpunimin ndërmjet partnerëve rajonale dhe integrimin e tregjeve të transportit të palëve të Europës Juglindore me BE-në. Maqedonia e Veriut është gjithashtu pjesë e Strategjisë së rajonit adriatiko-jonian.

Ne do të angazhohemi në krijimin e Qendrës së Menaxhimit të Trafikut, në mënyrë që të sigurojmë kapacitete të kualifikuara operative dhe administrative të organeve inspektuese për zhvillimin e kapacitetit të tyre zbatues për t'i reduktuar aksidentet në rrugë dhe në infrastrukturën hekurudhore.

Modernizimi i hekurudhës në Korridorin 10. Hekurudha ekzistuese do të modernizohet që transporti të jetë më i shpejtë, më efikas dhe më i sigurtë.

Ndërtimi dhe modernizimi i hekurudhës në Korridorin 8. Modernizimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i pjesës lindore dhe perëndimore të Korridorit 8, gjegjësisht lidhjes me Bullgarinë në lindje dhe me Shqipërinë në perëndim. Synimi ynë do të jetë hekurudha Shkup-Prishtinë-Durrës.

Ekonomia konkurruese dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Transporti hekurudhor zvogëlon kostot e transportit dhe e bën ekonominë më konkurruese, si dhe mbron e mjedisin jetësor dhe nuk e ndot ajrin në krahasim me transportin me karburante si lëndë djegëse.

3.3.2. ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

Zhvillimi rajonal si proces synon t'i reduktojë disparitetet në nivelin e zhvillimit dhe midis rajoneve të planifikimit me qëllim të sigurimit të zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm të rajoneve. Sipas kësaj, çdo rajon është definuar si njësi territoriale, funksionale për statistikë në nivelin e definuar në Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikë (NTES), e cila është e krijuar për nevojat e planifikimit të zhvillimit dhe për zbatimin e politikës së sigurimit të zhvillimit të barabartë rajonal. Politika për ta inkurajuar zhvillimin e barabartë rajonal është definuar si sistem që synon t'i reduktojë disparitetet në nivelin e zhvillimit dhe midis rajoneve të planifikimit dhe për ta siguruar zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Për një dekadë, politika për ta inkurajuar zhvillimin e barabartë rajonal është determinuar përmes Strategjisë së zhvillimit rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si një dokument i qartë planifikues që përcakton parimet, qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit rajonal në vend dhe definon masat, instrumentet dhe burimet financiare, si dhe aspekte të tjera për zbatimin e tyre. Me anë të Strategjisë së zhvillimit rajonal synohen të arrihen qëllimet e mëposhtme për inkurajimin e zhvillimit të barabartë rajonal:

- Zhvillimi i barabartë dhe i qëndrueshëm në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazuar në modelin e zhvillimit policentrik;
- Redukimi i dispariteteve në rajonet e planifikimit dhe brenda tyre, si dhe sigurimi i cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët;
- Rritja e konkurrueshmërisë së rajoneve të planifikimit duke fuqizuar kapacitetin e tyre ekonomik, duke shfrytëzuar dhe valorizuar në mënyrë optimale pasuritë natyrore, kapitalin e tyre dhe karakteristikat ekonomike të ndryshme të rajoneve;
- Ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të veçantë të rajoneve të planifikimit, si dhe promovimi dhe zhvillimi i tyre;
- Zhvillimi i zonave urbane;
- Zhvillimi i zonave me nevoja specifike zhvillimore;
- Zhvillimi i fshatrave;
- Përkrahja e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërqytetar e njësive të vetëqeverisjes në funksion të inkurajimit të zhvillimit të barabartë rajonal.

I. DECENTRALIZIMI DHE QËNDRUESHMËRI FISKALE

Në përpjekje për rregullimin e pabarazisë fiskale dhe për të ndihmuar në arritjen e zhvillimit më të barabartë rajonal është e rëndësishme të krijohet mekanizmi efektiv për barazimin fiskal. Kjo do të ndihmonte në adresimin e disproporcioneve në të hyrat dhe shpenzimet e

njësive të vetëqeverisjes lokale brenda një rajoni, duke siguruar nivel më të barabartë të shërbimeve publike dhe të mirave për të gjithë banorët.

- 1) Decentralizimi fiskal dhe rritja e burimeve të financimit
 - Pjesa e TVSH-së dhe tatimi personal që destinohet për komunat do të rritet nga 6% në 9%;
 - Formula e shpërndarjes së TVSH-së do të rishikohet për t'i avancuar komunat që kanë më shumë banorë dhe më pak burime;
 - Operacionalizimi i Fondit të Barazisë Zhvillimore (ndihmon komunat më pak të zhvilluara);
 - Operacionalizimi i Fondit të Performancës (motivon komunat që i menaxhojnë me sukses financat e komunës);
 - Instrumentet e reja financiare për zhvillimin e komunave (fletobligacione komunale, fletobligacione strukturore, etj.).
- 2) Rritja e transparencës dhe disiplinës financiare të komunave
 - Rregulla fiskale për buxhetin e komunave;
 - Transparencë elektronike në bazë ditore për buxhetin;
 - Kornizë ligjore dhe financiare për menaxhimin e vështirësive financiare.
- 3) Transformimi i Byrosë së Zhvillimit të Barabartë Rajonal në Agjencinë e Zhvillimit Lokal dhe Rajonal
 - Financimi me Programin nga buxheti i shtetit.
 - Financimi me instrumente të reja financiare nga Bashkimi Europian, institucionet financiare ndërkombëtare dhe institucionet financiare private.

iii. ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

Koncentrimi i madh i popullsisë, operatorëve ekonomikë dhe aktiviteteve në qytetin e Shkupit dhe rajonet përreth tij kanë krijuar model zhvillimi monocentrik për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky model i zhvillimit ka qenë i pranishëm që para pavarësisë dhe vazhdon të dominojë, duke krijuar sfida të mëdha për zhvillimin e rajoneve të tjera të vendit. Për ta përballuar këtë sfidë, rëndësi ka që strategjitë për zhvillimin rajonal të fokusohen në krijimin e strukturës policentrike, duke përkrahur rajonet e tjera për ta zhvilluar potencialin e tyre ekonomik, ku do të sigurohen shërbime cilësore për qytetarët. Ky model do të ndihmonte në reduktimin e pabarazive dhe në krijimin e mjedisit më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut.

Me zhvillimin e barabartë rajonal synohen qëllimet strategjike të mëposhtme:

- 1) **Rajone ekonomisht të zhvilluara, ekonomi e qëndrueshme dhe konkurruese në nivel rajonal, duke shfrytëzuar specializimin inteligjent dhe stimulimin e investimeve private bashkë me investimet publike:**
 - Programimi dhe implementimi i investimeve publike në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i barabartë rajonal

- Plani për rritjen ekonomike duhet të sigurojë shpërndarje më të barabartë të përkrahjes për kompanitë vendase, duke siguruar financimin e nevojave teknologjike dhe inovative të eksportit;
 - Buxheti më i parashikueshëm i investimeve kapitale së paku për një periudhë të ardhshme 3 vjeçare;
 - Implementimi i instrumentit të fuqishëm dhe të qëndrueshëm për barazimin fiskal në financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale është kyç për zhvillimin e barabartë.
- Sigurimi i stimujve më të gjerë dhe drejtimi i investimeve private
 - Implementimi i masave specifike për t'i orientuar investimet private në rajonet më pak të zhvilluara, përfshirë përjashtimet nga taksat dhe stimujt e ngjashëm;
 - Përmirësimi i kushteve për fillimin e biznesit, duke përfshirë uljen e kapitalit bazë të nevojshëm për krijimin e kompanisë, veçanërisht në rajonet ekonomikisht më pak të zhvilluara;
 - Sigurimi i qasjes së ndërmarrjeve në burimet joformale dhe formale të financimit, duke përfshirë kapitalin joformal sipërmarrës dhe zhvillimin e operacioneve të fondit të investimeve;
 - Krijimi i sistemit të informacionit që furnizon personat që dëshirojnë të fillojnë një biznes me të gjitha informacionet e nevojshme për realizimin e idesë së tyre;
 - Përjashtimi nga taksat për të gjitha ndërmarrjet private të krijuara rishtas nga individët e rinj deri në moshën 30 vjeçare ose nga femrat, deri në nivelin e caktuar të xhiros;
 - Përkrahja e drejtpërdrejtë e sipërmarrjes së të rinjve dhe femrave përmes granteve për fillimin e bizneseve të tyre të reja;
 - Krijimi i statistikave për monitorimin e veprimtarisë sipërmarrëse të femrave.
- Krijimi i infrastrukturës së transportit, telekomunikacionit dhe energjisë me shpërndarje më të barabartë në rajonet e planifikimit
 - Hartimi dhe avancimi i infrastrukturës së transportit;
 - Hartimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
 - Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës energjetike;
 - Hartimi dhe avancimi i infrastrukturës komunale (ujësjellësi dhe kanalizimi);
- Qasja rajonale në hartimin e politikave për përkrahjen e sipërmarrjes dhe zhvillimin e industrisë
 - Orientimi i ndihmës shtetërore nga programet e Ministrisë së Ekonomisë, FITR-së, Agjencisë së Përkrahjes së Sipërmarrjes dhe Agjencisë së Përkrahjes dhe Promovimit të Turizmit për përkrahje të drejtpërdrejtë financiare ose përkrahje teknike për zhvillimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve në rajonet e planifikimit më pak të zhvilluara;
 - Rritja e numrit të projekteve të financuara nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale dhe Byroja e Zhvillimit Rajonal nëpërmjet Qendrës së Zhvillimit Rajonal të Pollogut duke synuar drejtpërdrejt përfundimin e sipërmarrjes dhe zhvillimin e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve);

- Krijimi i formave të bashkëpunimit ndërkomunal për përkrahjen e ndërmarrjeve në nivelin e rajoneve të planifikimit për t'i bashkuar burimet e kufizuara financiare në programe të përbashkëta për zhvillimin e ndërmarrjeve;
 - Investimi në zhvillimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve për përgatitjen e projekteve cilësore, veçanërisht në rajonet me numrin më të ulët të projekteve të aprovuara;
 - Gjenerimi i regjistrave me të dhëna të ndara sipas gjinisë për ta monitoruar numrin e aplikuesve për ndihmë të drejtpërdrejt për sektorin privat dhe për të siguruar sinkronizimin e programeve përkrahëse të shkencës;
 - Profilizimi i rajoneve të planifikimit nëpërmjet specializimit të zgjuar për t'i fokusuar investimet në zonat me produktivitet më të lartë dhe me vlerë të shtuar;
 - Krijimi i platformës për ndërlidhjen e femrave sipërmarrëse në nivel të rajoneve të planifikimit, për të ofruar përkrahje dhe këshilla për zhvillimin e sipërmarrësisë dhe pavarësisë ekonomike të femrave;
 - Konsolidimi i organizatave ekzistuese për përkrahjen e sipërmarrësisë në nivelin e rajoneve të planifikimit nëpërmjet krijimit të rrjetit të integruar për përmirësimin e koordinimit dhe efektivitetit;
 - Përfshirja e komponentit rajonal në Strategjinë e zhvillimit të industrisë në Maqedoninë e Veriut;
 - Përrjashtimi nga taksat dhe ofrimi i stimujve të tjerë për gjetjen dhe zhvillimin e industrive të caktuara në rajonet e planifikimit më pak të zhvilluara duke marrë parasysh përparësitë e tyre krahasuese.
- Përmirësimi i strukturës së fuqisë punëtore në rajonet e planifikimit dhe investimi në kapitalin njerëzor
 - Zbatimi i programeve të trajnimit për fuqinë punëtore me qëllim të përshtatjes së kualifikimeve profesionale me kërkesat e tregut të punës. Këto programe ofrojnë trajnime dhe aftësim të specifikuar për t'i përmirësuar aftësitë dhe kualifikimet e punëkërkuarve për t'i bërë ata më konkurrues në tregun e punës;
 - Stimulimi i punësimit në sektorin privat përmes programeve të subvencionimit të pagave për punëtorët e sapo punësuar, granteve për vetëpunësim dhe përjashtimit nga tatimet për të punësuarit e rinj. Këto masa synojnë ta bëjnë punësimin në sektorin privat më tërheqës në krahasim me sektorin publik;
 - Organizimi i punëve publike si pastrimi i parqeve, rrugëve dhe pyllëzimit, si një mundësi për t'i punësuar grupet e kategorive më të ndjeshme të popullsisë;
 - Programet për trajnimin e punëkërkuarve për t'u ndihmuar atyre në procesin e aplikimit dhe intervistës për punë;
 - Programet specifike për stimulimin e punësimit të të rinjve dhe femrave duke përfshirë trajnime, subvencione për pagat dhe përkrahje lidhur me punësimin;
 - Programet që adresojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara për integrimin më të lehtë në tregun e punës;
 - Programet praktike për rritjen e punësimit të të rinjve, femrave dhe grupet e tjera të kategorive të ndjeshme të popullsisë, duke i përgatitur për tregun e punës dhe duke parandaluar mungesat e aftësive. Këto programe janë veçanërisht të fokusuar në rajonet më të prekura si: Rajoni i Pollogut, Rajoni Verilindor dhe Rajoni Jugperëndimor, ku papunësia është më e lartë.

- Për ta përforcuar punësimin dhe për t'i përmirësuar kushtet e tregut të punës janë përcaktuar masat e mëposhtme:
 - Institucionalizimi i Garancisë së rinisë nëpërmjet miratimit të ligjit të veçantë. Kjo do të sigurojë strukturë të qëndrueshme për përkrahjen e të rinjve në punësim, duke përfshirë programet dhe shërbimet që u ndihmojnë atyre në gjetjen dhe ruajtjen e vendit të punës;
 - Miratimi i Ligjit të Përkrahjes së Sipërmarrësisë Sociale, për t'u ndihmuar të rinjve dhe femrave në krijimin e ndërmarrjeve sociale. Ky ligj do të fokusohet në ndihmën financiare dhe teknike për ndërmarrjet sociale, duke thelluar angazhimin në nivelin e rajoneve të planifikimit nëpërmjet qendrave të specializuara për përkrahjen e tyre;
 - Konsolidimi i këshilleve komunalë ekonomike dhe sociale në rajonet e planifikimit për t'i bërë ata aktorë më të rëndësishëm në zhvillimin rajonal. Këshillet do të shërbejnë si forume për dialog social dhe përfshirje të aktorëve të ndryshëm në procesin e vendimmarrjes për politikën dhe masat që ndikojnë mbi punësimin;
 - Rritja e pagës minimale ligjërishit e përcaktuar për ta rritur atraktivitetin e punësimit në sektorët me pagë më të ulët. Kjo masë synon t'i zvogëlojë dallimet në normat e aktivitetit të punësimit midis meshkujve dhe femrave dhe ta përmirësojë përshtatshmërinë e kushteve të punës për të dy gjinitë;
 - Formalizimi i punësimit joformal, veçanërisht në zonat më të prekura si Pollogu, Rajoni Verilindor dhe Rajoni Jugperëndimor. Kjo do të sigurojë që kategoritë e prekshme të popullsisë, si femrat, të rinjtë, personat me nivel të ulët arsimor dhe romët, të kenë qasje në të drejtat e punësimit dhe të përfitojnë nga përkrahja e Qeverisë;
 - Përforcimi i kapaciteteve institucionale të rajoneve të planifikimit për ta lehtësuar hyrjen në tregun e punës për kategoritë e ndjeshme të qytetarëve, duke përfshirë femrat e zonave rurale, nënat e vetme dhe gratë e paarsimuara ose me nivel të ulët arsimimi. Kjo përfshin zhvillimin e programeve të përshtatura për nevojat e tyre specifike dhe ofrimin e shërbimeve përkrahëse për integrimin e tyre në fuqinë punëtore.

- Zhvillimi bujqësor dhe zhvillimi rural i bazuar në avantazhet krahasuese të rajoneve të planifikimit
 - Stimulimi i investimeve të Programit IPARD dhe përkrahja shtetërore për ta përforcuar strukturën bujqësore, përkrahjen dhe ekspertizën e njësive rajonale;
 - Krijimi i kushteve për formimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore në rajonet e caktuara dhe përfshirja e tyre në masat për konsolidimin e tokës dhe shfrytëzimin e burimeve të disponueshme për investime;
 - Përkrahja e investimeve në rajonet rurale për rritjen e produktivitetit dhe për konsolidimin (bashkimin) e tokës bujqësore, duke përfshirë krijimin e Fondit të Garancisë Shtetërore për ta lehtësuar kreditimin e bujqve dhe fermerëve;
 - Nxitja dhe krijimi i parakushteve për investime në sistemet e ujitjes në rajonet e prekura nga ndryshimet klimatike, siç është Rajoni i Vardarit, për të siguruar që fermerët të kenë qasje të mjaftueshme në ujë për kulturat e tyre.

- Ulja e ndikimeve negative dhe përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit në rajonet e planifikimit, duke arritur rezistencë më të madhe ndaj ndryshimeve klimatike dhe duke udhëhequr një cikël investimesh më dinamike dhe të shumëfishuara
 - Ndërtimi i digave në disa rajone për të siguruar furnizim me ujë dhe për të parandaluar probleme, të tilla si përmbytjet;
 - Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë për rritjen e qasjes së popullsisë në ujë të pijshëm në rajone të caktuara;
 - Hapja e burimeve të reja të ujit për ta adresuar deficitin e ujit të pijshëm në disa rajone të prekura;
 - Rindërtimi i rrjeteve të furnizimit me ujë në zonat rurale për përmirësimin e shërbimeve;
 - Ndërtimi i stacioneve të trajtimit të ujit për garantimin e cilësisë së ujit të pijshëm në disa komuna;
 - Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të mbeturinave në të gjitha rajonet e planifikimit;
 - Ndërtimi i deponive të reja dhe mbyllja e deponive të vjetra në të gjitha rajonet;
 - Fokusimi në ndërgjegjësimin publik për rritjen e përqindjes së riciklimit të mbeturinave komunale;
 - Planifikimi dhe zbatimi i strategjive për parandalimin e ndotjes së ajrit në të gjitha rajonet;
 - Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik dhe stimulimi i shfrytëzimit të mënyrave të transportit më të qëndrueshëm.

2) Rajone tërheqëse të planifikimit me shërbime të përmirësuara lokale, qasje efektive në tregun e punës, duke siguruar një shkallë më të lartë të barazisë gjinore dhe mbrojtje efektive sociale të kategorive më të ndjeshme të popullsisë

- Stimulimi i zhvillimit të zonave të pazhvilluara, zonave të shpopulluara dhe zonave me nevoja specifike për zhvillim
 - Rritja e Fondit për Ndërtimin e Banesave Sociale në zonat e shpopulluara për t'i ndihmuar të rinjtë dhe çiftet e reja të sapomartuara me çmime të favorshme;
 - Sigurimi i parcelave për ndërtim në zona të caktuara me tarifa simbolike për nxitjen e zhvillimit;
 - Krijimi i vendeve të punës, veçanërisht për grupet më të prekshme të popullsisë, në zonat rurale dhe qytetet e vogla;
 - Inkurajimi i rritjes së popullsisë nëpërmjet politikave që përkrahin nënat me fëmijë, si orar fleksibil i punës dhe mbrojtje ligjore gjatë shtatzënisë dhe pushimit të lehonisë.
 - Përmirësimi i qasjes së femrave në kujdesin shëndetësor dhe rritja e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore, veçanërisht në zonat rurale;
 - Sigurimi i kujdesit ditor falas për familjet me numër më të madh të fëmijëve dhe përkrahje për arsimimin e tyre;
 - Themelimi i Institutit Nacional Demografik, për ta studiuar dhe perceptuar më mirë strukturën dhe tendencat demografike të popullsisë. Kjo do të ndihmojë në hartimin e politikave më të përshtatshme dhe efikase për zhvillimin rajonal.

- Krijimi i sistemit të planifikimit hapësinor modern dhe krijimi i infrastrukturës së njohurive në fushën e planifikimit hapësinor rajonal
 - Përgatitja dhe miratimi i Planit të ri hapësinor nacional, duke përfshirë edhe plane hapësinore rajonale për ta koordinuar zhvillimin hapësinor në nivel vendor dhe rajonal;
 - Krijimi i metodologjisë së re të planifikimit hapësinor që do t'i reflektojë ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale në vend, duke u bazuar në praktikën adekuate dhe metodologjinë e BE-së për planifikimin hapësinor;
 - Themelimi i institucionit të posaçëm nga nënsistemi për zhvillimin rajonal me përgjegjësi të drejtpërdrejt për planifikimin hapësinor rajonal dhe për bashkëpunimin e ngushtë me Agjencinë e Planifikimit Hapësinor;
 - Zgjerimi i mandatit të këshillave për zhvillimin e rajoneve të planifikimit ose krijimi i organit të veçantë këshillues për planifikimin hapësinor rajonal në secilin rajon të planifikimit, duke përfshirë përfaqësuesit e të gjithë aktorëve për të siguruar përfshirjen e tyre në procesin e planifikimit hapësinor;
 - Përgatitja dhe miratimi i planeve të reja hapësinore rajonale për ta koordinuar zhvillimin hapësinor në të gjitha rajonet e planifikimit, duke shfrytëzuar burimet natyrore dhe potencialet e vendosura në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
 - Përforcimi financiar i planifikimit hapësinor rajonal nëpërmjet krijimit të burimeve të qëndrueshme të financimit për të siguruar mbulimin e nevojave të dokumentacionit të planifikimit hapësinor në të gjitha rajonet.

- Sigurimi i kohezionit më të madh shoqëror ndërmjet rajoneve të planifikimit
 - Ulja e shkallës së varfërisë duke shtuar ndarjet e buxhetit dhe fushat e programeve sociale për të mbuluar një gamë të gjerë të shfrytëzuesve. Do të rriten pagat minimale për ta tejkaluar kufirin e varfërisë midis të punësuarve, veçanërisht në rajonet më të rrezikuara siç janë Rajoni Verilindor dhe Rajoni i Pollogut;
 - Përmirësimi i aktivizimit dhe punësimit të të rinjve në tregun e punës, duke ofruar programe dhe masa për rritjen e përfshirjes së tyre në punësim dhe arsim, duke u fokusuar te të rinjtë që nuk janë të punësuar ose që nuk janë të përfshirë në arsim (NEET);
 - Përforcimi i rolit të organeve lokale në menaxhimin e varfërisë dhe përjashtimit social, përmirësimi i kapaciteteve dhe burimeve për të ndihmuar në trajtimin e këtyre sfidave në nivel lokal;
 - Niveli i lartë i përpjekjeve për aktivizimin dhe punësimin e kategorive të prekshme të personave, duke përfshirë shfrytëzuesit e ndihmës së garantuar minimale, personat me aftësi të kufizuara, femrat, si dhe komunitetin rom, me fokus të veçantë në Rajonin Verilindor;
 - Parandalimi dhe reduktimi i përjashtimit digjital nëpërmjet Strategjisë për përfshirjen digjitale, duke siguruar qasje të internetit për të gjitha familjet dhe digjitalizimin e shërbimeve publike për të rritur disponueshmërinë dhe shfrytëzimin e tyre;
 - Përmirësimi dhe përshtatja e përfitimeve sociale për personat dhe familjet e kategorive të ndjeshme shoqërore, veçanërisht në rajonin Verilindor dhe përforcimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve lokale dhe rajonale për sigurimin e qasjes më të gjerë në shërbimet sociale.

- Sigurimi i shkallës më të lartë të barazisë gjinore në rajonet e planifikimit
 - Përmirësimi i praktikave për identifikimin e çështjeve gjinore dhe zbatimi i tyre në procesin e mbrojtjes sociale dhe punës sociale, duke promovuar dhe shkëmbyer praktika të mira për mbledhjen dhe analizën e të dhënave në mënyrë që të monitorohet situata nga perspektiva gjinore. Kjo përfshin arsyet e rënies në varfëri dhe aspektin e përjashtimit social, të cilat do të përfshihen në politikat dhe programet sociale të komunave dhe qendrave komunale për punë sociale;
 - Krijimi dhe përforsimi i kapaciteteve për barazi gjinore të anëtarëve të këshillave të komunave, Komisionit të Mundësive të Barabarta (KMB) dhe Komisionit të Mbrojtjes Sociale, Shëndetësore dhe të Fëmijëve;
 - Grumbullimi sistematik dhe i rëndësishëm i të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe analiza e tyre nga perspektiva gjinore. Krijimi i mekanizmave të qartë për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni midis institucioneve lokale, shoqërisë civile, punëdhënësve lokalë, sindikatave, përfaqësuesve të kategorive të ndjeshme, Entit Shtetëror të Statistikave dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale;
 - Rritja e përfshirjes së fëmijëve në kopshte, duke krijuar mundësi të shumta për aktivizimin e tregut të punës për prindër, veçanërisht nënave. Kjo mase synon ta përmirësojë qasjen e nënave në tregun e punës duke siguruar kujdes për fëmijët e tyre në kopshte.

- Zhvillimi i arsimit fillor dhe të mesëm sipas specifikave të rajoneve të planifikimit, nëpërmjet optimizimit të rrjeteve shkollore dhe sipas nevojave të tregut të punës;
 - Optimizimi i rrjetit të shkollave për arsimin fillor, duke konsideruar veçanërisht shkollat rajonale në zonat rurale dhe bashkimin e shkollave në qytete më të mëdha për t'i zvogëluar kostot administrative dhe teknike, si dhe përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin;
 - Optimizimi i rrjetit të shkollave të mesme, me fokus në krijimin e qendrave rajonale për arsimin profesional në shkollat e mesme për ta zhvilluar arsimin profesional edhe pas arsimit të mesëm.
 - Përforsimi i kapaciteteve njerëzore në komuna për sigurimin e cilësisë së arsimit, duke formuar njësi të veçanta organizative për zhvillimin e arsimit dhe bashkëpunimin ndërkomunal brenda rajoneve të planifikimit;
 - Projektimi dhe zbatimi i mjeteve për thyerjen e stereotipeve gjinore në arsim, duke parandaluar largimin e parakohshëm nga shkolla dhe duke mundësuar qasje të barabartë për të gjithë;
 - Krijimi i modelit për shpërndarjen e investimeve në arsimin fillor dhe të mesëm duke marrë parasysh Indeksin e zhvillimit të rajoneve të planifikimit, për të siguruar fondet për ndërtimin dhe rindërtimin e ndërtesave shkollore.

3) Përforsimi i politikës së zhvillimit rajonal, përmirësimi i instrumenteve financiare dhe krijimi i kapaciteteve administrative në nivel qendror, rajonal dhe lokal

- Përmirësimi i kornizës normative për zhvillimin e barabartë rajonal
 - Përgatitja dhe miratimi i Rregullores së re mbi Metodologjinë për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit.

- Përmirësimi i bashkërendimit në zbatimin e politikës për zhvillim rajonal për ta ekuilibruar monitorimin, vlerësimin dhe raportimin mbi rezultatet e arritura
 - Përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik të bashkërendimit për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e fondeve për zhvillimin e barabartë rajonal.
 - Transformimi gradual i Byrosë së Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me reformën e administratës publike.

3.3.3. TURIZMI PËRFAQËSUES

Vizioni për turizmin në Maqedoninë e Veriut ka qenë dhe është i orientuar drejt zhvillimit të segmenteve kyçe përmes krijimit të produkteve turistike inovative. Në këtë rrafsh, fokusimi ynë kryesor ka qenë tek segmentet e fuqishme turistike, të tilla si: turizmi kulturor, ekologjik, rural, etnogastronomik dhe turizmi alternativ.

Me Strategjinë nacionale për zhvillimin e turizmit, turizmi bëhet një sektor prioritar. Me Ligjin e Zonave Turistike janë rregulluar kushtet për investimet në zona të tilla, respektivisht menaxhimi i tyre nga personat juridikë vendas ose të huaj dhe mundësia e dhënies së ndihmës shtetërore në formën e kredive të taksave dhe përjashtimeve (përjashtimi nga tatimet mbi të ardhurat personale për 10 vjet dhe lirimi nga pagesa e TVSH-së në materialet e ndërtimit për ndërtimin e objekteve në zonën përkatëse).

Ne kemi përgatitur rregullore për subvencionimin e turistëve vendas për përkrahjen e sektorit të hotelerisë dhe stimulimin e turizmit vendor për vitin 2024, respektivisht mjete në vlerë prej 40.000.000 denarëve. Në këtë rrafsh, u realizua subvencionimi i turistëve të huaj që vijnë në mënyrë të organizuar, kështu në vitin 2022, kjo vlerë ishte 1.500.000 euro dhe në vitin 2023, mjete në vlerë prej 1.550.000 eurove, në varësi se nga cili shtet vijnë turistët, rregullorja parasheh subvencionim prej 15 deri në 65 euro për turist që qëndron së paku 3 net në Maqedoninë e Veriut në mënyrë të organizuar.

Gjithashtu, u realizua vendosja e shenjave në dy gjuhë për vendet turistike, me qëllim që të njihen qendrat turistike në përputhje me standardet europiane dhe ndërkombëtare, si dhe është bërë subvencionimi i manifestimeve dhe forumeve në sferën e turizmit.

Qëllimi ynë është që të hapim tregje të reja, të vendosim linja të reja ajrore dhe t'i arrijmë qëllimet strategjike që do të krijojnë klimë pozitive dhe do të rrisin numrin e turistëve nga vendet europiane dhe botërore. Arritja e qëllimeve, ashtu si deri më tani, do të realizohet përmes ndryshimeve dhe plotësimeve, si dhe nëpërmjet aprovimit të infrastrukturës ligjore dhe zbatimit të saj me ekipe e kuadro profesionale të përgatitura për sferën e turizmit (turizmi kulturor, turizmi ekologjik, turizmi rural, turizmi etnogastronomik, turizmi alternativ etj.).

Turizmi kulturor. Ne synojmë zhvillimin e vendbanimeve arkeologjike dhe objekteve kulturore të ndryshme, si dhe subvencionimin e ngjarjeve kulturore në vend, si dhe subvencionimin e sektorit për implementimin e ekostandarëve.

Turizmi ekologjik. Kemi shpallur Malin Sharr si Park Nacional, si një nga destinacionet më të rëndësishme turistike të vendit tonë. Gjithashtu, në vitin 2022 është formuar zona e re turistike Saraj – Liqeni i Treskës, dhe është bërë përkujdesja ndaj Liqenit të Ohrit (dhe jo vetëm), si zonë e mbrojtur, duke përfshirë qendrat urbane Strugën dhe Ohrin me rrethinat e tyre, sigurisht edhe në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë sikundër edhe me përkujdesjen dhe përkrahjen e UNESCO-s si mbrojtëse e trashëgimisë kulturore, si dhe përmes marrjes së fondeve IPA.

Turizmi rural. Përkrahja e turizmit malor do të bëhet nëpërmjet trendit të turistëve të kategorive të ndryshme, promovimit të turizmit malor dhe fshatrave turistike, rritjes së aktiviteteve ekonomike që do të rezultojnë me shtimin e të hyrave në ekonominë familjare, si dhe në buxhetet komunale dhe shtetërore, ku si efekt real do të bëhet zvogëlimi i papunësisë dhe varfërisë, subvencione për qëllime turistike të familjeve fshatare në mjediset rurale, përkrahje financiare e sipërmarrësisë së femrave në turizëm, përkrahje të turizmit rural nëpërmjet investimeve në ndërtimin apo rikonstruktimin e kapaciteteve turistike për vendosje dhe ushqim në mjediset rurale, si dhe subvencione për adaptimin e objekteve hotelerike për qasje të personave me aftësi të kufizuara.

Turizmi etnogastronomik. Ne synojmë ta promovojmë kuzhinën e vendit tonë me shumëllojshmërinë dhe autenticitetin e saj, duke përdorur bioproduktet vendore me bazë bimore dhe shtazore. Gjithashtu, synojmë përkrahjen e turizmit si veprimtari ekonomike nëpërmjet marketingut, produkteve turistike cilësore, njohurive të ofruara për vlerat unike natyrore, gastronomike e shumë të tjera, përballë publikut ndërkombëtar.

Turizmi alternativ. Duke valorizuar aspektet socio-ekonomike nëpërmjet grupeve të paorganizuara shoqërore sikundër edhe përmes grupeve të organizuara siç janë: klubet sportive, kulturore, shkollore, etj., si dhe duke krijuar organizata për menaxhimin e destinacioneve (DMO).

Margaritarët turistikë. Do të bëjmë strategji me fokus në pikat më atraktive turistike me renome rajonale dhe globale:

- Ohri, Struga dhe Liqeni i Ohrit, si zonë e mbrojtur kulturore në UNESCO;
- Liqeni i Prespës bashkë me Parkun Nacional Pelister;
- Liqeni i Mavrovës bashkë me Parkun Nacional të Mavrovës, Kanjonin e Radikës dhe Dibrën me liqenet Gllloboçicë dhe Shpilje, si dhe banjat e Kosovrastit;
- Parku Nacional Mali Sharr me liqenet malore;
- Qendra Turisike “Kodra e Diellit” të zhvillohet në qendër rajonale për turizëm dimëror për skijim, por edhe si ofertë turistike gjatë gjithë vitit;
- Saraji me Kanjonin Matka dhe rivitalizimi i Liqenit të Treskës;
- “Bit Pazari” në Shkup dhe turizmi multikulturor “Kalaja e Shkupit”, Amfiteatri Antik “Skupi”, “Aquadukti”, etj;
- Observatori megalitik “Kokino”;

- Pikat arkeologjike “Stobi”, “Heraklea”, etj.;
- Manastiri si qytet me arkitekturë të njohur dhe rajoni malor “Molika”;
- Festivalet dhe traditat kulturore;
- Ushqimet tradicionale.

Të gjitha këto duhet ta reflektojnë diversitetin kulturor, si dhe respektin e ndërsjellë dhe konsistencën shekullore si vlerë civilizuese në nivel global.



3.4. KAPITALI NJERËZOR DHE CILËSIA E JETËS

- *Arsim cilësor*
 - *Rritje e buxhetit për arsim mbi 4.5% e PBB-së*
 - *Rritje e buxhetit për shkencë mbi 1.5% e PBB-së*
 - *Përmirësim i cilësisë në arsim dhe testime ndërkombëtare*
 - *Rritje e integritetit dhe standardit të kuadrit arsimor*
 - *Përmirësim i infrastrukturës arsimore (shkolla, salla sporti)*
 - *Kurrikula të përshtatshme me nevojat e tregut dhe shoqërisë*
 - *Aftësitë e nxënësve: kreativitet, kritikë, komunikim, bashkëpunim, organizim, sipërmarrësi, etikë, shëndet*
 - *Mësim gjithëditor dhe modular*
 - *Digjitalizim i procesit mësimor*

- *Shëndetësi moderne*
 - *Optimizim insitucional i shëndetësisë: shëndetësia primare, sekondare dhe terciare*
 - *Përmirësim i cilësisë dhe digjitalizim i shërbimeve shëndetësore*
 - *Reformat në sigurimin shëndetësor: sigurim bazik dhe sigurim i zgjeruar*
 - *Unifikim i çmimeve për shërbimet shëndetësore që financohen nga Fondi Shëndetësor*
 - *Financim i shërbimeve shëndetësore sipas performancës*
 - *Rishikim dhe zgjerim i listës pozitive të barnave*
 - *Paga dinjitoze dhe mbrojtje e sigurisë dhe integritetit të personelit shëndetësor*
 - *Integrim i Qendrës Klinike Universitare në Shkup dhe transformim në kompleksin e ri shëndetësor*
 - *Investime në klinikat dhe spitalet rajonale: Tetovë, Kërçovë, Strugë, Ohër, Manastir, Kumanovë, Shtip, etj.*

- *Siguri sociale e qëndrueshme*
 - *Sistem efikas për mbrojtje dhe siguri sociale, digjitalizim dhe inspektime në terren*
 - *Shërbime sociale për të moshuarit dhe qendra për kujdes*
 - *Zvogëlim i varfërisë me politika dhe masa sociale*
 - *Mirëqenie sociale dhe kopshte fëmijësh në çdo vendbanim*
 - *Pensionist me dinjitet sipas Metodologjisë sistemore për rritje të vazhdueshme të pensioneve*
 - *Pension minimal në nivel prej 70% të pagës minimale dhe paraqet rritje prej 20% nga ajo aktuale*
 - *Pension social dhe pension familjar*
 - *Pensionim i parakohshëm dhe rregullim i mungesës së stazhit*

3.4.1. ARSIMI CILËSOR

Arsimi është e drejtë themelore e individit që jo vetëm i përmirëson njohuritë, aftësitë, kompetencat dhe qëndrimet e individit por, gjithashtu, mundëson jetë më të mirë dhe më cilësore. Ky proces paraqet shtyllën bazë për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë, si dhe është mjet i rëndësishëm për luftimin e varfërisë, veçanërisht në vendet në zhvillim.

Arsimi cilësor është investim i rëndësishëm për të gjitha vendet që kontribuon në ndërtimin e shoqërive me prosperitet, të shëndetshme dhe të drejta. Ky investim hap rrugë për një të ardhme më të mirë për qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Sistemi arsimor modern dhe efikas, me qasje të barabartë për të gjithë qytetarët, është thelbi i zhvillimit afatgjatë të shoqërisë.

Sistemi arsimor është sfidë komplekse që kërkon ndryshime dhe përshtatje të kujdesshme gjatë një periudhe të gjatë kohore. Për adresimin e kësaj sfide, kemi vendosur udhëzime dhe jemi duke ndërmarrë masa konkrete për vazhdimin e procesit reformues drejt përmirësimit të cilësisë së arsimit.

Përmisimi i cilësisë së arsimit. Për arritjen e përmirësimit të cilësisë së arsimit, do t'i kthehemi aftësimin të vazhdueshëm të mësimdhënësve me metoda moderne të mësimdhënies dhe do t'i promovojmë mekanizmat që do të sigurojnë arsim modern dhe cilësor. Gjithashtu, përmirësimi i aftësive digjitale të mësuesve dhe aksesin në programet e zhvillimit profesional në fushën e teknologjisë digjitale dhe pedagogjisë.

- Integrimi i pedagogjisë digjitale në programet e studimit dhe trajnimi i stafit mësimdhënës për kompetencën digjitale.
- Forcimi i sistemit për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.
- Krijimi i një rutine për vlerësimin e jashtëm institucional të arsimit të lartë.
- Rritja e standardeve minimale për punë në arsimin e lartë.
- Arritja e anëtarësimit të plotë në Rrjetin Evropian për Cilësinë në Arsimin e Lartë (ENQA).
- Racionalizimi i sistemit universitar përmes integritit dhe bashkimit.
- Përmirësimi i orientimit në karrierë për të rinjtë.

Qasje e barabartë në arsim për të gjithë. Qëllimi kryesorë do të jetë përmisimi i aksesit në arsim dhe reduktimi i pabarazisë. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- Adresimi i rezultateve heterogjene në arsimin parashkollor duke pilotuar instrumentin MELQO.
- Zhvillimi i një sistemi qendror për monitorimin e cilësisë së arsimit parashkollor dhe zbatimi i programeve për përmirësimin e aftësive prindërore dhe shkrim-leximit të hershëm tek fëmijët.
- Kryerja e diagnostifikimit duke përdorur teste të standardizuara për identifikimin e nxënësve të arsimit fillore dhe dytësore, të cilët përballen me humbjen e orëve të mësimin, me theks të veçantë identifikimi i nxënësve që ekspozohen në rrezik të largimit të parakohshëm (duke përdorur burimet e disponueshme si EGRA, EGMA, PISA).

- Futja e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për identifikimin e nxënësve që rrezikojnë të mos përmbushin kompetencat kryesore arsimore.
- Përmirësimi i aksesit në arsimin e lartë për studentët nga grupet e cenueshme socio-ekonomike duke ulur kostot përmes bursave dhe mjeteve të tjera.

Efikasitet dhe optimizim i resurseve në arsim. Për të përmirësuar efikasitetin dhe përdorimin e efektshëm të burimeve në arsim, planifikojmë të zbatojmë disa masa konkrete:

- Introdiktimi i formulave të reja për Financim: Planifikojmë të ndërmerren hapa për të zbatuar formula të reja për financimin e të gjitha niveleve të arsimit, duke përfshirë parauniversitare, shkollën e mesme dhe universitetin, duke përfshirë elemente të shpërblimit bazuar në performancë.
- Përmirësimi i shpenzimeve për arsimin e lartë dhe shkencën: Synojmë të rrisim efikasitetin e shpenzimeve për arsimin e lartë dhe shkencën, ndërsa në ndërkohë forcojmë mekanizmat e përgjegjësisë.
- Lidhja e financimit me rezultatet konkretë dhe standarde të caktuara për cilësinë: Planifikojmë të lidhim financimin me rezultatet konkrete dhe përmbushjen e standardeve të caktuara për cilësinë e arsimit.
- Rritja e pjesës së përqindshme të BPJ për shkencën dhe zhvillimin: Synojmë të rrisim pjesën e dedikuar të Produktit Bruto Vendor për shkencën dhe zhvillimin.
- Përgjegjësia shtesë e komunave dhe përmirësimi i monitorimit dhe politikave nga ana e MASH-së: Planifikojmë të rrisim përgjegjësinë e komunave dhe të përmirësojmë monitorimin dhe krijimin e politikave nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
- Përmirësimi i transparencës në përcaktimin e shpërndarjes së shpenzimeve mes komunave dhe MASH: Synojmë të përmirësojmë qartësinë dhe transparencën në përcaktimin e shpërndarjes së shpenzimeve mes komunave dhe MAS.
- Investime në kapitalin njerzor si burimi më i rëndësishëm i shtetit: Planifikojmë të realizojmë një plan për optimizimin e shkollave në nivelet e detyrueshme të arsimit.
- Përmirësimi progresiv i pagave për mësuesit: Synojmë të rrisim pagat për mësuesit dhe të shpërblejmë ata mësues që punojnë më mirë.

Investimet në infrastrukturën arsimore. Investimet e vazhdueshme infrastrukturore në të gjitha nivelet e shkollimit, nga ato parashkollore deri në shkollimin e lartë, së bashku me investimet në trajnimet praktike dhe sistemin e avancimit në karrierë sipas performancës së mësimeve, do të ndihmojnë në krijimin e sistemit më dinamik edukativ dhe arsimor, praktik dhe efikas. Në këtë mënyrë, do të jemi në gjendje t'i përgjigjemi nevojave dhe trendeve globale të tregut të punës, duke siguruar të ardhme të suksesshme dhe të përgatitur për ballafaqimin me sfidat e kohës së sotme.

Buxheti i qëndrueshëm. Buxheti në arsim dhe shkencë krahasuar me PBB do të jetë sipas mesatares në Bashkimin Europian dhe OECD:

- Rritja e investimit në arsim, në nivel vjetor, jo më pak se 4,5% e PBB-së;
- Rritja e investimeve në hulumtimin dhe zhvillimin shkencor (ku bën pjesë Fondi i Inovacioneve dhe Zhvillimit Teknologjik), në nivel vjetor, jo më pak se 1,5% PBB-së.

I. MODERNIZIMI I KORNIZËS KURRIKULARE

Shkollimi që përshtatet me botën e punës. Korniza kurrikulare e programit shkollor është baza mbi të cilën formohen nxënësit për t'u ballafaquar me sfidat e botës së punës. Në epokën e ndryshimeve dinamike teknologjike dhe shkencore, për reflektimin ndaj nevojave të tregut të punës dhe zhvillimet më të fundit, përditësimi dhe modernizimi i kornizës kurrikulare është i domosdoshëm.

Korniza e përditësuar kurrikulare do të kujdeset për integrimin e njohurive dhe aftësive të reja që i kërkon tregu i punës. Kjo mund të përfshijë kurse të specializuara në fushat inovative, duke u dhënë nxënësve përvojë më të thellë.

Përveç kësaj, programet e praktikave dhe stazheve janë esenciale për sigurimin e përvojës praktike të studentëve. Kjo mund të realizohet nëpërmjet partneriteteve me industrinë, duke ofruar mundësi reale të punës në mjediset e biznesit. Ky lloj i eksperiencës është çelësi për përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe rritjen e aftësive praktike.

Modernizimi i kornizës kurrikulare nuk është vetëm nevojë, por është investim për të ardhmen e nxënësve. Duke siguruar që nxënësit të kenë dije dhe aftësi të përshtatshme me zhvillimet më të fundit, jemi duke i bërë ata të gatshëm për sfidat dhe mundësitë që sjell sot bota e punës. Kjo është rruga drejt arsimit më të përshtatshëm, të kapshëm dhe të harmonizuar me kërkesat e shoqërisë gjithnjë e më të zhvilluar.

Nëpërmjet modernizimit të kornizës kurrikulare do të arrijmë përparim të rëndësishëm në arsim, përkatësisht:

- **Përshtatja me nevojat e shoqërisë.** Korniza e përditësuar do të reflektojë ndaj nevojave të shoqërisë, duke përfshirë aftësitë STEM dhe kompetencat për jetë moderne;
- **Përgatitja për tregun e punës.** Nxënësit do të përgatiten për tregun e punës, do të zhvillojnë aftësi për industrinë teknologjike dhe biznesin;
- **Inkurajimi i inovacionit.** Nxënësit do të inkurajohen për shprehjen e kreativitetit dhe zgjidhjen e problemeve në mënyra të reja;
- **Mësimi më efektiv.** Përditësimi i kornizës kurrikulare do të sjellë metoda mësimore më të përshtatshme dhe më stimuluese për nxënësit;
- **Përfshirja dhe diversiteti.** Korniza e re do të inkurajojë përfshirjen dhe diversitetin, duke siguruar ambient mësimor të mirëpritur për të gjithë nxënësit.
- **Mësim praktik.** Mundësi e jashtë

Edukimi STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë). STEM sjell revolucion në mësim, duke bashkuar shkencën, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën në një kombinim shumë të fuqishëm. Kjo nuk është thjesht lëndë e pavarur në orarin e shkollës, por eksperiencë e tërësishme që lidh dijen dhe aftësitë me botën reale. Në vend që ta mësojmë teorinë pa marrëdhënie me realitetin, STEM na ofron mundësinë për zbatimin e njohurive në situata të vërteta jetësore. Kjo, jo vetëm zhvillon mendimin kritik, por gjithashtu përgatit nxënësit për sfidat e mëtejshme, duke i bërë ata të gatshëm për botën në të cilën zhvillimin

e drejtojnë shkencat dhe teknologjia. Duke investuar dhe implementuar në mënyrë efektive, edukimi STEM do të rezultojë në:

- **Zhvillimin e aftësive të nxënësve.** Nxënësit do të zhvillojnë aftësi kritike dhe analitike të nevojshme lidhur me probleme për t'u bërë pjesë e një fuqie punëtore të specializuar dhe inovative;
- **Përgatitjen për tregun e punës.** Nxënësit do të jenë më të gatshëm për t'iu përshtatur kërkesave të ndryshme të tregut të punës, duke pasur njohuri dhe aftësi praktike në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë;
- **Stimulimin e inovacionit.** Edukimi STEM inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin duke nxitur nxënësit të zhvillojnë zgjidhje të reja për sfidat dhe problemet e shoqërisë;
- **Rritjen e konkurrencës globale.** Nëpërmjet fokusimit të thelluar në shkencë dhe teknologji, shoqëria jonë do të jetë më konkurruese në nivel ndërkombëtar, duke krijuar mundësi të reja për tregtinë dhe zhvillimin ekonomik;
- **Përmirësimin e cilësisë së jetës.** Duke përdorur njohuritë dhe aftësitë e fituara nëpërmjet edukimit STEM, shoqëria jonë do të ketë mundësi të mëdha për zgjidhjen e problemeve komplekse, sociale, mjedisore dhe ekonomike.

Fuqizimi i aftësive kritike. Në kohën kur ndryshimet shpërthejnë në çdo fushë të jetës, fokusi në zhvillimin e aftësive kritike është jetik për përgatitjen e nxënësve për një botë gjithnjë e më komplekse. Zhvillimi i këtyre aftësive, përfshirë të menduarit kritik, kreativitetin dhe aftësinë për bashkëpunim dhe komunikim, nuk është thjesht zgjedhje por nevojë e rëndësishme.

- **Aftësi kritike.** Të menduarit kritik u ofron nxënësve aftësinë për të vlerësuar dhe analizuar informacionin nga perspektiva të ndryshme. Duke inkurajuar këtë aftësi, ne po i përgatisim ata për ta kuptuar realitetin thellësisht dhe për t'u bërë pjesë e zgjidhjeve të sofistikuara;
- **Të menduarit kreativ.** Kreativiteti është burim i fuqishëm i zgjidhjeve të reja dhe inovacionit. Nxënësit që janë të aftë t'i krijojnë dhe t'i shprehin idetë e tyre në mënyrë krijuese janë ata të cilët mund ta krijojnë dhe ndryshojnë botën. Kjo aftësi do të zhvillohet nëpërmjet sfidave që inkurajojnë lirinë e shpirtit dhe eksperimentimin;
- **Bashkëpunimi dhe komunikimi.** Bashkëpunimi dhe komunikimi janë thelbësorë në një shoqëri ku bashkëpunimi dhe komunikimi janë në qendër të zhvillimit. Programet që inkurajojnë projektet grupore dhe komunikimin efektiv nëpërmjet teknologjisë dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor janë katalizatorë të përgatitjes së nxënësve për ambient të punës gjithnjë e më global.
- **Organizimi dhe sipërmarrësia.** Aftësitë organizative dhe fryma sipërmarrëse janë kyçe në optimizimin e kohës dhe përcaktimin e prioriteteve dhe vendimmarrjes, si faktorë që do ta stimulojnë suksesin e të rinjve dhe ekonomisë në të ardhmen.
- **Etika dhe shëndeti.** Vlerat e shoqërisë dhe etika personale do të ndikojnë në krijimin e personalitetit me integritet. Edukata shëndetësore do të ndikojë në rritjen e vetëdijes mbi rëndësinë dhe mënyrat e ruajtjes së shëndetit.

Këto aftësi nuk janë vetëm elemente të programit shkollor, ato janë shtyllat e arsimit të përshtatshëm dhe të përgatitur për të ardhmen. Duke ndihmuar nxënësit që ta zhvillojnë të

menduarit kritik, kreativitetin dhe aftësitë sociale, jemi duke i bërë ata të gatshëm për sfidat dhe mundësitë që sjellë bota në kohën aktuale dhe në të ardhmen.

ii. ARSIMI PARASHKOLLOR

Arsimi parashkollor është fazë e rëndësishme e zhvillimit të fëmijëve, ku ata formojnë bazat e tyre për të ardhmen. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sistemi arsimor përfshin arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë. Kjo periudhë është e rëndësishme për ndryshime dhe përmirësime në arsim, duke kërkuar qasje dinamike dhe përmirësime të vazhdueshme.

Në arsimin parashkollor, sfidat kryesore paraqesin përfshirjen e të gjithë fëmijëve, përmirësimin e kushteve mësimore, si dhe sigurimin e standardeve të cilësisë. Do të zhvillojmë strategji që do të përfshijë:

- Përmirësimin e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për mësim;
- Përmirësimin e standardeve dhe kontrollin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Zhvillimin e kompetencave të arsimtarëve dhe edukatorëve për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë efikase;
- Promovimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha palëve të interesuara në arsimin parashkollor për arritjen e qëllimeve të përcaktuara për cilësinë dhe përfshirjen e fëmijëve.
- Arsim i detyrueshëm parashkollor me qëllim që të ndërtohet një lidhje e fortë mes arsimit detyrueshëm parashkollor dhe atij fillor, duke integruar arsimin fillor me arsimin parashkollor nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Aktualisht arsimi parashkollor është në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale;

Kjo qasje synon krijimin e mjedisit tërheqës dhe të pasur arsimor për të gjithë fëmijët, duke u fokusuar në përmirësimin e cilësisë së arsimit parashkollor dhe përparimin e fëmijëve në këtë fazë të rëndësishme të zhvillimit të tyre.

iii. TRASFORMIMI I ARSIMIT FILLOR

Arsimi fillor në Maqedoninë e Veriut përbën segment kyç në zhvillimin arsimor të vendit. Qëllimi është të sigurohet qasje e barabartë dhe cilësore për të gjithë fëmijët në moshën 6-14 vjeçare, duke përfshirë edhe ata që jetojnë larg shkollave. Megjithatë, kjo sfidohet nga disa vështirësi.

Një nga sfidat kryesore është përmirësimi i rezultateve të nxënësve që janë ende të ulëta në raport me testet ndërkombëtare. Segregacioni etnik në disa shkolla është problem i vazhdueshëm, duke sjellë ndikime negative në kohezionin shoqëror. Mungesa e përfshirjes

së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në sistemin e rregullt fillor është tjetër sfidë që do të adresohet.

Për përmirësimin e kësaj situatë, do të zhvillohen masa për përcaktimin dhe rritjen e përfshirjes së nxënësve në shkolla, veçanërisht atyre me nevoja të veçanta. Për arritjen e kësaj, duhet të ndërmerren një varg masash të caktuara edhe atë:

- **Mjedisi mësimor** do të përmirësohet për sigurimin e kushteve të përshtatshme për të gjithë nxënësit, duke përfshirë edhe krijimin e ambienteve të sigurta dhe të rehatshme për mësim;
- **Plane dhe programe të avancuara mësimore:** Gjithashtu, do të rritet cilësia e planeve dhe programeve mësimore për përmbushjen e nevojave të çdo nxënësi dhe për promovimin e qasjes së barabartë ndaj të gjithë nxënësve;
- **Kushte pune:** Krijimi i kushteve të zhvillimit të aftësive kyçe të nxënësve, si dhe përkrahja e pedagogëve dhe drejtuesve shkollorë janë hapa të rëndësishme drejt përparimit të arsimit fillor në Maqedoninë e Veriut.

Gjithashtu, një nga vështirësitë që duhet të adresohet për përmirësimin e arsimit fillor në Maqedoninë e Veriut është nevoja për rritjen e shfrytëzimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Investimi në teknologjinë dhe infrastrukturën digjitale në shkolla do të mundësonte qasje më të mirë mësimore dhe do të ndihmonte në përmirësimin e aftësive digjitale të nxënësve. Gjithashtu, trajnimi i mësuesve për shfrytëzimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në mësim do të ndihmonte në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së mësimin. Në këtë mënyrë, arsimi fillor do të bëhej më i përshtatshëm me kërkesat e shoqërisë së informacionit dhe do të ndihmonte në përgatitjen e nxënësve për botë të përmirësuar digjitale.

Në procesin e transformimit arsimor, rol të rëndësishëm luan vetë mësimdhënësi. Në këtë mënyrë, vendosja e standardeve profesionale dhe kualifikimeve për mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme përfshijnë aftësitë digjitale dhe të gjelbra, që në miratimin e Kornizës Nacionale të Kualifikimeve janë më se të domosdoshme. Qëllimi i Kornizës Nacionale të Avancimeve është sigurimi i strukturës së qartë dhe të harmonizuar për vlerësimin, certifikimin dhe njohjen e kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit profesional në një vend të caktuar. Korniza synon përmirësimin e përshtatshmërisë së sistemit arsimor dhe trajnimit me tregun e punës, duke mundësuar që individët t'i zhvillojnë dhe t'i vlerësojnë kompetencat e tyre në mënyrë që ato të jenë të njohura dhe të pranueshme nga punëdhënësit, institucionet arsimore dhe shoqëria në përgjithësi.

iv. KRIJIMI I ARSIMIT TË MESËM

Në sistemin arsimor të Maqedonisë së Veriut, arsimi i mesëm është themelues dhe pa pagesë, duke u organizuar në katër lloje kryesore për përshtatjen e nevojave dhe interesave të nxënësve, përkatësisht:

- **Gjimnazi:** Pjesa më e përgjithshme e arsimit të mesëm që përgatit nxënësit për studime më të larta dhe përvojë të thellë akademike. Kjo rrugë e studimeve përmban spektër të gjerë të lëndëve dhe sfidave akademike për përgatitjen e nxënësve për studime universitare dhe karrierë;
- **Arsimi i mesëm profesional:** Kjo rrugë e arsimit përqendrohet në përgatitjen praktike dhe teknike të nxënësve për përgatitjen e tyre për t'u integruar në tregun e punës menjëherë pas përfundimit të shkollës. Nxënësit e këtij lloji të arsimit mund të bëjnë përzgjedhjen e tyre nga një gamë e larmishme fushash profesionale, duke përfshirë teknikën, teknologjinë, dhe shërbimet;
- **Arsimi artistik:** Është lloji i veçantë i arsimit të mesëm që përfshin përgatitjet në fushën e artit vizual, muzikës, teatrit dhe të tjera. Nxënësit që përzgjedhin këtë fushë të studimeve i zhvillojnë aftësitë artistike dhe kreativitetin e tyre duke u përgatitur për karrierë në botën artistike dhe kulturore;
- **Arsimi për nxënësit me nevojë të veçanta arsimore:** Është lloji i arsimit të mesëm i përshtatur për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke ofruar programe dhe përkrahje të veçanta për adresimin e nevojave të tyre të arsimit dhe zhvillimit personal.

Arsimi i mesëm profesional mund të zgjasë 3-4 vite, duke ofruar përgatitje të thellë dhe të specializuara në fushën e përzgjedhur. Kjo i ndihmon nxënësit t'i fitojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u bërë konkurrues në tregun e punës dhe për ta ndërtuar karrierën e tyre me sukses. Bazat e shkollës së mesme janë themelore për zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme edhe për përgatitjen e brezave të ardhshëm për sfida dhe mundësi të mëdha.

Përmbajtja e kurrikulës dhe shkathtësitë e nxënësve:

- **Rritja e standardeve:** Sigurimi që të gjitha planet dhe programet mësimore t'i përmbushin standardet nacionale dhe ta inkurajojnë përparimin e qëndrueshëm të nxënësve;
- **Përgatitja për të drejtat e njeriut:** Promovimi i njohurive të të drejtave të njeriut dhe respektimi i diversitetit dhe vlerave demokratike për të gjithë nxënësit;
- **Sigurimi i burimeve të përmbajtjes:** Furnizimi i nxënësve me libra shkollorë cilësorë dhe burime të nevojshme për kuptimin e botës moderne dhe për promovimin e vlerave të demokracisë dhe diversitetit;
- **Përcaktimi i rezultateve:** Identifikimi dhe vlerësimi i qartë i rezultateve të nxënësve për adresimin e nevojave dhe përparësive të tyre për zhvillimin e shoqërisë.

Përfshirja dhe integrimi ndëretnik në arsimin e mesëm:

- **Sigurimi i kushteve të përfshirjes:** Krijimi i mjediseve të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara fizike dhe promovimi i administratës së bazuar në informacione për sigurimin e arsimit gjithpërfshirës;
- **Fokusimi në interaktivitet:** Intensifikimi i interaktivitetit ndërmjet nxënësve që mësojnë në gjuhë të ndryshme për promovimin e multikulturalizmit dhe bashkëpunimi ndërkulturor;

Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në shkollat e mesme:

- **Zhvillimi i kompetencave:** Përmirësimi i kompetencave profesionale të arsimtarëve dhe drejtorëve për sigurimin e ambientit më të mirë mësimor dhe përparimit në arsim;
- **Inkurajimi i motivimit:** Motivimi i arsimtarëve dhe drejtorëve për arritjen e rezultateve më të mira nëpërmjet përkrahjes së vazhdueshme dhe përmirësimit të kushteve të tyre të punës;
- **Sigurimi i kushteve për nxënësit:** Mundësia për kushte më të mira të mësimdhënies dhe mësimi jashtë klase për sigurimin e qasjes më efikase ndaj nevojave të nxënësve.

Përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë së arsimit:

- **Përmirësimi i informacioneve:** Sigurimi i informacioneve të vlefshme për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive të nxënësve për përkrahjen e vendimeve të politikave arsimore;
- **Përkrahja e nxënësve të talentuar:** Nxënësit e talentuar do të kenë mundësi për zhvillimin e potencialeve të tyre krijuese;

V. PËRMISIMI DHE SIGURIMI I CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË

Arsimi i lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është një segment kyç në zhvillimin e vendit. Qëllimi është të ofrojë një arsim cilësor dhe të përparuar për studentët, duke përfshirë një gamë të gjerë të degëve dhe programeve studimore. Përmirësimi dhe sigurimi i cilësisë së arsimit të lartë ka për qëllim të krijojë një mjedis arsimor ku të gjithë studentët kanë mundësi të përfitojnë një përvojë të shkëlqyer mësimore dhe zhvillojnë aftësi dhe njohuri të nevojshme për të përparuar në shoqërinë dhe tregun e punës gjithnjë e më konkurrues. Përmes implementimit të masave për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, krijimin e sistemeve të sigurisë së cilësisë, dhe publikimin e raporteve të sigurisë së cilësisë, synohet të sigurohet një standard i lartë i cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit të lartë. Kjo përfshin zhvillimin dhe implementimin e kurrikulave të përditësuara, përfshirjen e teknologjisë digjitale dhe inovacionit në mësimdhënie, si dhe përgatitjen e studentëve për t'u bërë pjesë e një bote gjithnjë e më të digitalizuar dhe të ndryshueshme. Nëpërmjet këtyre përpjekjeve, synohet të garantohet që arsimi i lartë të jetë i përshtatshëm, i përmbushë nevojat e studentëve dhe të jenë përputhje me sfidat dhe mundësitë e shekullit të tanishëm.

- **Rritja e investimeve në infrastrukturë:** Krijimi dhe përmirësimi i ambienteve mësimore, bibliotekave, laboratorëve dhe infrastrukturës teknologjike për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore.
- **Zhvillimi i programeve studimore të përshtatshme për tregun:** Identifikimi i nevojave të tregut të punës dhe zhvillimi i programeve studimore që përshtaten me këto kërkesa për të përgatitur studentët për karrierat e tyre të ardhshme.
- **Krijimi i lidhjeve me industrinë dhe sektorin privat:** Nxitja e bashkëpunimit dhe partneritetit me industrinë dhe sektorin privat për të siguruar që programe studimore janë të përshtatshme me kërkesat e tregut të punës dhe për të ofruar mundësi praktike për praktikën e punës dhe praktikën profesionale për studentët.

- **Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies:** Trajnimet për mësimdhënësit, përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie, si dhe inkurajimi i punës së tyre shkencore për të kontribuar në njohuritë dhe inovacionin.
- **Promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar:** Bashkëpunimi me institucione të tjera arsimore në nivel ndërkombëtar për shkëmbim të studentëve, stafit akademik dhe njohjen e programeve studimore.
- **Inkurajimi i diversitetit dhe përfshirjes:** Sigurimi i qasjes së barabartë për të gjithë studentët, duke përfshirë grupet e marginalizuara dhe të diskriminuara, dhe përmirësimi i klimës së arsimit për të ndjekur një mjedis të hapur dhe të respektueshëm për të gjithë.

vi. AVANCIMI I SISTEMIT TË ARSIMIT DHE TRAJNIMIT PROFESIONAL

Për përparimin e Sektorit të Arsimit dhe Trajnimit Profesional është e rëndësishme t'i kemi parasysh këto prioritete dhe rezultate të pritshme, të cilat janë përcaktuar në mënyrë të detajuar në vijim:

- Përshtatja e shpejtë e Sistemit të Arsimit dhe Trajnimit Profesional (APT) për nevojat e ndryshueshme të shkathtësive në tregun e punës, duke siguruar që oferta arsimore të jetë në pajtim me kërkesat aktuale të punëdhënësve;
- Organizimi fleksibil dhe efikas i procesit të nxënies në kuadër të APT-së, me qëllim që nxënësit t'i fitojnë kompetencat e nevojshme për t'u përshtatur me sukses në tregun e punës, duke u orientuar drejt arritjeve të caktuara të rezultateve sipas standardeve të përcaktuara;
- Shfrytëzimi i informacioneve të përcjelljes së nxënësve për vlerësimin e suksesit të tyre në përfundimin e arsimit ose për zbatimin e vendimeve për politikën arsimore, duke u bazuar në argumentet e rezultateve të nxënësve në karrierën e tyre të ardhshme;
- Sigurimi që kompetencat e nxënësve të cilët mbarojnë APT-në të harmonizohen me kërkesat e tregut të punës dhe të jenë në harmonizim me standardet e përcaktuara sipas Sigurimit Europian të Cilësisë në Arsim dhe Aftësim Profesional (EQAVET-SECAP);
- Efikasiteti i reformave në sektorin e APT-së duhet të sigurohet nëpërmjet centralizimit të investimeve dhe fokusimit të përpjekjeve në arritjen e rezultateve të qarta;
- Promovimi i përhapjes dhe miratimit të inovacioneve në APT, duke i bazuar ato në praktikën më adekuate kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe efikasitetit të sistemit.

vii. NDËRVEPRIMI NDËRKOMBËTAR NË EDUKIM: NDAJMË NJOHURI DHE KRIJOJMË UDHËZIMET E BOTËS SË NESËRME

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi kulturor janë ngjarje që mundësojnë çmim të lartë të dijes dhe perspektivave. Përtej kornizës së shkollimit lokal, hapja e dyerve për shkëmbime të studentëve dhe mësuesve me institucionet e tjera nxit ndarjen e njohurive dhe krijimin e lidhjeve të fuqishme ndërkombëtare.

Ky lloj bashkëpunimi ofron mundësinë për perspektivë më të gjerë, duke e zbërthyer horizontin e nxënësve dhe arsimtarëve. Shkëmbimi i nxënësve dhe arsimtarëve sjell ndjenjë autenticiteti në mësim, duke ndihmuar në kuptimin më të mirë realitetin global dhe diversitetin kulturor. Kjo eksperiencë ndihmon në zhvillimin e ndërgjegjes ndërkombëtare, duke inkurajuar respektin dhe kuptimin e vlerave të ndryshme kulturore. Nxënësit dhe arsimtarët që janë pjesëmarrës në këto shkëmbime zhvillojnë ndjenjë të thellë të solidaritetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në epokën ku bota po bëhet gjithnjë e më e ndërlidhur, ky ndërveprim ndërkombëtar përgatit nxënësit dhe arsimtarët për të jetuar dhe punuar në mjedis global. Ata fitojnë aftësi të rëndësishme sociale dhe emocionale, duke mësuar si të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë në ambient multikulturor.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi kulturor nuk janë thjesht ngjarje, por janë investime në të ardhmen e arsimit. Ata ndikojnë në formimin e një brezi të ri, të edukuar dhe të përgatitur për ndikim pozitiv në një botë vazhdimisht të ndryshueshme dhe komplekse.

Programi Erasmus është nismë e Bashkimit European për promovimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të studentëve, stafit akademik dhe institucioneve të tjera me institucionet e arsimit të lartë në Europë dhe në të gjithë botën. Implementimi i këtij programi në Republikën e Maqedonisë së Veriut është mundësi e rëndësishme për përforcimin e lidhjeve të arsimit të lartë me institucionet e tjera europiane, si dhe përmirësimin e cilësisë dhe përparimin e arsimit:

- Ngritja dhe fuqizimi i burimeve për promovimin dhe lehtësimin e aplikimeve për Programin Erasmus në institucionet e arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut;
- Organizimi i aktiviteteve të informimit dhe sensibilizimit për përfitimet dhe mundësitë e ofruara nga Programi Erasmus për studentët dhe stafin akademik;
- Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut dhe institucioneve në vendet e tjera, pjesëmarrëse në Programin Erasmus;
- Sigurimi i përkrahjes financiare dhe administrative për studentët dhe stafin akademik, pjesëmarrës në shkëmbimet Erasmus;
- Monitorimi dhe vlerësimi i efekteve të Programit Erasmus në institucionet e arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut, për identifikimin e sfidave dhe arritjeve, si dhe për përmirësimin dhe implementimin e tij në të ardhmen.

Gjithashtu, ndërveprimi ndërkombëtar në fushën e arsimit dhe edukimit mund të sjellë përparime të rëndësishme, përkatësisht:

- **Shkëmbimi i njohurive dhe praktikave të mira.** Ndërveprimi ndërkombëtar mundëson shkëmbimin e njohurive dhe praktikave adekuate në mësimdhënie, menaxhimin e shkollës dhe zhvillimin profesional të mësuesve. Kjo kontribuon në përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjithë botën;

- **Rritja e diversitetit dhe tolerancës kulturore.** Bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim mund ta rrisë ndërgjegjësimin për diversitetin kulturor dhe gjuhësor, duke promovuar tolerancën dhe respektin për kulturat dhe identitetet e tjera;
- **Përgatitja për botën e globalizuar.** Nëpërmjet ndërveprimit ndërkombëtar, nxënësit përgatiten për të jetuar dhe punuar në ambient globalizuar, duke zhvilluar aftësi të nevojshme për të komunikuar dhe bashkëvepruar me njerëz të kulturave të ndryshme;
- **Inkurajimi i bashkëpunimit shkencor dhe hulumtimit.** Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e arsimit mund të ndihmojë në rritjen e bashkëpunimit shkencor dhe hulumtimit, duke ndihmuar në zbulimin e zgjidhjeve të përbashkëta për sfidat globale.

viii. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Përmirësimi i kompetencave dhe aftësive profesionale të mësuesve për të siguruar një përvojë mësimore cilësore dhe efektive për nxënësit. Kjo përfshin zhvillimin e aftësive të tyre pedagogjike, përdorimin e teknologjisë në mësim, menaxhimin e klasës, si dhe zhvillimin personal dhe profesional të tyre. Nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme, mentorimit, inovacionit në mësim, përdorimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit mes institucioneve arsimore, synohet të krijojë një mjedis mësimor i cili inkurajon angazhimin dhe zhvillimin e nxënësve në mënyrë efektive:

- **Trajnim i vazhdueshëm:** Zhvillimi i programeve intensive të trajnimit për mësuesit në fusha të ndryshme të pedagogjisë, përdorimit të teknologjisë në mësim, menaxhimit të klasës, dhe zhvillimit personal dhe profesional.
- **Mentorim dhe mbështetje:** Krijimi i programeve të mentorimit për mësuesit e rinj dhe ata me përvojë të kufizuar, duke ofruar mbështetje dhe këshilla nga mësues të përvojës së lartë.
- **Inovacion në mësim:** Inkurajimi dhe mbështetja e projekteve inovative të mësimit nga mësuesit, duke përfshirë implementimin e metodave të reja, teknologjive inovative dhe praktikave të mira të mësimit.
- **Përdorimi i teknologjisë:** Sigurimi i pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme teknologjike për mësuesit, si dhe trajnimi i tyre për përdorimin efektiv të tyre në mësim dhe vlerësimin e nxënësve.
- **Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve:** Stimulimi i bashkëpunimit dhe ndarjes së përvojave mes shkollave, institucioneve arsimore dhe organizatave profesionale për të krijuar një mjedis të përkrahjes dhe të ndërthurjes së ideve inovative.
- **Vlerësimi i performancës:** Implementimi i sistemeve të vlerësimit të performancës së mësuesve në bazë të kritereve të qarta dhe objektive, duke inkurajuar rritjen e cilësisë së mësimit dhe angazhimit të tyre në zhvillimin profesional të vazhdueshëm.
- **Përforcimi i profesionit të mësuesit** nëpërmjet kushteve më të mira, përkrahjes institucionale dhe trajnimeve, si dhe pagave më të larta krahasuar me mësuesit e lëndëve dhe paga më të larta për drejtimit deficitare në arsimin e mesëm dhe atë universitare.
- **Fakulteti i mësuesisë.** Rritjen e atraktivitetit të fakulteteve të mësuesisë nëpërmjet masave stimuluese dhe programeve moderne.

- **Përforcimi i rolit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit dhe Inspektoratit Shtetëror Arsimor** në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet rritjes së fondeve dhe burimeve njerëzore.
- **Qendra të arsimit profesional.** Krijimi i Qendrës së Arsimit Profesional në Tetovë dhe avancimi i qendrës në Kumanovë, krijimi i Qendrës së Arsimit Profesional në Strugë.

Punësimi i bashkëpunorëve profesional, në ndihmë të mësimdhënësve: Për të përparuar pozicionin e mësimdhënësve, planifikohet punësimi i bashkëpunorëve profesionalë në shkolla, duke përfshirë psikologë, edukatorë special dhe rehabilitatorë, si dhe logopedë. Me këtë do të përmirësojmë ambientin mësimor dhe të ofrojmë mbështetje të nevojshme për të gjithë nxënësit, duke lejuar mësimdhënësit të punojnë në një mjedis më efektiv dhe të fuqizojnë aftësitë e tyre.

ix. INFRASTRUKTURA NË ARSIM

Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe investimet në trajnime praktike dhe sistemin e avancimit të karrierës për mësimdhënësit për të krijuar një ambient më dinamik, praktik dhe efikas në sistemin arsimor.

Infrastruktura. Investimet e vazhdueshme në infrastrukturën e shkollave në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë ato parashkollore dhe të larta, për të siguruar mjedise mësimore të përshtatshme dhe të avancuara teknologjikisht. Gjithashtu, me rrëndësi është përmirësimi i infrastrukturës shkollore për të siguruar ambiente mësimore cilësore dhe të sigurt për nxënësit:

- Modernizimi dhe rikonstruimi i shkollave: Investime për modernizimin dhe rikonstruksionin e shkollave për të siguruar mjedise mësimore të përshtatshme për nxënësit dhe mësimdhënësit.
- Rritja e efikasitetit energjetik: Ndërmarrja e masave për të rritur efikasitetin energjetik në shkolla për të ulur koston e energjisë dhe për të mbrojtur mjedisin.
- Kushte higjienike dhe sanitare: Përmirësimi i kushteve higjienike dhe sanitare në shkolla për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit.
- Siguria e nxënësve: Përmirësimi i masave për sigurinë e nxënësve në ambientet shkollore, duke përfshirë masat e sigurisë fizike dhe të emergjencave për të parandaluar incidente dhe për të siguruar reagime të shpejta në raste të nevojshme.
- Përfundimi i të gjitha projekteve kapitale në ndërtimin e shkollave (Shkolla Fillore e Idrizovës, Gjimnazi "Sami Frashëri" në Kumanovë dhe shkolla e fshatit Sellcë dhe shkolla tjera);

Digjitalizim. Digjitalizimi i plotë i të gjitha shërbimeve në arsimin e fillor, të mesëm dhe të lartë (Digjitalizimi i Regjistrimit të librave të amzës dhe diplomimit të studentëve, me çka drejtpërdrejt do të luftohet korrupsioni në arsimin e lartë):

- Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike, përditësimi dhe përmirësimi i pajisjeve teknologjike në shkolla për të siguruar një mjedis mësimor interaktiv dhe të përshtatshëm me nevojat e kohës në të cilën jetojmë dhe veprojmë.
- Komunikimi i menjëhershëm i prindërve dhe mësimdhënësve, dëftesa dhe diploma elektronike.
- Sistemi informativ elektronik për lidhjet elektronike të të gjitha të dhënave arsimore të qytetarit (nxënësit/studentit).

3.4.2. SHËNDETËSI MODERNE

Shëndetësia është aspekt i rëndësishëm i jetës së çdo individi dhe shoqërie në tërësi. Krijimi i sistemit shëndetësor cilësor dhe modern është kyç për sigurimin e mirëqenies së përgjithshme dhe ballafaqimin efikas me sfidat shëndetësore të kohës së sotme.

Investimi në shëndetësi paraqet strategji afatgjate të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies sociale. Në këtë kontekst është e rëndësishme që të kthehemi në trajnimin e mjekëve dhe personelit shëndetësor, duke shfrytëzuar metodat dhe teknologjitë moderne për përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Për t'u ballafaquar me sfidat e shëndetit publik, duhet të ndërmerren masa konkrete për promovimin e parandalimit, diagnostikimit të hershëm dhe trajtimit efikas të sëmundjeve. Investimet në infrastrukturën shëndetësore, si dhe shfrytëzimi i teknologjive moderne në monitorimin e shëndetit, do të ndihmojnë në krijimin e sistemit shëndetësor të përshtatur me kohën.

Në këtë epokë dinamike, ne kemi mision të qartë: ta shpërblejmë dhe përforcojmë shoqërinë nëpërmjet inovacionit në fushën e shëndetësisë bashkëkohore. Me vizion të qartë dhe përgjegjësi të theksuar, synojmë krijimin e mjedisit shëndetësor që reflekton vlerat tona themelore.

Përmirësimi i cilësisë së shëndetësisë. Të përmirësohet cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve shëndetësore duke fokusuar në përmirësimin e menaxhimit të burimeve humane dhe kompetencave të personelit shëndetësor, si dhe në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore primare dhe emergjente:

- Investime në zhvillimin e burimeve njerzore: Përmirësimi i trajnimeve dhe kualifikimeve të personelit shëndetësor në sektorin e shëndetësisë primare, përfshirë mjekët, infermierët, teknikët dhe patrnazhët, duke përfshirë edhe trajnimin e tyre në fushën e shërbimeve të përgjithshme mjekësore.
- Modernizimi i sistemit të punësimit dhe avancimit të personelit: Rishikimi dhe përmirësimi i proceseve të punësimit dhe avancimit të personelit shëndetësor, duke siguruar një bazë objektive për vendimet e punësimit dhe promovimit duke u bazuar në performancën dhe përparimin e tyre profesional.
- Rritja e kapacitetit dhe distribucionit të personelit shëndetësor: Rritja e numrit të mjekëve dhe infermierëve në të gjithë vendin, duke përmirësuar distribucionin gjeografik të tyre për të siguruar një shërbim të barabartë dhe të zonës së shëndetit.

- Sigurimi i vazhdimësisë së aftësive dhe trajnimeve për personelin shëndetësor: Krijimi i programeve të vazhdueshme për trajnimin dhe zhvillimin e aftësive të personelit shëndetësor, duke përfshirë trajnime në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në shëndetësi.
- Modernizimi i infrastrukturës së shërbimeve shëndetësore: Përmirësimi i mjediseve fizike në qendrat shëndetësore, duke përfshirë edhe investime në teknologjinë diagnostike dhe terapeutike për të përmirësuar shërbimet e ofruara në nivel lokal dhe të përmirësuar kapacitetin e shërbimeve të ndihmës së shpejtë mjekësore.

Qasje e barabartë në shëndetësi për të gjithë. Sigurimi i një përfqësimit të barabartë në shërbimet shëndetësore për të gjitha grupet shoqërore dhe territoriale, duke përmirësuar qasjen dhe cilësinë e kujdesit shëndetësor dhe duke përdorur mjete inovative për të arritur këtë qëllim:

- Rishikimi i pakos së beneficioneve dhe modelit të pagesës: Rishikimi dhe përmirësimi i pakos së beneficioneve në kujdesin shëndetësor primar dhe ndryshimi i modeleve të pagesës për të siguruar stimulime të përballeshme për ofruesit dhe kujdestarët shëndetësorë.
- Bashkëpunimi për financimin e kujdesit shëndetësor primar: Partneriteti me Fondin për sigurim shëndetësor dhe palët e interesuara të tjera për të përmirësuar shkallën e financimit për kujdesin shëndetësor primar, duke përdorur metrika të përcaktuara për të vlerësuar performancën dhe për të siguruar kujdes në zona rurale dhe të largëta.
- Përdorimi i telemedicinës për ndihmë në zonat rurale: Zbatimi i telemedicinës për të ofruar konsulta dhe trajtim në zonat më të largëta (rurale) dhe të vështira për tu arritur fizikisht nga shërbimet tradicionale shëndetësore.
- Përmirësimi i qasjes dhe disponueshmërisë së barnave: Rritja e disponueshmërisë së barnave dhe shtrirja e kundërtash të barnave në kuadër të programit të kujdesit shëndetësor universal, duke përfshirë edhe menaxhimin efektiv të furnizimit të barnave dhe kontrollin e barnave të falsifikuara.
- Rregullimi i çmimeve të barnave: Zbatimi i një rregullimi të rreptë të çmimeve të barnave për të siguruar qasje të drejtë dhe të arsyeshme për pacientët dhe sistemin shëndetësor në tërësi.

Efikasitet dhe optimizim i resurseve në shëndetësi. Përmirësimi i shfrytëzimit të efektshëm dhe efikas të burimeve në sistemin shëndetësor, duke siguruar financa të qëndrueshme dhe në rritje, si dhe duke identifikuar dhe zbatuar mekanizma të rinj financimi për të përmirësuar kujdesin shëndetësor dhe për të zvogëluar barrën e kostove për qytetarët:

- Rritja e Investime në Shëndetësi: Rritja e investimeve kapitale dhe operacionale në sistemin shëndetësor për të përmirësuar infrastrukturën, teknologjinë dhe shërbimet shëndetësore.
- Rishikimi i taksave dhe kontributeve për sigurimin shëndetësor: Rishikimi dhe riformatimi i strukturës së kontributeve dhe taksave për sigurimin shëndetësor për të siguruar një bazë të qëndrueshme financiare dhe për të përmirësuar qasjen për të gjithë qytetarët.

- Taksa specifike për produktet Nocive: Zbatimi i taksave specifike për produktet që kanë ndikim negativ në shëndetin e qytetarëve, siç janë duhani, alkooli, dhe pije të ëmbla, për të nxitur shëndetin dhe për të ulur konsumin e këtyre produkteve.
- Rritja e fondeve për shëndësinë për Capita: Rritja e buxhetit të shëndetësisë për person në nivel kombëtar për të siguruar një cilësi më të mirë të kujdesit shëndetësor dhe për të mbuluar nevojat e popullsisë në mënyrë efikase dhe efektive.
- Përshtatja dhe riformatimi i sistemit të financimit: Përshtatja dhe riformatimi i sistemit të financimit të shëndetësisë nga një qasje normative dhe bazuar në inpute në një qasje bazuar në outpute dhe rezultate, për të siguruar që fondet të përdoren në mënyrë më efikase dhe të japin rezultate të dukshme për shëndetin publik.

i. OPTIMIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR

Me qëllim të shërbimit më efikas mjekësor dhe ruajtjes së shëndetit të qytetarëve do të optimizohet kujdesi shëndetësor ndërmjet tre niveleve të shërbimeve shëndetësore: primare, sekondare dhe terciare. Çdo nivel është vendimtar për ruajtjen e shëndetit të popullsisë, me kujdesin primar që shërben si bazë për parandalimin e sëmundjeve dhe menaxhimin e çështjeve të vogla shëndetësore. Nivelet e kujdesit sekondar dhe terciar ofrojnë trajtime më të specializuara të kushteve që nuk mund të menaxhohen në mënyrë adekuate në nivelin e kujdesit primar.

Mjekësia primare. Ky është niveli i parë i kontaktit për individët, familjet dhe komunitetet me Sistemin e kujdesit shëndetësor. Shërbimet shëndetësore parësore përfshijnë kryesisht kujdesin parandalues dhe kurues të ofruar nga mjekët e përgjithshëm, mjekët familjarë, qendrat shëndetësore komunitare dhe klinikat. Ato fokusohen në mirëmbajtjen e përgjithshme të shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe trajtimin e sëmundjeve ose lëndimeve të vogla. Vaksinimet, edukimi shëndetësor, kujdesi shëndetësor i nënës dhe fëmijës dhe menaxhimi i sëmundjeve kronike janë shërbime tipike të ofruara në këtë nivel.

Mjekësia sekondare. Kur nevojitet kujdes më i specializuar mjekësor, pacientët referohen në shërbimet shëndetësore dytësore. Ky nivel përfshin kujdesin e ofruar nga specialistët në spitalet e sëmundjeve akute ose lëndimeve që kërkojnë ndërhyrje urgjente. Kujdesi dytësor shpesh përfshin shtrimin në spital, kirurgjinë rutinë, konsultimet e specializuara ambulatorë dhe shërbimet e rehabilitimit. Gjithashtu, mjekësia sekondare shërben si urë lidhëse ndërmjet kujdesit parësor dhe kujdesit terciar, duke ofruar shërbime më të avancuara diagnostikuese dhe opsione trajtimi.

Shërbimi terciar. Ky është niveli më i specializuar i kujdesit shëndetësor, i ofruar zakonisht në spitale të mëdha ose qendra të specializuara. Shërbimet shëndetësore terciare u shërbejnë pacientëve me raste të ndërlikuara ose të rënda shëndetësore që kërkojnë diagnostifikim, operacione, trajtime dhe rehabilitim të avancuar. Gjithashtu, shërbimi terciar përfshin shërbime të tilla si trajtimi i kancerit, neurokirurgjia, kirurgjia kardiovaskulare, kirurgjia plastike, trajtimi i djegieve të rënda, si dhe përfshin shërbimet e avancuara të neonatologjisë etj. Kujdesi terciar shpesh kërkon teknologji dhe ekspertizë të sofistikuar.

ii. PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS SHËNDETËSORE

Investimet e qëndrueshme në infrastrukturën shëndetësore janë thelbësore për përmirësimin dhe avancimin e sistemit tonë shëndetësor. Kjo përpjekje thekson modernizimin e ndërtesave, shfrytëzimin e pajisjeve të reja dhe teknologjisë inovative për sigurimin e ambientit modern dhe efikas shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Pjesë e rëndësishme e këtij përmirësimi është edhe investimi në ndërtesat shëndetësore, duke përfshirë rikonstruimin e strukturave ekzistuese dhe ndërtimin e objekteve të reja me standarde të larta. Këto ndërtesa do të ofrojnë hapësira të përshtatshme dhe të sigurta për pacientët dhe personelin shëndetësor.

- **Investimet në pajisje dhe teknologji.** Përveç kësaj, investimet në pajisje dhe teknologji të reja do të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Pajisjet e avancuara dhe teknologjia e re do të mundësojnë diagnostifikim më të shpejtë dhe të saktë, trajtim më të personalizuar dhe menaxhim më efikas të informacionit shëndetësor.
- **Infrastruktura shëndetësore e modernizuar.** Në këtë kohë inovative që i paraprin ndryshimeve, infrastruktura shëndetësore e modernizuar do ta përgatisë sistemin tonë shëndetësor ndaj sfidave në kohën e sotme dhe në të ardhmen. Investimet e vazhdueshme dhe strategjike në këtë drejtim do të kontribuojnë në krijimin e mjedisit të përshtatshëm shëndetësor për nevojat e pacientëve dhe për arritjen e standardit cilësor të kujdesit shëndetësor.

iii. RITJA E CILËSISË SË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Optimizimi i sistemit shëndetësor dhe përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore janë dy faktorë të rëndësishëm për shërbimet cilësore shëndetësore. Gjithashtu, faktorë të rëndësishëm janë: Siguria dhe financimi i qëndrueshëm i shërbimeve shëndetësore, menaxhimi i mirëfilltë i institucioneve shëndetësore dhe integriteti financiar dhe shoqëror i personelit shëndetësor.

- **Reforma e sigurimit shëndetësor.** Do ta riprojektojmë sistemin e sigurimit shëndetësor, duke promovuar sigurimin themelor shëndetësor që përfshin pako të shërbimeve shëndetësore të patjetërsueshme dhe sigurimin shëndetësor shtesë që do të përfshijë shërbime shtesë, ndërsa kjo pako do të ketë model shtesë pagesore sipas kërkesave të palës që sigurohet;
- **Shërbimet shëndetësore me vlerë të unifikuar.** Fondi i Sigurimit Shëndetësor do të mbulojë vlerë të njëjtë për shërbimet e njëjta shëndetësore, pavarësisht se nga cili institucion publik ose privat në vend do ta kërkojnë shërbimin mjekësor. Diferencën në çmim ata që përzgjedhin institucione private e mbulojnë nga buxheti i tyre privat ose familjar, apo sigurimi shtesë shëndetësor që do aplikojnë;

- **Metodologjia e financimit sipas performancës së shërbimeve shëndetësore.** Fondi i Sigurimit Shëndetësor do të implementojë metodologji të financimit të institucioneve shëndetësore sipas performancës së shërbimeve shëndetësore për përmirësimin e menaxhimit të institucioneve shëndetësore dhe njësimin e kostove për shërbimet përkatëse;
- **Integrimi i Qendrës Klinike Universitare të Shkupit.** Integrimi dhe centralizimi i Qendrës Klinike Universitare të Shkupit në institucion që do ta përmirësojë menaxhimin dhe do t'i zvogëlojë kostot, por njëkohësisht do ta rrisë cilësinë e shërbimeve mjekësore. Ndërtimi dhe modernizimi i Qendrës Klinike Universitare në Shkup;
- **Rishikimi dhe zgjerimi i listës pozitive të barnave.** Rishikimi i listës dhe plotësimi i saj do të ndihmojë në mjekimin e qytetarëve. Gjithashtu do të rregullohen protokole të trajtimit mjekësor dhe përdorimit të barnave biologjike, si dhe trajtimit të sëmundjeve të rralla. Vlera e barnave në këtë listë do jetë e njëjtë për barnat gjenerike pavarësisht prodhuesit, diferenca do të paguhet si shtesë nga përdoruesit e barnave ose nga sigurimi plotësues;
- **Paga dinjitoze dhe mbrojtja e integritetit për personelin shëndetësor.** Personeli shëndetësor do të ketë pagë që garanton standard të lartë pune dhe do të parashihen norma ligjore për mbrojtjen e personelit shëndetësor nga sulmet fizike të pacientëve dhe qytetarëve agresivë.

iv. MONITORIMI INDIVIDUAL I SHËNDETIT TË ÇDO PACIENTI: TRANSFORMIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Monitorimi i personalizuar i shëndetit sjell revolucion në mënyrën se si ne e menaxhojmë shëndetin tonë. Ky koncept inovativ thekson shfrytëzimin e teknologjisë dhe njohurive të avancuara për personalizimin dhe përmirësimin e trajtimit dhe parandalimit të sëmundjeve.

Monitorimi i personalizuar shfrytëzon teknologjinë për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave shëndetësore të individëve. Kjo përfshin informacione për ritmin e zemrës, nivelet e sheqerit në gjak, aktivitetin fizik dhe aspektet e tjera shëndetësore që mund të ndikojnë në mirëqenien tonë.

Ndryshim kryesor në qasje është shfrytëzimi i aplikacioneve dhe pajisjeve të inteligjencës artificiale që ofrojnë analiza të personalizuar dhe rekomandime shëndetësore. Ky nivel i personalizimit siguron që trajtimi të jetë i përshtatshëm për nevojat unike të secilit individ.

Në botën ku teknologjia është duke e ndryshuar mënyrën se si jetojmë dhe punojmë, monitorimi i personalizuar i shëndetit sjell ndryshim adekuat në qasjen tonë ndaj shëndetit. Duke personalizuar kujdesin shëndetësor, ne mund ta përmirësojmë cilësinë e jetës dhe ta reduktojmë rrezikun për sëmundje. Ky është hap drejt mënyrës më të përshtatshme dhe efikase për t'u kujdesur për shëndetin tonë personal.

Monitorimi i individual i shëndetit të çdo pacienti. Ky monitorim ofron shumë përfitime për individët dhe sistemin shëndetësor në tërësi. Nëpërmjet këtij procesi do të arrihet:

- **Parandalimi i sëmundjeve.** Duke monitoruar të dhënat shëndetësore të individëve në mënyrë të personalizuar, mund të identifikohen faktorët e rrezikut për sëmundje të caktuara dhe të ndërmerren masa parandaluese për uljen e këtij rreziku;
- **Mënyra e përshtatshme e trajtimit.** Me monitorimin personalizuar të shëndetit, mjekët kanë qasje në të dhënat shëndetësore të përdoruesve për krijimin e planeve të trajtimit të individualizuar dhe të përshtatshëm për nevojat e tyre të veçanta shëndetësore;
- **Përmirësimi i menaxhimit të sëmundjeve kronike.** Në rastin e sëmundjeve kronike, monitorimi i personalizuar i shëndetit mund të ndihmojë në ndjekjen e vazhdueshme të gjendjes së pacientëve dhe në përmirësimin e menaxhimit të tyre nëpërmjet monitorimit të simptomave dhe ndërhyrjeve të nevojshme;
- **Inkurajimi i sjelljeve të shëndetshme.** Duke ndjekur dhe monitoruar progresin e tyre shëndetësor në mënyrë të personalizuar, individët mund të inkurajohen të marrin vendime të ndërgjegjshme në lidhje me stilin e tyre të jetesës dhe të kujdesen për shëndetin e tyre;
- **Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit shëndetësor.** Monitorimi i personalizuar i shëndetit mund të ndihmojë në përmirësimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve shëndetësore, duke përmirësuar diagnostikimin e hershëm, trajtimin dhe rezultatet për pacientët.

v. FOKUSIMI NË MBROJTJEN E SHËNDETIT MENDOR: NGRITJA E NIVELIT TË KUJDESIT PËR MIRËQENIEN MENDORE

Investimet në programet e shëndetit mendor janë përpjekje e rëndësishme për ngritjen e nivelit të kujdesit për mirëqenien mendore të individëve. Kjo përfshin integrimin e kujdesit për shëndetin mendor në mënyrë të barabartë me trajtimin e shëndetit fizik, duke krijuar qasje të plotë dhe holistike ndaj shëndetit të njeriut.

Në kohën kur shëndeti mendor është duke fituar rëndësi gjithnjë e më të madhe, investimet në këtë fushë janë të domosdoshme për adresimin e nevojave të njerëzve me vështirësi mendore. Ky fokus ndihmon në parandalimin e problemeve mendore, trajtimin e tyre dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së individëve të prekur:

- **Zhvillimi i programeve të shëndetit mendor.** Një pjesë të rëndësishme të këtyre investimeve përfshin zhvillimin e programeve të shëndetit mendor, përfshirë edukimin dhe sensibilizimin e publikut për shëndetin mendor, ofrimin e këshillave dhe përkrahjes për njerëzit me vështirësi mendore, si dhe krijimin e kapaciteteve për trajtimin dhe mbikëqyrjen e këtyre pacientëve.
- **Mbrojtja e shëndetit mendor.** Në shoqërinë ku stigma rreth shëndetit mendor ende ekziston, fokusi në mbrojtjen e shëndetit mendor është i rëndësishëm për sigurimin e qasjes së barabartë të njerëzve në kujdesin shëndetësor dhe për përkrahjen e mirëqenies mendore të të gjithëve. Ky investim do të sjellë përparime të mëdha në shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë, duke ndihmuar në krijimin e një shoqërie më të fuqishme dhe më të shëndetshme për të gjithë.

vi. NDIHMA DHE ZHVILLIMI I KUADROVE PROFESIONALE SHËNDETËSORE

Ky program për burimet njerëzore në fushën e shëndetësisë synon t'i adresojë sfidat e largimit të kuadrove adekuate (brain drain) nga fusha e shëndetësisë në Maqedoninë e Veriut, duke përmirësuar kushtet e punës dhe pagat për profesionistët shëndetësorë. Kjo është e rëndësishme për mbrojtjen dhe avancimin e sistemit shëndetësor duke siguruar që kuadrot e nevojshme të jenë në dispozicion për t'u kujdesur për popullsinë.

Disa pika kyçe të këtij programi janë:

- **Përmirësimi i kushteve të punës për mjekët dhe personelin mjekësor:** Kjo përfshin rritjen e satisfaksionit të punës, përmirësimin e kushteve të punës dhe implementimin e sistemeve adekuate për shpërbllim sipas punës. Kjo është e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe për përkrahjen e parimit “mjek i lumtur, pacient i lumtur”;
- **Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i të punësuarve shëndetësorë:** Ka për qëllim të sigurojë që askush në fushën e mjekësisë të mos jetë i pa punë, si dhe të implementohet përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në institucionet shëndetësore;
- **Përkrahja e kuadrove profesionale shëndetësore:** Përfshin stimulimin dhe angazhimin e mjekëve të rinj dhe specializantëve, duke ofruar politika stimuluese dhe rritje të pagave në këtë drejtim;
- **Rritja e pagave të mjekëve:** Ka për qëllim të sigurojë që mjekët të kenë të hyra të kënaqshme, duke e bërë profesionin e mjekut më tërheqës për të rinjtë;
- **Specializimi në shëndetësinë preventive:** Ka për qëllim ta rrisë interesin dhe përqendrimin në shëndetësinë preventive, duke ofruar mundësi punësimi në këtë fushë dhe të sigurojë trajnime për të rinjtë që dëshirojnë të specializojnë në këtë fushë.
- **Trajnime jashtë shtetit dhe bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtarë:** Ka për qëllim përforcimin e potencialeve njerëzore në fushën e shëndetësisë duke ofruar trajnime dhe bashkëpunim me ekspertë të njohur në nivel ndërkombëtar;
- **Modernizimi i shërbimit të infermierisë:** Përfshin përmirësimin e shërbimeve të infermierisë për harmonizimin me standardet europiane dhe për adresimin e nevojave reale të sistemit shëndetësor;
- **Mjeku rural:** Gjithashtu, ne kemi qëllim të veçantë për stimulimin e mjekëve që punojnë në zonat rurale duke ofruar subvencione dhe stimuj. Kjo përmbush detyrim ligjor për sigurimin e mbrojtjes shëndetësore primare për çdo banor në këto zona.

3.4.3. MIRËQENIE SOCIALE E QËNDRUESHME

Siguria sociale e qëndrueshme është detyrim për shtetin dhe sistemin tonë social, që duhet të kujdeset për të gjithë qytetarët, duke u përqendruar posaçërisht në grupet më të ndjeshme shoqërore. Ne kemi pasur rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e politikave të solidaritetit social, duke kontribuar në vazhdimësi për barazinë sociale, uljen e varfërisë dhe rritjen e niveleve të punësimit. Qëllimi është që zhvillimi dhe përfitimet shoqërore të jenë të arritshme për të gjitha shtresat e shoqërisë.

Sistemi i qëndrueshëm dhe efikas i sigurisë sociale është themeli i shoqërsë së shëndoshë dhe të barabartë, që ofron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.

Pandemia e Covid19 na bëri ta kuptojmë rëndësinë e përforsimit të sistemit shëndetësor dhe politikave të qëndrueshme sociale. Ne kemi vazhduar përkrahjen dhe promovimin e politikave në drejtim të mbrojtjes së vendeve të punës, rritjes së pensioneve dhe përfitimeve sociale, si dhe luftës kundër varfërisë. Në këtë mënyrë, ne krijojmë rrjet social të qëndrueshëm, që siguron përkrahje dhe përfshirje për të gjithë.

Përmirësimi i mirëqenies sociale. Përmirësimi i efikasitetit dhe cilësisë së sistemit për mbrojtjen sociale për të siguruar një ndihmë më të mirë për të gjithë qytetarët dhe për të adresuar nevojat e komuniteteve të marginalizuara:

- Rishikimi dhe riformatimi i proceseve administrative: Përmirësimi i efikasitetit në administratën e sistemit për mbrojtjen sociale përmes rishikimit të proceseve dhe procedurave, duke përfshirë rregullimin e regjistrimit të përdoruesve dhe lehtësimin e barrës administrative për familjet dhe punonjësit social.
- Avancimi i kushteve dhe pagave për punonjësit social: Rritja e numrit, kualifikimeve dhe pagave të punonjësve socialë për të përmirësuar cilësinë dhe për të zvogëluar rotacionin e punës në këtë fushë të rëndësishme.
- Përmirësimi i programeve për tregun e punës: Zhvillimi i programeve të reja dhe përmirësimi i atyre ekzistuese për të ndihmuar punëkërkuarit, duke përfshirë trajnimin për aftësi të reja dhe mbështetjen në gjetjen e punës.
- Zhvillimi i sistemeve për vlerësim dhe monitorim: Krijimi dhe zhvillimi i sistemeve të avancuara për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së programave të ofruara nga Agjencia për Mbrojtjen Sociale, duke përfshirë analizën e efektivitetit dhe ndikimit të tyre në komunitet.

Qasje e barabartë në shërbimet sociale. Përmirësimi i përfshirjes dhe shërbimit të përshtatshëm të mbrojtjes sociale për të gjithë qytetarët, duke siguruar që shërbimet sociale të jenë të arritshme për të gjithë ata që kanë nevojë:

- Rishikimi dhe përmirësimi i sistemit të shërbimeve: Rishikimi dhe ndryshimi i sistemit të shërbimeve sociale për të siguruar që shërbimet sociale janë të arritshme për të gjithë ata që janë të përshtatshëm për mbrojtje sociale.
- Zhvillimi i kapaciteteve lokale: Zhvillimi i kapaciteteve lokale për të siguruar një tranzicion të qetë në decentralizimin e shërbimeve sociale dhe për të lejuar një shërbim të paprekshëm lokal përmbi nivelin qendror.
- Ndihma për komunat në shërbimet sociale: Krijimi i një mekanizmi mbështetës për të ndihmuar komunat në ofrimin e shërbimeve sociale lokale.
- Zgjerimi i kujdesit afatgjatë për personat e moshuar: Zgjerimi i mundësive për kujdes afatgjatë për personat e moshuar, duke përfshirë opsione për sigurimin privat të kujdesit.
- Zgjerimi i programit të tregut të punës: Zgjerimi i programeve për tregun e punës në rajonet më pak të pasura për të siguruar një përfshirje më të gjerë dhe një ofertë më të madhe të shërbimeve për punësim.

- Përshtatja e programit të punës sipas nevojave rajonale: Përshtatja e ofrimit të programeve të punës sipas nevojave të tregut të punës në nivel rajonal.

Efikasitet dhe optimizim i nurimeve për mirëqenie sociale. Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve dhe efikasitetit në sistemin e mbrojtjes sociale për të siguruar një përdorim më të mirë të burimeve dhe një ndikim më të madh në mbështetjen e nevojave të qytetarëve:

- Rritja e shpenzimeve për ndihmën sociale: Rritja e buxhetit për ndihmën sociale për të siguruar që nevojat e popullsisë së varfër dhe të lartpërfshirëse adresohen në mënyrë efektive.
- Investime prioritare për segmentet më të nevojshme: Përparimi i investimeve në segmentet më të varfra dhe më të prekura të popullsisë, duke i dhënë prioritet këtyre grupeve në krahasim me ato të klasave mesatare dhe të larta.
- Sigurimi i qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të rritjes së shpenzimeve: Sigurimi që rritja e shpenzimeve të jetë e qëndrueshme dhe efikase në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të shërbimeve sociale.
- Stabilizimi fiskal i sistemit pensional: Rishikimi i performancës së sistemit pensional për të siguruar që pensionet për të moshuarit e varfër të mbulojnë nevojat e tyre në mënyrë adekuate.
- Marrja e masave për stabilizim fiskal dhe përmirësim të drejtësisë: Implementimi i një pakete masash për stabilizimin fiskal dhe përmirësimin e drejtësisë, përfshirë rritjen e moshës së pensionit dhe harmonizimin e llogaritjeve për periudhën e shërbimit të pensionit.

I. SISTEMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE EFIKAS I MBROJTJES DHE SIGURISË SOCIALE

Sistemi i mbrojtjes dhe sigurisë sociale duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe efikas në mënyrë që t'i përmbushë nevojat e qytetarëve dhe t'i ndihmojë në përmirësimin e gjendjes së tyre, duke reduktuar varfërinë dhe duke përforcuar kohezionin social.

Për arritjen e këtij qëllimi, nevojitet ofrimi i masave të ndryshme mbrojtëse sociale, programet e punësimit dhe nismat arsimore. Këto masa duhet të jenë të orientuara drejt ofrimit të përkrahjes financiare gjithëpërfshirëse, kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve bazë për individët e pambrojtur dhe të marginalizuar, përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, studentët dhe të gjithë ata që përballen me vështirësi ekonomike.

Njëkohësisht, qasja e përpiktë administrative dhe zgjerimi i mbulimit të shërbimeve janë thelbësore për rritjen e efikasitetit të sistemit. Duke siguruar procese administrative të rregulluara dhe duke zgjeruar kushtet e mbulimit të shërbimeve, do të mundësojmë që individët të kenë lehtësisht qasje në përkrahjen e nevojshme. Kjo, jo vetëm që do të ndihmojë në përmirësimin e situatës së tyre, por gjithashtu do të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më të barabartë dhe të qëndrueshme.

Sistemi i tillë i sigurisë sociale duhet të përfaqësojë rrjet të fuqishëm sigurie që ofron qasje të barabartë në ndihmë për të gjithë qytetarët në nevojë, duke reflektuar kështu përkushtimin tonë për drejtësi dhe solidaritet shoqëror.

Me realizimin e sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë sociale në mënyrë efikase dhe gjithëpërfshirëse, do të arrijmë disa përfitime të rëndësishme për shoqërinë tonë:

- **Përmirësimi i kohezionit social.** Një sistem i fuqishëm i mbrojtjes sociale do të ndihmojë në përforcimin e lidhjeve shoqërore dhe solidaritetit, duke krijuar një ndjenjë të përbashkët të përkujdesjes për të gjithë anëtarët e shoqërisë;
- **Rritja e përfshirjes sociale.** Duke ofruar qasje të barabartë në shërbime dhe përkrahje për të gjithë, siguria sociale do të ndihmojë në rritjen e përfshirjes sociale dhe në reduktimin e dallimeve sociale dhe ekonomike;
- **Përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies.** Kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja sociale do të ndihmojnë në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve, duke ofruar shërbime të kujdesit të nevojshëm shëndetësor dhe mjekësor.
- **Ndihma për grupet e ndjeshme.** Sistemi i mbrojtjes sociale do të ofrojë përkrahje të veçantë për grupet më të ndjeshme shoqërore, përfshirë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e prekur nga varfëria dhe papunësia.

ii. ZHVILLIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME: KONTRIBUTI PËR SIGURINË SOCIALE DHE EKONOMINË E QËNDRUESHME

Zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) është nismë që synon përkrahjen e rritjes dhe zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve si mjet i përmirësimit të sigurisë sociale të kontribuimit në drejtim të një ekonomie të qëndrueshme.

Këto ndërmarrje shpesh janë motori i inovacionit dhe rritjes së punësimit në ekonomi. Për ta ndihmuar zhvillimin e tyre, programi ofron përkrahje të gjerë, duke përfshirë kreditë e përbalueshme, trajnimet e specializuara dhe ofrimin e këshillave për menaxhimin e biznesit.

Duke përmirësuar qasjen dhe mundësitë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, programi kontribuon në krijimin e vendeve të nevojshme të punës dhe në rritjen e të hyrave të bashkësive lokale. Përveç kësaj, përkrahja për inovacionet dhe shfrytëzimin e teknologjisë në këto ndërmarrje promovon ekonomi më efikase dhe konkurruese në tregun global.

Për të kontribuar në arritjen e sigurisë së qëndrueshme sociale, kjo masë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme mund të implementohet me fokus të veçantë në disa pika kyçe, përkatësisht:

- **Krijimi i vendeve të qëndrueshme të punës.** Programi do të përqendrohet në kriimin e vendeve të punës që ofrojnë pagë të arsyeshme dhe kushte të mira punësimi, duke kontribuar në këtë mënyrë në sigurinë sociale të qytetarëve në mënyrë të qëndrueshme;
- **Përkrahja e inovacionit dhe rritjes së sektorit të teknologjisë.** Duke investuar në inovacionet dhe shfrytëzimin e teknologjisë për NVM-të, programi do të ndihmojë për rritjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së tyre në tregun global, duke siguruar që ato të kenë qëndrueshmëri afgjate;

- **Kujdesi ndaj rritjes së ndërmarrjeve të qëndrueshme sociale dhe mjedisore.** Do të inkurajojmë zhvillimin e ndërmarrjeve të qëndrueshme sociale dhe mjedisore që kanë ndikim pozitiv në shoqëri dhe mjedis. Kjo do të sigurojë bazë më të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik dhe sigurinë sociale;
- **Përqendrimi në trajnimin dhe aftësimin profesional.** Duke ofruar trajnime dhe programe të specializuara për të punësuarit e NVM-ve, do të ndihmojmë për rritjen e aftësive dhe kompetencave të tyre, duke siguruar që ata të jenë të konkurrueshëm në tregun e punës dhe të kenë mundësi për rritje personale dhe profesionale.

iii. SHËRBIMET SOCIALE PËR TË MOSHUARIT: INVESTIMI NË MIRËQENIE DHE KUJDES

Në shoqërinë në të cilën numri i të moshuarve është në rritje, rëndësi ka që të kujdesemi për mirëqenien dhe sigurinë e kësaj pjesë të rëndësishme të popullsisë. Masat për shërbimet sociale të të moshuarve janë thelbësore për sigurimin e përkujdesjes së duhur dhe të qëndrueshme në këtë drejtim.

Aspekt i rëndësishëm i kësaj mase është krijimi i qendrave të kujdesit për të moshuarit. Këto qendra ofrojnë ambient të sigurt për përkujdesjen për të moshuarit, duke siguruar kujdes mjekësor dhe social për të cilin ata kanë nevojë. Gjithashtu, këto qendra ofrojnë edhe aktivitete sociale dhe rekreacione për të moshuarit, me qëllim që të moshuarit të jenë aktivë dhe në marrëdhënie me bashkësinë.

Tjetër aspekt i shërbimeve sociale për të moshuarit është sigurimi i kujdesit në shtëpi. Kjo përfshin ofrimin e shërbimeve për përkujdesje në shtëpi për ata që preferojnë të qëndrojnë në ambientet e tyre të njohura. Kujdesi në shtëpi përfshin kryesisht ushqimin, higjienën personale dhe përkujdesjen mjekësore për të moshuarit.

Për të garantuar qasjen në këto shërbime për të gjithë të moshuarit është e rëndësishme të investohet në infrastrukturën sociale dhe të sigurohet që këto shërbime janë të qasshme dhe të përbalueshme për të gjithë. Shoqëria, me përkujdesje ndaj të moshuarve është shoqëri më e drejtë dhe më e qëndrueshme për të gjithë qytetarët.

Në këtë drejtim do t'i realizojmë projektet në vijim:

- **Krijimi i qendrave të kujdesit për të moshuarit.** Ndërtimi i qendrave të kujdesit, të specializuara për të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta shëndetësore, duke ofruar përkujdesje të nevojshme për këtë grup të popullsisë. Ndërtimi i shtëpive të reja për pensionistët në komunat e Dibrës, Tetovës, Shkupit dhe Manastirit;
- **Programet për aftësim dhe rikualifikim të të punësuarve të moshuar.** Organizimi i programeve trajnuese dhe aftësuese për të moshuarit që janë në rrezik të humbjes së punës për shkak të teknologjisë së re apo ndryshimeve në tregun e punës, duke i përgatitur ata për tregun e sotëm të punës;
- **Investimi në infrastrukturën e banimit për të moshuarit.** Ndërtimi i qendrave në vendbanimet e përshtatshme për të moshuarit, duke përfshirë shtëpitë e përshtatshme për nevojat e tyre dhe qendrat e banimit me kujdes dhe përkrahje për pjesën e moshuar të komunitetit;

- **Shërbimi i rekreacionit klimaterik në banjë.** Këtë shërbim falas mund ta shfrytëzojnë personat – shfrytëzues të pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor dhe pensionit familjar të realizuar sipas Rregullativës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dispozitave të marrëveshjeve të sigurimit social që i zbaton Republika e Maqedonisë së Veriut, si dhe personat që jetojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

iv. ULJA E VARFËRISË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Për uljen e nivelit të varfërisë, politikat tona do të fokusohen në parandalimin e saj, duke i kushtuar rëndësi veçanërisht kujdesit social për mbrojtjen e familjeve në nevojë dhe duke promovuar investime në shërbimet sociale.

- **Politika sociale:** Këtu përfshihet ofrimi i shërbimeve të zgjeruara sociale dhe qasja më e lehtë në kujdesin shëndetësor, duke përfshirë zero pagesë për fëmijët deri në moshën 5 vjeçare dhe zero pagesë për qëndrimin spitalor të njërit prind me fëmijë deri në moshën 5 vjeçare;
- **Qasja në arsim:** Përmban krijimin e mundësive për qasje më të lehtë në arsim dhe edukim nga mosha e fëmijërisë;
- **Pensioni social:** Do t'u ofrohet të gjithë qytetarëve që kanë mbi 65 vjet, duke përfshirë të dy bashkëshortët, si e drejtë e veçantë dhe e pavarur për secilin prej tyre. Kjo do t'u ndihmojë rreth 65.000 qytetarëve që nuk i plotësojnë kushtet për të marrë pension, për t'u siguruar atyre ambient më të mirë jetese;
- **Mundësi punësimi dhe vetëpunësimi për të gjithë:** Gjithashtu, politikat për punësim dhe vetëpunësim do të përmbajnë disa masa, duke përfshirë disperzimin e zyrave të Agjencisë së Punësimit në komuna, krijimin e qendrave për kualifikimin dhe rikualifikimin e fuqisë punëtore, si dhe përkrahje të punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Trajnimi në vendin e punës, trajnimet profesionale dhe programet për të rinjtë do të ofrohen për t'i zgjeruar mundësitë e punësimit.

v. MIRËQENIA SOCIALE

Mirëqenia sociale është koncept i gjerë që ka për qëllim sigurimin e jetesës së qëndrueshme, të sigurt dhe të përmirësuar për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Gjithashtu, përfshin shumë dimensione të jetës së njeriut, duke filluar nga siguria ekonomike e individëve dhe familjeve, që përfshin të drejtën për të punuar në kushte adekuate dhe për ndërmarrjen e masave për pagesa të mjaftueshme për mbulimin e nevojave të tyre, deri në qasjen e barabartë në shërbimet dhe burimet e rëndësishme si: arsimi, shëndetësia, strehimi dhe infrastruktura. Mirëqenia sociale përfshin edhe përkrahjen e individëve dhe familjeve në nevojë, duke ofruar ndihmë financiare, kujdes shëndetësor, qasje në shërbimet sociale dhe shpërndarje të drejtë të mjeteve. Rrjedhimisht, mund të ndërmeren masa të ndryshme politike dhe sociale për përmirësimin e mirëqenies sociale, duke përfshirë politikat që rrisin punësimin, ofrojnë ndihmë financiare dhe përkrahin qasjen e barabartë në shërbimet publike për të gjithë qytetarët. Në këtë mënyrë, shoqëria mund të zhvillohet në mënyrë më të drejtë dhe më të qëndrueshme për të gjithë qytetarët e saj.

- **Decentralizimi i qendrave të shërbimeve sociale** në nivel komunal ka për qëllim transferimin e përgjegjësiave të qendrave sociale të pushtetit qendror në komuna, për menaxhimin e transfertave sociale dhe për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Kjo do t'u mundësojë qytetarëve qasje më të lehtë në institucionet sociale dhe reduktim të shpenzimeve familjare gjatë realizimit të të drejtave të tyre;
- **Ndërtimi i kopshteve të fëmijëve në çdo vendbanim** ka për qëllim të mundësojë që të gjithë fëmijët, pa dallim të statusit shoqëror, të kenë qëndrime ditore në objektet e reja sa më afër vendbanimeve të tyre. Kjo do t'u ndihmojë prindërve që janë në punë dhe që jetojnë larg kopshteve ekzistuese;
- **Hapja e qendrave ditore për fëmijët** me nevoja të veçanta siguron aktivitete rekreacioni, socializimi, edukimi, dhe aftësimi nga stafi profesional për t'u ofruar ndihmë fëmijëve me nevoja të veçanta dhe për integrimin e tyre në jetën sociale.

vi. RREGULLIMI I PENSIONEVE DHE SIGURIMIT TË STAZHIT

Nismat për rregullimin e pensioneve dhe stazhit të sigurimit paraqesin hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të sigurisë sociale të qytetarëve. Duke ofruar pensione të parakohshme të pleqërisë, bazuar në moshën dhe stazhin e sigurimit, si dhe mundësi për t'i kompensuar mungesat në stazhin e sigurimit, me ç'rast këto masa synojnë t'i adresojnë nevojat e të siguruarve në mënyrë më të drejtë dhe efektive. Gjithashtu, pagesa e kontributeve të sigurimit në raste kur punëdhënësi nuk ka kryer detyrimet e tij për pagesën e sigurimit ofron mundësi shtesë për të siguruarit, për mbajtjen e statusit të tyre edhe në rrethana të veçanta. Këto masa jo vetëm që sigurojnë mbrojtjen financiare të qytetarëve në moshë të pleqërisë, por gjithashtu përshpejtojnë procesin e përmirësimit të sistemit pensional dhe të sigurisë sociale në përgjithësi.

- **Pensioni i parakohshëm i pleqërisë bazuar në moshën dhe stazhin e sigurimit.** Pensioni i parakohshëm i pleqërisë do t'u ofrohet personave të siguruar në moshën 62 vjeçare, ndërsa stazhi i sigurimit për meshkujt prej në moshën 40 – 60 vjeçare, si dhe stazhi i sigurimit për femrat prej në moshën 35 vjeçare;
- **Rregullimi i stazhit të mungesës së sigurimit.** Nëpërmjet kësaj mase do të rregullohet stazhi i sigurimit për periudhat që mungojnë në evidencën amë edhe kur nuk ekzistojnë dëshmi nga ana e të siguruarit apo nga ana e obliguesve për shkak të falimentimit të ndërmarrjeve ose mungesës së dokumentacionit në Arkivin Shtetëror;
- **Pagesa e kontributeve të sigurimit pensional dhe invalidor.** Në raste kur punëdhënësi nuk ka kryer detyrimet e tij për pagesën e sigurimit pensional dhe invalidor në kohën e duhur, kjo masë do t'u ofrojë mundësi të siguruarve ose anëtarëve të familjes që kanë të drejtë të realizimit të së drejtës familjare, ta realizojnë pagesën e kontributeve ;
- **Rritja e standardit të pensionistëve.** Bazuar në metodologjinë e vendosur, me rritjen e çmimeve dhe me rritjen e ekonomisë së vendit, në bazë sistematike pensionet harmonizohen dy herë në vit.
- **Pensioni minimal.** Për mbrojtjen e pensionistëve me pensione më të ulëta do të parashihen modalitete për vendosjen e pensionit minimal që të mund të jenë të vetëqëndrueshëm duke u bazuar në shportën sociale minimale (rritje e nivelit të

pensionit nga 58% në 70% të pagës minimale, që nënkupton rritje prej rreth 20% e pensionit minimal);

- **Standardi minimal i garantuar për pensionistët.** Krijimin e kushteve për pensionistët, që të mund të blejnë prodhime vendore dhe të shfrytëzojnë shërbime nga kompanitë vendore me këste pa interes. Me këtë projekt do të mundsojmë që pensionistët tanë të mund të blejnë prodhime vendore dhe të shfrytëzojnë shërbime nga kompanitë vendore me këste pa interes, me ndalesë administrative të kësteve, duke marrë parasysh se mbi 140 mijë pensionistë shfrytëzojnë pension me vlerë deri më 16 mijë denarë;
- **“Pensioni social” për siguruesit që nuk e plotësojnë kushtin e pensionit të pleqërisë (mimumum 15 vite stazh).** Me këtë projekt do të mundsojmë që qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët nuk kanë mundësi ta realizojnë të drejtën e pensionit të pleqërisë (të drejtat pensionale), do t’u mundesohet realizimi i të drejtës së kompensimit monetar (pension social) dhe realizimi i blerjes së stazhit;
- **Pensioni familjar.** Personat që plotësojnë kushtin e pensionit familjar gjatë realizimit të së drejtës së pensionit familjar, duhet të tërhiqet përkufizimi i moshës prej 50 vjeç për bashkëshortin/en e mbijetuar. Fëmijët të cilët nuk kanë lidhje martesore, jetojnë në bashkësi dhe përkujdesen për prindërit, duhet ta kenë të drejtën e pensionit familjar pa marrë parasysh moshën e tyre. Amviset që kryejnë veprimtari të ndryshme (ushqime apo veshje tradicionale), ndërsa nuk janë të përfshira në sigurimin social do t’u mundësohen kushte të volitshme si kategori të veçanta, respektivisht të jenë pjesë e sistemit social.
- **Marrëveshja e sigurimit social ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës.** Me këtë marrëveshje do të jenë të përfshira të gjitha të drejtat sociale dhe jo vetëm konfirmimi i periudhave të sigurimit, siç është paraparë me marrëveshjen aktuale që zbatohet. Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut bën pagesën e rregullt të pensioneve ndaj shtetasve të Republikës së Kosovës që e plotësojnë kushtin për pension të plotë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

3.5. RINI AKTIVE DHE SHOQËRI E BARABARTË

- *Diversitet dhe barazi*
- *Kulturë përfaqësuese*
 - *Promovim i diversitetit kulturor*
 - *Rruajtje dhe kultivim i trashëgimisë kulturore*
 - *Avancim i infrastrukturës kulturore dhe artistike*
 - *Zhvillim i artit, muzikës, teatrit, filmit dhe modës e dizajnit*
- *Rini aktive*
 - *Pjesëmarrje në vendimmarrje*
 - *Nxitje e sipërmarrësisë të rinjtë*
 - *Garanci për të rinjtë*
 - *Platformë digjitale për të rinjtë*
- *Sport dhe rekreacion*
 - *Politikë për nxitje të sportit*
 - *Vauçerë për sport të përkrahura nga buxheti*
 - *Lehtësime tatimore për përkrahje të sportit*
 - *Nisma publike dhe private për rekreacion*
- *Aktivizëm qytetar*
 - *Media të lira dhe liria e shprehjes*
 - *Platforma të hapura për diskutime*
 - *Kyçje në të gjitha proceset e shoqërisë dhe vendimmarrjes*
- *Familja bërthama e shoqërisë*
- *Demografi, migracion dhe diasporë*
 - *Politikë për rimëkëmbje demografike*
 - *Politikë për ngadalësimin e migracionit dhe krijimin e mundësive për t'u rikthyer në vendlindje me përkushtim të veçantë për rininë*
 - *Përforcim i lidhjeve ekonomike, sociale dhe kulturore me diasporën*

3.5.1. DIVERSITET DHE BARAZI

Ne jemi një shoqëri me diversitet etnik dhe kulturor dhe kjo është vlerë që duhet të kultivohet si përparësi e shoqërisë tonë me mundësi të barabarta. Promovimi i barazisë etnike dhe kulturore është normë kushtetuese e cila u institucionalizua me Marrëveshjen e Ohrit. Gjithashtu respektimi i vlerave njerëzore dhe demokratike kërkon respektin e diversitetit në aspekt gjinor, moshë, religjion dhe përcaktime tjera. Në këtë drejtim do të vazhdojmë të promovojmë shoqëri të barabartë për të gjithë, duke patur parasysh edhe nevojën për afirmim më të theksuar të komuniteteve më të vogla, siç janë: turqët, boshnjakët, romët, vllahët dhe të tjerët që jetojnë në vendin tonë.

Dallimi është përparësi. Të gjitha komunitetet do të kenë mundësi të barabarta dhe do t'jennë plotësisht të integruar në shoqëri dhe insitucionet e vendit. Turqët, boshnjakët, vllahët dhe komunitetet tjera do të i gëzojnë të gjitha të drjetat që burojnë nga Marrëveshja e Ohrit dhe Kushtetuta. Barazia në dallimet do të jetë normë e shoqërisë në të gjitha aspektet, duke u nisur nga brazia gjinore, fetare dhe forma tjera të prkatësisë si të drejta themelore njerëzore.

Rom të integruar. Barazia e plotë dhe integrimi në shoqëri është mënyra më e drejtë e integritit në shoqëri. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për romët si komunitet i margjinalizuar dhe integrimi i tyre në shoqëri do të realizohet nëpërmjet këtyre politikave:

- **Qasje në punësim dhe strehim të denjë.** Rritja e punësimit të romëve duke krijuar masa të veçanta punësimi për pjesëtarët e komunitetit rom. Një grup i veçantë masash për romët e papunë afatgjatë dhe përfituesit afatgjatë të asistencës minimale të garantuar. Rritja e numrit të punonjësve romë në administratën publike dhe shtetërore sipas parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat. Programimi i banesave sociale individuale - vendbanimeve sociale në komunat ku jetojnë romët në vende nën standarde jo të urbanizuara. Sigurimi i një mekanizmi të centralizuar për monitorimin e urbanizimit të vendbanimeve ku jetojnë pjesëtarët e komunitetit rom duke ofruar infrastrukturë të përshtatshme komunale në ato pjesë të komunave.
- **Arsimi dhe shëndetësia.** Sigurimi i bursave për nxënësit romë në arsimin fillor. Sigurimi i objekteve (dhe rritja e numrit të çerdheve për fëmijë) për futjen e arsimit të detyrueshëm parashkollor. Përmirësimi i qasjes në kujdesin shëndetësor parandalues për romët duke rritur kapacitetet e njësive shëndetësore që ofrojnë shërbime në komunitetet rome.
- **Rinia, kultura dhe sporti.** Futja e përfaqësimit të drejtë në shpërndarjen e fondeve për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile me fokus mbështetjen e organizatave rinore që punojnë në çështjet e zhvillimit të të rinjve romë.

3.5.2. KULTURË PËRFAQËSUESE

Misioni ynë është që të krijojmë një shoqëri ku kultura është forcë unifikuese dhe e përbashkët që promovon bashkëpunimin, tolerancën dhe mirëkuptimin ndërkulturor. Synohet të ndërtohet ambienti ku kultura promovohet dhe respektohet si pjesë e

rëndësishme e identitetit kombëtar, duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë së ardhshme me diversitet kulturor.

Gjithashtu, fokusi ynë në sferën e kulturës është të ndërmarrim masa konkrete për të investuar në qendrat kulturore, për të promovuar artin dhe kulturën e vendit tonë, dhe për të institucionalizuar festivalet kulturore me anë të masave konkrete:

i. MODERNIZIMI I AMBIENTIT KULTUROR

Me modernizimin e ambientit kulturor do të promovohet diversiteti kulturor dhe do të krijohet mjedis ku të gjitha komunitetet do të ndihen të barabarta dhe do të respektohen për identitetin e tyre kulturor. Me këtë ne synojmë të krijojmë një shoqëri të bashkuar dhe me harmoni, duke i dhënë rëndësi të veçantë mbrojtjes së kulturave dhe ruajtjes së identitetit të të gjithë qytetarëve.

Për ta arritur qëllimin e promovimit të diversitetit kulturor dhe krijimit të një ambienti të përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kulturore është e nevojshme të modernizohet infrastruktura dhe ambientet kulturore në vendin tonë. Kjo, mund të realizohet nëpërmjet përmirësimit dhe ndërtimit të qendrave kulturore, teatrove, bibliotekave, galerive artistike, si dhe hapësirave të tjera ku zhvillohen aktivitete të tilla. Këto ambiente duhet të krijojnë atmosferë të stimulueshme për shkëmbimin e ideve, ekspozitave artistike, koncerteve, dhe manifestimeve të tjera kulturore. Nëpërmjet investimeve në teknologji të fundit dhe dizajn inovativ, mund të krijojmë ambiente që inkurajojnë krijimtarinë dhe promovojnë diversitetin kulturor. Duke siguruar qasje të barabartë për të gjitha komunitetet dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të tyre në zhvillimin e këtyre ambienteve, ne do të krijojmë mjedis të pasur kulturor dhe të përkushtuar ndaj mirëqenies së të gjithë qytetarëve, respektivisht:

- **Edukimi dhe sensibilizimi:** Krijimi i programeve të edukimit dhe sensibilizimit për të promovuar respektin dhe mirëkuptimin ndaj diversitetit kulturor nëpërmjet shkollave, institucioneve arsimore dhe mediave.
- **Përkrahja e veprimtarive kulturore:** Inkurajimi dhe përkrahja e aktiviteteve kulturore dhe artistike të të gjitha komuniteteve, duke përfshirë festivale, ekspozita, koncerte dhe manifestime të tjera që promovojnë diversitetin kulturor.

Projekte:

- **Hapja e Teatrit për Fëmijë në Tetovë.** Themelimi i institucionit të ri për teatrin e fëmijëve do të sjellë një hap të rëndësishëm përpara në promovimin e artit dhe kulturës për audiencën e vogël;
- **Investime kapitale në Qendrën e Kulturës në Tetovë.** Rregullimi i sistemit termoteknik dhe klimatizimit në qendër kulturore për t'i adresuar problemet e nxemjes dhe ftohjes së objektit që është në gjendje të amortizuar. Përmirësimi i sistemit të ndriçimit dhe zerimit në Qendrën e Kulturës në Tetovë për të siguruar ambient të përshtatshëm për aktivitetet kulturore;

- **Investim kapital në Qendrën e Kulturës në Gostivar.** Është e nevojshme të investohet në sistemin e nxemjes, ftohjes dhe ventilimit në këtë qendër për t'i përmirësuar kushtet për aktivitetet kulturore;
- **Hapja e Galerisë Nationale në Kërçovë.** Hap i rëndësishëm përpara do të ishte hapja e institucionit të ri kulturor, siç është Galeria Nationale në Kërçovë, për ta promovuar artin dhe kulturën në këtë zonë;
- **Ndërtimi i Teatrit të Fëmijëve dhe të Rinjve në Shkup.** Ndërtimi i objektit të ri për teatrin e fëmijëve dhe të rinjve do të ofronte platformë të re për shfaqjet dhe aktivitetet artistike për këtë grup të publikut;
- **Restaurimi i çatisë së Galerisë së Tetovës dhe përmirësimi i Sistemit mekanik dhe elektrik.** Restaurimi i çatisë së Galerisë së Tetovës dhe përmirësimi i sistemit mekanik dhe elektrik do të siguronin mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për ekspozitat dhe aktivitetet kulturore.

ii. ZHVILLIMI I ARTIT FILMIK

Arti filmik në Maqedoninë e Veriut ka potencial të madh për ta zhvilluar skenën kinematografike të pasur dhe të diversifikuar. Për ta arritur këtë qëllim është e rëndësishme që të ndërmerren disa masa të cilat do ta nxisin prodhimin e filmit, si dhe do t'i promovojnë dhe do t'i përkrahin artistët vendas.

- **Përfaqësimi institucional dhe në Buxhet.** Një masë e rëndësishme është përfaqësimi i drejtë institucional dhe ndarja proporcionale e buxhetit në Agjencionin e Filmit. Kjo do të sigurojë që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive për ta përkrahur prodhimin e filmit dhe krijuesit vendas;
- **Krijimi i infrastrukturës së nevojshme:** Investimi në infrastrukturën e filmave, siç janë: studio të prodhimit, salla kinemaje dhe rrjeti shpërndarës, paraqet masë thelbësore për ta lehtësuar prodhimin, shfaqjen dhe promovimin e filmave.
- **Rritja e Fondeve.** Për ta përkrahur artin filmik, rrisim përqindjen e fondeve nga tatimi i lojërave të fatit, duke siguruar që kjo të kalohet drejtpërdrejt në buxhetin e Agjencionit të Filmit;
- **Promovimi i filmit vendas.** Organizimi i festivaleve të filmave vendas dhe prezantimi i tyre në skena ndërkombëtare. Ky lloj promovimi i filmit, i krijuar në Maqedoninë e Veriut, do ta rris ndërgjegjësimin e publikut dhe interesin për artin filmik lokal.

iii. RUAJTJA DHE KULTIVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE

Ruajtja dhe kultivimi i trashëgimisë kulturore është një detyrë e rëndësishme për ta ruajtur identitetin kulturor të një vendi dhe për ta pasuruar jetën kulturore të brezave të ardhshëm. Kjo përfshin ruajtjen e monumenteve historike, trashëgimisë arkitektonike, traditave folklorike, artit, muzikës, letërsisë dhe praktikave të tjera që janë pjesë e trashëgimisë së një populli. Në Maqedoninë e Veriut, kjo përfshin të mbrojturit e monumenteve të trashëgimisë kulturore, restaurimin e objekteve historike, dokumentimin e traditave të humbura dhe promovimin e aktiviteteve kulturore tradicionale.

- **Ruajtja dhe restaurimi i monumenteve historike.** Ky proces përfshin ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve historike, trashëgimisë arkitektonike, traditave të ndryshme folklorike, muzikës, artit dhe gjitha aspekteve të tjera të kulturës së ndryshme të vendit. Investimi në edukimin dhe sensibilizimin e popullsisë për diversitetin kulturor dhe historik të vendit është gjithashtu thelbësor për të garantuar qasje të kujdeshme ndaj trashëgimisë multikulturore.
- **Dokumentimi dhe studimi i trashëgimisë.** Në të njëjtën kohë, rëndësi ka përqëndrimi i përpjekjeve në dokumentimin dhe studimin e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe testimin e teknikave dhe praktikave inovative për restaurimin dhe prezantimin e saj në mënyra atraktive dhe edukative. Krijimi i platformave dhe aktiviteteve që inkurajojnë bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit ndërmjet komuniteteve të ndryshme kulturore është gjithashtu thelbësor për ta promovuar bashkëpunimin dhe respektin ndërmjet tyre.

Ruajtja dhe kultivimi i trashëgimisë kulturore është një detyrë e përbashkët dhe një investim në të ardhmen e përbashkët kulturore dhe shoqërore të Maqedonisë së Veriut. Përmes përkushtimit ndaj mbrojtjes së kësaj trashëgimie të pasur, vendi mund të përfitojë në mënyra të shumta, duke përfshirë zhvillimin e turizmit kulturor dhe promovimin e imazhit të tij si një destinacion i rëndësishëm kulturor.

Në drejtim të ruajtjes dhe kultivimit të trashëgimisë kulturore është e rëndësishme të ndërmerren masa të cilat do të promovojnë dhe do ta mbrojnë pasurinë kulturore të Maqedonisë së Veriut për të siguruar që ajo të kthehet në një burim frymëzimi dhe identiteti për brezat e ardhshëm:

- **Politikat e trashëgimisë kulturore** do të përqendrohen në investime në objektet kulturore dhe historike, duke punuar drejtuar krijimit të modelit të turizmit kulturor. Nëpërmjet kësaj, synojmë t'i promovojmë vlerat tona kulturore dhe ta rrisim ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe turistëve për pasurinë tonë kulturore të vlefshme.
- **Investimi në trashëgiminë muzeale.** Planifikojmë të hapim sektorin e veçantë brenda Muzeut të Tetovës dhe Galerisë së Arteve të Gostivarit për të ekspozuar artefakte dhe trashëgimi të rëndësishme iliro-dardane. Kjo do të ndihmojë në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore;
- **Hapja e katedrave arkeologjike** Nismë e rëndësishme do të jetë hapja e katedrave universitare për arkeologji dhe histori arti. Këto katedra do të kontribuojnë në prodhimin e një numri të nevojshëm të specialistëve në këto fusha, të cilët do të kenë rol të rëndësishëm në studimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore.

iv. PROMOVIMI I FOLKLORIT MUZIKOR

Folklori muzikor është aspekt shumë i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore në Maqedoninë e Veriut, pasi përfaqëson identitetin dhe origjinalitetin kulturor të komunitetit .

Për ta përforcuar dhe zhvilluar këtë dimension të kulturës, kemi përcaktuar disa synime dhe masa të rëndësishme:

- Organizimi i festivaleve të muzikës folklorike për ta prezantuar dhe promovuar trashëgiminë muzikore të çdo etnie në mënyrë të qartë dhe të përmasave të mëdha;
- Krijimi i programeve edukative për ta inkurajuar rininë që ta mësojë dhe ta praktikojë muzikën folklorike tradicionale të vendit, duke përfshirë mësimin e instrumenteve tradicionale dhe të valleve popullore;
- Përkrahja e ansambleve dhe grupmoshave të ndryshme që përfaqësojnë çdo komunitet për të zhvilluar dhe përhapur muzikën e tyre në nivele lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Shfrytëzimi i teknologjisë moderne dhe platformave të mediave sociale për ta përhapur dhe promovuar muzikën folklorike në mënyra inovative dhe të përshtatshme me kohën;
- Inkurajimi i studimeve dhe hulumtimeve mbi muzikën folklorike të çdo komuniteti për të dokumentuar dhe ruajtur trashëgiminë muzikore në mënyrë të qëndrueshme.

Promovimi i folklorit muzikor të komuniteteve të ndryshme do të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit për kulturën e tyre, duke kontribuar në një shoqëri më të pasur dhe më të bashkuar në Maqedoninë e Veriut.

Projekte:

- **Ndërtimi i objektit për ansamblin e këngëve.** Në këtë kontekst, planifikojmë ndërtimin e objektit të specializuar për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV). Ky objekt do të ofrojë ambient të përshtatshëm për trupin artistik dhe do të kontribuojë në promovimin e performancave të kulturës popullore shqiptare;
- **Promovimi i muzikës tradicionale shqiptare në arenën ndërkombëtare.** Gjithashtu, synojmë të ndërmarrim një nismë për njohjen e muzikës polifonike të trevave shqiptare nga Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat relevante ndërkombëtare të folklorit. Ky veprim do të ndihmojë në përhapjen dhe promovimin e muzikës tradicionale shqiptare në arenën ndërkombëtare;
- **Themelimi i Departamentit të Folklorit dhe Artit Skenik.** Për të krijuar mjedis më të përshtatshëm për studimin dhe zhvillimin e folklorit muzikor, do të themelohet Departamenti i posaçëm i Folklorit dhe Artit Skenik pranë Universitetit të Tetovës. Kjo do të sjellë fokus të veçantë në studimin dhe promovimin e trashëgimisë muzikore popullore në nivelin akademik;
- **Çmim shtetëror "Lorenc Antoni".** Do të krijojmë çmimin shtetëror "Lorenc Antoni" për kontributin e shquar në fushën e muzikës folklorike dhe atë popullore. Ky çmim do të jepet nëpërmjet konkursit të shpallur nga Ministria e Kulturës, duke nxitur hulumtues, interpretues dhe artistë të kësaj sfere.
- **Festivali Tradicional i Kulturës.** Për ta promovuar dhe mbrojtur trashëgiminë kulturore, planifikojmë ta organizojmë Festivalin Tradicional Ndërkombëtar të Kulturës dhe Artit "Shkup-Çarshia e Vjetër", në bashkëpunim me Ansamblin e Këngëve dhe Valleve popullore shqiptare në RMV. Ky festival do ta prezantojë artin dhe kulturën tradicionale shqiptare për publikun ndërkombëtar;
- **Insitucionalizimi i evenimenteve kombëtare.** Në të njëjtën kohë, synojmë insitucionalizimin e evenimenteve të rëndësishme kombëtare si "Dita e Plisit",

"Pranvera e Dinjitetit", "Karadaku i Pamposhtur" dhe "Këngë Jeho". Këto evenimente do të shërbejnë si platforma për ta promovuar trashëgiminë kulturore të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

v. INDUSTRIA E MODËS DHE DIZAJNIT

Industria e modës dhe dizajnit është sektor që po zhvillohet me shpejtësi në Maqedoninë e Veriut, duke sjellë kontribut të rëndësishëm në ekonominë vendase dhe duke promovuar kulturën dhe kreativitetin e vendit tonë. Ky sektor ofron një gamë të gjerë të mundësive për zhvillimin e karrierës për të rinjtë dhe talentet vendas.

Në këtë kontekst, planifikojmë t'i ndërmarim disa masa për ta përforcuar dhe avancuar industrinë e modës dhe dizajnit në Maqedoninë e Veriut:

- **Krijimi i Departamentit të Modës dhe Dizajnit** në kuadër të Universitetit "Nënë Tereza". Ky departament do të ofrojë programe të specializuara në dizajnin e modës, tekstilit dhe modelizmit, duke përgatitur profesionistë të aftë për t'i përmbushur nevojat e tregut të brendshëm dhe atij ndërkombëtar;
- **Inkurajimi i bashkëpunimit ndërinstitucional** ndërmjet universiteteve, industrisë së modës dhe dizajnit për ta siguruar trajnimin e duhur dhe të përshtatshëm për studentët në fushën e modës dhe dizajnit;
- **Krijimi i Qendrës së Specializuar për Inovacion dhe Zhvillim** në industrinë e modës dhe dizajnit. Kjo qendër do të ofrojë hapësira të përshtatshme dhe pajisje moderne për krijim dhe eksperimentimin e dizajnit të modës;
- **Organizimi i evenimenteve të rëndësishme si "Java e Modës"**, ku dizajnerët vendas mund të shfaqin krijimet e tyre para një publiku të gjerë dhe të kenë mundësi për t'u njohur me tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar;
- **Përkrahje financiare dhe teknike:** për startup-et dhe bizneset e vogla dhe të mesme në ndustrinë e modës dhe dizajnit, duke u fokusuar në inovacion dhe kreativitet.

Këto masa do të ndihmojnë në rritjen e konkurrueshmërisë së industrisë së modës dhe dizajnit në Maqedoninë e Veriut, duke sjellë zhvillim të qëndrueshëm në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë vendase.

vi. ARTI DRAMATIK-TEATRAL

Arti teatral dramatik në Maqedoninë e Veriut është pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore dhe historisë së vendit. Në përpjekje për ta avancuar dhe për ta kultivuar këtë art, kemi hartuar disa masa dhe synime:

- Ndërtimi i objektit IN Teatri i Fëmijëve dhe të Rinjve në Shkup;
- Ndërtimi i objektit multifunksional për institucionet nacionale: Teatri dhe Galeria e Gostivarit;
- Krijimi i Teatrit eksperimental shqiptar në Shkup, me prioritet për performuesit e rinj të artit skenik;

- Institucionalizimi i plotë i jetës teatrale mbetet ndër çështjet e rëndësishme të programit tonë ku parashihet: pavarësimi i plotë i Teatrit të Kumanovës, krijimi i teatrit rajonal në trekëndëshin Strugë, Dibër dhe Kërçovë, krijimi i qendrës kulturore shqiptare në Veles, Dollnen, Prilep, Manastir, Prespë, institucionalizimi i festivalit “Moisiu”.

Përveç investimeve kapitale dhe institucionalizimit të jetës teatrale është relevante edhe përkrahja e trupave teatrale amatore në kuadër të qendrave të kulturës në qytetet ku nuk ka teatro si: Kërçovë, Strugë, Dibër, Veles, Prespë, Manastir, Dollnen dhe Ohër.

vii. ARTI INTERKULTUROR

Në drejtim të artit interkulturore, kemi përpiluar një seri masash për ta promovuar dhe avancuar bashkëpunimin dhe diversitetin kulturor në Maqedoninë e Veriut. Këto masa janë si në vijim:

- **Institucionalizimi i festivaleve:** Këtë vit, synojmë ta institucionalizojmë festivalin "Vera e Kulturës Tetovare", si dhe Festivalin e Këngëve Qytetare “TEUTA” si evenimente që synojë të prezantojnë gamën e gjerë të artit dhe kulturës, duke përfshirë muzikë, libra, konferenca, ekspozita dhe shfaqje teatrale. Kjo do të ndihmojë në stimulimin dhe përkrahjen e artistëve vendas dhe rigjallërimin e ambienteve të trashëgimisë kulturore;
- **Themelimi i Festivalit "Vera Kulturore Strugane":** Po ashtu, planifikojmë ta themelojmë festivalin "Vera Kulturore Strugane", që synon të sjellë një gamë të gjerë të performancave interkulturore për turistët gjatë sezonit veror-turistik. Ky festival do të mbahet në ambiente të hapura dhe do të përfshijë aktivitete të ndryshme artistike dhe kulturore.
- **Përkrahja e evenimenteve tradicionale:** Kemi vendosur ta përkrahim evenimentin tradicional që do të njohë personalitetet dhe institucionet e suksesshme të vitit në fushën e artit dhe kulturës.
- **Themelimi i Festivalit "Vera Kulturore në Saraj":** Po ashtu, synojmë ta themelojmë festivalin "Vera Kulturore në Saraj" për t'i prezantuar vlerat e zonës së Dërvenit dhe për ta promovuar bashkëpunimin dhe diversitetin kulturor në këtë zonë.

Këto masa janë pjesë e angazhimit tonë për ta nxitur dhe promovuar artin dhe kulturën në Maqedoninë e Veriut, duke i dhënë rëndësi të veçantë bashkëpunimit dhe diversitetit kulturor në vend.

3.5.3. RINI AKTIVE

Rinia e shëndoshë dhe aktive, pjesëmarrëse në vendimmarrje dhe procese shoqërore është parakusht i zhvillimit të qëndrueshëm dhe të shëndoshë shoqëror. Ne gjithnjë kemi fuqizuar politika rinore që kanë për qëllim krijimin e kuadrove të reja, që do të mbajnë mbi supe

peshën e vendimeve dhe nevojave progresive të shoqërisë. Rinia është aset i cili përmes origjinalitetit dhe kreativitetit autentik, vendos kahjet dhe drejtimin për të ardhmen. Rinia aktive nënkupton, zhvillim, inovacion, energji dhe vazhdimësi të qëllimeve të cilat si shtet i kemi vendosur si objektiva afatgjate. Investimi në politikat rinore, përmes edukimit dhe arsimimit të mirëfilltë, promovimit të sportit dhe kulturës, kyçjes aktive në vendimmarrje dhe vlerësimit të origjinalitetit krijues të të rinjëve, garanton shoqëri inkluzive, të zhvilluar dhe të bazuar në meritokraci.

Miratimi dhe implementimi i strategjive dhe politikave shtetërore për fuqizimin e të rinjve, si katalizator i progresit natyror drejt Bashkimit European, ka për qëllim krijimin e gjeneratës udhëheqëse dhe të guximshme, e cila jo vetëm që do bartë peshën e problemeve të trashëguara, por do të ofrojë zgjidhje reale dhe të arritshme në të ardhmen. Sporti, rekreacioni, kultura përfaqësuese dhe aktivizmi qytetar janë padyshim rruga drejt një rinie e cila krijon, lufton për bindjet dhe idealet e kohës, duke qenë aktive, e në raste edhe reaktive ndaj sfidave dhe problemeve shoqërore.

Qëllimi ynë është krijimi dhe zbatimi i Strategjisë integrale për të rinjtë, e cila do të sigurojë mjedis ku të rinjtë mund ta zhvillojnë potencialin e tyre në mënyrë të plotë, duke ofruar përkrahje në zbulimin e nevojave individuale të tyre dhe duke promovuar talentet, interesat dhe kreativitetin e tyre. Për ta kundërshtuar trendin negativ të rënies së numrit të të rinjve në shoqëri, është me rëndësi njohja e tyre si një kategori qytetarësh me nevoja specifike dhe karakteristika të veçanta. Në këtë drejtim, përqendrohemi në fuqizimin e politikave rinore bazuar në fakte dhe ndryshime konstante të nevojave rinore. Vizioni ynë për të ardhmen është shoqëria ku të rinjtë trajtohen si partnerë të barabartë në krijimin dhe zbatimin e politikave rinore, pa diskriminime dhe paragjykime. Synojmë të krijojmë mjedis ku ata mund të ndjehen të lirë, t'i shprehin mendimet e tyre dhe të marrin pjesë aktivisht në procesin vendimmarrës. Në nivel ndërkombëtar, qëllimi ynë është t'i koordinojmë politikat rinore me agjendën globale, duke përfshirë thirrjet dhe udhëzimet e organizatave ndërkombëtare si Bashkimi European, Kombet e Bashkuara dhe Këshilli i Europës. Ne besojmë në rëndësinë e strategjive të koordinuara për ta siguruar pjesëmarrjen e të rinjve në zgjidhjen e sfidave globale dhe në zhvillimin e shoqërive të qëndrueshme.

- **Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje:** Fuqizimi i ndikimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse, si në nivel lokal ashtu edhe nacional është prioritet kyç për krijimin e shoqërisë më të përfshirë dhe të drejtë;
- **Pjesëmarrja aktive e të rinjve në vendimmarrjen brenda institucioneve arsimore:** Përritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse në institucionet arsimore, synojmë të garantojmë përkrahjen ligjore, përkrahjen financiare, si dhe edukimin e vazhdueshëm të rinisë;
- **Fuqizimi i aktivizmit rinor brenda hapësirës digjitale:** Sigurojmë qasje në mjete digjitale për të rinjtë dhe përmirësojmë infrastrukturën e teknologjisë së informacionit në hapësirat publike, duke përfshirë teknologjinë e ndihmës për personat me aftësi të kufizuara;
- **Fuqizimi dhe qëndrueshmëria e kapaciteteve të sektorit të rinisë si partner i institucioneve në krijimin e politikave drejt jetesës më cilësore për të rinjtë:** Ta krijojmë analizën e programeve dhe fondeve lokale dhe nacionale për ta siguruar

përshtatshmërinë e tyre me nevojat aktuale të rinisë për qëndrueshmëri dhe zhvillim të organizimeve rinore;

- **Puna me të rinjtë të njihet zyrtarisht, politikisht dhe shoqërisht dhe si qasje kyçe për përkrahjen e zhvillimit autentik të të rinjve:** Rregullimin e punës për të rinjtë nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të legjislacionit përkatës dhe rishikimit të atyre që ekzistojnë;
- **Krijimi i sistemit funksional për të garantuar punë të qëndrueshme dhe cilësore për të rinjtë:** Për të garantuar punë të qëndrueshme dhe cilësore për të rinjtë është e nevojshme të krijohet sistemi i strukturuar dhe funksional që të sigurojë përkrahje dhe zhvillim të tyre në tregun e punës.
- **Profesioni i të punësuarve të rinj njihet, zhvillohet dhe promovohet:** Për të siguruar ambient pune të favorshëm për të rinjtë është e rëndësishme ta përcaktojmë dhe miratojmë listën me kompetenca minimale për të punësuarit e rinj;
- **Garantimi i qasjes së barabartë në arsimin cilësor për të rinjtë:** Për të ndihmuar nxënësit që kanë përballuar vështirësi të shaktuara nga pandemia COVID-19, do të krijohen mekanizma për monitorimin e tyre të rregullt dhe ofrimin e përkrahjes së nevojshme;
- **Të mundësojmë avancimin e të rinjve, kompetencave dhe zgjedhjes së profesionit të tyre:** Masat për ta përmirësuar përgatitjen e të rinjve për tregun e punës dhe për ta rritur orientimin e tyre të karrierës;
- **Përmirësimi i stilit të jetesës dhe cilësisë së jetës të të rinjtë:** Promovimi i stilit të shëndetshëm dhe cilësi më e mirë të jetës për të rinjtë.
- **Nxitja e sipërmarrjes dhe zhvillimit të punësimit për të rinjtë:** Në përputhje me synimin për të krijuar mjedis të favorshëm për sipërmarrjen dhe krijimin e vendeve të punës për të rinjtë, kjo sërë masash synon të nxisë kulturë sipërmarrëse dhe të ofrojë përkrahje konkrete për zhvillimin e bizneseve të tyre;
- **Ndalimi i dhunës dhe promovimi i siguris tek të rinjtë:** Implementimi i masave për sigurinë kibernetike dhe digjitale në shkollat e mesme fillon me integrimin e tyre në kurrikulën e lëndës së Informatikës, duke sensibilizuar nxënësit për rrezikun dhe praktikat e sigurisë në internet.

Pjesmarrja e të rinjve në vendimmarrje. Ndërmarrja e një sërë masash, përfshirë sigurimin e zbatimit të ligjeve dhe politikave për pjesëmarrjen rinore, analizën periodike të efekteve të këtyre ligjeve, përshtatjen dhe miratimin e akteve ligjore në bashkëpunim të ngushtë me të rinjtë, si dhe përfshirjen e tyre në proceset konsultative për negociatat me Bashkimin Europian. Për më tepër, rëndësi ka edhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale, përmirësimi i përfshirjes së të rinjve në organet vendimmarrëse lokale dhe nacionale, si dhe avancimi i politikave për të rinjtë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Prioriteti ynë kyç është që të sigurojmë rol aktiv dhe të përshtatshëm për të rinjtë në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes, duke kontribuar në zhvillimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Pjesmarrja aktive e të rinjve në vendimmarrjen brenda institucioneve arsimore. Fuqizimin e kompetencave të stafit, përmirësimin e materialeve mësimore, përfshirjen e barabartë të të rinjve dhe prezantimin e modelit të Avokatit të Popullit në drejtim të nxënësve. Këto masa promovojnë pjesëmarrjen aktive dhe qytetarinë në mënyrë të përshtatshme për të rinjtë. Garantimi dhe nxitja e pjesëmarrjes së shkollave të mesme dhe nxënësve në kuadrin ligjor që

rregullon arsimin e mesëm dhe të lartë. Kjo përfshin monitorimin e rregullt dhe masat korrigjuese nëse nevojiten. Gjithashtu, rëndësi ka të sigurohet përkrahje financiare të mjaftueshme nga institucionet arsimore për përfaqësues të nxënësve dhe studentëve, duke u fokusuar në mbarëvajtjen e veprimtarive të tyre. Një dimension i rëndësishëm është edukimi dhe informimi i vazhdueshëm i nxënësve për rëndësinë dhe avantazhet e pjesëmarrjes së tyre në procesin arsimor. Kjo përfshin zhvillimin e kompetencave të anëtarëve të organeve përfaqësuese rinore në shkolla dhe institucione të arsimit të lartë për ndikim efektiv në proceset vendimmarrëse. Në përgjithësi, ky përkushtim për pjesëmarrje aktive dhe përfshirje sistematike është kritike për të siguruar mjedis arsimor ku të rinjtë ndihen të motivuar, me ç'rast ndjehen të dëgjuar dhe të përfshirë në proceset që kanë ndikim në jetën e tyre arsimore.

Fuqizimi i aktivizmit rinor brenda hapësirës digjitale. Në përputhje me zhvillimet e fundit teknologjike, fokus i veçantë është në sigurimin e qasjes së përgjithshme në mjete digjitale dhe përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në hapësirat publike. Kjo përfshin ndërtimin dhe përmirësimin e mjeteve të nevojshme për përdorimin e teknologjisë informative, duke adresuar veçanërisht nevojat e të rinjve me aftësi të kufizuara. Po ashtu, një përqendrim i rëndësishëm është në promovimin e shkrim-leximit digjital dhe aftësive të teknologjisë së informacionit në mesin e zyrtarëve vendas dhe qendror. Kjo përfshin trajnimin e tyre në përdorimin e mjeteve digjitale për të komunikuar me të rinjtë dhe për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete digjitale. Gjithashtu është e rëndësishme që të përmirësohen dhe promovohen mjetet digjitale ekzistuese për ta inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe për të siguruar që ata të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë moderne.

Fuqizimi i kapaciteteve të sektorit të rinisë si partner i instiucioneve në krijimin e politikave drejt jetesës më cilësore për të rinjtë. Krijojmë sistem të qëndrueshëm të financimit buxhetor për aktivitetet rinore, duke siguruar mbulimin e barabartë rajonal dhe fokusimin e madh në rininë rurale. Inkurajojmë rrjetëzimin dhe bashkëpunimin strukturor midis organizatave rinore, rinisë dhe vendimmarrësve, në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar, duke përfshirë dialogun strukturor rinor. Sigurojmë masa afirmative për përkrahjen e organizatave rinore nga zonat rurale dhe ata me më pak mundësi. Përforcojmë kapacitetet e organizatave rinore dhe inkurajojmë formimin e tyre, duke u fokusuar drejt zonave dhe rajoneve më pak të zhvilluara dhe tek të rinjtë me më pak mundësi.

Puna me të rinjtë të njihet zyrtarisht, politikisht dhe shoqërisht si qasje kyçe për përkrahjen e zhvillimit autentik të të rinjve. Përqipemi për rritje të dukshmërisë së punës rinore dhe për promovimin e shumëfaqshëm të saj në nivel social, duke përfshirë arsimin joformal, vullnetarizmin dhe qendrat rinore, si dhe ofruesit e punës për të rinjtë. Inkurajojmë bashkëpunimin në nivel lokal midis qendrave rinore, shoqatave civile, institucioneve arsimore dhe bizneseve për t'i përmirësuar mundësitë e punësimit të të rinjve.

Krijimi i sistemit funksional për të garantuar punë të qëndrueshme dhe cilësore për të rinjtë. Këtë do ta arrijmë duke formuar Këshillin Nacional Ndërsektorial, i cili do të ketë përgjegjësi për të siguruar punë cilësore dhe të qëndrueshme për të rinjtë. Ky këshill do të operojë në bazë të dokumentit strategjik nacional, duke përfshirë udhëzime, prioritete dhe aktivitete për rritjen e potencialit të punësimit rinor në të ardhmen. Në këtë kontekst është e rëndësishme

që të monitorohet dhe vlerësohet zbatimi i ligjeve dhe politikave që lidhen me punën rinore, si dhe të përgatiten dhe miratohen standardet nacionale për cilësinë e punës. Gjithashtu, do të krijohet një bazë ekspertësh për ta monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e punës rinore në qendrat rinore dhe programe për të rinjtë, si dhe do të implementohet sistemi nacional për dhënien e "**Etiketës së cilësisë**", që konfirmon përmbushjen e standardeve të cilësisë së këtyre programeve dhe qendrave rinore për të rinjtë. Këto masa do të ndihmojnë në sigurimin e ambientit të favorshëm për punësimin dhe zhvillimin e të rinjve në shoqërinë tonë.

Profesioni i të punësuarve të rinj të identifikohet, zhvillohet dhe promovohet. Gjithashtu, duhet të ofrojmë mundësi për arsimim formal dhe joformal bazuar në këto kompetenca, duke përkrahur vlefshmërinë e njohurive të fituara paraprakisht në këtë fushë. Në këtë drejtim, krijimi i programeve të studimit për punën rinore në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë do të ndihmojë në rritjen e interesit për përfshirje në këto programe. Po ashtu, hapja e vendeve të punës për të rinjtë në të gjitha institucionet përkatëse dhe sigurimi i pagave adekuate paraqesin masa të rëndësishme.

Garantimi i qasjes së barabartë në arsimin cilësor për të rinjtë, përgatitja për shoqërinë bashkëkohore. Modernizimi i kurrikulave dhe teksteve shkollore do të bëhet për t'u përshtatur më mirë me realitetin bashkëkohor. Gjithashtu, do të rishikohen programet e studimit për mësuesit dhe do të rritet fondi për mësimin praktik në fakultetet e tyre. Për të siguruar arsim cilësor, stafi arsimor do të përfitojë nga zhvillimi i tyre profesional, duke përfshirë edhe trajnime për kompetencat digjitale. Do të kemi mekanizma të sigurimit që të rinjtë të mund ta shprehin vlerësimin e tyre për mënyrën se si po funksionon sistemi arsimor dhe mjedisi i mësimin. Për ta garantuar integritetin akademik, do të promovohet ndërgjegjësimi brenda institucioneve arsimore. Për mësimin modern, do të përdoret gjërësisht TIK-u dhe do të investohet në platforma digjitale për mbledhjen e materialeve mësimore. Gjithashtu, do të kemi proces të digjitalizimit të shërbimeve administrative për ta përmirësuar eksperiencën arsimore për gjimnazistët dhe studentët.

Të mundësojmë avancimin e të rinjve dhe kompetencave, si dhe përzgjedhjes së profesionit të tyre. E rëndësishme është përmirësimi i shërbimeve të orientimit dhe këshillimit në të gjitha nivelet e arsimit, si dhe përkrahja e sistemit për të rinjtë që nuk janë në punë, arsim, ose trajnim (NEET). Lidhjet e ngushta midis shkollave, bizneseve, organizatave joqeveritare dhe institucioneve të arsimit të lartë do të rriten për të krijuar programe më efikase të mësimdhënies dhe studimit, duke përfshirë arsimin praktik dhe të nxënit përmes punës. Investimet do të rriten në arsimin e mesëm profesional dhe në standardet për certifikimin e arsimit praktik.

Përmirësimi i stilit të jetesës dhe cilësisë së jetesës tek të rinjtë. Një pjesë e rëndësishme e këtyre masave përfshin edukimin mbi ushqimin dhe praktikën e shëndetshme të jetesës, me përqendrimin në ushqim të shëndetshëm dhe promovimin e aktiveve fizike. Për ta realizuar këtë, rëndësi ka të ofrohet edukim nga ekspertë të fushës, të përmirësohen kushtet e ushqimit në institucionet arsimore dhe të sigurohen hapësira për aktivitete sportive. Fokus i veçantë është ndalimi i zakoneve të këqija të jetesës, siç janë konsumi i duhanit dhe alkoolit, si dhe përdorimi i drogave narkotike. Kjo kërkon përkushtim të përbashkët për parandalimin e varësive të sjelljes dhe trajtimin e përdoruesve me varësi në mënyrë efektive dhe humane.

Përveç kësaj, rëndësi ka që të rritet ndërgjegjësimi për këto çështje në mes të të rinjve, prindërve dhe stafit mësimdhënës.

Nxitja e sipërmarrjes dhe zhvillimit të punësimit për të rinjtë. Në këtë drejtim, ndërhyrje kryesore është rritja e ndërgjegjësimit për përfitimet e sipërmarrjes dhe përkrahja e frymës sipërmarrëse te të rinjtë. Kjo shoqërohet me nxitjen dhe përkrahjen e të rinjve për të filluar dhe zhvilluar bizneset e tyre, duke u përqendruar sidomos në digjitalizimin e tyre për të përfituar nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit. Për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie gjithnjë e më të ndërgjegjshme për ambientin, përkrahja e inovacionit në ekonominë e gjelbër është një pikë kyçe. Gjithashtu, për lehtësimin e punësimit dhe formalizimin e sipërmarrësve të rinj, përmirësimi i mjedisit ligjor dhe administrativ është thelbësor. Përveç kësaj, një fokus i veçantë është rritja e ndihmës së ofruar për startup-et e reja, veçanërisht për ata në sektorët strategjikë për zhvillimin e vendit. Në këtë rrugëtim, për të ndihmuar mbi rritjen e mundësive të ekonomisë së rinisë, përkrahja e sipërmarrësve në zonat rurale, për ta promovuar zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit, luan rol të rëndësishëm në përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së jetës së të rinjve.

Ndalimi i dhunës dhe promovimi i sigurisë tek të rinjtë. Me anë të masave konkrete që do ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve, prindërve dhe stafit mësimdhënës për format dhe ndikimin e dhunës kibernetike, si dhe me anë të bashkëpunimit me Qendrën Nacionale të Reagimit ndaj Incidenteve Kompjuterike, do të ndihmojmë në përforcimin e sigurisë kibernetike në ambiente arsimore. Përveç kësaj, fokusi i veçant do të orientohet në mekanizmat për parandalimin dhe trajtimin e të gjitha llojeve të dhunës dhe dhunës së bashkëmohatarëve në mënyrë që të sigurohet mjedisi shkollor i sigurt dhe i mbrojtur për të gjithë të rinjtë.

3.5.4. SPORT DHE REKREACION

Sporti paraqet dimension thelbësor në krijimin e shoqërisë progresive dhe gjithëpërfshirëse. Duke theksuar rëndësinë e sportit, synojmë të ndikojmë në zhvillimin e mjedisit ku ndërveprimi shoqëror rritet, ndërsa vlerat etike themelore përjetohen nga të gjitha kategoritë e qytetarëve, sidomos nga rinia. Sporti për ne është mjedisi që ndihmon në ngritjen e përfshirjes sociale dhe krijimin e shoqërive të hapura dhe tolerante.

Synimi ynë është të krijojmë sistem ku sporti dhe arritjet sportive jo vetëm zhvillohen, por kontribuojnë gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe promovimin e mënyrës së shëndetshme të jetesës për një numër sa më të madh të qytetarëve.

Për këtë, suksesin do ta arrijmë nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të rinjve në sport, rritjes së numrit të profesionistëve sportivë, arritjes së rezultateve të shquara dhe afirmimit të sportit në nivele të larta, rritjes së angazhimit të femrave në sport, krijimit të infrastrukturës sportive cilësore, përmirësimit të statusit të sportistëve dhe profesionistëve të fushës së sportit, si dhe promovimit të vlerave olimpike dhe largimit të sportit nga ndikimet partiake. Synimet tona për katër vitet e ardhshme janë:

- **Investime në infrastrukturë sportive:** Ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve sportive si stadione, palestra, fusha sportive dhe pista atletike. Kjo do të krijojë ambiente më të mira për trajnimet, garat dhe aktivitetet sportive të komunitetit;
- **Promovimi i barazisë gjinore në sport:** Ndërmarrja e masave për nxitjen e barazisë gjinore në sport, duke përfshirë përkrahjen e programeve dhe turneve për vajzat dhe gratë, si dhe promovimin e trajnereve dhe drejtuesve të femrave në sport;
- **Promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në sport:** Nisma për inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve në sport dhe për të ofruar më shumë mundësi për zhvillimin e aftësive sportive për të rinjtë në shkolla dhe qendra rinore.

i. INVESTIME NË INFRASTRUKTURË SPORTIVE

Investimet në infrastrukturë sportive janë të rëndësishme për të krijuar ambiente cilësore për aktivitetet sportive në komunitetin tonë. Këto investime do të përfshijnë ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve sportive si: stadione, palestra, fusha sportive dhe pista atletike. Synimi është të krijohen ambiente të përshtatshme për trajnimet, garat dhe aktivitetet sportive të të gjithë komunitetit.

Në veçanti, në fushat e futbollit, do të kërkojmë të ndërtojmë fusha sportive multifunkionale, të cilat do të ofrojnë hapësira për të zhvilluar jo vetëm futboll, por edhe sporte të tjera si basketboll, volejball, dhe sporte të tjera ekipore. Kjo do ta rrisë shfrytëzimin e fushave sportive dhe do të mundësojë më shumë aktivitete sportive për të gjithë komunitetin.

Për përballimin e nevojës për palestër sportive për gara ndërkombëtare në Tetovë, synojmë të krijojmë infrastrukturë të përshtatshme për sportistët tanë. Ky objekt do t'i përmbushë të gjitha kriteret për të mbajtur gara zyrtare dhe ndërkombëtare të shumë llojeve të sporteve.

Përveç kësaj, në objektet kryesore sportive në Maqedoninë e Veriut, do të kryhet Projekti për përmirësimin e efikasitetit energjitik. Kjo do të përfshijë vendosjen e teknologjive të fundit për energjinë e ripërtëritshme dhe zvogëlimin e konsumit të energjisë. Kjo, jo vetëm që do të ulë kostot operative, por gjithashtu do të ndihmojë në mbrojtjen e mjedisit.

Për më tepër, do të kemi fokus të veçantë në rikonstruimin e sallave sportive ekzistuese. Rikonstruimi i tyre do të përfshijë modernizimin e infrastrukturës, shfrytëzimin e materialeve të cilësisë së lartë dhe përmirësimin e kushteve për sportistët dhe për të gjithë shfrytëzuesit e objekteve sportive.

Këto hapa do të krijojnë ambiente më të mira dhe më të përshtatshme për të gjithë ata që dëshirojnë të angazhohen në aktivitete sportive në komunitetin tonë.

ii. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE NË SPORT

Ne kemi një përkushtim të fortë për të nxitur barazinë gjinore në fushën e sportit. Kjo përfshin marrjen e masave konkrete për të inkurajuar pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në sport. Ne

do të promovojmë programe dhe turne për vajzat dhe gratë, duke siguruar që ato të kenë mundësi të barabarta për të zhvilluar aftësitë e tyre sportive dhe për të përjetuar kënaqësinë e sportit. Gjithashtu, do të kemi një fokus të veçantë në promovimin e trajnereve dhe drejtuesve të grave në sport, duke u përkushtuar në të sjellë më shumë liderë dhe modele femërore në fushën e sportit.

Për të arritur këtë qëllim, do të ofrojmë mbështetje të konsiderueshme për klubet sportive dhe për të krijuar klube të specializuara për gratë dhe vajzat. Ne do të sigurojmë që femrat të kenë mundësi të përparojnë në sport në mënyrë të barabartë me burrat. Përveç mbështetjes financiare, ne gjithashtu do të ofrojmë këshillim dhe trajnime për të ndihmuar klubet sportive në zhvillimin dhe menaxhimin e kubeve të tyre për femra.

Këto masa do të ndihmojnë në ndërtimin e një mjedisi më të përfshirë dhe më të barabartë për të gjithë sportistët, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore dhe duke promovuar një kulturë të shëndetshme të përfshirjes në sport.

iii. PROMOVIMI I KULTURËS SË GARAVE SPORTIVE NË SHKOLLA

Ne kemi një vizion për të inkurajuar dhe promovuar gara sportive në të gjitha shkollat e vendit tonë. Përmes kësaj iniciative, synojmë të krijojmë një mjedis ku nxënësit do të kenë mundësinë për të garuar me nxënësit e shkollave të tjera në nivel kombëtar.

Në këtë kontekst, do të organizojmë gara sportive periodike në të cilat shkollat nga e gjithë vendi do të marrin pjesë. Këto gara do të përfshijnë një gamë të gjerë sportesh si futboll, basketboll, volejball, dhe shumë të tjera. Pjesëmarrja në këto gara do të ndihmojë në promovimin e solidaritetit dhe bashkëpunimit në mes të nxënësve, duke u mundësuar atyre të socializohen dhe të ndajnë njohuri dhe përvoja të reja.

Çmimet dhe shpërblimet do të ndahen për ekipet më të mira në secilën garë, duke inkurajuar përpjekjet dhe talentet e nxënësve në fushën e sportit. Gjithashtu, në fund të çdo sezone sportive, do të bëhet një seleksion për të identifikuar lojtarët më të mirë të vitit në çdo sport. Këta lojtarë do të kenë mundësinë për të zgjedhur dhe për të përfaqësuar klubet më të mira në ligën e parë të vendit.

Kjo iniciativë do të sjellë përfitime të mëdha për nxënësit dhe për shoqërinë në përgjithësi, duke promovuar shëndetin dhe mirëqenien fizike, duke inkurajuar talentet sportive të reja, dhe duke ndihmuar në zhvillimin e një kulture sportive në vendin tonë.

3.5.5. AKTIVIZËM QYTETAR

Ne, besojmë në fuqinë e qytetarëve të angazhuar dhe në ndikimin e tyre pozitiv në zhvillimin e komunitetit tonë. Aktivizmi qytetar është një mjet jetësor për të përshpejtuar përparimin dhe për të garantuar që ne të gjithë të jetojmë në një shoqëri më të mirë dhe më të drejtë.

Ne besojmë se qytetarët e angazhuar janë baza e një demokracie të fuqishme dhe të qëndrueshme. Ata nuk janë vetëm dëgjues, por janë pjesëmarrës aktivë në zgjidhjen e sfidave dhe në ndërtimin e zgjidhjeve. Duke mbështetur dhe inkurajuar aktivizmin qytetar, do të krijojmë një mjedis ku çdo qytetar ka mundësinë dhe guximin të japë kontributin e tyre për të mirën publike.

Ne promovojmë një kulturë të qytetarëve të përfshirë dhe të përgjegjshëm. Do të përkrahim iniciativat dhe projektet komunitare që synojnë të përmirësojnë cilësinë e jetës dhe të zgjidhin problemet e komuniteteve tona. Nëpërmjet bashkëpunimit dhe përkrahjes së njëri-tjetrit, mund të krijojmë ndryshime të mëdha dhe të qëndrueshme në shoqërinë tonë.

Prandaj, ne angazhohemi për të krijuar një mjedis ku qytetarët janë të informuar, të motivuar dhe të përfshirë në proceset vendimmarrëse. Kjo synon të:

- **Promovojë edukimin qytetar:** Edukimi qytetar është thelbësor për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në shoqëri. Shkollat, organizatat joqeveritare dhe mediat mund të luajnë një rol kyç në përmirësimin e ndërgjegjësimit publik dhe në promovimin e pjesëmarrjes aktive në jetën politike dhe shoqërore.
- **Krijojë Platforma të Hapura për Diskutim:** Platformat dhe forumet e hapura për diskutim dhe debate janë të rëndësishme për të inkurajuar shkëmbimin e ideve dhe për të lehtësuar bashkëpunimin mes qytetarëve. Këto platforma mund të organizohen në nivel lokal dhe kombëtar dhe të përfshijnë të gjithë qytetarët pa dallim.
- **Iniciativa dhe Projekte Lokale:** Mbështetja e iniciativave dhe projekteve lokale është një mënyrë efektive për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në zgjidhjen e çështjeve të komunitetit. Duke ofruar resurse dhe mbështetje për këto projekte, mund të stimulojmë qytetarët që të mund të ndikojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e jetës në zonat e tyre.
- **Media të paanshme dhe liria e shprehjes:** Informimi i drejtë i qytetarëve është vlerë e rëndësishme e demokracisë dhe ndikon në procesin e vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes. Liria e shprehjes garantohej si e drejtë themelore.

I. PROMOVIMI I EDUKIMIT QYTETAR

Edukimi qytetar është një hap thelbësor për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në shoqëri. Kjo përfshin një gamë të gjerë veprimesh dhe iniciativash që synojnë të nxisin ndërgjegjësimit publik dhe të promovojnë angazhimin e qytetarëve në jetën politike dhe shoqërore. Në mënyrë që të kryejmë këtë mision, ne duhet të shohim në detaje se si shkollat, organizatat joqeveritare dhe mediat mund të luajnë një rol kyç në këtë proces:

- **Shkollat:** Shkollat kanë një rëndësi të veçantë në edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve në lidhje me qytetarinë dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri. Programet shkollore mund të përfshijnë mësimdhënie mbi sistemin politik, të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, si dhe aktivitete praktike për të inkurajuar pjesëmarrjen në jetën shoqërore.

- **Organizatat Joqeveritare:** Organizatat joqeveritare kanë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e ndërgjegjësimit publik dhe mobilizimin e qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitete shoqërore dhe politike. Ato mund të organizojnë seminare, trajnime, dhe fushata informuese për të rritur vetëdijen e qytetarëve dhe për të promovuar angazhimin e tyre.
- **Mediat:** Mediat kanë një ndikim të madh në opinionin publik dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve. Përmes raportimeve të rregullta, analizave, dhe diskutimeve të hapura, mediat mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në nxitjen e qytetarëve për të marrë pjesë në debatet dhe proceset vendimmarrëse.

Në një kombinim të këtyre përpjekjeve të ndryshme, mund të arrijmë të ndërtojmë një shoqëri ku qytetarët janë të informuar, të motivuar dhe të përfshirë në proceset vendimmarrëse. Kjo do të çojë në një shoqëri më të drejtë, më të zhvilluar dhe më të përparuar për të gjithë.

ii. KRIJIMI I PLATFORMAVE TË HAPURA PËR DISKUTIM

Platformat dhe forumet e hapura për diskutime dhe debate janë të rëndësishme për ta inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën politike dhe shoqërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Platformat dhe forumet e hapura do të mundësojnë:

- **Inkuadrimin e qytetarëve:** Platformat e hapura për diskutime ofrojnë mjedis ku qytetarët mund të shkëmbejnë ide dhe mendime në mënyrë të lirë dhe të hapur. Duke u angazhuar në diskutime dhe debate të tilla, qytetarët do të bëhen pjesë e procesit të përbashkët, ku idetë dhe shqetësimet e ndryshme janë të vlerësuara dhe të diskutuara;
- **Favorizimin e bashkëpunimit:** Platformat e hapura për diskutim lehtësojnë bashkëpunimin dhe bashkëveprimin mes qytetarëve. Përmes diskutimeve të ndryshme dhe analizave të thelluara, qytetarët mund të gjejnë pikëpamje të përbashkëta, t'i identifikojnë sfidat e përbashkëta dhe të kërkojnë zgjidhje të përbashkëta për to;
- **Përfaqësimin e të gjithëve:** Aspekt kyç i këtyre platformave është që ato janë të hapura për të gjithë, pa dallim moshës, gjinisë, ose origjinës së tyre. Kjo, mundëson që qytetarët të dëgjohen dhe të jenë pjesë e procesit vendimmarrës, duke i bërë ato më të përfshirë dhe të përgjegjshëm për shoqërinë dhe vendin e tyre.

Për t'i arritur këto qëllime, platformat e hapura për diskutim do të organizohen në nivel lokal, si sesione të diskutimeve në komunitetet lokale dhe në nivel nacional, duke përfshirë qytetarët në debatet mbi çështje të rëndësishme nacionale. Kjo mund të bëhet nëpërmjet rrjeteve sociale, faqeve të internetit, ose organizimeve komunitare. Kjo përfshirje e gjerë dhe e hapur e qytetarëve në procesin e diskutimit dhe vendimmarrjes është themelore për një shoqëri të përfshirë dhe të drejtë për të gjithë.

iii. PËRKRAHJA E NISMAVE DHE PROJEKTEVE LOKALE

Ne angazhohemi të sigurojmë përkrahje të plotë për nismat dhe projektet që synojnë t'i adresojnë sfidat dhe t'i përmbushin nevojat e qytetarëve në nivel lokal. Këtu përfshihet:

- **Financimi dhe grantet:** Ofrimi i fondeve dhe granteve për projektet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve;
- **Trajnimet dhe këshillimi teknik:** Sigurimi i trajnimeve dhe këshillimit teknik për organizatorët e projekteve për përmirësimin e menaxhimit dhe efikasitetit të tyre;
- **Ndihma administrative dhe legislative:** Ndhmë në zbatimin e procedurave administrative dhe legislative për lehtësimin e realizimit të projekteve;
- **Promovimi dhe komunikimi:** Ndhma në promovimin dhe komunikimin e projekteve për nxitjen e pjesëmarrjes dhe përkrahjen e komunitetit;

Me këto masa, ne synojmë t'i inkurajojmë aktivitetet lokale dhe të krijojmë mjedis ku inovacioni dhe angazhimi lokal janë vlerësuar dhe përkrahur në mënyrë të qëndrueshme. Duke hapëruar bashkë me komunitetin tonë në rrugën drejt përparimit, ne shpresojmë të krijojmë një shoqëri më të fuqishme, më të përfshirë dhe më të zhvilluar për të gjithë qytetarët tanë.

iv. MEDIA TË PAANSHME DHE LIRIA E SHPREHJES

Liria e shprehjes do të mbrohet si vlere themelore e njeriut dhe normë demokratike. Gjithashtu do të ngriten institucione dhe rregullativa që mbrojnë nga lajmet e rreme (fake news) dhe ndihmojnë në rritjen e besueshmërisë së mediave. Avancimi i profesionalizmit në gazetari.

Do të promovohen politika dhe rregullativa në harmoni me praktikat e mira ndërkombëtare për rrjete sociale me qëllim të informimit të drejtë dhe ndikimit që kanë në shoqëri.

3.5.6. FAMILJA BËRTHAMA E SHOQËRISË

Familja është thelbi i shoqërisë së shëndoshë. Politikat familjare do të synojnë adresimin e fazave dhe sfidave kyçe në jetën familjare, nga kujdesi për fëmijët dhe edukimi deri te kujdesi dhe strehimi për të moshuarit. Duke u fokusuar në këto fusha, do të krijojmë një mjedis më mbështetës për familjet, duke rritur stabilitetin e tyre dhe duke kontribuar në shëndetin e përgjithshëm të shoqërisë.

Institucionalizim i politikave familjare. Politikat familjare do të insituionalizohen dhe të njëjtat do të jenë sistemore dhe jetike në zhvillimin e shoqërisë duke përcaktuar institucione përgjegjëse në nivel të shtetit. Këto janë prioritetet kryesore të politikave:

- **Kujdesi universal për fëmijët dhe arsimi i hershëm.** Investimi në shërbime universale, të përballueshme dhe me cilësi të lartë për kujdesin ndaj fëmijëve dhe edukimin e hershëm. Kjo jo vetëm që mbështet prindërit që punojnë, por gjithashtu kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në rezultatet e zhvillimit të fëmijëve, duke vendosur një bazë për mësimin dhe suksesin gjatë gjithë jetës.
- **Pushimi familjar me pagesë.** Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse të pushimit familjar me pagesë që mbulojnë një sërë nevojash familjare, duke përfshirë pushimin e lehonisë dhe atësisë, si dhe pushimin për përgjegjësitë e kujdesit familjar, si për shembull kujdesi për një të afërm të sëmurë ose një të porsalindur. Kjo politikë ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit punë-jetë dhe mbështet përfshirjen e prindërve gjatë fazave kritike të jetës familjare.
- **Aksesueshmëria në kujdesin shëndetësor.** Sigurimi që të gjithë anëtarët e familjes të kenë akses në shërbime shëndetësore të përballueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo përfshin kujdesin parandalues, shërbimet e shëndetit mendor, shërbimet e shëndetit riprodhues dhe kujdesin e specializuar për fëmijët dhe të moshuarit. Kujdesi shëndetësor i aksesueshëm është thelbësor për mirëqenien e familjes dhe shëndetin e shoqërisë.
- **Iniciativat për strehim të përballueshëm.** Zhvillimi i politikave që e bëjnë strehimin më të përballueshëm dhe më miqësor ndaj familjes. Kjo mund të përfshijë mbështetjen e ndërtimit të njësive të banimit të përballueshëm, ofrimin e subvencioneve ose bonove për familjet me të ardhura të ulëta dhe zhvillimin e lagjeve që janë të sigurta dhe kanë akses në shërbimet thelbësore si shkollat dhe parqet.
- **Mbështetje për kujdesin ndaj të moshuarve.** Krijimi i politikave që ofrojnë mbështetje për familjet që kujdesen për anëtarët e moshuar. Kjo mund të përfshijë mbështetje financiare, të tilla si lehtësime tatimore ose subvencione për shërbimet e kujdesit në shtëpi, dhe zhvillimin e programeve të bazuara në komunitet që ofrojnë ndihmë të përditshme dhe angazhim social për të moshuarit.

3.5.7. DEMOGRAFIA, DIASPORA DHE MIGRACIONI

Në kontekstin e rritjes së migracionit nga Republika e Maqedonisë së Veriut, nevoja për ta përmirësuar bashkëpunimin me diasporën është e rëndësishme për adresimin e sfidave dhe për përfitimin nga potencialet e zhvillimit që mund të ofrojë bashkëpunimi mes vendit dhe diasporës. Struktura e migrimit po ndryshon, duke bërë që ky bashkëpunim të jetë më thelbësor dhe në përputhje me nevojat e aktuale. Aktualisht, ne kemi bërë të qartë se një nga prioritetet kryesore është përgatitja dhe miratimi i masave dhe politikave me diasporën për një periudhë katërvjeçare. Me implementimin e masave të parapara në programin tonë do të bëhet përpjekje nga vendi, për ta organizuar dhe koordinuar më mirë veprimtarinë e diasporës, duke shfrytëzuar potencialet e tyre në rritje për zhvillimin e vendit.

Implementimi i masave konkrete na shpion drejt vizionit tonë që të krijojmë bashkëpunim të gjerë dhe efektiv me diasporën e Republikës së Maqedonisë së Veriut nëpërmjet rrjetit të fuqishëm të lidhjeve dhe besimit reciprok. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin socio-ekonomik dhe kulturor të vendit tonë, duke shfrytëzuar potencialin njerëzor dhe material të diasporës dhe vlerat e saj kombëtare. Misioni ynë është ta përmirësojmë angazhimin tonë ndaj diasporës, nëpërmjet krijimit të kornizës institucionale dhe politikës së qëndrueshme dhe

koherente. Kemi synimin që të sigurojmë të drejta të garantuara për të gjithë përfaqësuesit e diasporës, duke ofruar informacione dhe mundësi për kontribut në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit tonë, duke përmirësuar të ardhmen tonë të përbashkët.

i. DEMOGRAFIA

Në vitet e fundit, Maqedonia e Veriut ka përjetuar rritje të shkallës së emigracionit, me një ndryshim të qartë në strukturën demografike të emigrantëve. Përveç rritjes së numrit të emigrantëve është vërejtur rritje e theksuar e pjesëmarrjes së femrave në këtë kontingjent. Përqindja e femrave në totalin e emigrantëve është shtuar nga 45.6% në 47.9% gjatë periudhës së fundit. Gjithashtu, struktura e moshës së emigrantëve ka ndryshuar. Rritja e numrit të fëmijëve dhe të rinjve ka qenë e dukshme, me përqindje prej 18.4% për fëmijët dhe 23.4% për të rinjtë. Në të njëjtën kohë, numri i qytetarëve të moshuar që largohen është rritur, duke sjellë përqendrim të veçantë në grupmoshën mesatare të popullsisë emigrante.

Për ta përballuar këtë realitet demografik të ndryshuar dhe për t'i adresuar sfidat afatgjata, do të ndërmarim masa si:

- **Nxitja e rikthimit të Diasporës:** Duhet të zhvillojmë politika dhe programe për ta nxitur rikthimin e emigrantëve, duke ofruar mundësi të punësimit dhe zhvillimit të karrierës së tyre në vend;
- **Investimi në edukimin dhe zhvillimin ekonomik:** Ngritja e nivelit të arsimit dhe krijimi i mundësive të punësimit në vend do të ndihmojë në uljen e emigracionit të rinjtë dhe përmirësimin e strukturës së moshës së popullsisë;
- **Politika demografike afatgjate:** Maqedonia e Veriut duhet të zhvillojë politika dhe strategji afatgjata për menaxhimin e ndryshimeve demografike, duke përfshirë përkrahjen e familjeve dhe promovimin e lindshmërisë;
- **Përmirësimi i kushteve për të moshuarit:** Qeveria duhet të investojë në shërbime dhe programe për të moshuarit, duke përfshirë kujdesin shëndetësor dhe përkrahjen sociale për ata që kthehen nga emigracioni.

Këto masa, nëse zbatohen me efikasitet, do të ndihmojnë në menaxhimin e ndryshimeve demografike dhe në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme socio-ekonomike të vendit.

ii. MIGRACIONI

Gjendja aktuale e migracionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e ndërlikuar dhe përfshin faktorë "makro", "meso" dhe "mikro" që ndikojnë në vendimet e individëve për t'u shpërngulur brenda dhe jashtë vendit. Situatat politike, demografike, socio-ekonomike dhe mjedisore janë faktorët kryesorë që influencojnë migracionin, duke përfshirë atë ndërkombëtar dhe brenda vendit, si dhe migracionin ligjor dhe të paligjshëm.

Për adresimin e këtij realiteti kompleks të migracionit, nevojiten masat e mëposhtme:

- **Përmirësimi i koordinimit institucional:** Veprimtaria e ministrive, agjencive dhe institucioneve të tjera shtetërore në fushën e migracionit duhet të koordinohet më mirë për të siguruar qasje të përbashkët dhe efektive ndaj sfidave të migracionit;
 - **Stabilizimi i situatës politike dhe socio-ekonomike.** Është e rëndësishme të krijohet një ambient të qetë dhe të sigurtë politik dhe socio-ekonomik, që të ndihmojë në zvogëlimin e shkaqeve të migracionit të paligjshëm dhe në përmirësimin e stabilitetit të vendit;
 - **Promovimi i edukimit dhe punësimit lokal:** Investimet në arsim dhe zhvillimin e mundësive të punës në vend janë thelbësore për ta zvogëluar nevojën për migracion të paligjshëm dhe për të krijuar mundësi për rininë;
 - **Përfshirja e Diasporës:** Përqendrim i veçantë duhet t'i kushtohet përfshirjes së diasporës në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimin e politikave migratore;
 - **Integrimi i ligjit me standarde ndërkombëtare:** Është e rëndësishme të hartohet dhe të zbatohet legjislacioni që përputhet me standardet ndërkombëtare për ta adresuar migracionin, duke përfshirë luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm;
 - **Ngritja e nivelit të përgatitjes dhe informimit:** Do të ndërmarrim masa për rritjen e nivelit të informacionit dhe përgatitjes së qytetarëve në lidhje me rreziqet dhe avantazhet e migracionit, duke përfshirë programet e këshillimit, si dhe ndërgjegjësimin publik;
- Me implementimin e këtyre masave në mënyrë efektive dhe koordinuese, do të ndihmohet në menaxhimin e migracionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme socio-ekonomike të vendit.

iii. DIASPORA

Nevoja për ta përmirësuar lidhjen me diasporën është theksuar edhe më shumë për shkak të transformimeve të mëdha në kontingjentin e emigrantëve dhe mundësive të tyre për të kontribuar në zhvillimin e vendit. Duhet që kontribojmë në përmirësimin e marrëdhënieve me këtë komunitet, pasi që bashkëpunimi është mjet i fuqishëm për t'i shfrytëzuar potencialet dhe përvojat e diasporës. Në këtë kontekst, krijimi i platformave dhe nismave për ta inkurajuar lidhjen e përhershme me diasporën, duhet të bëhen pjesë të strategjisë së përgjithshme të shtetit. Kjo përfshin organizimin e ngjarjeve kulturore, hapjen e kanaleve të vazhdueshme të komunikimit me komunitetin e diasporës, si dhe ofrimin e mundësive për investimet dhe kontributet e tyre në projekte zhvillimore.

Qëllimi jonë shpie drejt krijimit të bazës juridike dhe institucionale që do të ndihmojë në zhvillimin e kornizës së qëndrueshme dhe gjithpërfshirëse për bashkëpunim midis institucioneve shtetërore dhe diasporës. Ky bashkëpunim do të bazohet në besim, nisma dhe përfitime të përbashkëta. Qëllimi është të përmirësohet pozita e diasporës në vendet e banimit dhe të lehtësohen opsionet produktive të rikthimit nga diaspora. Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet realizimit të katër qëllimeve strategjike të përcaktuara:

- **Fuqizimi i lidhjes politike dhe sociale të diasporës: Krijimi i besimit dhe bashkëpunimit efektiv me shtetin:** Avancimi i kornizës rregullatore dhe kapaciteteve institucionale për diasporën është një hap kryesor drejt përfshirjes më të madhe

politike dhe realizimit të të drejtave civile dhe sociale. Me këtë përpjekje synojmë ta krijojmë besimin dhe të vendosim bashkëpunim efektiv me shtetin për përforcimin e marrëdhënieve dhe identitetin kulturor të diasporës;

- **Rritja e bashkëpunimit ekonomik: Partneriteti dhe mundësitë e barabarta për shtetin dhe diasporën:** Synojmë për krijimin e marrëdhënieve të përforuara ekonomike mes diasporës dhe shtetit, duke u bazuar në modelin e bashkëpunimit të barabartë dhe përfitimit reciprok. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi synohet të inkurajohet shkëmbimi i dijeve, përvojave dhe burimeve njerëzore për të përfituar të dyja palët;
- **Zgjerimi i bashkëpunimit me Diasporën në fushën e arsimit, shkencës dhe të rinjtë:** Do të përfshihet shkëmbimi i dijeve, zhvillimi i programeve të arsimit dhe inkurajimi i bashkëpunimit në projekte shkencore dhe inovacion. Përmes këtij bashkëpunimi synohet të inkurajohet shkëmbimi i dijeve, përvojave dhe burimeve njerëzore për të përfituar të dyja palët.
- **Fuqizimi i lidhjeve kulturore me Diasporën: Nxitja e identitetit kulturor dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore:** Përmes kësaj mase synojmë nxitjen e ndjenjës së identitetit kulturor në Diasporë, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore për të siguruar që ajo të ruhet dhe të përhapet nëpër brezat. Kjo përfshin krijimin e nismave që promovojnë kulturën, gjuhën, traditat dhe vlerat e vendit të origjinës në mes të Diasporës, si dhe bashkëpunimin për mbrojtjen dhe promovimin e monumenteve historike, traditave dhe praktikave kulturore në mes të Diasporës dhe shtetit të tyre të origjinës.



PROJEKTE

Projekte dhe iniciativa të reja dhe ata që janë në vijim. Këto kanë dalur si kërkesa nga takimet me qytetarë, komunitetin e biznesit dhe grupe të ndryshme interesi si tentative dhe të njëjtat do të meren në konsideratë në qeverisjen 2024-2028.

Gjatë qeverisjes sipas mundësisë do të përfshihen edhe projekte dhe iniciativa tjera që nuk janë në listën e kërkesave në këtë shtojcë të programit, si dhe komunat dhe sektorët që nuk janë të përfshira për arsye objektive dhe teknike në konsolidimin e programit zgjedhor EUROPA 2030.



PROJEKTE SIPAS KOMUNAVE

Saraj

- Realizimi i rrugës kryesore – Llaskarcë (asfaltimi dhe kanalizimi atmosferik);
- Realizimi i rrugës rajonale Kondovë-Radushë-Jegunovcë;
- Projektimi dhe realizimi i rrugës rajonale Saraj – Bojanë 12km;
- Rruga Bojanë - te varrezat (2.4km) – Kopanicë (1.5+0.92km) – Rashçe deri te hekurudha (3.6km) - gjithsej 8.4km;
- Realizimi i rrugës nr.2 Saraj - deri te rruga për në Rashçe 2.8km;
- Realizimi i rrugës kryesore Matkë e Epërme 5km;
- Realizimi i rrugës – Llokë – Krushopek (që lidhet me vendbanimin Nerez) 2km;
- Përfundimi i fazës së fundit Gërçec – Gërçec i Epërm 1.1km;
- Rregullimi i shtratit të lumit të thatë dhe kolektori për grumbullimin e ujërave të zeza nga vendbanimin Bojanë deri në Gllumovë;
- Vendosja e sistemit të ujitjes në vendbanimin Bojanë, Kopanicë (400-500 hektarë tokë bujqësore);
- Rregullimi i shtratit të lumit nga vendbanimi Svillare e Epërme – Svillare e Poshtme (REKA) 2.5km;
- Realizimi i stacioneve filtruese – zgjerimi i kapacitetit në vendbanimin Gllumovë– Bukoviq – Semenishtë– Krushopek– Rashçe– Kondovë;
- Rrjeti i kanalizimit – Matkë – 10km;
- Rrjeti i kanalizimit – Çajlanë – Semenishtë 7km;
- Ujësjiellësi – Radushë – Çajlanë – Semenishtë;
- Ndërtimi i objektit të shkollës në vendbanimin Lubin: 720m²;
- Realizimi i sallave sportive në në Rashçe, Bukoviq dhe Krushopek;
- Ndërtimi i çerdheve të fëmijëve në vendbanimet: Svillare e Poshtme, Shishovë-Gllumovë, Bukoviq
- Fushë futbollit (Rikonstruimi i terrenit në vendbanimin Lubin dhe Svillare);
- Ndërtimi i sallës sportive në Lubin;
- Hapja e shtëpisë së kulturës;
- Hapja e bibliotekës leximore.

Çair

- Ndërtim i pishinës në Çair e financuar nga Qeveria
- Renovim të të gjitha shkollave fillore
- Ndërtim të sallës së djegur të Partizanit
- Ndërtim i kompleksit sportiv dhe kulturor në stadium e FC Shkupi
- Ndërtim i garazhave në kate
- Përfundim i rrjeteve të ujësjiellësit dhe kanalizimit si dhe asfaltimet e rrugëve në Dizhon, Seravë, Gazi Babë.
- Zgjerim i Bulevardit Cvetan Dimov
- Ndërtim i Bulevardit Hasan Prishtina
- Mobilim i çerdhes më të madhe në shtet të ndërtuar në Çair
- Rregullim i të gjitha parqeve në Çair
- Përfundim i Kampusit të Universitetit Nënë Tereza
- Kulme fotovoltaike në shkollat dhe çerdhet e Cairit

Karposh

- Ndërtimi dhe adaptimi i çerdhes së fëmijëve për banorët e kësaj lagjeje me përkatësi të nacionalitetit shqiptar;
- Rregullimi/asfaltimi i rrugëve/rrugicave në lagjen Nerez, veçanërisht me fokus në pjesën e Nerezit të Mesëm që i përkasin territorit Karposh-Nerez;
- Ndërtimi i hapësirës së përshtatshme për aktivitete sportive dhe rekreacion për fëmijët e kësaj zone.

Petrovec

- Ndërtimi i sallës sportive në Konjari i poshtëm
- Hapja e Qendrës Kulturore Boshnjake në Shkup

Shuto Orizare

- Ndërtimi i qendrës së parë kulturore të romëve;
- Ndërtimi teatrit të parë të romëve;
- Ndërtimi i stadiumit në komunën e Shuto Orizarit.

Haraçinë

- Rikonstruimi, asfaltimi dhe kanalizimi atmosferik i rrugës 14 në vendbanimin Haraçinë;
- Ndërtimi i rrjetit sekondarë të kanalizimit fekal - segmenti në kolektorin ekzistues 1 në vendbanimin Haraçinë;
- Projekti bazë i kanalizimit fekal për rrjetin sekondar në vendbanimin Haraçinë kol. 2, 3, 4, 4b, 4v, 4g, 5 dhe 7;
- Projekti bazë i kanalizimit atmosferik në vendbanimin Haraçinë rr.1 dhe 12;
- Projekti bazë i kanalizimit fekal për fshatin Mojancë e Epërme;
- Projekti bazë i kanalizimit fekal për fshatin Mojancë e Poshtme kol. 1,5 dhe 3a;
- Projekti bazë i kanalizimit fekal për fshatin Mojancë e Poshtme kol.3 dhe 6;
- Projekti bazë i kanalizimit fekal për fshatin Orllancë;
- Projekti bazë i ujësjellësit për fshatin Orllancë;
- Projekti për asfaltimin e një pjesë të Rrugës 10 në Vendbanimin Haraçinë;
- Projekti bazë i kanalizimit fekal për vendbanimin Grushinë.

Studenica

- Ndërtimi i rrugës që lidhë Studenicanin me Petrovecin në gjatësi prej 5 km dhe urë mbi Lumin Vardar
- Ndërtimi i ujësjellësit për furnizim me ujë të disa vendbanimeve
- Rikonstruimi i rrugës që lidhë fshatrat Pagarushë, Vërtekicë dhe Gaber,
- Ndërtimi i rrugës për në Kitkë
- Ndërtimi i shtratit të lumit në f. Studenica.
- Ndërtimi i ujësjellësit në f. Draçevicë
- Ndërtimi i 4 klasave në shkollën e Koliçanit të poshtëm.

Kumanovë

- Përfundimi i punimeve të shtratit të lumit Kumanovka, gjegjësisht prej te parku i qytetit deri ne lagjen Sroderek;
- Çerdhe fëmijësh në “Lagjen e Trimave”;
- Rinovimi i i objektit të Shkollës Fillore “Bajram Shabani”;
- Zgjerimi i kapacitetit të shkollës “Naim Frasheri” ose lirimi i hapësirave nga pjesa e shkollës “Vuk Karaxhic”;
- Ndërtimi ujësjellësit dhe kanalizimit ne fshatin Rramanli;
- Rikonstruimi i rrugës industriale qe lidh lagjen Bedinje me Çerkezin.

Likovë

- Ujësjellësi dhe rezervoari në fsh. Ropalcë
- Ujësjellësi dhe rezervoari në fsh. Opajë
- Stadiumi i K.F. „Besa,, , f. Sllupçan
- Kopsht për fëmijë në mes fhsatrave: Vaksincë dhe Llojan
- Ndërtimi i sallës së sportit në SHFK „Rilindja,, , Llojan
- Vazhdimi i asfaltimit të rrugës për në fshatin Goshincë
- Ndërtimi i objektit shtesë në SHFK „7 Marsi,, , në fsh. Opajë
- Rekonstruimi dhe rregullimi i oborit - parterit të SHFK „Anton Zako Çajupi,, , f. Hotël
- Rekonstruimi dhe mbindërtimi i shkollës periferike „Dituria,, , fsh. Goshincë
- Rekonstruimi dhe mbindërtimi i shkollës periferike „Kultura,, , fsh. Vishticë
- Rregullimi i oborrit-parterit në SHFK „5 Tetori,, , në fsh. Nikushtak
- Ndërtimi i terrenit të hapur sportiv në Shkollën periferike „5 Tetori,, , në fsh. Ropalcë
- Ndërtimi i sallës sportive në SHFK „5 Tetori,, , fsh. Nikushtak
- Ndërtimi i shtartit të lumit në fsh. Orizare
- Hapje e bibliotekës komunale në Komunën e Likovës
- Vazhdimi i ndërtimit të shtretërve të lumenjve në fshatrat: Likovë, Sllupçan, Hotël dhe Mateç
- Rekonstruimi i rrugës lokale fsh. Orizare - fsh. Sllupçan - fsh. Vaksincë - fsh. Llojan
- Asfaltimi i rrugës fsh. Mateç - fsh. Llopat
- Asfaltimi i rrugës Hekurudhë Reçicë (fsh. Vaksincë) - Autostradë
- Asfaltimi i rrugës fsh. Ropalcë - fsh. Novo Sellë
- Asfaltimi i rrugës fsh. Mateç deri Manastir
- Asfaltimi i rrugës fsh. Nikushtak - fsh. Grushinë
- Rregullimi i rrugës fsh. Bellanoc - fsh. Strzhë

Çashkë

- Ndërtimi i rrugës Jabollçishtë e Epërme-Shkup;
- Rikonstruimi i rrugës f. Lisiçe - f. Drenovë;
- Rikonstruimi i rrugës f. Drenovë - f. Jabollçishtë e Epërme;
- Ndërtimi i rrugës f. Jabollçishtë e Epërme - f. Nezhillovë;
- Çerdhe për fëmijët në f. Jabollçishtë e Epërme;
- Vendosja e shtëpisë së shëndetit në f. Jabollçishtë të Epërme;
- Vendosja e stacionit policor në f. Jabollçishtë të Epërme;
- Të vendoset në funksion punkti për vaksinim në f. Jabollçishtë të Poshtme;
- Ndërtimi i sallës sportive në f. Mellnicë.

Veles

- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Orizare e Epërme
- Vendosja e sinjalizimit të trafikut para hyrjes në fshatin Orizare e epërme – vendosja e rampës përballë hekurudhës
- Infrastruktura rrugore për qytetarët e komunës së Dollnenit në rrugët që çojnë në tokat ku kultivohet duhan dhe kultura të tjera bujqësore.
- Sigurimi i ujit të pijshëm për qytetarët e Konjarit të mesëm dhe Çiflikut
- Ndërtimi i një fushe futbollit në fshatin Orizar i Epërm

Dollnen

- Pastrimi me hapjen e kanalit kullues ndërmjet vendbanimeve Zhitoshe dhe Lazhani në gjatësi prej 2 kilometrave, i cili do të shpëtojë nga përmbytjet rreth 250 hektarë tokë bujqësore të punueshme;
- Pastrimi dhe hapja e kanaleve në pjesë të caktuara të kanalit kullues "Blato";
- Pastrimi dhe hapja e kanalit kullues ndërmjet vendbanimeve Peshtalevë dhe Sekircinë në gjatësi prej 3 kilometrave;
- Ndërtimi i akumulimit artificial në afërsi të vendbanimit Debreshtë;
- Ndërtimi i mikroakumulimit në afërsi të vendbanimit Cërnilishtë;
- Rehabilitimi i mikroakumulimit ekzistues në vendbanimin Desovë.

Plasnicë

- Rruga kryesore për në mes të fshatit;
- Ujërat e zeza fekale në një gjatësi prej 2 km;
- Rrugët tjera më të vogla në Plasnicë,
- Në stacionin e pastrimit të Preglovës;
- Në Preglo, shtrimi i rrugëve më të vogla me bekaton;
- Në stacionin e pastrimit të Lisiçanit;
- Kanalizim fekal në Lisiçan prej 4 km;
- Përfundimi i disa rrugëve më të vogla në fshatin Lisiçan;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve në komunën e Plasnicës,
- Rregullimi i këndit të lojërave për fëmijë në komunën e Plasnicës.

Kërçovë

- Përfundimi i Projektit Ura e Qytetit në lagjen Çiflig, financuar nga BERZH dhe Komuna e Kërçovës.
- Përfundimi i banesave sociale, financuar nga Bashkimi Evropian në bashkëpunim me Komunën e Kërçovës.
- Përfundimi i Shkollës fillore "Milto Gurra" në f. Cërvicë, financuar nga Qeveria dhe Komuna e Kërçovës.
- Ndërtimi i objektit të Komunës së Kërçovës.
- Ndërtimi i Kanalizimit në fshatin Tuhin, financuar nga Banka Evropiane Investuese me Qeverinë dhe konfinacim nga Komuna e Kërçovës.
- Rruga Uzhiçka dhe Boris Kidric.
- Përgatitja e projektit të Stacionarit për qentë endacakë (trajtimi i vazhdueshëm nga ana e komunës).
- Fillimi i rrugës regjionale që lidh qytetin me fshatrat e rretheve, financuar nga qeveria dhe Byroja për zhvillim rajonal në Komunën e Kërçovës.

- Ndërtimi i Qendrës së Qytetit, financuar nga Qeveria.
- Ndërtimi i impiantit për mbledhje të deponisë dhe mbeturinave, financuar nga qeveria.
- Ndërtimi i fazës së dytë të kanalizimit që do të përfshi të gjithë territorin e Kërçovës, financuar nga BE, IPA-II, Qeveria e RMV dhe Komuna e Kërçovës.

Strugë

- Mënjanimi i tubacionit të azbestë të ujësjellësit dhe zëvendësimi me tubacion ekologjik
- Ndërtimi i sistemit të kolektorit për pjesën Kalishtë-Radozhdë
- Vendosja e sistemeve fotovoltaike
- Ndërtimi i bulevardit Kolektorit Lindor, faza 1 midis rrugës rajonale dhe rrugës turistike
- Ndërtimi i rrugës turistike, faza 2 prej te lumi Sateskë deri në qytet të Strugës
- Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit Borovedcë-Labunishtë
- Ndërtimi i stacionit të pastrimit në Labunishtë
- Rikonstruksioni i rrugëve në pjesë rurale dhe urbane dhe vende me nevoja të posaçme
- Ndërtimi i çerdheve të fëmijëve
- Rikonstruksioni i Entit të Nefrologjisë (Dializa)
- Rikonstruksioni dhe sanacioni i Spitalit të Qytetit, faza 2
- Ndërtimi i sistemit sekondar të kanalizimit në qytet dhe fshatra
- Sanacioni i deponisë së qytetit
- Sjellja e Planit Gjeneral Urbanistik, Planeve Detale Urbanistike dhe Planeve Urbane për Fshatrat
- Smart City (qyteti i mençur)
- Ndryçimi publik (mirëmbajtja dhe pagesat vjetore)
- Ndërtimi i infrastrukturës (super dhe supra strukturës) për Zonat Industriale dhe për Zonat Ekonomike
- Rikonstruksioni i qendrës së qytetit dhe bulevardeve me ndriçim
- Rregullimi i brigjeve të lumit Drini i Zi, në gjatësi prej 1.000 metrave
- Rikonstruksioni dhe suvatimi i fasadave të objekteve me arkitekturë të vjetër të mbrojtura me ligj
- Rikonstruksioni i objekteve fetare (xhami, kisha dhe hamami)
- Ndërtimi i terreneve multifunkionale sportive

Dibër

- Ndërtimi i parkingut të qytetit
- Rregullim i shtratit të rrjedhave të ujërave të përonjëve në lokalitetet Trapi i Dacit - Sitnice dhe Tabakane - Busheve
- Rikonstruksioni dhe ndërtimi i rrugëve: Ndërtimi i qarkores së qytetit (lidhja me Rrugën e Arbërti), Petre Popovski, Zdravko Cockovski, Venec 1 dhe Venec 2, Rrugë lokale në f. Spas, Rrugë lokale në f. Bohmovë, Rrugë lokale në f. Solokiç
- Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrjetit të sistemit të kanalizimeve fekale dhe atmosferik, ndrim i kolektoreve me qendër për trajtimin të ujërave të zeza për qytetin e Dibrës,
- Ujësjellsi I qytetit faza II, qendra për klorim dhe ujëmatës
- Ndërtimi i qendrës për të rinjtë.

Gostivar

- Ndërtimi i sheshit të qytetit në Komunën e Gostivarit;
- Qarkore dhe dy hyrje në dalje të qytetit;
- Rehabilitimi i tërësishëm i rrugës Beliçica;

- Hapja dhe asfaltimi i rrugës lokale f.Padalisht – f.Qafë;
- Përpilimi i planeve të detajuara urbanistike për ato fshatrat që nuk kanë;
- Ndërtimi i urës së katërt mbi lumin Vardar dhe rrugët lidhëse.
- 6 objekte kolektive - stacioni i trenit;
- 10 objekte kolektive - Kej Vardar;
- 2 objekte kolektive pas NP Komunalec;
- 17 objekte kolektive – në lagjen Maleardi;
- Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike, bllok 21 prej kolektorit verior;
- Sanimi dhe rregullimi i Deponisë Rusino;
- Themelimi i muzeut të qytetit (adaptimi i objektit aktual të zjarrfikësve);
- Themelimi i kinemasë së qytetit (në suaza të IN Qendra për Kulturë Gostivar);
- Themelimi i orkestrës muzikore të qytetit;
- Përkrahje për ndërtimin e pallatit të kulturës në Çegran;
- Ndërtimi i dy terreneve multifunksionale sportive;
- Ndërtimi i terreneve për tenis;
- Qendra për patinazh që do të jetë funksionale për gjithë sezonit dimëror;
- Rregulimi dhe asfaltimi i rrugës që lidh fshatrat prej në f. Bellovishtë deri në f.Forinë;
- Rregullimi i rrugës së vjetër prej f. Bellovishtë për në f. Llakavicë – depërtimi dhe tamponimi;
- Rregullimi i rrugës së f. Padalishtë – në vendin ku ndërtohet hidrocentrali.

Vrapçisht

- Ndërtimi i poliklinikës në Komunën e Vrapçishtit;
- Ndërtimi i stacionit për filtrimin e ujërave fekale për Komunën e Vrapçishtit;
- Rikonstruimi i rrugës lokale Negotinë - Kalishtë (4km);
- Rikonstruimi i rrugës lokale Doberdoll - Autostrade (5km);
- Rikonstruimi i rrugës lokale Senokos - Gjurgjevishtë (6km);
- Ndërtimi i qendrës multifunksionale sportive të hapur – Gradec;
- Rikonstruimi i rrjetit kryesor të ujësjellësit – Vrapçisht;
- Sanimi i rrjetit sekondar të ujësjellësit – Gradec;
- Rikonstruimi i rrugës lokale Negotinë - Llomnicë (12km);
- Ndërtimi i stacionit filtrues të ujërave të zeza për Komunën e Vrapçishtit.

Tetovë

- Klinikë universitare si qendër rajonale mjekësore ku do të përfshihej shëndetësia sekondare dhe ajo terciare.
- Ndërtimi i një inceneratori rajonal për përpunimin e mbeturinave.
- Rindërtim i Stadiumit të qytetit.
- Zhvillim Kodrës së Diellit si qendër turistike dhe modernizimi i teleferikut nga Tetova në Kodrën e Diellit
- Ndërtimi i një qendre strehimore për Kafshët endacake.
- Përpilimi dhe Miratimi i Planit Gjeneral Urbanistik gjithashtu do të lehtësonte punën e udhëheqësisë Komunale.

Tearcë

- Mini zonë ekonomike në kryqëzimin e hekurudhës dhe rrugës regjionale ne vendbanimin fsh Leshkë
- Park të enegjisë së rinovuar me diell dhe erë në vendbanimet Nerashtë, Dobroshtë, Gllogjë, Përshevcë, Tearcë, etj)

- Finalizim të infrastrukturës dhe integrimi i sistemit të ujit të pijshëm, ujërave të zeza dhe atmosferike për të gjitha vendbanimet
- Ngritja dhe rikonstruksimi i kapaciteteve të reja të objekteve shkollore, sportive dhe terreneve multifunksionale
- Zhvillimi i një platforme të ngritjes së kapaciteteve të agroturizmit dhe zhvillimit të vendbanimeve malore (për katër vendbanimet e komunës)

Zhelinë

Zhelinë:

- Bulevardi kryesor nga Ura e gurit deri në qendër dhe nga qendra deri te trafoja;
- Rregullimi i infrastrukturës së zonës industriale;
- Rregullimi i shtratit të Lumit Vardar.

Pallaticë:

- Rikonstruimi i rrugës Zhelinë-Pallaticë-Uzurmishtë (asfaltim dhe trotuar anësor së bashku me kandelabra);
- Ndërtimi i rrugës së re në Pallaticë dhe lidhja rrugore Trebosh-Tetovë (Rruga e Masllarëve);
- Përfundimi i kanalizimit në të gjithë fshatin;
- Rregullimi i shtratit të lumit që kalon përmes fshatit;
- Ndërtimi i sallës sportive me sistem të mbyllur;
- Ndërtimi i rrjetit sekondar të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim.

Trebosh:

- Rikonstruimi i 2 rrugëve në f. Trebosh të cilat janë paraparë edhe në programin vjetor të Komunës së Zhelinës;
- Rikonstruimi i Shkollës Filllore “Fan Noli”, f. Trebosh;
- Ndërtimi i sallës sportive në f. Trebosh;
- Ndërtimi i rrjetit sekondar të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim;
- Rregullimi i shtratit të lumit që kalon përmes fshatit.

Strimnicë:

- Rruga Strimnicë-Falish pjesa e mbetur;
- Rruga Strimnicë-Saraqinë dhe lidhja me rrugën rajonale Shkup-Tetovë;
- Ndërtimi i urës së re me standard bashkëkohor për zhvillim më të mirë;
- Ndërtimi i bazenit të ri dhe rikonstruimi i bazenit aktual.

Uzurmishtë:

- Rregullimi i fushës sportive dhe rregullimi parter i saj;
- Përfundimi i rrjetit të kanalizimit në tërë vendbanimin;
- Ndërtimi i rrjetit sekondar të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim.

Leshnicë e Poshtme:

- Rikonstruimi i rrugës aktuale dhe zgjerimi i saj;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim;
- Ndërtimi i kanalizimit në të gjithë fshatin;
- Rregullimi i shtratit të lumit që kalon përmes fshatit.

Leshnicë e Epërme:

- Rikonstruimi i rrugës aktuale dhe zgjerimi i saj;
- Ndërtimi i rrugës së shkollës.

Debërcë:

- Rikonstruimi i tërësishëm i shkollës “Pashko Vasa” duke përfshirë rikonstruimin e brendshëm dhe të jashtëm;
- Rregullimi parter i oborrit të shkollës dhe fushës sportive;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në tërë vendbanimin;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;

- Largimi i deponisë në hyrje të fshatit;
- Largimi i deponisë së egër në vendin e quajtur “Krasta”.

Grupçin:

- Rikonstruimi i rrugës prej te Xhamia deri te pompa e benzinës dhe zgjerimi i saj;
- Rikonstruimi i rrugës prej te Kafja e Elezit deri te Ura e Debërcës;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit (rikonstruimi aktual i tij dhe zgjerimi);
- Rikonstruimi i shkollës duke përfshirë rikonstruimin e brendshëm (ndërrimi i karrigeve dhe bankave, lyerja);
- Ndërtimi i sallës sportive me sistem të mbyllur;
- Dhënia e prioritetit të veçantë ndaj zonës zhvillimore.

Kapazhdoll:

- Fusha sportive te shkolla dhe rregullimi i parkingut;
- Rikonstruimi i rrugës brenda fshatit;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në tërë vendbanimin;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
- Rregullimi i shtratit të lumit që kalon përmes fshatit.

Çiflik:

- Rregullimi i shtratit të lumit që kalon përmes fshatit së bashku me ujërat e zeza;
- Ndërtimi i sallës sportive me sistem të mbyllur në Shkollën Qendrore “Rametulla Ameti”.

LLërcë:

- Ndërtimi i sallës sportive;
- Rikonstruimi i rrugëve brenda fshatit.

Cerovë:

- Ndërtimi i kanalizimit në të gjithë fshatin;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim;
- Ndërtimi i rrugës së re Zhelinë-Cerovë te Kazerma.

Rogle:

- Rregullimi i fushës sportive në kuadër të shkollës;
- Ndërtimi i kanalizimit në të gjithë fshatin;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim;
- Ndërtimi i rrugës së quajtur “Rruga e UÇK-së”.

Novo Sellë:

- Rregullimi i fushës sportive në kuadër të shkollës;
- Ndërtimi i kanalizimit në të gjithë fshatin;
- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim;
- Asfaltimi i rrugës Novosellë-Rogle;
- Asfaltimi i rrugës Novosellë (Rruga e Merovës).

Merovë:

- Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrjetit të ujësjellësit dhe lëshimi i tij në përdorim;
- Nxemje qendrore në shkollën e fshatit;
- Vendosja në përdorim e Ambulancës së fshatit.

Sallarevë:

- Rikonstruimi i rrugës aktuale dhe zgjerimi i saj;
- Afirmimi i fshatit për zhvillim të turizmit malor;
- Rikonstruimi i rrugës lokale Sallarevë-Gurguricë dhe zgjerimi i saj.

Për realizimin e proektit të ujësjellësit për të gjitha vendbanimet e pjesës së Dërvenit duhet të ndërtohet REZERVUAR me kapacitet të madh për 8 vendbanime.

Jegunovcë

Shemshovë:

- Ndërtimi i rrugës që lidh fshatin Shemshovë me fshatin Tearcë;
- Rinovimi i tërësishëm i projektit të shkollës fillore të fshatit;
- Rregullimi i rrugës në fshat.

Jazhincë:

- Rregullimi i rrugës kryesore të fshatit nga rruga rajonale Tetovë-Jazhincë deri në qendrën e fshatit;
- Rinovimi i tërësishëm i objektit të shkollës fillore, si dhe rregullimi i rrethojave të oborrit të shkollës;
- Ndërtimi i sallës sportive për nevojat e shkollës fillore.

Orashë e Epërme:

- Rregullimi dhe sanimi i rrjetit të ujësjellësit;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për të gjithë fshatin;
- Ndërtimi i objektit të ri të shkollës fillore;
- Përkrahje financiare për aktivitetet kulturore, konkretisht manifestimi tradicional kulturor “Kalaja e Nicës”.

Orashë e Poshtme:

- Rregullimi dhe meremetimi i rrugës që lidh fshatin me rrugën magjistrale Jegunovcë-Radushë;
- Ndërtimi i rrugës që lidh fshatin Orashë e Poshtme me fshatin Orashë e Epërme;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit.

Kopanicë:

- Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
- Rregullimi i shtratit të lumit Vardar që kalon përgjatë fshatit;
- Ndërtimi dhe meremetimi i rrugicave.

Bogovinë

- Ndërtimi i kanalit të ujërave të zeza në vendbanimet Pirok dhe Pallçishtë e Poshtme;
- Ndërtimi i kolektorit dhe stacionit filtrues për trajtimin e ujërave të zeza në Bogovinë;
- Rikonstruimi i rrugëve në Kamjan-Çellopek, Bogovinë-Sellarcë e Epërme dhe Pirok-autostradë;
- Projekti për ujësjellës në të gjitha vendbanimet me ndërtimin e rezervuarit për furnizim me ujë për pije për të gjitha vendbanimet;
- Vendosja e ujëmatësve në Pallçishtë të Poshtme dhe Kamjan;
- Ndriçimi publik: Projekti i Bankës Botërore;
- Ndërtesat administrative në Bogovinë dhe Kamjan;
- Rikonstruimi i shkollës fillore në Urviç;
- Salla sportive në Bogovinë, Pirok dhe Pallçishtë;
- Zgjerimi i objektit shkollor në Novo Sellë;
- Rikonstruimi i sallës sportive në Zherovjan;
- Qendra për qëndrim ditor për fëmijët dhe personat e moshuar në Kamjan.

Bërvenicë

Çellopek:

- Rikonstruimi dhe zgjerimi i Urrës së Lumit Vardar në f.Çellopek.
- Salla e Sportit ne f. Çellopek.
- Ndërtimi i Rrugës Marski Dol ne f. Çellopek me gjatësi prej 1.500 metra dhe gjërësi prej 5.50 meter.

- Rikonstruimi dhe zgjerimi i Rrugës lokale prej dalje të f.Cellopek deri te Rruga Regjionale R2233 me gjatësi prej 1.400 meter dhe gjerësi prej 5.50 metër.

Miletinë:

- Rikonstruimi dhe zgjerimi i Urrës për f. Miletinë.
- Rikonstruimi i Shkollës fillore 7-Marsi.
- Asfaltimi i rruges lokale neper f. Miletinë me gjatesi prej 700 meter.
- Ndërtimi i Bazenit për Ujë te pijshëm në f. Miletinë me kapacitet prej 300 m3.

Tenovë:

- Ndërtimi i rrugës lokale prej qendre deri te fusha e sportit me gjatesi prej 1.200 meter dhe gjersi prej 5.00 meter.
- Ndërtimi i rrugës prej ne qendër te fshatit te vendi i quajtur Kastel me gjatësi prej 1.000 meter dhe gjerësi prej 5.00 meter.

Radiovcë:

- Regullimi dhe ndërtimi i shtratit të Liumit (Reka e Bogovinës) me fazat 2, 3, 4, 6 me gjatësi prej 1.500 meter dhe gjersi prej 3,00 meter me gur natzral.

Gurgurnicë:

- Ndërtimi dhe rikonstruimi i rruges lokale prej rruges regjionale R2233 deri ne f. Gurgurnicë me gjatësi prej 16.000 meter dhe gjërësi prej 4.50 meter dhe vendosje te mbrojtësve.



PROJEKTE SIPAS SEKTORËVE

Bujqësi dhe zhvillim rural

- Hidrosistemi Raven-Reçicë;
- Rikonstruimi, rehabilitimi dhe modernizimi i stacionit të pompave për ujitje në Dibër;
- Sistemi i ujitjes në fushën e Tearcës;
- Kanali për ujitje në fushën e Zajazit;
- Sistemi i ujitjes në fushën e Kolibarit dhe Cërvides;
- Sistemi i ujitjes me programin e luginës së Vardarit për fshatrat e Çashkës dhe Velesit;
- Rehabilitimi dhe modernizimi i sistemit për ujitje në Komunën e Sarajit;
- Sistemi i ujitjes për fshatrat e Dollnenit;
- Penda e Sllupçanit
- Rikonstruimi, rehabilitimi dhe modernizimi i rrjetit të sistemit të ujitjes;
- Sistemi i ujitjes në Komunën e Sarajit (Bojanë, Kopanicë);
- Pastrimi me hapjen e kanalit kullues ndërmjet vendbanimeve Zhitoshe dhe Llazhan;
- Pastrimi dhe hapja e kanaleve në pjesë të caktuara të kanalit kullues "Bllato";
- Pastrimi dhe hapja e kanalit kullues ndërmjet vendbanimeve Peshtalevë dhe Sekirci;
- Ndërtimi i akumulimit artificial në afërsi të vendbanimit Debreshtë;
- Ndërtimi i mikroakumulimit në afërsi të vendbanimit Cërnilishtë;
- Rehabilitimi i mikroakumulimit ekzistues në vendbanimin Desovë.

Kulturë dhe sport

- Palestër sportive për gara ndërkombëtare në Tetovë;
- Dy stadione të mëdha futbollit në Tetovë;
- Tërheqja e terrenit të tenisit në Tetovë;
- Staza të atletikës në Tetovë dhe në komunat përreth (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Dibër, Likovë, Kumanovë);
- Mjete të gjimnastikës në qytete të ndryshme;
- Hapja e teatrit për fëmijë në Tetovë;
- Themelimi i institucionit të ri për teatrin e fëmijëve;
- Investime kapitale në Qendrën e Kulturës në Tetovë;
- Investim kapital në Qendrën e Kulturës në Gostivar;
- Ndërtimi i objektit për Ansamblin e Këngëve;
- Themelimi i Departamentit për Folklor dhe Art Skenik;
- Hapja e Galerisë Nacionale në Kërçovë;
- Ndërtimi i Teatrit për Fëmijë dhe të Rinj në Shkup;
- Restaurimi i Çatisë së Galerisë së Tetovës dhe përmirësimi i Sistemit mekanik dhe elektrik;
- Investim në trashëgiminë muzeale;
- Hapja e katedrave arkeologjike;
- Ndërtimi i fushës së futbollit në fshatin Orizar i Epërm;
- Ndërtimi i sallës sportive në Lubin, Komuna e Sarajit;
- Ndryshimi i politikave për të siguruar përfaqësimin e drejtë në ndarjen e fondeve për përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile, me fokus në përkrahjen e organizatave rinore që punojnë në çështjet e zhvillimit të të rinjve romë;
- Fushë sportive në vendbanimin Haraçinë, tribuna jugore;
- Zhvillimi i projekteve shtetërore interaktive, përmes të cilave të gjitha komunitetet etnike do të promovojnë kulturën dhe identitetin e tyre përmes gjuhës së tyre;

- Rritja e fondit nga Ministria e Kulturës për boshnjakët me qëllim të mbajtjes dhe promovimit të kulturës autentike;
- Më shumë kujdes dhe përfshirje aktive në mbrojtjen e monumentit “Akuadukt” në Vizbeg.

Arsim dhe shkencë

- Përfundimi i të gjitha projekteve kapitale në ndërtimin e shkollave (shkolla fillore e Idrizovës, Gjumnazi “Sami Frashëri” në Kumanovë dhe shkolla në Sellcë);
- Projekti i shkollës fillorë në vendbanimin Haraçinë (Astreks);
- Sigurimi i bursave për nxënësit romë në arsimin fillor;
- Sigurimi i kapaciteteve (rritja e numrit të çerdheve të fëmijëve) për ta implementuar arsimin parashkollor obligativ;
- Ndryshimi i katedrës për gjuhën boshnjake në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup ose në Universitetin “Nëna Terezë” në Shkup;
- Sanimi dhe rikonstruksioni i Shkollës Fillore “Liria” në fshatin Zhitoshe - njësi pjesore në fshatin Llokven, Komuna e Dollnenit.

Transport dhe lidhje

- Përfundimi i Korridorit 8: Ndërtimi i autostradës sipas standardeve bashkëkohore në tre akse (pjesë): Tetovë-Gostivar, Gostivar-Kërçovë, Qafë Thanë-Strugë-Trebenishtë;
- Përfundimi i Korridorit 8: Shqipëri-Bullgari: Faza e parë: Kumanovë-Beljakocë (31 km), Faza e dytë: Beljakocë-Kriva Pallankë (36 km), Faza e tretë: Kriva Pallankë-Kufiri me Bullgarinë (24km);
- Ndërtimi i pjesës perëndimore: Shqipëri-Kërçovë (linja duhet të ndërtohet, 63 km);
- Ndërtimi i autostradës Kërçovë-Ohër: Projekti ka filluar në seksionin Kërçovë-Ohër me vlerë prej rreth 600 milionë eurove;
- Autostrada Shkup-Bllacë: Ndërtimi i autostradës me gjatësi prej 12 km në dy pjesë;
- Rruga Tetovë-Prizren: Kontrata është nënshkruar në muajin janar 2024;
- Ndërtimi i autostradës Kërçovë-Bukojçan: Fillimi i punimeve është planifikuar për muajin mars 2024, me një buxhet prej 130 milion eurove;
- “Rruga e Arbërit”: Ndërtimi i rrugës rajonale Burim-Ura e Garit me gjatësi 19 km;
- Rrugët lokale (projekte të financuara nga Banka Botërore);
- Komuna e Bogovinës: Ndërtimi i rrugës lokale f. Bogovinë-Sedllarcë;
- Rikonstruimi i rezervuarit për ujësjellës në Zagraçan;
- Komuna e Brvenicës:
 - Rindërtimi i unazës në f. Çellopek;
 - Rikonstruimi dhe rehabilitimi i rrugës në f. Radiocë;
 - Rikonstruimi i rrugës Dubravë në f. Bërvenicë.
- Komuna e Gostivarit:
 - Rikonstruimi i rrugës lokale nga f. Zdunje deri në f. Debresh;
 - Rikonstruimi i rrugës lokale nga f. Banjicë e Poshtme deri në f. Banjicë e Epërme.
- Komuna e Zhelinës:
 - Rikonstruimi i rrugës lokale në f. Kopaçin Doll;
 - Rikonstruimi i rrugës lokale Pallaticë-Ozormishtë;
 - Ndërtimi i rrugës lokale 2-A në f. Zhelinë.
- Komuna e Jegunovcës:
 - Rikonstruimi i rrugës lokale në Jegunovcë.
- Komuna e Sarajit:
 - Rikonstruimi i rrugës lokale nga f. Svillarë e Poshtme deri në f. Svillarë e Epërme;
 - Ndërtimi i rrjetit të kanalit të ujërave të zeza edhe kolektorit kryesor në Kopicë.

- Komuna e Tearcës:
 - Ndërtimi i rrugës lokale 102 në f. Sllatinë;
 - Ndërtimi i rrugës lokale në f. Tearcë.

Mjedisi jetësor

Infrastruktura ujore dhe sisteme të kanalizimeve në çdo komunë:

- Kërçovë - Rehabilitimi, zgjerimi dhe mbikëqyrja e Rrjetit të kanalizimit në Kërçovë;
- Tetovë – Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit;
- Veles - Ndërtimi i Sistemit të kolektorit dhe Rrjeti dytësor i kanalizimit në Vinicë dhe kyçja në Stacionin e pastrimit të ujërave të zeza në Koçan (gjysma e dytë e vitit 2024) – Projekt i planifikuar;
- IPA Manastir – Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Manastir (rrjeti aktual, në ndërtim).

Infrastruktura e ujësjellsëve dhe sistemit të ujërave të zeza:

- Çair - Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellsit, kanalizimit atmosferik dhe fekal në vendbanimin Sahat Kulla;
- Kumanovë – Rikonstruksioni i kanalizimit fekal në rr. Kiro Fetak;
- Strugë - Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për largimin e ujërave të zeza për fshatin Vranishtë;
- Plasnicë - Projekti bazë për ujërat e zeza fekale në vendbanimin Plasnicë;
- Dibër – Projekti bazë për ndërtimin e rrugës në vendbanimin Tiljbe Dibër, Komuna e Dibrës;
- Tetovë - Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik në Sheshin “Video Smilevski Bato” nga rruga 159 afër kazermës deri te rruga rajonale Tetovë-Jajincë në fshatin Poroj;
- Kumanovë - Rindërtimi i rrjetit të ujësjellsit në qytetin e Kumanovës rr. Boris Kidriç;
- Dibër – Rikonstruksioni i gardhit mbrojtës në burimet e Rosokit për furnizim me ujë të Dibrës;
- Gostivar – Tubacioni i furnizimit me ujë për fshatin Mitrovi Kërsti, Komuna e Gostivarit;
- Zhelinë – Ndërtimi i një pjese të rrjetit dytësor me puseta të veçanta për lidhjen e konsumatorëve në vendbanimin Trebosh;
- Haraçinë – Rregullimi i kanalit qarkor në Komunën e Haraçinës;
- Strugë – Rehabilitimi dhe përmirësimi i efikasitetit të sistemit të kolektorëve Ohër – Strugë.

Stacionet e pastrimit të ujërave të zeza në vendbanime:

- Ndërtimi i Stacionit për pastrimin e ujërave të zeza në Tetovë;
- Manastir– Ndërtimi i Stacionit të pastrimit të ujërave të zeza (ai aktual, në ndërtim);
- Shkup – Stacioni i pastrimit të ujërave të zeza;
- Projekte nga BEI-ja+BERZH-i+WBIF-ja – Shkup / Stacioni i pastrimit të ujërave të zeza.

Lëndët djegëse fosile:

- Gostivar – Mbrojtja e ajrit të ambientit – zëvendësimi i sistemeve të ngrohjes që shfrytëzojnë lëndë djegëse fosile si energji në institucionet dhe objektet administrative dhe arsimore në kompetencat e Komunës së Gostivarit, të cilat përdorin dru zjarri ose vaj për ngrohje.

Ajër të pastër në bashkëpunim me BE-në:

- Ndërtimi i sistemeve për nxemje nëpër objektet publike në Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë;

- Modernizimi i sistemit të transportit publik në Shkup nëpërmjet furnizimit me autobusë të sistemit CNG;
- Gjelbërimi në hapësirat urbane në qytetet e Shkupit, Manastirit, Kumanovës dhe Tetovës;
- Hartimi i studimit të fizibilitetit për zgjerimin e Rrjetit të sistemit të energjisë për ngrohje në Shkup dhe realizimi i fushatës për ngritjen e vetëdijes publike nga përfitimi i reduktimit të ndotjes së ajrit;
- Vendosja e stacioneve mobile për ndjekjen e cilësisë së ajrit në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë;
- Përmirësimi i sistemeve të ngrohjes në objektet publike në Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë;
- Gjelbërimi urban në Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë;
- Instalimi i stacioneve mobile për monitorimin e cilësisë së ajrit në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë;
- Përmirësimi i sistemeve të ngrohjes në objektet publike në Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë;
- Gjelbërimi urban në Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë;
- Vendosja e stacioneve mobile për monitorimin e cilësisë së ajrit në Shkup, Kumanovë dhe Tetovë.

Projekte të tjera të financuara nga ministria e mjedisit jetësor dhe plinifikimit hapësinor:

- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, zëvendësimi dhe instalimi i ujëmatësve të rinj në Komunën e Bogovinës (Pallçishtë e Poshtme);
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit, Gostivar;
- Rregullimi i shtratit të kanalit në Haraçinë;
- Furnizimi me ujë për fshatrat Nikushtak dhe Vishticë;
- Stacioni filtrues dhe sistemi i ujësjellësit në Përshovcë dhe Gllogj;
- Ndërtimi i rezervuarit për ujë të pijshëm në Saraj dhe rregullimi i shtratit të lumit “Suva Reka”;
- Ndërtimi i sistemit të kolektorëve Radozhdë – Kalishtë;
- Ndërtimi i sistemit të kanalizimit dhe kolektorëve në disa vendbanime në Vrapçishtë;
- Rikonstruimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Poroj.

#EUROPA2030

#FRONTIEUROPIAN

EUROPA 2030

PROGRAMI ZGJEDHOR 2024 - 2028



**FRONTI
EUROPIAN**



ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2024